

LIGJ
Nr. 9272, datë 16.9.2004

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN EUROPIANE
“PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME
(ADR)” DHE PROTOKOLLIN E NËNSHKRIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe Protokollin e Nënshkrimit”, Gjenevë, më 30 shtator 1957.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4334, datë 29.9.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA EUROPIANE
NË LIDHJE ME TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME ME
RRUGË (ADR) DHE PROTOKOLLI NËNSHKRIMIT

Bërë në Gjenevë më 30 Shtator 1957

VOLUMI 1

(Marrëveshja, Protokollin nënshkrimin, Aneksi A dhe Shtojcat në Aneksin A, me amendamentet
deri më 1 Janar 1999)

Shpërndarë në Mbretërinë e Bashkuar nga Zyra Stacionare Ltd.

KOMBET E BASHKUARA
NJU JORK dhe Gjenevë, 1998

SHËNIM

Përcaktimi dhe paraqitja e materialit në këtë publikim nuk përfshin shprehjen e ndonjë opinionin sidomos në pjesën e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin legal të ndonjë vendi, territori, qyteti ose zone, ose të autoriteteve të tij ose në lidhje me kufizimin e kufijve të tij

ECE/TRANS/130 (Vol I)

Hyrje

Teksti i mëposhtëm përfshin:
Në Volumin I:

- Hyrjen në Marrëveshjen Europiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me rrugë;
 - Vetë Marrëveshjen dhe Protokollin e nënshkrimin
 - Aneksin A të ADR
- Në Volumin II:
- Aneksin B të ADR
 - Supplementin No. 1 (Listën alfabetike të substancave dhe të neneve të ADR)
 - Supplementin No. 2 (Listën numerike në identifikimin e substancave (KB) numrin rendor të substancave dhe neneve të ADR);
 - Supplementin No. 3 (Listën e autoriteteve kompetente);
 - Supplementin No. 4 (Riprodhimin e ngjyrave të kufirit 250 001;
 - Supplementin No. 5 (Riprodhimin e ngjyrave të kufirit 270 000;

Hyrja nuk formon pjesë përbërëse të ADR. Ajo është përgatitur nga Sekretariati pas miratimit nga Grupi Punës mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme të Komitetit të Transportit të Brendshëm në sesionin e nëntëdhjetë e pestë mbi bazën e propozimit nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (TRANS/ËP.15/142, PAR.108)

Vetë Marrëveshja e bërë në Gjenevë më 30 Shtator 1957 dhe që ka hyrë në fuqi më 29 Janar 1968, është riprodhuar si një amendament nga neni amendues i Protokollit 14(3) konkluduar në Nju Jork më 21 Gusht 1975 (Njoftimi i Depozituesit C.N. 229 1975. TREATIES-8 të 18 Shtatorit 1975), i cili ka hyrë në fuqi më 19 Prill 1985 (Njoftimi i Depozituesit C.N. 65 1985. TREATIES-1 të 4 Prillit 1985),

Anekset A dhe B në mënyrë të rregullt janë amenduar deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Teksti i mëposhtëm ka marrë në llogari të gjitha amendamentet, të cilët janë pranuar në përputhje me

proçedurën e Nenit 14 të ADR, si dhe të atyre të adoptuara nga Gupi Punës mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme në sesionet e tij 63 dhe 64 të (TRANS/ËP.15/151 dhe (TRANS/ËP.15/153, Aneksi 2), të cilat janë propozuar nga Qeveria e Portugalisë për të hyrë në fuqi në Janar 1999 (Njoftimi i Depozituesit C.N. 310 1998. TREATIES-1 të 1 Korrikut 1998),

Lista suplementare Numrat 1 dhe 2 nuk formojnë pjesë përbërëse të ADR. Ato janë përgatitur nga Sekretariati me qëllim për të lehtësuar konsultimin e këtij publikimi, por informacioni i përmbajtur në këto lista është dorëzuar ose tek Grupi i Punës mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme për kontroll dhe miratim ose tek Palët Kontraktuese të ADR për pranim formal. Sidoqoftë këto lista nuk kanë ndonjë status legal dhe në rast të ndonjë konflikti me parashikimet e Aneksit A ose B, teksti i Aneksëve A ose B gjykohet të jetë ai autoritar

Suplementi No. 3 përmban një listë të autoriteteve kompetente për aplikimin e ADR hollësitë e të cilave janë komunikuar tek Sekretariati nga Qeveritë e Palëve Kontraktuese dhe të cilat duhet të konsultohen në se është e nevojshme, veçanërisht në se Aneksët A dhe B kanë reference nga autoritetet kompetente ose në rast të transportit të prekur nga Marrëveshjet e veçanta si është parashikuar në anësoret 2010 dhe 10 602. Kjo listë është përmirësuar me 14 Korrik 1998.

HYRJE NË MARRËVESHJEN EUROPIANE NË LIDHJE ME TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME ME RRUGË (ADR)

Përdorimi i kësaj hyrje

Kjo hyrje është vetëm një përmbledhje e rregullave të ADR, për të dhënë një udhëzim të përgjithshëm. Ajo nuk është pjesë e Marrëveshjes dhe nuk është për të zëvendësuar aplikimin e rregullave të detajuara të Marrëveshjes.

TË PËRGJITHËSHME

ADR është një Marrëveshje e hartuar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën në Gjenevë, në të cilën shumë shtete në Europë kanë pranuar rregulla të përbashkëta për lëvizjen e mallrave të rrezikshme me rrugë nëpërmjet kufijve dhe territoreve të tyre, Emri i shkurtuar : ADR: vijnë nga fjalët kyç në titullin e frëngjishtes.

Në kohën e shkrimit Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje janë Austria, Bjelarusia, Belgjika, Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Latvia, Lihtështëjn, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mbretëria e Bashkuar, Jugosllavia.

Marrëveshja vetë është e shkurtër dhe e thjeshtë. Neni kyç është i dyti, i cili është efektiv në se, përveç disa nga mallrat shumë të rrezikshme, mallrat e tjera të rrezikshme mund të lëvizin në mënyrë ndërkombëtare me anë të mjetete rrugore duke siguruar se:

- paketimi dhe etiketat janë në përputhje me Aneksin A të Marrëveshjes;
- konstruksioni mjetit, paisja dhe operimet janë në përputhje me Aneksin B.

Aneksët A dhe B përmbajnë rregulla të hollësishme se çfarë duhet të bëhet.

Në Aneksin A janë listat e mallrave të rrezikshme të cilat mund të transportohen në mënyrë ndërkombëtare. Aty gjithashtu jepen rregulla mbi paketimin dhe etiketimin, si dhe përshkrimin e mallrave të rrezikshme në dokumenta. Të gjitha këto rregulla duhet të aplikohen nga dorëzuesi i mallrave.

Aneksi B jep rregullat për mjetet dhe operimet e transportit, për të cialt transportuesi është përgjegjës.

ADR u zhvillua pas luftës së dytë botërore nga marrëveshjet e hekurudhave europiane për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme, e cila daton më përpara me 1890. Marrëveshja fillimisht u nënshkrua me 1975, por rregullat më të hollësishme d.m.th. Aneksët A dhe B nuk u publikuan deri dymbëdhjetë vjet më vonë më 1969 pasi Marrëveshja hyri në fuqi (29 Janar 1968) dhe vetë anekset u amenduan dhe u përmirësuan (29 Korrik 1968). Ajo është rishikuar në mënyrë të rregullt, me botimet aktuale efektive nga Janari 1999.

ADR është një Marrëveshje midis Shteteve dhe nuk ka ndonjë autoritet të përgjithshëm detyrues. Në praktikë rrugët (autostradat) janë kontrolluar nga shtetet Kontraktuese, dhe mos-përputhjet që mund të rezultojnë në aksione nga autoritetet kombëtare kundër drejtuesit të mjetit në

përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. ADR vetë nuk përshkruan ndonjë dënim. Në interes të uniformitetit dhe tregëtisë së lirë nëpërmjet Bashkimit Europian, Aneksat A dhe B të ADR nuk janë adoptuar nga të gjithë Shtetet Anëtare të BE si bazë për rregullat e tyre të brendshme. Ato gjithashtu janë adoptuar në mënyrë të ngjashme nga një numër Shtetesh Kontraktuese të ADR, dhe numri i tyre është duke u rritur vazhdimisht. Në këtë botim të ADR, është përdorur një sistem numrimi në Aneksa për të identifikuar një ose më shumë paragrafë në lidhje me një subjekt të veçantë. Numrat janë shtypur në kufijtë e faqeve dhe pjesët përkatëse të tekstit janë referuar si: anësore”. Anësoret janë numëruar në bllok me hapsira ndërmjet tyre, për të lejuar tekstin shtesë dhe numrat për tu futur pa patur ndryshime në të gjithë sekuencën. Ato gjithashtu janë ndarë për arsye që seksione të ndryshme në Aneksa që kanë të bëjnë me të njëjtin subjekt të kenë numra anësore të njohur të njëte. Ky sistem është, sidoqoftë, do të zhduket në botimet e ardhshme në se propozimet aktuale për një paraqitje ristrukturuese të Aneksave teknike do të miratohen së fundmi dhe do të zbatohen.

PARATHENIE ANEKSI A – PJESA I

Sistemi i klasifikimit të mallrave të rrezikshme sipas ADR ndjek sa më afër Rekomandimet mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme, të hartuar nga Komiteti i Eksperteve të Këshillit Social dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme, të botuar në një dokument të njohur popullor si “Libri i Portokalltë” (nga ngjyra e kapakut të tij). Ky sistem është hartuar për t’u aplikuar në të gjithë botën, në të gjitha mënyrat e transportit, shënon mallrat në nënet klase të ndryshme në përputhje me tipin kryesor të rrezikshmërisë që ato mund të paraqesin në transportim p.sh. eksplozion, toksikim, etj.

Rregulla të tjera në Pjesën mbulojnë nevojat për dokumentin e transportit dhe deklaratën që shoqëron dorëzimin, pakon e përzier dhe metodat për klasifikimin e solucioneve dhe përzierjeve, përfshi humbjet.

Lëvizja e mallrave të rrezikshme në disa raste të veçanta janë të përjashtuara nga të gjitha rregullat p.sh. kur mallrat transportohen:

- nga individë privat për përdorim vetiak
- brenda makinerive në funksione të operimit të tyre
- në sasi të kufizuara nga ndonjë ndërmarrje në ndihmë të aktiviteteve të tyre kryesore p. sh. Shpërndarje nga një firmë konstruksioni për ndërtimin e një vendi të caktuar
- në shërbime emergjente ose në rimontin e mjetit

Nëse pjesë të udhëtimit të ADR janë kërkuar sipas rregullave të tjera ndërkombëtare p.sh. Kodi Ndërkombëtar i mallrave të Rrezikshme Detare për transportin në det, këto rregulla në mënyrë shtesë aplikohen dhe zëvendësojnë rregullat e ADR ekuivalente për atë pjesë të udhëtimit.

Kjo veçanërisht në lidhje me operimet shumë-mënyrësh midis shteteve me ngarkim në porte në Europën Veri-Perëndimore dhe Skandinave (shiko anësoren 2006)

Në se pjesë të udhëtimit të ADR paraprijnë dhe ndjekin ngarkesën me det ose me ajër, mallrat duhet të pranohen për transport sipas ADR edhe në se paketimi ose IBC janë etiketuar në përputhje me mënyrën e detit ose të ajrit dhe jo me ADR-, por të jenë subjekt i rregullave përklasifikimin dhe dokumentacionin e kërkuar nga ADR, përfshi një deklaratë speciale:

“Transport sipas Anësore 2007 të ADR”. Kjo veçanërisht në lidhje me dërgesat nga jashtë Europës të cilat transportohen sipas rregullave të ADR.

ANEKSI A – PJESA II

Kjo konsiston për kapitujt e secilit Klas duke filluar nga 1 deri në 9. Përveç Klasës 7, i cili ka një format të veçantë, kapitujt e tjerë në seksionet e tjerë janë të një mënyre të njëjtë p.sh.

Një listë e mallrave në Klasa. Këto janë përshkruar nga numri i identifikimit të substancave të KB, e ndjekur nga emri, p.sh. acid sulfurik ose nga një term i përgjithshëm p.sh. Likuid i djegshëm, toksik që përfaqësojnë shkallën e rrezikshmërisë. Gërmat përfaqësojnë një shkurtime për fjalën “ nuk është specifikuar ndryshe”, që ka kuptim që një material i veçantë nuk është emërtuar në mënyrë individuale dhe i identifikuar nën një numër “substancë e vetme”.

Mallrat e njëta janë grupuar nën numrat “titull” i ADR, të shkruajtura si 1°, 2°, 3° dhe kështu me rradhë. Në më të shumtën e klasave, numrat titull kanë nëngrupe (a), (b), dhe (c) për të shënuar graden e lartë, të mesme dhe të ulët të rrezikshmërisë. Këto korrespondojnë me Grupën I, II dhe III të Paketimit të KB. Njëlloj si “anësoret” numrat titull dhe gërmat e nëngrupeve mesa duket do të zhduken nga botimet e ardhshme.

Kufijtë e peshës neto për disa tituj, në varësi të rrezikshmërisë, poshtë të cilave mallrat e rrezikshme janë përjashtuar nga ADR, subjekt i shënimit të numrave të KB dhe parashikimeve të kufizuara të paketimit.

Rregulla të përgjithshme për paketim të substancave të vetme dhe për paketim të përzier, dhe për shënim dhe etiketim të paketimeve.

Rregulla për përshkrimin e mallrave në dokumentin e transportit si dhe për bërjen e një deklarimi të konformitetit.

Rregulla për shënimin dhe etiketimin e paketimeve bosh dhe rezervuareve të cilët janë potencialisht akoma të rrezikshëm.

Në disa klasa, rregulla të tjerë të veçanta.

Mallrat e mbetura trajtohen si mallra të tjerë të rrezikshëm sipas ADR-së dhe klasifikohen në përputhje me ingredientët e rrezikshëm. Duhet shënuar se në shtesë të kërkesave të ADR, legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar për ambientin mund të këtë nevojë për përshkrime të veçanta për mallrat e mbetura që janë të rrezikshme dhe për dokumenta shtesë që autorizojnë transferimin dhe tregojnë origjinën e materialeve dhe pikën e disponimit.

Një rregull në klasën 3 kapitulli (lëngjet e djegshme) lejon mjetet të transportojnë karburant rezervë, në rezervuarë ndihmës ose fuçi jashtë rregullave. Për përjashtim për tu aplikuar, kapaciteti total i rezervuarit të karburantit në një mjet (rezervuar pune normal dhe rezervuar ndihmës të kombinuar) nuk duhet ti tejkalojnë 1, 500 litra një limit për rezervuaret ndihmës në trailerët. Jo më shumë se një total prej 60 litra në fuçi karburanti mund të transportohet në rezervuaret e karburantit rezervë.

ANEKSI A – PJESA III

Kjo përmban një numër të Shtojcave, nga të cilat më të rëndësishmet për operate të përgjithëshme janë:

A.5 për paketim

A.6 për kontenier ndërmjetës

A.9 për etiketim

Shtojcat A.5 dhe A.6 janë bazuar në Rekomandimet e KB, përfshi specifikimet e përgjithëshme për tipe të ndryshme paketimi dhe metoda për kryerjen e testeve.

ANEKSI B – PJESA I

Kjo përmban një seksion të përgjithshëm dhe gjashtë të tjerë, Seksioni i përgjithshëm përfshin një tabelë të peshës bruto të dërgesës poshtë së cilës shumë rregulla për mjetet dhe operate të transportit në Aneks nuk alokohen. Këto kufizime janë krejt të ndara nga ato në kapitujt e Klasës të Aneksit A, e cila referon për sasi të vogla të mallrave të cilat zakonisht janë të përjashtuara nga ADR.

Seksioni 1 të referon tek format e lejueshme të transportit p.sh. forma të mëdha, rezervuar, kontenier-rezervuar si dhe mallrat që mund të mbarten në to.

Seksioni 2 të referon tek tipet e mjeteve, tiparet e përgjithëshme të projektit, paisjet miratimin e mjeteve dhe lëshimin e certifikatës

Seksioni 3 përmban rregulla të përgjithshme operimi, trainimin e drejtuesve të mjeteve, mbikqyrjen e mjetit, dokumentet dhe instruksionet e emergjencës

Seksioni 4 mbulon ngarkimet, stivimin dhe shkarkimin

Seksioni 5 mbulon shenjën e mjetit, mënyrat e parkimit, veprimet që duhet të ndërmerren në një emergjence.

Seksioni 6 përshkruan se si Shtetet Kontraktuese mund të pranojnë lëvizje testimi midis tyre për të zhvilluar dhe zgjeruar Marrëveshjen.

ANEKSI B – PJESA II

Kjo përbëhet nga kapitujt për secilin Klas, duke dhënë rregulla shtesë, që bëhen të nevojshme nga natyra e Klasës. Kapitujt janë shtrirë në Seksione nën të njëjtin titull si në Pjesën I.

Normalisht kur një rregull i Klasës të Pjesës II ekziston në një subjekt të veçantë, ajo tejkalon dhe zëvendëson rregullin e përgjithshëm ekuivalent në Seksionin korrespondues të Pjesës I.

SHTOJCA TE ANEKSI B

Këto shtojca janë kryesisht teknike, si më poshtë:

B.1 a-e Projekt, konstruksion dhe tipare të tjera të rezervuarit dhe të kontenierit rezervuar

B.2 Tiparet e konstruksionit të mjetit në lidhje me paisjet eklektrike, frenat, rrezikun e zjarrit dhe kufizim të shpejtësisë

B.3 Modeli i certifikatës së miratuar të mjetit

B.4 Kërkesat e trainimit të drejtuesit të mjetit

B.5 Lista e substancave të cilat mund të transportohen në rezervuar ose në sasi të mëdha me numrat e identifikimit të substancave të KB që të tregohen tek targa e veçantë e mjetit

B.6 Modeli i certifikatës së trainimit të drejtuesit të mjetit

B.7 Shenja që përfaqëson ekzistencën e substancës me temperaturë të lartë

Shtojca B.5 liston substancat sipas një rregulli alfabetik dhe tregon Klasin dhe numrat e titullit dhe të referon tek etikëta përkatëse e rrezikshmërisë. Ajo nuk është një indeks i plotë për mallrat sipas ADR, dhe sipas përkufizimit ajo nuk përfshin ato mallra të cilat mbarten në paketime dhe jo në rezervuar p.sh. sendet. Listat jo-zyrtare që janë suplementare për tekstin janë më shumë të përshtatëshme për qëllime referimi.

RREGULLAT MË TË RËNDËSISHME PËR TË PUNUAR SIPAS ADR

Sa për të kujtuar se, rregullat në Aneksin A kanë të bëjnë me identifikimin e mallrave, paketimin, etiketimin dhe dokumentat e transportit. Ato duhet të jenë në vëmendjen e dorëzuesit të mallrave.

Aneksi B ka të bëjë me përgjegjësitë e transportuesit, për të furnizuar dhe paisur automjetin, dhe për të siguruar punën e drejtuesit të mjetit që udhëtimi të kryhet në mënyrë të përshtatëshme.

Rregullat më të rëndësishme të cilat aplikohen në udhëtimet e ADR janë përmbledhur më poshtë. Referencat janë dhënë në kllapa tek anësoret nga të cialt janë nxjerrë përmbledhjet. Kur lëvizet me një ngarkesë të rrezikshme duhet të studiohet teksti i plotë i ADR për tu siguruar se të gjitha hollësitë përkatëse janë shënuar, veçanërisht ato në kapitujt e Klases të Pjesës II të Aneksit dhe shtojcës B.1.

1. DOKUMENTET QË DUHET TË MBAHEN NË MJET (10 381)

1.1. Dokumenti transportit dhe deklarata (2002)

Të gjitha dorëzimet ADR duhet të shoqërohen me dokumenta të transportit. Nuk ka ndonjë format të veçantë për këtë, por ajo duhet të përfshijë hollësi specifike si më poshtë. Dorëzuesi duhet ti japë transportuesit informacionin e nevojshëm me shkrim para udhëtimit për ti lënë kohë atij të përgatitet. Në se dërgesa transportohet në më shumë se një mjet duhet të këtë dokumente të veçanta për secilin mjet.

Përshkrimet duhet të bëhen në formën ekzakte të dhënë në kapitujt e Klasës. Emri duhet të jetë njëri në listën e Klasës, përfshi numrin e identifikimit të substancave të KB, i ndjekur nga numri i Klasës, numri i titullit, gërma në se ka dhe inicialet ADR p.sh.

1402 karbit kalciumi, 4,3 17° (b)1, ADR

Në se në një paketim përmbahet më shumë se një substancë, duhet të bëhen përshkrimet e veçanta për secilin. Përshkrimet duhet të ndiqen nga përshkrime të tjera të hollësishme të dërgesës, d.m.th. numrin dhe përshkrimin e paketimeve ose IBC, masën bruto në kilogram (dhe masën neto për eksplozivet), emrin dhe adresën e dërguesit dhe të marrësit ose të marrësve të veçantë.

Dokumenti duhet të jetë në një gjuhë zyrtare të vendit që do ta dërgosh, dhe në se nuk është anglishtja, frengjishtja ose gjermanishtja duhet të bëhet në një nga këto gjuhë.

Në se dërgesa është më poshtë së kufiri më i ulët i peshës së dhënë në Aneksin B (10 011) dhe atëherë është e përjashtuar nga shumë rregulla të Aneksit B, kjo duhet të citohet në dokumentin e transportit (10 012)

Në se mallrat transportohen me anë të një marrëveshje midis shteteve, e lejuar nën anësoret 2010 dhe 10 602 një kopje e tekstit kryesor të marrëveshjes duhet ti bashkangjitet dokumentit të transportit (10 381)

Dërgesat duhet të përjashtohen nga disa rregulla të paketimeve dhe etiketimeve të ADR kur ato lëvizin me det, me ajër dhe konform me këto rregulla. Kjo duhet të citohet në dokumentet e transportit (2007)

Dorëzuesi gjithashtu duhet të deklarojë në se në dokumentin e transportit ose në mënyrë të veçantë që mallrat janë të lejuara të transportohen sipas ADR dhe se të gjitha rregullat e aplikueshme në kapitullin e Klasës të Aneksit A janë plotësuar.

1.2. Çertifikata e paketimit të kontenierit (2008)

Në se një kontenier është në rrugë në një port për të filluar një udhëtim në det, çertifikata e nënshkruar nga personi përgjegjës i paketimit duhet të përfshihet për të treguar se mallrat janë në një gjendje të përshtatëshme dhe të sistemuara mirë brënda etj. në përputhje me seksionin 12 të Hyrjes së Përgjithshme (Volumi I) i Kodit Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme Detare.

1.3. Instruksione për drejtuesin e mjetit (19 385)

Drejtuesit të mjetit duhet ti jepen instruksione me shkrim ku të theksohet për çdo substancë ose artikull që transportohet :

-Emrin e substancës ose të artikullit ose grup mallrash, Klasin dhe numrin e KB ose për një grup mallrash numrin e KB për të cilët aplikohen instruksionet

-Natyrën e rrezikshmërisë që paraqesin mallrat së bashku me masat që duhet të aplikohen dhe të nevojës për mbrojtjen e personelit shoqërues dhe drejtues të mjetit.

-masat e menjëhershme që duhet të ndërmerren nga drejtuesi i mjetit dhe shoqëruesit në rast të një aksidenti

Një seri rregullash duhet të mbahen në kabinën e mjetit në gjuhën që drejtuesi i mjetit mund ta kuptojë dhe në të gjitha gjuhët e vendeve të origjinës, tranzitit dhe të destinacionit.

1.4. Miratimi certifikatës për disa mjete (10 281 dhe 10 282)

Disa mjete si janë dhe në listën anësore 10 282 (1) duhet të miratohen. Ky miratim duhet të jepër mbi bazën e një tipi miratimi të fituar nga prodhuesi për automjetin “bazë” d.m.th. para ngarkimit të kompartimentit ose të rezervuarit të jetë shtuar, në fazën e para-prodhimit me anë të dorëzimit të hollësive të projektit tek autoritetet kombëtare.

Çertifikata e miratimit vjetor, e lëshuar nga autoritetet kombëtare kërkohet për të gjithë mjetet, për të vertetuar së mjeti është konform me rregullat e ADR dhe në kushte të përshtatëshme për të udhëtuar në rrugë. Kopjet duhet të mbahen në mjet.

Çertifikata duhet të ketë formën e dhënë në Shtojcën B.3 dhe duhet të mbulojë së bashku tërheqësin dhe trajlerin.

1.5. Çertifikata e trainimit të drejtuesit të mjetit (10 315)

Çertifikata e ADR e lëshuar nga autoritetet kompetente në secilin shtet për drejtuesin e mjetit të mallrave të rrezikshme me peshë maksimale mbi 3.5 ton, në sasi mbi ato të specifikuara në tabelë në fillim të Aneksit B (10 011). Formati i certifikatës është dhënë në Shtojcën B.6.

Drejtuesi i mjetit duhet të kalojë një kurs të miratuar nga autoriteti në secilin shtet dhe të kalojë një provim me shkrim. Çertifikata është e vlefshme për pesë vjet, pas kësaj periudhe ajo duhet të rinovohet pasi të këtë kaluar një kurs rifreskimi

Hollësi mbi kërkesat e trajnimit fillestar dhe rifreskues në termat e orëve të mësimin për secilin seksion, ushtrime praktike, provime me shkrim etj. janë dhënë në Shtojcën A.4.

1.6 Autorizimi lejes dhe kryerjes së transportit (10 381)

Kjo mund të imponohet nga disa shtete. Këshillime mund të përfitohen nga autoritetet kombëtare përkatëse.

2. PAKETIMI

Rregullat për paketim të mallrave të ndryshme janë dhënë në kapitujt e Klasës të Aneksit A. Paketimi i miratuar nga KB duhet të përdoret si është përshtatur në Shtojcën A.5 por ka disa rregulla të veçanta për disa mallra të veçanta të rrezikshme në kapitullin e vetë Klsës.

Rregullat për IBC gjithashtu dihet të miratohen nga KB janë dhënë në Shtojcën A.6.

Këto rregulla janë për secilin Klasë mbi paketimet e përziera d.m.th. kur dy ose më shumë mallra në paketime të brendëshme të veçanta kanë reaksion midis mallrave në se paketime të brendshëm prishet. Për disa mallra të rrezikshme, kur cilësia për transport është e kufizuar jo më shumë se vlera e kufirit përkatës të dhënë në anësoret xxxla të secilës Klasë dhe mallrat janë pakeluar në paketime të kombinuara si janë përcaktuar në këto anësore atëherë këto mallra janë të përjashtuara nga miratimi sipas skemës së KB.

3. SHËNIMI

Rregullat për shënim të paketimit janë dhënë në kapitujt e Klasës të Aneksit A.

Në përgjithësi kërkohet shënim i numrit të KB, e paraprirë nga gërmat “UN” (“KB”) në të gjitha paketimet e mallrave të rrezikshme përfshi ato paketime në përputhje me anësoret 2xxla.

4. ETIKETIMET

Kapitujt e Klasës specifikojnë etiketimet të cilat duhet të bashkangjiten tek paketimet. Format e etiketës është përshkruar në Shtojcën A.9 dhe normalisht janë në format 100 mm me 100 mm. Etiketat e mëdha të njohura si postera kërkohen për rezervuarët (shiko 5). Ato janë 250 mm me 250 mm.

Për disa mallra, paketime duhet të tregojë bashkë me etiketën e Klasës kryesor dhe një ose më shumë etiketa sekondare të rrezikut p.sh. të djegëshme dhe toksike. Një etiketë për përpunim të sigurt është përshkruar d.m.th : “Të mbahet në drejtimin lart”

Paketimet në konformitet me anësoret 2xxla nuk kërkohen të vendosen etiketa.

Është detyra e dorëzuesit për të dhënë dhe bashkangjitur etiketat tek paketimet, Konteinerët dhe rezervuarët.

5. TRANSPORTI NË SASI TË MËDHA DHE NË REZERVUAR

Mallrat mund të transportohen vetëm në sasi të mëdha në se kjo është autorizuar në kapitujt e Klasës të Aneksit B sipas anësoreve XX 111 .

Mallrat mund të transportohen me mjete-rezervuar dhe konteiner-rezervuar në se janë autorizuar në kapitujt e Klasës në Pjesën II respektivisht të Shtojcave B.1 dhe B.2 . Rrezja e mallrave të autorizuara është e njëjte në secilën shtojcë B.1 dhe e njëjte si në Shtojcën B.5.

6. SHËNIMI I MJETEVE (10 500)

Targat portokalli

Mjetet duhet të paisen me targa portokalli reflektuese, me një bazë prej 400 mm dhe lartësi 300 mm përpara dhe në fund përderisa nuk është e përjashtuar sipas (10 011)

Mjetet rezervuar, mjetet transportues konteiner-rezervuar dhe3 mjetet ose Konteinerët që transportojnë mallrat e rrezikshme në sasi të mëdha gjithashtu duhet të paisen me targa portokalli në secilën anë të rezervuarit, kompartmentit të rezervuarit ose të konteinerit. Kjo tregon disa shqetësime dhe numrat e KB nga Shtojca B.5. Kur këto mjete transportojnë një substancë të vetme, numri i KB mund të tregohet në targën portokalli në pjesën e përparme dhe të fundit të mjetit.

Në rast të rezervuareve me shumë-kompartimente me disa kombinime të KB 1202 (diesel), gasolinee 1203 KB dhe (vajguri) 1223 KB, targa individuale në secilën anë të kompartmenteve nuk kërkohen, dhe numri KB i materialeve me një pikë fleshë të ulët mund të tregohet tek targat portokalli në pjesën e përparme dhe të mbrapme.

Konteinerët-rezervuar ose konteinerët me sasi të mëdha duhet të kenë numrin e KB në konteiner, dhe të jenë të shikueshëm gjatë shkarkimit nga mjete.

Numrat mbi targat portokalli duhet të mbeten të lexueshme pas pesëmbëdhjetë minutash në rast zjarri. Në një konteiner ato mund të zëvendësohen nga pllaka zjarrduruese, e lyer rose me një proces ekuivalent që ti rezistojë kohës dhe të këtë një jetëgjatësi të madhe. Në këtë rast nuk aplikohen rregullat e rezistencës ndaj zjarrit.

Numri identifikimit të shqetësimeve është bërë nga një sekuenca e numrave të Klasës, disa herë e njohur si Kodi Kemler, për të dhënë një paralajmërim në rast se substanca në mënyrë aksidentale lirohet. Shifra 0 pas numrit të Klasës tregon një rrezik të vogël p.sh 60, nënkupton një substancë toksike. Numri dyfishohet për të treguar një rritje të rrezikut p.sh 66 është një toksikim shumë i lartë. Numrat shtohen për të treguar një rrezik sekondar p.sh. 46 nënkupton një material solid të djegshëm i cili është gjithashtu toksik, 886 është shumë gërryes dhe toksik.

Gërma X në pjesën ballore nënkupton “të mos aplikohet uji” p.sh. X423 paralajmëron për një material solid i cili hyn në reaksion me ujën dhe mund të prodhojë një gaz të djegshëm.

Posterat

Përveç targave portokalli, mjetet-rezervuar, mjetet që transportojnë kontenierë-rezervuar dhe mjete ose kontenierë që transportojnë mallrat e rrezikshme në sasi të mëdha duhet të tregohen në poster a te Klasës në përputhje me rregullat në kapitujt e KISSIT TË Aneksit B (XX500). Rezervuarët dhe mjetet duhet të paisen me postera në secilën anë dhe mbrapa ndërsa Kontenierët vetëm në anë

Targat dhe posterat duhet të mbeten në vend përderisa njësitë të jenë boshatisur dhe të pastruar duke i bërë të sigurta dhe pastaj mund të hiqen ose të mbulohen.

Kontenierët e ngarkuar me pako duhet të tregojnë posterat në secilën anë, në mënyrë korresponduese me etiketimet e Klasës të paketimeve brenda tyre.

7. MIRATIMI I REZERVUARËVE (SHTOJCA B.1)

Përveç miratimit të mjetit të përmendur në 1.4 më sipër, mbulesa e rezervuarit që transporton substanca të rrezikshme duhet të miratohet nga autoritetet kombëtare. Së pari projektohet një rezervuar prototip dhe ndërtohet ai, që duhet të inspektohet dhe testohet.

Pas kësaj duhet të lëshohet çertifikata përkatëse për të vertetuar përshtatshmërinë dhe konformitetin me të gjitha rregullat e ADR.

Miratimi i tipit është i vlefshëm për rezervuarët e tjerë në seri përderisa ata janë në konformitet me prototipin, por secili rezervuar duhet të inspektohet në mënyrë individuale, kontrolluar dhe testuar para se ai të hyjë në shërbim. Gjatë kohës së shërbimit ai duhet të inspektohet dhe të ritestohet në intervale kohe. Hollësitë e miratimit, testimit etj. duhet të tregohen në një tabelë mbi rezervuar dhe për mjetet-rezervuar, hollësitë e transportimit dhe peshës etj. në vetë mjetin.

Çertifikatat e rezervuarit nuk duhet të mbahen në mjet, por duhet të jenë të vlefshme për procedurat e miratimit të mjetit.

8. PAISJET ELEKTRIKE (10 251)

Mjetet-rezervuar dhe mjetet speciale duhet të kenë paisje elektrike në konformitet me disa ose të gjitha rregullat në Shtojcën B.2.

9. VEÇORI TË TJERA TË MJETIT (10 220, 10 221 dhe 10 261)

Mjetet-rezervuar të jenë paisur me amortizues të mbrapëm si është specifikuar në rregullat për motorrat, lodhjet dhe sistemin e karburantit të mjeteve kur transportohen lëngje të djegshme në rezervuar. Mjetet-rezervuar të reja, mjetet që kanë kontenier-rezervuar dhe mjetet e eksploziveve (special) EX/III duhet të jenë të përshtatshëm me paisje anti mbyllje të frenave dhe sistemin e frenimit. Të gjithë mjetet të jenë në këtë mënyrë të përshtatshëm deri fund të 1999. Mjetet me një peshe maksimum prej 12 tonësh, së pari të rregjistruar pas 1 janarit 1988, duhet të kenë një kufizim shpejtësie prej 85 km/orë.

10. FIKËSIT E ZJARRIT (10 240 dhe 10 340)

Mjetet duhet të jenë paisur me fiksa zjarri, të paktën një për mjet (minimumi 2 kg pluhur i thatë ose një ekuivalente me të) dhe një për ngarkesë (minimumi prej 6 kg) dhe ekuipazhi duhet të dijë si ti përdorë ato. Fikësi për ngarkesën duhet të jetë një standart i njohur duke patur një vulë për të treguar se ajo nuk është e hapur dhe një tregues të datës së inspektimit të fundit.

Mjetet poshtë peshës maksimum prej 3.5 tonësh mund të kenë 2 kg pluhur të thatë fikës.

11. PAISJA E MJETIT (10 260)

Mjetet duhet të jenë të paisur me bllokues të rrotave, shenjat e paralajmërimit, veshjen paralajmëruese dhe një llampë dore. Paisjet për veprime shtesë dhe speciale nga drejtuesi i mjetit duhet të specifikohen në instruksionet me shkrim në përputhje me anësoren 10 385.

12. SUPERVIZIONI (10 321)

Mjetet duhet të supervizionohen në vazhdimësi, ose të parkohen sipas kushteve të dhëna në anësore. Mundësitë e parkimit janë dhënë në këtë rregull.

Depo e sigurt ose fabrikë

Parkim mjetesh i ruajtur

Parkim mjetesh ku mjetet mund të dëmtohen

Hapsirë larg nga rrugët dhe shtëpitë, ku normalisht publiku nuk shkon

Ka kufi të sasisë poshtë të cilave këto kushte nuk aplikohen dhe për disa mallra më pak të rrezikshme ato nuk aplikohen fare. Hollësitë janë dhënë në kapitujt e Klasës në Pjesën II.

Për Klasat 1 deri në 7, ka një kërkesë sigurie për të ruajtur mjetet dhe mallrat gjatë gjithë kohës dhe për ti dhënë alarmin autoriteteve menjëherë për ndonjë emergjence.

13. MJETET STACIONARE (10 503 dhe 10 507)

Mjetet duhet të parkohen duke përdorur frenat e dorës.

Në rast emergjence kur një mjet është parkuar dhe p.sh. një substancë e rrezikshme është derdhur në rrugë, ekuipazhi i mjetit duhet të njoftojë autoritetet dhe duhet të ndërmarë masa në përputhje me instruksionet me shkrim.

14. NGARKESË E PËRZIER (10 403 dhe 212 178)

Ngarkesa e përzier në referencë të një përzierje të paketimeve që përmbajnë mallrat e klasave të ndryshme të ngarkuara në të njëjtin mjet ose në të njëjtin kontenier. Rregullat janë dhënë në kapitujt e Klasës në Aneksin B bazuar në krahasimin ose në klasat. Në përgjithësi Klasa I (eksplozivët) nuk duhet të transportohen së bashku me klasat e tjera, megjithatë ekzistojnë dhe disa kufizime.

Ngarkesat e materialeve të krahasueshëm nuk duhet të transportohen në kompartmente të afërta me mjetet-rezervuar.

15. PIRJA E DUHANIT (10 416)

Pirja e duhanit në afërsi të mjetit gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe përpunimit.

16. PËRPUNIMI (10 410 dhe 10 431)

Regullat e përgjithshme të përpunimit përfshijnë:

- paketimet të cilat duhet të sistemohen në mnyre të përshtatëshme në mjet dhe të sigurohen që ato të mos lëvizin në lidhje me njëra tjetrën ose në muret e mjetit.

- Mallrat e rrezikshme të jenë të ndara nga të tjerat

- Substancat toksike të jenë të ndara nga furnizimet për njerzit dhe kafshët

- Ekuipazhi nuk duhet të hapë paketimet

- Mjetet duhet të pastrohen në rast rrjedhje

- Mjetet që transportojnë në sasi të mëdha duhet të pastrohen para ringarkimit të një substance të ndryshme.

- Rezervuarët duhet tokëzohen para ngarkimit ose shkarkimit të substancave të djegshme me një tokëzues prej 61° C ose me poshtë.

- Motorat e mjeteve nuk duhet të jenë në punë gjatë ngarkimit ose shkarkimit përveç paisjeve të operimit të përpunimit. P.sh. pompat.

Regulla speciale të përpunimit mund të aplikohen për disa mallra si p.sh të përshkruara në kapitujt e Klasës në Aneksin B, Pjesa II.

MARRËVESHJA EUROPIANE NË LIDHJE ME TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME ME RRUGË (ADR)

PALËT KONTRKTUESE

Duke dëshiruar të rrisin sigurinë e transportit ndërkombëtar me rrugë,
KANË PRANUAR si me poshtë:

Neni 1

Për qëllim të kësaj Marrëveshje,

(a) termi “mjet” nënkupton mjetet me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota dhe rimorkio e gjysëm rimorkio (kategoria e klasifikimit ndërkombëtar N dhe O sipas Kodit Rrugor të R.Sh.) si janë traileret si janë përcaktuar në nenin 4 të Konventes mbi trafikun e Rrugës të 19 shtatorit 1949, përveç mjeteve që i përkasin ose janë nën urdhrat e forcave të armatosura të Palëve Kontraktuese.

(b) termi “mallrat e rrezikshme” nënkupton ato substanca dhe artikuj të transportit ndërkombëtar me rrugë të cilat janë të ndaluara nga ose të autorizuar vetëm sipas disa kushteve të veçanta nga Aneksit A dhe B.

(c) termi “transport ndërkombëtar” nënkupton çdo shërbim transporti të kryer në territorin e të paktën dy Palëve Kontraktuese me anë të mjeteve të përcaktuar në pikën (a) më sipër

Neni 2

1. Subjekti i parashikimeve të nenit 4, paragrafi 3, mallrat e rrezikshme të transportuara sipas Aneksit A nuk duhet të pranohen për transport ndërkombëtar

2. Transporti ndërkombëtar i mallrave të tjera të rrezikshme duhet të autorizohen si subjekt i

përputhjes me:

(a) kushtet e vendosura në Aneksin A për mallrat në fjalë, në veçanti në lidhje me paketimin e tyre dhe etiketimin dhe

(b) kushtet e vendosura në Aneksin B, në veçanti në lidhje me konstruksionin, paisjet dhe operimin e mjetit që transporton mallrat në fjalë subjekt i parashikimeve të nenit 4, paragrafi 2.

Neni 3

Anekset e kësaj Marrëveshje formojnë pjesë përbërëse ketu.

Neni 4

1. Çdo Palë Kontraktuese ka të drejtën të rregullojë ose të ndalojë për arsye përveç se të sigurisë gjatë transportimit, futjes së mallrave të rrezikshme në territorin e saj.

2. Mjetet në shërbim në territorin e një Pale Kontraktuese në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje ose të sjellë në shërbim në një territor të tillë brënda dy muajve pas hyrjes në fuqi duhet të lejohet për një periudhë prej tri vjetësh nga hyrja në fuqi për të kryer transport ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme edhe kur konstruksioni i tyre dhe paisja nuk është plotësisht konform me kërkesat e Aneksit B për kryerjen e transportit në fjalë. Sipas klauzolave speciale të Aneksit B, kjo periudhë mund të reduktohet.

3. Palët Kontraktuese kanë të drejtën të rregullojnë me anë të Marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe të veçanta që disa nga mallrat e rrezikshme të cilat sipas kësaj marrëveshje janë të ndaluara nga transporti ndërkombëtar mund të jenë subjekt i disa kushteve, për tu pranuar për transport ndërkombëtar në territoret e tyre ose ato mallra të rrezikshme të cilat sipas kësaj Marrëveshje pranohen për transport ndërkombëtar vetëm sipas kushteve specifike, mund të pranohen për transport ndërkombëtar në territoret e tyre sipas kushteve më pak shtrënguese së sa ato të vendosura në Aneksin të kësaj Marrëveshje. Marrëveshjet e veçanta dypalëshe ose shumëpalëshe referuar në këtë paragraf duhet të komunikohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet ti komunikojë ato tek Palët Kontraktuese të cilat nuk janë nënshkruese të marrëveshjeve në fjalë.

Neni 5

Kryerja e transportit për të cilin kjo Marrëveshje aplikohet do të mbetet subjekt i rregullave kombëtare ose ndërkombëtare të aplikuara në përgjithësi për trafikun rrugor, transportin rrugor ndërkombëtar dhe tregëtinë ndërkombëtare

Neni 6

1. Vendet antare të Komisionit Ekonomik për Europën dhe vendet e pranuar në Komision me cilësinë konsultative sipas paragrafit 8 të termave të referencës të Komisionit mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshje

(a) duke e nënshkruar atë;

(b) duke e ratifikuar atë pas nënshkrimit subjekt të ratifikimit

(c) duke e pranuar atë.

2. Vende të tilla që mund të marrin pjesë në disa aktivitete të Komisionit Ekonomik për Europën në përputhje me paragrafin 11 të termave të referencës së Komisionit mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshje duke e pranuar atë pas hyrjes në fuqi.

3. Marrëveshja do të jetë e hapur për nënshkrim deri me 15 dhjetor 1957. Me tej ajo do të jetë e hapur për pranim.

4. Ratifikimi ose pranimi do të bëhet efektiv me anë të depozitimit të një instrumenti tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje do të hyje në fuqi një muaj pas datës në të cilën një numër vendesh të

përmendur në Nenin 6, paragrafi 1, të cilët e kanë nënshkruar atë pa rezervim të ratifikimit ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të pranimit kur ka arritur në një total prej pesë. Megjithatë anekset nuk do të aplikohen deri gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të vetë Marrëveshjes.

2. Për çdo vend që ratifikon ose pranon këtë Marrëveshje pas pesë vendeve të referuara në nenin 6, paragrafi 1, e kanë nënshkruar atë pa rezervim të ratifikimit ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të pranimit, kjo Marrëveshje do të hyje në fuqi pas një muaji pasi vendi në fjalë ka depozituar instrumentet e tij të ratifikimit ose të pranimit dhe Anekset do të aplikohen për vendin në fjalë ose në të njëjtën ditë në se ato janë tashme në fuqi ose në se ato nuk janë në fuqi në këtë datë, në datën në të cilën ata aplikojnë sipas parashikimit të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 8

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të jetë efektiv dymbëdhjetë muaj pas datës së marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të njoftimit të denoncimit.

Neni 9

1. Marrëveshja do të pushojë të jetë efektive, në se pas hyrjes së saj në fuqi, numri i palëve Kontraktuese është më i vogël se pesë gjatë dymbëdhjetë muajve vazhdues.

2. Në rast të konkudimit të një Marrëveshje me përmasa botërore për rregullimin e transportit të mallrave të rrezikshme, ndonjë parashikim i kësaj Marrëveshje e cila është në kundërshtim me ndonjë dispozitë të marrëveshjes me përmasa botërore në fjalë do të hynë në fuqi, automatikisht do të pushojë së aplikuari në marrëdhëniet midis Palëve të kësaj Marrëveshje, të cilat bëhen Palë në marrëveshjen me përmasa botërore dhe automatikisht do të zëvendësohet nga parashikimi përkatës i marrëveshjes me përmasa botërore në fjalë.

Neni 10

1. Çdo vend mund në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje pa rezervim të ratifikimit ose të depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit ose të pranimit ose në çdo kohë, të deklarojë duke njoftuar në adrese të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara së kjo marrëveshje do të shtrihet në të gjithë ose në një nga territoret për marrëdhënie ndërkombëtare për të cilin ai është përgjegjës. Marrëveshja dhe Anekset do të shtrihen në territorin ose në territoret e emëruara në njoftim një muaj pasi ajo është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Çdo vend i cili ka bërë një deklaratë sipas paragrafit 1 të këtij neni e shtrin këtë marrëveshje në një territor për të cilin marrëdhëniet ndërkombëtare janë në përgjegjësinë e tij mund të denoncojë Marrëveshjen në mënyrë të veçantë në lidhje me territorin në fjalë në përputhje me parashikimin e nenit 8.

Neni 11

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Palëve Kontraktuese në lidhje me intrepertimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshje duhet sa të jetë e mundur të zgjidhet me miëkuptim midis palëve.

2. Çdo mosmarrëveshje nuk zgjidhet me anë të bisedimeve do të dorëzohet në arbitrim në se një nga Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje e kërkon dhe do të referohet në përputhje me një ose më shumë arbitra të zgjedhur me marrëveshje midis Palëve në mosmarrëveshje. Në se brënda tri muajve nga data e kërkesës për arbitrim Palët në mosmarrëveshje nuk janë në gjendje të pranojnë mbi zgjedhjen e arbitrit ose të arbitrave njëra nga këto Palë mund ti kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të emrojë një arbitër të vetëm në të cilin të rshqyrtohet mosmarrëveshja për vendim.

3. Vendimi i arbitrit ose arbitrave të caktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni do të jetë detyrues për Palët Kontraktuese në mosmarrëveshje.

Neni 12

1. Çdo Palë Kontraktuese në kohën e nënshkrimit ose të pranimit të kësaj Marrëveshje deklarohet se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga neni 11. Palët e tjera Kontraktuese nuk janë të detyruara nga neni 11 në lidhje me çdo Palë Kontraktuese e cila ka futur një rezervim të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese e cila ka futur një rezervim si është parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni mund në çdo kohë të terheqë rezervimin duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 13

1. Pasi kjo Marrëveshje ka qenë në fuqi për tri vjet, njëra nga Palët Kontraktuese mund të kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, mbajtjen e një konference për qëllim të rishikimit të tekstit të Marrëveshjes. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për kërkesën dhe konferenca për rishikimin do të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm në se brënda një periudhë prej katër muajsh në vijim të datës së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, dhe jo më pak se një e katra e Palëve Kontraktuese të njoftojë atë për mirëkuptimin me kërkesën.

2. Në se konferenca mbledhet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha Palët Kontraktuese dhe i fton ato të dorëzojnë brënda një periudhe prej tri muajsh propozimet e tyre, që ata dëshirojnë për tu marrë në konsideratë në konference. Sekretari i Përgjithshëm do të qarkullojë tek të gjitha Palët Kontraktuese axhenden e përkohshme të konferencës së bashku me tekstin e propozimeve të bëra, të paktën tri muaj para datës në të cilin do të mbledhet konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm fton në çdo konferencë që mbledhet në përputhje me këtë nen të gjitha vendet referuar në nenin 6, paragrafi 1, dhe vendet të cilat janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 6, paragrafi 2.

Neni 14**

1. Në mënyrë të pavarur nga procedura e revizionit dhënë në nenin 13, çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente tek Anekset e kësaj Marrëveshje. Në fund ajo do të transmetojë tekstin tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm mund gjithashtu të propozojë amendamente tek anekset e kësaj Marrëveshje me qëllim të sigurimit të përputhjes midis këtyre Anekseve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme.

2. Sekretari i Përgjithshëm transmeton çdo propozim të bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni tek të gjitha Palët Kontraktuese dhe informon vendet e tjera në referim të nenit 6, paragrafit 1.

3. Çdo amendament i propozuar tek Anekset do të gjykohet të jetë i pranueshëm brënda tri muajve nga data në të cilën Sekretari i Përgjithshëm e qarkullon atë të paktën tek një e treta e Palëve Kontraktuese, ose pesë prej tyre në se një e treta e tejkalon këtë shifer, i kanë dhënë Sekretarit të Përgjithshëm njoftim me shkrim për objeksionet e tyre për amendamentet e propozuara. Në se amendamenti është gjykuar të pranohet ai do të hyjë në fuqi për të gjithë palët Kontraktuese me skadimin e një periudhë prej tri muajsh përveç se në rastet si më poshtë:

(a) Në rastet kur amendamente të tjera të njëjta janë bërë ose do të bëhen në marrëveshje të tjera ndërkombëtare në referim të paragrafit 1 të këtij neni, amendamenti do të hyjë në fuqi pas skadimit të periudhës vazhdueshmëria e së cilës do të përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm në atë mënyrë që të lejojë, kur është e mundur hyrjen simultantë në fuqi të amendamentit dhe të atyre që janë bërë ose që janë duke u bërë në marrëveshje të tilla të tjera, një periudhë e tillë nuk do të jetë më pak se një muaj.

(b) Palët Kontraktuese do të dorëzojnë amendamentin e propozuar për modifikim me specifikimet e propozimet e tyre me qëllim të hyrjes në fuqi të amendamentit, jo më vonë se një periudhë prej tri muajsh.

**Teksti i nenit 14 paragrafi 3 përfshin një modifikim i cili hyn në fuqi me 19 prill 1985 në përputhje me protokollin transmetues të paleve kontraktuese nën mbulimin e C.N.229.1975.traktati i

8,me 18 shtator 1975.

4. Sekretari i Përgjithshëm sa në menyrën më të shpejtë të mundëshme njofton Palët Kontraktuese dhe të gjithë vendet referuar nenit 6, paragrafit 1, për çdo objeksion që mund të marrë nga Palët Kontraktuese për amendamentin e propozuar.

5. Në se amendamenti i propozuar tek Anekset gjykohet se nuk është i pranueshëm, por të paktën një nga Palët Kontraktuese, përveç palës Kontraktuese që propozon amendamentin i ka dhënë Sekretarit të Përgjithshëm një njoftim me shkrim të marrëveshjes së tij për propozimin, një mbledhje e të gjithë Palëve Kontraktuese dhe të gjitha vendet në referim të nenit 6 paragrafit 1 duhet të mbidhen nga Sekretari i Përgjithshëm brënda tri muajve pas datës së skadimit të periudhës prej tri muajsh brënda së cilës sipas paragrafit 3 të këtij neni njoftimi duhet të jetë dhënë për objeksionin e këtij amendamenti. Sekretari i Përgjithshëm mund të ftojë përfaqësues të:

(a) organizmave ndërqeveritare të cilët kanë lidhje me çështjet e transportit

(b) organizma jo-qeveritare ndërkombëtare aktiviteti i të cilave është i lidhur direkt me transportin e mallrave të rrezikshme në territoret e Palëve Kontraktuese.

6. Çdo amendament i adoptuar nga më shumë se gjysma e numrit total të Palëve Kontraktuese në një mbledhje të mbajtur në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni do të hyje në fuqi për të gjitha Palët Kontraktuese në përputhje me procedurën e pranuar në një mbledhje të tillë nga maxhoranca e Palëve Kontraktuese që merr pjesë në të.

Neni 15

Në shtesën 4 të njoftimeve të dhëna sipas nëneve 13 dhe 14, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të njoftojë vendet në referim të nenit 6 paragrafi 1 dhe vendet të cillat janë bërë Palë Kontraktuese sipas nenit 6, paragrafit 2, të

(a) nënshkruese, ratifikimi dhe pranimi në përputhje me nenin 6

(b) datat në të cilat kjo Marrëveshje dhe Anekset hynë në fuqi në përputhje me nenin 7;

(c) denoncimet në përputhje me nenin 8

(d) përfundimi i marrëveshjes në përputhje me nenin 9

(e) njoftimet dhe denoncimet e marra në përputhje me nenin 10

(f) deklaratimet dhe njoftimet e marra në përputhje me nenin 12, paragrafi 1, dhe 2;

(g) pranimi i datës së hyrjes në fuqi të amendamenteve në përputhje me nenin 14, paragrafi 3 dhe 6.

Neni 16

1. Protokollin e Nënshkrimit të kësaj Marrëveshje do të ketë të njëjtën fuqi, efekt dhe vazhdueshmëri sa dhe Marrëveshja vetë, i cili konsiderohet të jetë pjesë përbërse.

2. Asnjë rezervim nuk lejohet në këtë Marrëveshje përveç atyre që kanë hyrë në fuqi në Protokollin e Nënshkrimit dhe ato të bëra në përputhje me nenin 12 nuk lejohen.

Neni 17

Pas 15 dhjetorit 1957, origjinali i kësaj Marrëveshje duhet të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara i cili do të transmetoj kopje të vërteta të çertifikuara në secilin vend në referim të nenit 6, paragrafit 1.

NË DESHMINE E të nënshkruarit, i autorizuar plotësisht ka nënshkruar këtë Marrëveshje.

BËRË në Gjenëvë këtë ditë të trembedhjetë të shtatorit njëmijëenënteqintepesëdhjetë shtatë në një kopje të vetme në gjuhën anglisht dhe frengjisht për tekstin përkatës të Marrëveshjes dhe në gjuhën frengjisht për Anekset, secili tekst është i barabartë në mënyre autentike për Marrëveshjen përkatëse

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara i është ngarkuar të përgatisë një përkthim autoritar të Anekseve në gjuhën anglisht dhe ta bashkëngjisë atë tek kopja origjinale e çertifikuar, referuar në nenin 17.

PROTOKOLLI I NËNSHKRIMIT

I MARRËVESHJES EUROPIANE MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME ME RRUGË (ADR)

Në procedimin e nënshkrimit të Marrëveshjes Europiane mbi Transportin e Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me Rrugë (ADR) të nënshkruarit janë plotësisht të autorizuar,

1. DUKE KONSIDERUAR që kushtet e drejtimit të transportit të mallrave të rrezikshme me det për ose nga Mbretëria e Bashkuar ndryshon shumë nga ato të dhëna në Aneksin A të ADR dhe është e pamundur për ta modifikuar atë për të qenë në konformitet në të ardhmen e afërt

Në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar për të dorëzuar si një amendament në Aneksin A një shtojce të veçantë që përmban parashikime të veçanta për transportin rrugë-det të mallrave të rrezikshme midis Kontinentit dhe Mbretërisë së Bashkuar;

DUKE PRANUAR, deri në hyrjen në fuqi të një shtojce të tillë të veçantë, mallrat e rrezikshme të transportuara sipas ADR tek ose nga Mbretëria e Bashkuar do të jenë konform me parashikimet e Aneksit A të ADR si dhe me kushtet e Mbretërisë së Bashkuar për transportin e mallrave të rrezikshme me det

2. DUKE SHËNUAR deklaratën nga përfaqësuesi i Francës që Qeveria e Republikës së Francës rezervon të drejtën pa paragjykuar parashikimet e nenit 4 paragrafi 2 të refuzojë të lejojë mjetet në shërbim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pavaresisht nga data në të cilën ata janë vënë në shërbim, për tu përdorur për transportimin e mallrave të rrezikshme në territorin e Francës përderisa ato mjete të jenë në përputhje me kushtet e vëna për një transport të tillë si në Aneksin B ose me kushtet e vendosura për transportin e mallrave në fjalë në rregulloret franceze që drejtojnë transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë;

3. REKOMANDON se, para dorëzimit në përputhje me nenin 14, paragrafin 1 ose nenin 13, paragrafi 2, amendamentet e propozuara në këtë Marrëveshje ose në Aneksin e saj duhet të jenë diskutuar në mbledhjen e eksperteve të Palëve Kontraktuese dhe në se është e nevojshme, të vendëve të tjera të përmendura në nenin 6, paragrafi 1 të Marrëveshjes dhe të organizmave ndërkombëtar të përmendur në nenin 14, paragrafi 5 i Marrëveshjes.

MARREVEESHJA EUROPIANE NE LIDHJE ME TRANSPORTIN NDERKOMBETAR TE MALLRAVE TE RREZIKSHME ME RRUGE

ANEKSI A

MASAT NE LIDHJE ME MATERIALET E RREZIKSHME DHE MARREVEESHJET

PJESA I. PËRKUFIZIME DHE PARASHIKIME TË PËRGJITHËSHME

1-1999

PËRKUFIZIME

2000 (1) Për qëllim të këtij Aneksi:

- termi “transport i mbuluar” nënkupton transportin e substancave solide pa paketim;
- termi “autoritete kompetente” nënkupton autoritetin e caktuar në çdo vend në çdo rast specifik nga Qeveria;
- termi “substancë të rrezikshme: kur përdoret vetëm, nënkupton substancat dhe artikujt e caktuar si të tilla për ADR;
- termi “gaz” nënkupton një gaz ose avuj
- termi “Instruksione teknike të ICAO” nënkupton instruksione teknike për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme me anë të Ajrit” publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil në Montreal;
- termi “Kodi IMDG” nënkupton Kodin Detar Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme, publikuar nga Organizata Detare Ndërkombëtare (IMO) në Londër;
- termi “Manual i testimit dhe Kriteve” nënkupton botimin e dyte të rishikuar të

Rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme, Manuali Testimit dhe Kriteret (ST/SG/AC.10/11/Rev.2);

- termi “paketim: nënkupton procesin e plotë të kryerjes së paketimit, që konsiston në paketim ose IBC dhe të përmbajtjes së tij të përgatitur për shpërndarje. Termi përfshin pranimet për gazet të përkufizuar në anësoren 2211 si dhe në nënet, të cilat për arsye të përmasave, peshës ose konfiguracionit mund të transportohen të pa paketuara ose të transportohen në gjysem fuçi, barrela ose mjete të tjera të dorës. Termi nuk aplikohet për artikujt e pa paketuara ose substancat e transportuara të mbuluara në kontenier ose në mjete , ku të mos këtë substanca të tjera në rezervuar.

- Termi “ Rekomandime mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme” nënkupton botimin e dhjetë të rishikuar të Rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme (ST/SG/AC.10/1/Rev.10);

- Termi “ RID” shënon rregullat në lidhje me Transportin e Mallrave të Rrezikshme me hekurudhë, Aneksi I, i Konventes COTIF në lidhje me transportin ndërkombëtar me hekurudhë, Shtojca B Rregullat uniforme në lidhje me kontratën e transportit ndërkombëtar të mallrave me hekurudhë (CIM)

(2.) Për qëllim të këtij Aneksi, rezervuarët (shiko përkufizimet në Aneksin B) nuk janë vendosur në të njëjtin fund të faqes si marrëse, termi “marrës” përdoret në një sens të kufizuar. Parashikimet në lidhje me marrësin janë të aplikueshme për rezervuar fiks, elementet e baterise së mjeteve, rezervuar të çmontueshëm dhe kontenier-rezervuar vetëm në se është shprehur në mënyrë të veçantë.

(3.) termi “ngarkesë e plotë” nënkupton çdo ngarkesë me origjine nga një dërgues për të cilin përdorimi i një mjeti me kontenier të madh është eskuzivisht i rezervuar dhe të gjitha operimet e ngarkimit dhe të shkarkimit të cilat janë mbartur në konformitet me instruksionet e dërguesit ose të rezervuarit.

Përkufizime dhe parashikime të përgjithëshme.

2000 (4) Për qëllim të ADR “ hyrje n.o.s.” (jo e specifikuar ndryshe) nënkupton një hyrje kolektive në të cilën substancat, e përziera, solucionet ose artikujt mund të shënohen në se ato:

(a) nuk janë përmendur me emër sipas titujve të listës së substancave

(b) paraqitet kimike, fizike dhe/ose përmbajnë të rrezikshme korresponduese të Klasës, titullit, gjermës dhe emrit të hyrjes n.o.s.

(5) Shkrirësat janë substanca, solucione, përzierje ose artikuj për të cilat nuk këshillohet përdorimi direkt por të cilat transportohen për porositiesin, dumpingun, eliminimin me anë të djegies ose me metoda të tjera.

(6) për qëllim të klasifikimit, mallrat e rrezikshme me një pikë shkrirje ose pikë shkrirje fillestare prej 20° C ose me poshtë në një presion 101.3 kPa duhet të konsiderohen si lëngje.Për substancat viskoze për të cilat nuk mund të përcaktohet pika e shkrirjes do të jenë subjekt i testimit ASTM D 4359-90 ose të testimit të përcaktuar shkallën e fluiditetit (testi penëtrometër) I përshkruar në Shtojcën A.3, anësore 3310.

2001 (1) Njësitë e mëposhtëme të matjes 1 janë të aplikueshme në këtë Aneks dhe në Aneksin B

Përmasat e Njësia 2 SI Njësia alternative e pranueshme Mardheniet midis njësive

Gjatësia	m (metra)	--	--	
Zona	m ² (metra katrore)	--	--	
Volumi	m ³ (metra kub)	l (litra)	1l	=10 ⁻³ m ³
Koha	s (sekonda)	min	minuta)	1 min = 60 s
		h	(orë)	1 h =3600 s
		d	(ditë)	1d =86 400s
Masa	kg (kilogram)	g	(gram)	1g =10 ⁻³ kg
		t	(ton)	1t =10.3kg
Densiteti masës	kg/m ³ kg/l		1 kg/l	- 103 kg/m ³
Temperatura	K (Kelvin)	°C	(grade) °C	= 273.15 K
			(Celsius)	
Diferenca e temperaturave	K (Kelvin)	°C	“	1°C =1K

Forca	N (njuton)		''	1N	=1kg' m/s ²
Presioni	Pa (paskal)	bar	(bar)	1 bar	=10 Pa
				1Pa	=1N/m
Shtypja	N/m ²	N/mm ²		1N/mm ²	=1MPa
Puna)	kWh (kilovat		1kWh	=3.6 MJ
Energjia)	orë)			
)	J (xhul)		1J	=1N.m=1W.s
Sasia)	eV(elektronvolt)		1eV	=0.1602X 10 ⁻¹⁸ J
E nxehtesisë					
Fuqia		W (vat)	--	1W	=1J/s =1N.m/s
Viskoziteti					
Kinematik	m ² /s	mm ² /s		1 mm ² /s	=10 ⁻⁶ m ² /s
Viskoziteti					
Dinamik	Pa.s	mPa.s	1mPa.s		= 10 ⁻³ Pa.s
Aktiviteti ⁴	Bq (bekerel)				
Doza					
Ekuivalent ⁵	Sv (sievert)				

2001 (shënime në fund të faqes 2)

1 Shifrat e rumbullakosura vijuese janë të aplikueshme për konversioni i njësive të përdorura në Njësitë SI.

Forca	Presioni		
1kg=9.807 N	1kg/mm ²	=9.807 N/mm ²	
1N=0.102kg	1 N/mm ²	=0.102kg	
Presioni			
1Pa	-1Nm ² =10 ⁻⁵ bar	=1.02x10 ⁻⁵ kg/cm ²	=0.75x10 ⁻² torr
1bar	=10.5Pa	=1.02kg/cm ²	=750torr
1kg/cm ²	=9.807x10 ⁴ Pa	=0.9807 bar	=736torr
1torr	=1.33x10 ² Pa	=1.33 x10 ⁻³ bar	=1.36x10 ⁻³ kg/cm ²

Energjia, Puna, Sasia e nxehtesisë

1J	=1Nm	=0.278x10 ⁻⁶ kWh	= 0.102kgm	=0.239x10 ⁻³ kcal
1kWh	=3.6x10 ⁶ J	=367x10 ³ kgm	=860kcal	
1kgm	=9.807J	=2.72x10 ⁻⁶ kWh	=2.34x10 ⁻³ kcal	
1kcal	=4.19x10 ³ J	=1.16x 34x10 ⁻³ kWh	=427kgm	

Fuqia Viskoziteti kinematik

1W	=0.102KGM/S	=0.86kcal/h	=1m ² /s	=104St(stok)
1kgm/s	=9.807W	=8.43kcal/h	=1St	=10 ⁻⁴ m ² /s
1kcal	=1.16W	=0.119kgm/s		

Viskoziteti dinamik

1Pa.s	=1 Ns/m ²	=10 P(pois)	=0.102 kgs/m ²
1P	=0.1 Pa.s	=0.1 Ns/m ²	=1.02x10 ⁻² kgs/m ²
1kgs/m ²	=9.807 Pa.s	=9.807 Ns/m ²	=98.07 P

2/ Sistemi ndërkombëtar i njësive (SI) është rezultat i vendimeve të marra në Konferencën e Përgjithshme mbi Peshat dhe Masat (Adresa: Pavillon de Breteuil, Parc de St-Cloud, F-92 310 Sevres).

3/ Shkurtime “L” për liter mund të përdoret gjithashtu “l” kur gjatë shtypjes nuk mund të dallohet shifra “1” nga “l”

4/ Për të qenë më e qartë, aktiviteti mund të tregohet në paranteza në Ci (kuri)(marëdhëniet midis njësi: 1 Ci=3.7 x 10¹⁰ Bq). Duke hequr nga formula e bisedimit mund të jepen vlera të rrumbullakosura)

5/ Për të qenë më e qartë doza ekuivalente mund të tregohet në paranteza në (marëdhëniet midis njësi: 1 rem=0.01Sv)

2001 decimalet e shumëzuara dhe të nënshumëzuara të një njësi mund të formohen me prefikse ose simbole, duke patur kuptimin si me poshtë, të vendosur para emrit ose simbolit të njësisë:

Faktori	Prefiksi	Simboli		
1 000 000 000 000 000 000	=10 ¹⁸ kuintilon	exa	E	
1 000 000 000 000 000	=10 ¹⁵ kuaderilon	përa		P
1 000 000 000 000	=10 ¹² trilion	tera	T	
1 000 000 000	=10 ⁹ bilion	giga		G
1 000 000	=10 ⁶ milion	mega		M
1 000	=10 ³ mije	kilo		k
100	=10 ² qint	hekto		h
10	=10 ¹ dhjet	deca		da
0.1	=10 ⁻¹ i dhjet	deci	d	
0.01	=10 ⁻² I i qint	centi	c	
0.001	=10 ⁻³ i mijt	mili	m	
0.00000	=10 ⁻⁶ i milionit	micro		μ
0.000000001	=10 ⁻⁹ I i bilionit	nano		n
0.000000000001	=10 ⁻¹² i trilionit	pico		p
0.000000000000001	=10 ⁻¹⁵ i kuaderilont	femto		f
0.000000000000000001	=10 ⁻¹⁸ i kuintilont	atto		a

SHËNIM: 10⁹=1 bilion është përdorimi i Kombeve të Basdhkuara në Anglisht. Për analogji, 10⁻⁹= 1 bilion

(2) Kur fjala “peshe” përdoret në këtë Aneks dhe në Aneksin B, nënkuptohet masa,

(3) kur pesha e paketimit permendet ne kete Anex dhe Anexin B masa bruto nënkuptohet veçse në është cituar ndryshe. Masa e kontenerit ose rezervuarit e përdorur për transportin e mallrave të rrezikshme nuk përfshihet në masën bruto.

(4) Përveç në se është cituar ndryshe, shenja “%” në këtë Aneks dhe në Aneksin B përfaqëson:

(a) në rast të përzierjes së solideve ose të lëngjeve dhe në rastin e solucioneve dhe të solideve të shkrirë nga ndonjë lëng: përqindja e masës bazohet në masën totale të përzierjes, solucioni ose solidi tretur;

(b) në rast të përzierjes të gazeve të komprimuar: kur janë të mbushur me presion, proporcioni i volumit të treguar si një përqindje e volumit total të gazeve të perxzier, ose kur mbushet me masë, proporcioni i masës i treguar si një përqindje e masës totale të përzierjes;

në rast të përzierjes së gazeve likuid dhe të gazeve të zberthyer nën presion; proporcioni i masës i treguar si një përqindje e masës totale të përzierjes;

(5) Presionet e të gjitha llojeve që kanë të bëjnë me enët (si testimi i presionit, presioni i brendshëm, valvola e sigurimit të hapjes së presionit) gjithashtu tregohen në presionin e përcaktuar (presion më i madh se ai i presionit atmosferik); presioni i avullimit të substancave gjithmonë shprehet në presion absolut.

(6) Ku ky Aneks ose Aneksi B specifikon një grade të mbushjes për marrësin ose për rezervuarin, kjo shkallë e mbushjes gjithmone i referohet temperaturës së substancës prej 15°C pavarësisht se janë treguar temperatura të tjera.

(7) formulat e bisedimit të perafërta vijuese janë autorizuar përderi sa njësitë SI të jenë përfshirë në të gjithë tekstet e këtij Aneksi dhe të Aneksit B.

1kg/mm2 = 10.N/mm2

1kg/cm2 = 1bar

Përcaktime dhe parashikime të përgjithëshme.

PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

2002 (1) Ky Aneks specifikon mallrat e rrezikshme që përjashtohen nga transporti ndërkombëtar me rrugë dhe mallrat e rrezikshme që pranohen në një transport të tillë sipas disa kushteve të përcaktuara. Ajo grupon mallrat e rrezikshme në klasa kufizuese dhe jo-kufizuese. Nga mallrat e rrezikshme të mbuluara nga titujt e klasave kufizuese (Klasi 1 dhe 7), janë ato në listën, në klauzolat në lidhje me klasat (anësoret 2101 dhe 2701) që do të pranohen për transport vetëm sipas kushteve të specifikuara në këto klauzola, dhe të tjerat do të përjashtohen nga transporti. Disa nga mallrat e rrezikshme të mbuluara nga titujt e klasave jo-kufizuese (KIASET 2,3,4.1,4.2,4.3,5.1,5.2,6.1,6.2,8 dhe 9) ME ANË TË SHËNIMEVE TË FUTURA NË KLAUZOLA NË LIDHJE ME klasat e ndryshme, të përjashtuara nga transporti, i mallrave të tjera të mbuluara nga titujt e klasave të pa-kufizuara, ato të cilat janë përmendur në klauzolat në lidhje me këto klasa (anësoret 2201, 2301, 2401, 2431 2471, 2501, 2551, 2601, 2651, 2801 dhe 2901) të cilat pranohen për transport vetëm sipas kushteve të specifikuara në këto klauzola, ato që nuk janë të përmendura ose të mbuluara nga një titull kolektiv nuk janë gjykuar të jenë mallra të rrezikshme për qëllim të kësaj Marrëveshje dhe pranohen për transport pa ndonjë kusht të veçantë.

(2) Klaset e këtij Aneksi janë si më poshtë:

Klasi 1 Substancat dhe artikujt eksploziv.....	kufizuara
Klasi 2 Gazet.....	jo-të kufizuara
Klasi 3 Lëngjet vetëndezës.....	jo-të kufizuara
Klasi 4.1 Lëndë të ngurta të ndezshme.....	jo-të kufizuara
Klasi 4.2 Substanca që vetëndizen.....	jo-të kufizuara
Klasi 4.3 Substanca rrezikshme kur lagen	jo-të kufizuara
Klasi 5.1 Substanca oksiduese.....	jo-të
kufizuara	
Klasi 5.2 Perokside organike.....	jo-të
kufizuara	
Klasi 6.1 Substanca toksike.....	jo-të
kufizuara	
Klasi 6.2 Substanca infektuese.....	jo-të
kufizuara	
Klasi 7 Substanca radiokative.....	kufizuara
Klasi 8 Substanca gërryese.....	jo-të
kufizuara	
Klasi 9 Substanca dhe artikuj të tjerë të rrezikshëm.....	jo-të kufizuara

(3) Transporti mallrave sipas këtij Aneksi duhet të shoqërohet me dokumentet si më poshtë:

(a) dokumenti transporti që përmban të paktën informacionin vijues (për Klasën 7, shiko gjithashtu anësoren 2709):

-një përshkrim të mallrave që përfshin numrin e identifikimit të substancave (kur është e vlefshme) 6/

-klasin 6/

-titullin e numrit së bashku me ndonjë gërmë 6/inicialet ADR ose RID 6/

-numrin dhe një përshkrim të paketimeve ose IBC

-sasinë totale të mallrave të rrezikshme (si volum ose si masë bruto ose si masë neto, në -rast të substancave dhe artikujve eksploziv të Klasës 1, masën neto totale të përmbajtjes së eksplozivit)

SHENIM 1: Ky informacion nuk kërkohet në rastin e paketimeve bosh të papastra, të konteinerëve ose të rezervuarve.

SHËNIM 2: Në rast të një aplikimi të anësore 10 011, sasia totale e mallrave të rrezikshme për njësi transporti do të shprehet si një vlerë e llogaritur në përputhje me parashikimet e kësaj anësore të aplikueshme për llogaritjen e sasisë maksiale totale për njësi transporti.

- emrin dhe adresën e dërguesit
- emrin dhe adresën e rezervuarit
- një deklaratë e kërkuar nga termat e ndonjë marrëveshje të veçantë

Dokumenti që përmban këtë informacion mund të jetë ai i kërkuar dhe nga rregullore të tjera në fuqi për transport me anë të një mënyrë tjetër transporti. Në rast të shumë dorëzuesëve emri dhe adresa e dorëzuesve dhe sasia e shpërndarë duke aftësuar natyrën dhe sasinë e e transportuara të vlerësohen në çdo kohë, mund të futen dokumente të tjerë të cilat do të përdoren ose në një dokument tjetër të bërët e detyrueshme në përputhje me rregullore të tjera specifike dhe të cilat duhet të qendrojnë në kabine të mjetit. Dorëzuesi duhet të komunikojë këtë informacion tek transportuesi me shkrim.

Të veçanta që mund të futen në dokument duhet të hartohen në një gjuhë zyrtare të vedit që do të dërgohen, në se gjuha nuk është anglisht, frengjisht ose gjermanisht, përveç tarifave të transportit rrugor ndërkombëtar, në se ka, ose ndonjë marrëveshje të konkluduar midis vendeve të interesuara në lidhje me kryerjen e transportit.

(b) instruksionet që do të zbatohen në rast të një aksidenti (shiko Aneksin B, anësoren 10 385), (përveç atyre të përjashtuara sipas anësore 10 011).

(4) Në rast së për arsye të përmasave të ngarkesës një dërgues nuk mund të ngarkojë të tërë atë në një njësi të vetme transporti, të paktën duhen bërë dokumente të veçanta, ose kopje të dokumentit të vetëm si njësi të transportit të ngarkuara. Për më tepër në të gjitha rastet e dokumenteve të transportit të veçanta duhet të bëhen për dërgëast ose pjesë të dërgesës, të cilat nuk mund të ngarkohen së bashku në të njëjtin mjet për arsye të ndalimeve të vëna në Aneksin B.

6/ Këto dhe hollësi të tjera mund të gjenden në seksionin 2.B “ të veçanta në dokumentin e transportit” të secilës klasë ose në Rregullat e Klasës 7.

2002 (5) (a) Për transportin e paketimeve që përmbajnë mallrat e rrezikshme, mund të përdoren mbipaketime në se ato plotësojnë kushtet si më poshtë:

Mbipaketimi nënkupton një hapsirë të mbyllur e përdorur nga një dërgues i vetëm ku të përmbahen një ose më shumë paketime, të futur në një njësi të vetme e lehtë për tu përpunuar dhe sistemuar gjatë transportit.

Shëmbuj të mbipaketimeve:

(i) një mjet ngarkimi si një paletë, në të cilën vendosen disa paketime dhe të siguruara nga rripa plastik, mbërthime ose veshje ose mjete të tjera të pershtëshme; ose

(ii) një mbrojtës i jashtëm i paketimeve si kuti ose kafaz.

SHËNIM: Ky përkufizim nuk aplikohet për mbipaketimet e përcaktuara në Klasin 7 (shiko anësoren 2700, përkufizimin 13)

Një duhet të këtë numrin e identifikimit të mallrave, të paraprirë nga gërmat “UN” dhe etiketat e të gjitha paketimeve që përmbahen në mbipaketim, përderisa numrat e identifikimit dhe etiketat që përfaqësojnë mallrat e rrezikshme të përmbajtura në mbipaketim janë të dukshme.

Çdo paketim i mallrave të rrezikshme të përmbajtura në një mbipaketim duhet të jetë në përputhje me të gjitha parashikimet në fuqi. Funkzioni i çdo paketimi nuk duhet të çënohet nga mbipaketimi.

Ndalimi i ngarkesave të përziera në klasa të ndryshme gjithashtu aplikohet tek këto mbipaketime.

(b) paketime e dëmtuara, me difekt ose rrjedhje të mallrave të rrezikshme që mund të jenë derdhur ose rrjedhur mund të transportohen në paketime shpëtimi të veçanta të përshkruara në anësoren 3559. Kjo nuk parandalon përdorimin e një paketimi me përmasa me të mëdha të tipit përkatës dhe të nivelit të kryerjes sipas kushteve të anësore 3500 (14). Kur transportohen paketime të dëmtuara, paketimet e shpëtimit duhet të mbajnë numrin e identifikimit të paraprirë nga gërmat “UN” dhe të gjitha etiketat e rrezikut të paketimeve të dëmtuara që ajo përmban si dhe fjalën (SHPËRIM). Në shtesë të kërkesave të veçanta në klase të ndryshme për transportin e mallrave, dërguesi duhet të

fusi fjalën “Shpëtim paketimi” në dokumentet e transportit.

(6) Në se paketimi i përzier i disa substancave të rrezikshme me njëra tjetrën ose me mallrat e tjera është lejuar nga parashikimet e seksionit A.3 të parashikimeve të aplikueshme për klase të ndryshme, paketimi i brendshëm që përmban substanca të ndryshme të rrezikshme duhet të ndahen me kujdes dhe në mënyrë efektive nga njëra tjetra në paketimet kolektive në se ka reaksione të rrezikshme, si prodhimi i nxehtësisë së djegies, formimi i përzierjeve sensitive ndaj fërkimeve ose goditjeve si dhe lëshimi i gazeve të djegshëm ose toksik, që mund të ndodhin si rezultat i dëmtimit ose të shkatërrimit të paketimit të brendshëm. Përderisa nuk është dhënë ndryshe në këtë paragraf ose kushte të veçanta për paketim të disa substancave, lëngjeve të Klasës 3,4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 6.1, 8 ose 9 të klasifikuara sipas (a) ose (b) të titujve të ndryshëm, në paketime xhami ose balte duhet të paketohen duke përdorur materiale të afta për të absorbuar lëngjet. Materialet absorbuese nuk kërkohen në se paketimet e brëndëshme janë të mbrojtura nga thyerjet dhe rrjedhjet e përmbajtjes së tyre nga paketime të jashtme që mund të ndodhin gjatë kushteve normale të transportit. Kur kërkohet material absorbues dhe një paketim i jashtëm nuk është kundër rrjedhjeve, duhet të ketë mjete që të mbajnë lëngjet në rast të rrjedhjeve si linja kundër rrjedhjeve, thasë plastik ose mjete të tjera efektive (shiko anësoren 3500 (5))

2002 Për paketime të përziera të Klasës 7, shiko anësoren 3711 të Shtojcës A.7

(7) Në se përdoret një paketim i përzier, parashikimet e këtij Aneksi në lidhje me veçoritë do të specifikohen në dokumentet e transportit do të aplikohen në lidhje me secilin prej llojeve të ndryshme të substancave të rrezikshme të përmbajtura në paketimin kolektiv, dhe paketimi kolektiv duhet të ketë të gjitha përshkrimet dhe etiketat e rrezikut të përshkruara në Aneks për substancat e rrezikshme që përmban paketimi kolektiv.

(8) Parashikimet vijuese do të aplikohen për substancë, solucione, përzierje (si përgatitja e shkriësave) jo të përmendura me emër në listën e substancave të klasave të ndryshme:

SHËNIM 1; Solucionet dhe përzierjet përmbajnë dy ose me shumë komponente. Këto komponentë mund të jenë substancë të ADR ose substancë të cilat nuk janë subjekt i parashikimeve të ADR.

SHËNIM 2: Solucionet dhe përzierjet që përmbajnë një ose më shumë komponentë të një klasi kufizues nuk mund të pranohen për transport përderisa këto komponentë të vihen në listë me emra në listën e substancave të klasës të kufizuar.

SHËNIM 3. Solucionet dhe përzierjet që kanë një aktivitet specifik që e tejkalon 70kBq/kg (2nCi/kg janë substanca të Klasës 7 (shiko anësoren 2700(1)).

(a) Solucioni ose përzierja që përmban një substancë të rrezikshme që është në listë me emër në ADR së bashku me një ose më shumë substanca jo-të rrezikshme, do të konsiderohen si substanca të rrezikshme që është në listën emërore, përveç se:

1. Solucioni ose përzierja që është vënë në listën emërore specifike me emër në ADR: ose

2. kur është kreu e qartë nga titulli për substancat e rrezikshme dhe është e aplikueshme vetëm kur është e pastër ose teknikisht e pastër, ose

3. klasa, gjendja fizike ose grupi i paketimit (gërma), e solucionit ose përzierjes është e ndryshme nga ajo e një substance të rrezikshme.

Për solucione ose përzierje të tilla, fjala “solucion” ose “e përzier” duhet të shtohet si pjesë e emrit në dokumentin e transportit për qëllim të sqarimit të përshkrimit, “solucion acetoni”

Në se në klasë gjendja fizike ose grup paketimi ndryshojnë nga substancat puro solucioni ose përzierja duhet të përcaktohen tek hyrja n.o.s përkatëse në varësi të shkallës së rrezikut.

Një përzierje ose solucion që përmban një ose më shumë substancë të identifikuar me anë të emrit ose të klasifikuara sipas një hyrje n.o.s dhe një ose më shumë substanca të rrezikshme nuk është subjekt i parashikimeve të ADR në se karakteristikat vepruese të përzierjes ose të solucionit

janë të tilla që nuk plotësojnë kriteret (përfshi kriterin e experiencës së njëriut) për çdo klas.

(b) Substancat që kanë një ose më shumë karakteristika të rrezikshme dhe solucionet ose përzierjet që përmbajnë dy ose më shumë komponentë subjekt i ADR duhet të vendosen në të njëjtin titull dhe germë të klasit përkatës në përputhje me karakteristikat e rrezikshme. Ky klasifikim në bazë të karakteristikave të rrezikshme duhet të zbatohet si me poshtë:

1.1.Karakteristikat fizike, kimike, dhe fiziologjike që zotërojnë mund të jenë përcaktuar me mesataren e llogaritjeve dhe të jenë klasifikuar në lidhje me kriteret e klasave të ndryshme.

2002 1.2. Në se ky përcaktim nuk është i mundur pa një kosto disproporcionale ose përppjekje të disa lloj shkrirove) solucioni ose përzierja duhet të vendoset në klasën e komponentit që përfaqëson rrezikun më të madh.

2. Në se substanca paraqet më shumë se një karakteristikë rreziku ose një solucion ose përzierje përmban më shumë se një komponentë të klasës ose të grupeve të substancave që janë në listën më poshtë, ato duhet të klasifikohen në klasën ose grupin e substancave që paraqesin rrezikun më të madh.

2.1. Në se nuk ka ndonjë rrezik predominues, klasifikimi do të bazohet në një rregull tjetër si mëposhtë:

-substancat dhe artikuj të Klasës 1
-substancat dhe artikuj të Klasës 1
-vetëreaksionet e substancave në lidhje me to, substancë eksplozive në një gjendje jo eksplozive (substancat të buta dhe flegmatike) të Klasës 4.1

-substancë piroforike të Klasës 4.2
-substancat e Klasës 5
-substancat të Klasës 6.1 të cilat janë shumë toksike dhe veprojnë në frymëmarrje në përputhje me kriteret e anësorës 2600 (3) (përjashtuar substancat, solucionet dhe përzierjet (të tilla të përgatitura dhe shkrirose) që plotësojnë kriteret e klasifikimit të Klasës 8 dhe që kanë një toksitet të frymëmarrjes, mjegull dhe pluhur (LC50) në një rradhë të grupit (a) dhe toksikime nëpërmjet gojës dhe organeve të tretjes ose në kontakt me lekurën janë vetëm në rangun e grupit (c) ose më poshtë, substanca të tilla solucione dhe përzierje (të tilla të përgatitura dhe shkrirose) duhet të caktohen në

Klasën (8)

-substancë infektuese të Klasës 6.2

2.2. Në se karakteristikat e rrezikshmërisë bien brenda në më shumë se në një klasë ose grup të substancave në listën 2.1 substancat, solucionet dhe përzierjet do të klasifikohen në klasa ose në grup të substancave që përfaqësojnë rrezikun më të madh.

2.3 Në se nuk ka ndonjë rrezik predominues substancat, solucionet dhe përzierjet do të klasifikohen si më poshtë:

2.3.1. Përcaktimi në një klasë duhet të bëhet mbi bazën e karakteristikave të ndryshme të rrezikut ose të komponentëve në përputhje me tabelën si më poshtë 8/. Për klasat 3, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 6.1, 8 dhe 9 duhet të merret parasysh shkalla e rrezikut të treguar me anë të gërmeve (a), (b) ose (c) të titujve të ndryshëm (shiko anësoret 2300 (3), 2400 (3), 2430 (3), 2470 (3), 2500 (3), 2600 (3), 2800 (3), 2900 (2),

SHËNIM: Shëmbujt për të ilustruar përdorimin e tabelës 8/

Përshkrimi i përzierjes

Përzierja konsiston në një lëng të djegshëm të klasifikuar sipas Klasës 3, gërma (c) një substancë toksike e klasifikuar sipas Klasës 6.1, gërma (b) dhe një substancë gërryese të klasifikuar sipas Klasës 8, gërma (a)

Procedura

Ndërprerja e linjës 3(c) në kolumnën 6.1 (b) jep 6.1(b). Ndërprerja e linjës 6.1 (b) në kolumnën 8 (a) jep 8(a).

2.3.2. Klasifikimi sipas i një hyrje n.o.s. e një titulli të një klasi në përputhje me 2.3.1. mbi bazën e karakteristikave të rrezikut të komponentëve të ndryshëm të solucionit ose të përzierjes. Klasifikimi sipas një hyrje të Përgjithshme n.o.s është i lejuar vetëm kur klasifikimi sipas një hyrje specifike n.o.s. nuk është e mundur.

SHËNIM: Shëmbujt për klasifikimin e përzierjeve dhe solucioneve sipas klasës dhe titujve:

Një solucion fenol i Klasës 6.1, 14°(b) i Klasës 3.3° (b) duhet të klasifikohet në Klasën 3.3°(b), ky solucion duhet të klasifikohet sipas hyrjes 1992 të lëngjeve të djegshme, toksik, Klasi 3.19°(b) sipas toksitetit të fenolit.

Një përzierje solide e arsenatit të sodiumit të Klasës 6.1, 51°(b) duhet të klasifikohet sipas hyrjes 3290 solid toksik, gërryese, inorganike, hyrja n.o.s. 6.1, 67°(b)

Një solucion i papërpunuar ose naftalin e rafinuar e Klasës 4.1, 6°(c) në vajgurin Klasës 3.3°(b) duhet të klasifikohet sipas hyrjes 3295 të hidrokarboneve, lëngje, n.o.s në Klasën 3.3°(b)

Një përzierje e hidrokarbonit të Klasës 3, 31°(c) dhe e polikronidit bifenil (PCB) të Klasës 9,2°(b) duhet të klasifikohet sipas hyrjes 2315 të polikronidit bifenil në Klasin 9,2°(b)

Një përzierje e propilenit të Klasës 3.12° dhe të polikronidit bifenil (PCB) të Klasës 9,2°(b) duhet të klasifikohet sipas hyrjes 1921 të propilenimine inhibite të Klasës 3,120

TABELE [SHIH MARXHINAT 2002 (8) (B) 2.3.1]

Klasa dhe zeri	4.1 b)	4.1 c)	4.2 b)	4.2 c)	4.3 a)	4.3 b)	4.3 c)	5.1 a)1/	5.1 b)1/	5.1 c)1/	6.1 a)3/ DERMAL	6.1 a)3/ ORAL	6.1 b)3/	6.1 c)3/	8 a)1/	8 b)1/	8 c)1/	9
3a)2/	SOL LIQ 4.15/3a)	SOL LIQ 4.15/3a)	SOL LIQ 4.25/3a)	SOL LIQ 4.25/3a)	4.3 a)	4.3 a)	4.3 a)	SOL LIQ 5.1a)3a)	SOL LIQ 5.1a)3a)	SOL LIQ 5.1a)3a)	3 a)	3 a)	3 a)	3 a)	3 a)	3 a)	3 a)	3 a)
3b)2/					4.3 a)	4.3 b)	4.3b)	SOL LIQ 5.1a)3a)	SOL LIQ 5.1b)3b)	SOL LIQ 5.1b)3b)	3 a)	3 a)	3 b)	3 b)	8 a)	3 b)	3 b)	3 b)
3c)2/					4.3 a)	4.3 b)	4.3 c)	SOL LIQ 5.1a)3a)	SOL LIQ 5.1b)3b)	SOL LIQ 5.1c)3c)	6.1 a)	6.1 a)	6.1 b)	3 c) 8/	8 a)	8 b)	3 c)	3 c)6/
4.1 b)					4.3 a)	4.3 b)	4.3b)	5.1 a)	4.1 b)	4.1 b)	6.1 a)	6.1 a)	SOL LIQ 5.1b)6.1b)	SOL LIQ 5.1b)6.1b)	8 a)	SOL LIQ 4.1b)8b)	SOL LIQ 4.1b)8b)	4.1b)
4.1 c)					4.3 a)	4.3 b)	4.3 c)	5.1 a)	4.1 b)	4.1 c)	6.1 a)	6.1 a)	6.1 b)	SOL LIQ 5.1b)6.1b)	8 a)	4.2 b)	SOL LIQ 4.1c)8c)	4.1c)6/
4.2 b)					4.3 a)	4.3 b)	4.3b)	5.1 a)	4.2 b)	4.2 b)	6.1 a)	6.1 a)	4.2 b)	4.2 b)	8 a)	8 b)	4.2 b)	4.2b)
4.2 c)					4.3 a)	4.3 b)	4.3 c)	5.1 a)	5.1 b)	4.2 c)	6.1 a)	6.1 a)	6.1 b)	4.2 c)	8 a)	4.2 b)	4.2 c)	4.2c)6/
4.3 a)								5.1 a)	4.3 a)	4.3 a)	5.1 a)	4.3 a)	4.3 a)	4.3 a)	4.3 a)	8 b)	4.3 a)	4.3 a)
4.3 b)								5.1 a)	4.3 b)	4.3 b)	6.1 a)	4.3 a)	4.3 b)	4.3 b)	8 a)	4.3 a)	4.3 b)	4.3 b)
4.3 c)								5.1 a)	5.1 b)	4.3 c)	6.1 a)	6.1 a)	6.1 b)	4.3 c)	8 a)	4.3 b)	4.3 c)	4.3 c)6/
5.1 a)1/											5.1 a)	5.1 a)	5.1 a)	5.1 a)	5.1 a)	8 b)	5.1 a)	5.1 a)
5.1 b)1/											5.1 a)	5.1 a)	5.1 b)	5.1 b)	8 a)	5.1 a)	5.1 b)	5.1 b)

5.1 c)1/											6.1 a)	6.1 a)	6.1 b)	6.1 c)	8 a)	5.1 b)	5.1 c)	5.1 c)6/
6.1 a)3/ DERMAL															SOL LIQ 6.1a) 8a)	6.1 a)	6.1 a)	6.1 a)
6.1 a)3/ ORAL															SOL LIQ 6.1a) 8a)	6.1 a)	6.1 a)	6.1 a)
6.1 b)3/ INHAL															SOL LIQ 6.1a) 8a)	6.1 b)	6.1 b)	6.1 b)
6.1 b)3/ DERMAL															SOL LIQ 6.1a) 8a)	SOL LIQ 6.1b) 8b)	6.1 b)	6.1 b)
6.1 b)3/ ORAL			SOL = Substancë e ngurtë dhe përzierje LIQ = Substancë e lëngët, përzierje dhe solucion DERMAL = Helmuese te lëkures ORAL = Helmuese te gojës INHAL = Helmuese te hundës											8 a)	SOL LIQ 6.1b) 8b)	6.1 b)	6.1 b)	
6.1 c)3/														8 a)	8 b)	8 c)	6.1 b)6/	
8 a)1/																	8 a)	
8 b)1/																	8 b)	
8 c)1/																	8 c)6/	

2002 Shënime për tabelën.

1/ Këto përzierje dhe solucione mund të kenë veti eksplozive, në këto raste ato nuk mund të pranohen për transport përderisa të plotësojnë kërkesat e Klasës 1.

2/ Solucionet ose përzierjet që përmbajnë substancë të Klasës 3. anësore 2301, 6°,12° ose 13° duhet të vendoset në këtë Klasë sipas këtyre titujve

3/ Solucionet ose përzierjet që përmbajnë substanca të Klasës 6.1. anësore 2601, 1° deri 3° ose 13° duhet të vendoset në këtë Klasë sipas këtyre titujve

4/ Solucionet ose përzierjet që përmbajnë substanca të Klasës 8. anësore 2801, 6°,14° dhe 15° duhet të vendoset në këtë Klasë sipas këtyre titujve

5/ Përcaktimi në një klasë dhe germë të një titulli mund të bazohet mbi procedurën e testit (shiko anësoren 2400 dhe 2430)

6/ Solucionet ose përzierjet që përmbajnë substanca të Klasës 9, anësore 2901, 2°(b) duhet të vendosen në atë klasë sipas titullit, por që të mos përmbajë substanca të përmendura në shënim 1/ deri 4/ më sipër. Në se ato përmbajnë të tilla ato duhet të klasifikohen në përputhje me to.

7/ Aktualisht nuk ka ndonjë kriter për testim për përcaktimin e shkallës së rrezikut (grup paketimi) për lëngjet e Klasës 5.1. Shkalla e rrezikut (grup paketimi) për substanca të tilla mund të përcaktohet vetëm me anë të krahasimit të substancave të vëna në listë me emër sipas një titulli dhe një grupi të përcaktuar nga germat (a), (b) dhe (c).

8/ Klasa 6.1 është për pesticide.

2002 (9) Dërguesi ose në dokumentin e transportit ose në një deklaratë të veçantë të bashkangjitur ose të kombinuar me të, duhet të vertetojë se substanca e paraqitur mund të transportohet me rrugë në konformitet me parashikimet e ADR dhe të kushtit, trajtimit ose të paketimit përkatës, të kontejnerit të mbuluar ndërmjetës ose të rezervuarit të kontejnerit dhe etiketimit konform me parashikimet e ADR. Në se disa mallrat e rrezikshme janë paketuar së bashku në një paketim kolektiv ose në një kontejner të vetëm, dërguesit i kërkohet të deklarojë që kjo pako e përzier nuk është e ndaluar.

(10) Një substancë jo-radioaktive [shiko përkufizimin e materialeve radioaktive në anësoren 2700 (1)], e cila është mbuluar nga një titull kolektiv të një klase të përjashtuar nga transporti në se është e mbuluar nga një klasë kufizuese në të cilën nuk është në listë.

(11) Një substancë jo-radioaktive [shiko përkufizimin e materialeve radioaktive në anësoren 2700 (1)] e cila nuk është në listë me emër në një klasë, por e cila është e mbuluar nga dy ose më shumë tituj kolektiv të kalsave të ndryshme, do të jetë subjekt i kushteve të transportit si më poshtë:

(a) në klasën kufizuese, në se një nga klasat përkatëse është klasë kufizuese

(b) në klasën koresponduese të rrezikut predominues të substancës gjatë transportit, në se një nga klasat përkatëse është klasë kufizuese

(12) Materiali radioaktiv aktiviteti specifik i së cilës e tejkalon 70 kBq/kg(2 nCi/g) dhe e cila:

(a) plotëson keriteret për transport sipas Rregullit 1 të Klasës 7; dhe

(b) ka veti ndërhyrëse e mbuluar nga titulli i ndonjë klasi tjetër ose klasa duhet të përjashtohet nga transporti në se është e mbuluar nga një titull e një klase kufizuese në të cilën nuk është në listë.

(13) Materiali radioaktiv aktiviteti specifik I së cilës e tejkalon 70 kBq/kg(2 nCi/g) dhe e cila:

(a) plotëson keriteret për transport sipas Rregullit 1 të Klasës 7; dhe

(b) ka veti ndërhyrëse e mbuluar nga titulli i ndonjë klasi tjetër ose klasa duhet të plotësojë keriteret për transport sipas Rregullit 1 të Klasës 7, subjekt i kushteve si më poshtë:

(i) në klasën kufizuese, në se një nga klasat përkatëse është një klasë kufizuese dhe substanca është në listë;

ose

(ii) në klasin korespondues të rrezikut predominues të rrezikut shfaqet gjatë transportit, në se një nga klasat në lidhje me të është një klasë kufizuese.

(14) Për qëllim të ADR, substancat, solucionet dhe përzierjet (të tilla si përgatitëset dhe shkrirëset) të cilat nuk mund të përcaktohen në Klasat 1 deri 8 ose 9,1° deri 8°, 13°, 14°, 20°, 21° dhe

31° deri 36°, por të cilat mund të përcaktohen të Klasat 9, 11° ose 12°, mbi bazën e metodës së testit dhe kriterëve në përputhje me Shtojcën A.3, seksion C, anësoret 3320 deri 3326 duhet të konsiderohen të jenë të dëmshme për ambientet ujore.

2002 Solucionet dhe përzierjet (të tilla si përgatitet dhe shkrirëset) për të cilat klasifikimi i vlerave në konformitet me kriteret e klasifikimit nuk janë të vlefshme, duhet të konsiderohen të jenë të ndotura për amientet ujore në se LC50 9/ vlersohet në përputhje me formulën:

LC50 të ndotjes x 100

LC50= -----

Perqindja e ndotjes (në masë)

Është e barabartë ose më e ulët se:

(a) 1mg/l

(b) 10 mg/l në se ndotja nuk është e degraduar ose të degradohet, ka një log Poë ≥ 3.0 .

SHËNIM: Për substancat e Klasës 1 deri 8 dheKlasi 9.1° deri 8°, 13°, 14°, 20°, 21° dhe 31° deri 36°, të cilat janë ndotëse për ambientin ujor në përputhje me kriteret e Shtojcës A.3, seksioni C, anësoret 3320 deri 3326 dhe nuk aplikohet ndonjë kusht shtesë.

(15) Dërguesi i mallrave të rrezikshme sipas këtij Aneksi duhet të sigurojë se personeli i punësuar në lidhje me detyrat e kryerjes së transportit të ketë trainimin përkatës në zonat që ka nën përgjegjësi (shiko Aneksin B, anësoren 10 316)

2003 (1) Ky Aneks përmban për secilin klasë përveç klasës 7:

(a) listën e substancave të rrezikshme që përbëjnë klasën, kur është e aplikueshme sipas anësoreve që mban me gjermën “a” përjashtimet e lejuara nga parashikimet e ADR për disa nga këto substanca në se ato përputhen me disa kushte :

(b) parashikimet e nën-ndarjes si më poshtë:

A. Paketimet:

1. Kushtet e përgjithshme të paketimit

2. Kushtet speciale të paketimit

3. Paketim i përzier

4. Shënimi dhe etiketat e rrezikut mbi paketimet

B. Vecoritë në dokumentet e transportit

C. Paketimet bosh

D. (kur është e pershtshme) parashikime të tjera

(2) Parashikime në lidhje me:

-dorëzimi në mjet të mbuluar, në kontenier dhe në rezervuar

-mënyrat e shpërndarjes dhe të kufizimeve të dërgimit

-ndalimi i ngarkesave të përziera, dhe

9/ ne lidhje me perkufizimet ne anesoren 3326

-pajset e transportit

mund të gjenden në Aneksin B dhe shtojcat e tij, të cilat gjithashtu përmbajnë parashikime të tjera përkatëse të aplikuara në mënyrë të veçantë në transportin me rrugë

(3) Për Klasën 7 parashikimet janë përmbledhur në formën e rregullave të përmbajtura në titujt si më poshtë:

1. Materiale
2. Pako të paketuara
3. Niveli maksimum i radiacionit të paketimit
4. Ndotja në paketim, mjet, konteiner, rezervuar ose në mbipaketimet
5. Infektimi dhe përdorimi i mjeteve, pajseve ose pjesëve
6. Paketim i përzier
7. Ngarkesë e përzier
8. Shënimi dhe etiketat e rrezikut mbi paketimet, Konteinerët, rezervualet dhe mbipaketimet
9. Shënimi dhe etiketat e rrezikut mbi mjetet ose mjetet rezervuar
10. Dokumentet e transportit
11. Sistemimi dhe shpërndarja
12. Transporti i paketimeve, kontejner, rezervuar dhe mbipaketime

13. Parashikime të tjera

(4) Shtojcat e këtij Aneksi përmbajnë:

Shtojca A.1. Stabiliteti dhe kushtet e sigurise në lidhje me substancat, artikujt eksploziv dhe përzierjet e nitratis të nitrocelulozës, si dhe lista e emrave në anësoren 2101

Shtojca A.2 Parashikimet në lidhje me natyrën e lidhjeve-aluminium për disa gaze të Klasës 2: parashikime në lidhje me materialet dhe konstruksionin e enës, që ka për qëllim transportin e gazeve të lëngët me ftohje të madhe të Klasës 2 dhe parashikimet në lidhje me testimin në dispenserat aerosol dhe enët, të vogla, që përmbajnë gaz (fishekë me gaz) të Klasës 2.5:

Shtojca A.3. Testime në lidhje me gazet e djegshëm të Klasave 3, 6.1 dhe 8, testime për përcaktimin e fluiditetit: testime për përcaktimin e ekotoksitetit, qëndrueshmërinë dhe bioakumulimin e substancave në ambient ujor për përcaktimin në Klasin 9.

Shtojca A.5 Kushtet e paketimit të përgjithshëm, tipër e paketimit, kërkesat e aplikueshme për paketim, kërkesat e testimit për paketim:

Shtojca A.6 Kushte e Përgjithshme për përdorimin e kontejnerëve të mbuluar ndërmjetës (IBC), tippër e IBC, kërkesat në lidhje me konstruksionin e IBC dhe specifikimet e testimit për IBC

Shtojca A.7 Parashikime në lidhje me materialet radiokative të Klasës 7.

Shtojca A.9 Parashikime në lidhje me etiketat e rrezikut, dhe spjegimet e simboleve

Shtojca A.4 dhe A.8 janë të rezervuara

2004

2005 Ku aplikohen parashikimet në lidhje me transportin si një “ngarkesë e plotë” autoritetet kompetente mund të kërkojnë që mjeti ose një kontenier i madh të përdoret për kryerjen e transportit në lidhje me ngarkimin vetëm në një pikë dhe të shkarkimin vetëm në një pikë.

2006 (1) Në se mjeti kryen një transport subjekt i parashikimeve të ADR është konvejer në një seksion të udhëtimit përveç se një transport me rrugë atëherë ndonjë nga rregullat kombëtare ose ndërkombëtare, të cilat në seksionin e dhënë drejtojnë transportin e mallrave të rrezikshme me mënyrën e transportit të përdorur për konvejerët mjete rrugore është i aplikueshëm vetëm në seksionin e dhënë të udhëtimit.

(2) Në rastet kur kryerja e transportit subjekt i parashikimeve të ADR është subjekt mbi të gjithë ose të një pjesë të udhëtimit të tij rrugor sipas parashikimeve të një konvente ndërkombëtare e cila rregullon transportin e mallrave të rrezikshme me anë të një mënyre transporti përveçse transportit rrugor sipas klauzolave që shtrijne aplikimin e konventes në fjalë tek disa shërbime mjeteshe, atëherë konventa ndërkombëtare do të aplikohet për udhëtimin në fjalë, në mënyrë konkurruese me ato të ADR të cilat nuk janë të krahasueshme, klauzolat e tjera të ADR nuk do të aplikohen në udhëtimin në fjalë

(3) Në nenin 1(c) të ADR fjala “mjet” duhet ti referohet një nga mjeteve e njëjte. Një operim ndërkombëtar mund të kryhet nga disa mjete të ndryshme kur operimi kryhet në territorin e të paktën dy Palëve Kontraktuese të ADR midis dërguesit dhe dërgesës së treguar në dokumentet e transportit.

2007 Paketimet që përfshijne kontejner ndërmjetës (IBC) , kontenier dhe kontenier rezervuar, të cilat nuk plotësojnë tërësisht kërkesat e paketimit, të paketimit të përzier, të kërkesave të shënimit dhe etiketimit të aneksit dhe shënimit dhe etiketimit e kërkesave të Aneksit B por janë në konformitet me kërkesat e transportit detar ose ajror të mallrave të rrezikshme 10/ do të pranohen për transport para ose duke ndjekur transportin detar ose ajror subjekt i kushteve si më poshtë:

(a) Në se paketimet nuk janë shënuar ose etiketuar në përputhje me ADR ato duhet të shënohen dhe të etiketohen në përputhje me parashikimet e transportit detar ose ajror

(b) Parashikimet për transport detar ose ajror 10/ do të jenë të aplikueshme për transport të përzier brënda një paketimi

(c) Për transportin që duke ndiqet nga transporti detar vetëm në se kontenieri ose kontenieri rezervuar nuk janë shënuar ose etiketuar në përputhje me ADR ato duhet të shënohen dhe etiketohen në përputhje me parashikimet e transportit detar 10/. Në raste të tilla vetëm paragrafi 1 i anësore 10 500 është i aplikueshëm për shënimit dhe etiketimet e vetë mjetit.

(d) Në shtesë të veçorive të përshkruara për ADR , fjala Transport sipas anësore 2007 të ADR” duhet të futet në dokumentet e transportit.

Ky përjashtim nuk aplikohet në raste të mallrave të klasifikuar si mallrat e rrezikshme në Klasin 1 deri 8 në përputhje me ADR dhe të konsideruara si jo të rrezikshme në bazë të parashikimeve

për transportin detar dhe ajror 10/

10/ këto kërkesa janë vendosur në Kodin Detar Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme (IMDG) të publikuar nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO), Londër dhe në Istruksionet Teknike për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme me Ajër të publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) Montreal.

2008 Në se transporti i mallrave të rrezikshme në një kontenier të madh paraprihet nga një udhëtim me det, duhet një certifikatë paketimi të kontenierit sipas paragrafit 12.3.7 të Hyrjes së Përgjithshme në Kodin e IMDG 11/ duhet të jepër me dokumentet e transportit

Funksionet e dokumenteve të transportit të kërkuara sipas anësore 2002(3)(a), e deklaratës së kërkuar sipas anësore 2002(9) dhe të certifikatës së paketimit të kontenierit të dhënë si më sipër duhet të jepen si një dokument i vetëm në se jo këto dokumente duhet të bashkangjiten me njëri tjetrin. Në se këto funksione janë vënë si një dokument i vetëm, futja në dokumentet e transportit të një deklaratë që ngarkesa e kontenierit është kryer në përputhje me rregullat modale të aplikueshme së bashku me identifikimin e personit përgjegjës për certifikatën e paketimit të kontenierit, do të jetë e mjaftueshme. Përdorimi i të dhënave elektronike procesuese (EDP) ose të shkëmbimit teknik të të dhënave elektronike (EDI) si një ndihmëse ose në vend të dokumenteve në letër nuk mund të paragjykoet.

SHËNIM: Certifikatë e paketimit të kontenierit nuk kërkohet për Konteinerët rezervuar.

2009 Parashikimet e vendosura në Aneks nuk alikohën për:

(a) Transportin e mallrave të rrezikshme nga individë privat kur mallrat në fjalë janë paketuar për shitje dhe janë për përdorim vetiak ose të brndshëm, ose për zbavitje, ose aktivitetet sportive;

(b) transporti makinerive ose pajisjeve që nuk janë specifikuar në Aneks dhe të cilat mund të kenë mallrat e rrezikshme në brëndesi të tyre ose pajisje operacionale;

(c) Transporti i kryer nga ndërmarrjet, të cilat kanë shitjen si aktivitet të tyre kryesor, si shpërndarje në interesat e ndërtimeve ose të vendeve civile inxhinierike, ose në lidhje me survejimin, riparime dhe mirembajtje, në sasi jo më shumë se 450 litra për paketim dhe brënda një sasi maksimum të specifikuar në anësoren 10 011.

Transporti i kryer nga ndërmarrjet për furnizimin e tyre ose për shpërndarje të brëndshme ose të jashtme, të cilat nuk bien Brënda qëllimit të këtij përjashtimi.

(d) Transporti i kryer nga, ose nën mbikqyrjen e, shërbimet e ndryshme ndërhyrëse, në veçanti ato të dëmtimeve të mjeteve, dhe të cilat përmbajnë mallrat e rrezikshme.

(e) Transport emergjent me qëllim shpëtimin e jeteve njerëzore ose të mbrojtjes së ambientit ku të jenë marrë të gjitha masat ku të sigurohet së një transport i tillë kryhet me një siguri të plotë.

2010 Për qëllim të transportit të testimit të nevojshëm për të amenduar parashikimet e këtij Aneksi me qëllim për ti adoptuar ato në përputhje me zhvillimin dhe teknologjinë industriale, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të bien dakort direkt midis tyre për të kryer transportin në disa lloje në territorin e tyre duke mos zbatuar përkohsisht parashikimet e këtij Aneksi

11/ Publikimi nga Organizata Detare Ndërkombëtare (IMO) – udhëzimet për përdorim në praktik dhe në trainimin për ngarkesat e mallrave në kontenier të mëdhenj janë përgatitur gjithashtu nga IMO dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe janë publikuar nga IMO – (“ Udhëzime IMO/ILO për Paketimin e Mallrave në Konteniere Mallrave ose Mjete”)

2010 Periudha e vlefshmërisë së anullimit të përkohshëm nuk duhet të jetë më shumë se pesë vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi. Heqja e Përkohshme e pranuar me marrvëshje para 1 janarit 1995 nuk do të jetë e vlefshme pas 31 dhjetorit 1998 përderisa ajo të jetë rinovuar. Heqja e përkohshme automatikisht mbaron nga data e hyrjes në fuqi të një amendamenti korespondues të këtij aneksi. Autoriteti i cili merr inisiativen në lidhje me heqjen e përkohshme do të njoftojë shërbimin kompërent të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për heqjen, shërbimi i të cilit do të jetë në vëmëndjen e Palëve Kontraktuese.

2011 Substancat dhe artikujt e ADR mund të zbatohen deri me 30 qershor 1999 në përputhje me kërkesat e Aneksit A dhe B të ADR të aplikueshme deri me 31 dhjetor 1998. Dokumentet e transportit në këtë rast duhet të kenë mbishkrimin “Transport në përputhje me ADR në fuqi para 1 janarit 1999”

2012

2009

PJESA II LISTA E SUBSTANCAVE DHE PARASHIKIMEVE TË VEÇANTA PËR KLASE TË NDRYSHME

KLASI 1. SUBSTANCAT DHE ARTIKUJT EKSPLOZIV

1. Lista e substancave dhe artikujve.

2100 (1) Midis substancave dhe artikujve të mbuluar nga titulli I Klasës 1, vetëm ato që janë në listën e anësore 2101 ose të përcaktuara si hyrje n.o.s. ose të hyrja “ Modelet 0190, eksplozive” në anësoren 2101 janë të pranueshme për transport. Këto substanca dhe artikuj janë të pranueshëm për transport subjekt i kushteve të vendosura në anësoret 2100 (2) deri 2116, Shtojca A.1 dhe Aneksi B. Ato konsiderohen si substanca dhe artikuj të ADR.

(2) Klasi 1 përfshin:

(a) Substancat eksplozive, substancat solide ose lëngje (ose përzierje të substancave) të afta për reaksione kimike të prodhimit të gazeve në një temperaturë dhe presion të tillë dhe në atë shpejtësi që mund të shkaktojnë dëmtime në ambientin rrethues. Substancat piroteknike: substancë ose përzierje të substancave të përcaktuara që prodhojnë nxehtësi, ndericim, zhurm gaz ose tym ose një kombinim të tyre si rezultat i vetë-shpërthimit të reaksioneve kimike ekzotermike.

SHËNIM 1: Substancat eksplozive të cilat janë shumë të ndjeshme ose të gatëshme për reaksione spontane nuk duhet të pranohen për transport.

SHËNIM 2: Substancat të cilat nuk janë vetë eksplozuese por , mund të formojnë përzierje eksplozivi të gazit, avullit ose pluhurit nuk janë substanca të Klasit1.

SHËNIM 3: Gjithashtu përjashtohen nga Klasa 1: materiale ekspozive të ndotur me ujë ose alkool, ose uji me alkool që tejkalojnë limitet e treguara në anësoren 2101 dhe ato që përmbajnë plastik, keto materiale , janë përcaktuar në Kllasin 4.1 (anësore 2401), 21°, 22° dhe 24°) dhe ato eksplozive, të cilët në bazën e tyre predominon rreziku, janë përcaktuar si të Klasës 5.2.

(b) Artikujt eksploziv: artikuj që përmbajnë një ose më shumë substanca eksplozive dhe/ose substanca piroteknike.

SHËNIM: Mjetet që përmbajnë eksploziv dhe/ose substancë piroteknike në sasi të vogla ose të një karakteri të tillë që në mënyrë indirekte ose shkaktojnë ndezje aksidentale gjatë transportit nuk shkaktojnë ndonjë manifestim të jashtëm tek mjetet me anë të projeksionit, zjarrit, tymit, nxehtësisë ose zhurma të mëdha nuk janë subjekt i kërkesave të Klasës 1.

(c) Substancat dhe artikujt që nuk janë përmendur tek (a) ose (b) më sipër të cilat janë fabrikuar për të prodhuar efekte praktike me anë të eksplozionit ose të efektit piroteknik

(3) Substancat dhe artikujt eksploziv duhet të përcaktohen me një emër tek anësorja 2101 në përputhje me mënyrat e testimi për përcaktimin e vetive eksplozive dhe procedurat e klasifikimit të vendosura në Aneksin A.1 dhe ato duhet të plotësojnë kushtet përkatëse të këtij emri ose duhet të përcaktohen tek një hyrje n.o.s. në anësoren 2101 në përputhje me mënyrat e testimi dhe procedurat e klasifikimit.

Modelet e substancave ose artikujve të reja ose ekzistuese me qëllim transporti përfshijnë: testimin, klasifikimin, kërkimin dhe zhvillimin, kontrollin e cilësisë ose modelin komercial, përveç eksploziveve fillestar, mund të përcaktohen në hyrjen “Modelet 0190, eksplozive”, titulli 51° i anësore 2101.

Përcaktimi i substancave dhe artikujve të pa përmendur me emër në një hyrje n.o.s. ose në hyrjen “Modelet 0190, eksplozive”, si dhe të disa substancave, transporti i të cilave është subjekt i një autorizimi të veçantë nga autoritetet kompetente në përputhje me shënimet e dhëna në listën e substancave dhe të artikujve në anësoren 2101, mund të transportohen vetëm me miratimin e autoriteteve kompetente të vendit të origjinës dhe sipas kushteve të vendosura nga autoriteti.

Në se vendi i origjinës nuk është pjesë në ADR, kushtet e vendosura duhet të njihen nga autoritetet kompetente të vendit të parë të ADR, të arritur nga dërguesi.

Miratimi duhet të lëshohet me shkrim:

(4) Substancat dhe artikujt e Klasës 1, përveç paketimeve boshe, të pa pastëra të 91°, duhet të përcaktohen në një ndarje në përputhje me paragrafin (6) dhe në një grup krahasues në përputhje me paragrafin (7).

Ndarja duhet të bazohet në rezultatet e testimi të përshkruara në Aneksin A.1 duke aplikuar

përkufizimet në paragrafin (6)

Grupi i krahasimit duhet të përcaktohet në përputhje me përkufizimet në paragrafin (7). Kodi i klasifikimit duhet të konsistojë në numrin e ndarjes dhe të gjermës së grupit të krahasimit.

(5) Substancat dhe artikujt e Klasës 1 tek grupi II i paketimit (shiko Shtojcën A.5)

(6) Përkufizimi i ndarjeve

1.1 Substancat dhe artikujt të cilët kanë një masë eksplozivi të rrezikshme. (Masa e eksplozivit është një eksplozion i cili prek pothuaj të tërë ngarkesën virtualisht në mënyrë të menjëherëshme)

1.2. Substancat dhe artikujt të cilat kanë një projeksion të rrezikshëm, por jo masë eksplozivi të rrezikshme.

1.3. Substancat dhe artikujt të cilët kanë ndezje të rrezikshme si dhe një rrezik të vogël shpërthimi ose projeksion të rrezikshëm, ose të dyja bashke, por jo një masë të rrezikshme eksplozivi:

(a) djegia e të cilave jep nxehtësi rrezatuese.; ose

(b) të cilat digjen njëra pas tjetres duke prodhuar shpërthime të vogla ose efekte të projeksionit ose të dyja.

2435 (c). fuçi plastike me kokë të heqshme konform me anësoren 3526 ose (d). kuti çeliku ose alumini konform me anësoren 3522 ose

2436. (1) Substanca të klasifikuara sipas (b) të titujve të ndyshëm duhet të paktohen në:

(a). fuçi çeliku konform me anësoren 3520 ose

(b). fuçi alumini konform me anësoren 3521 ose

(c). bidona çeliku ose alumini konform me anësoren 3522 ose

(d). fuçi plastike dhe bidona konform me anësoren 3526 ose

(e). paketim të përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537 më paketim të brendshëm metalik

(f). paketim i kombinuar konform me anësoren 3538 me paketim të brendshëm metalik

(g). paketim të përbërë (xham, porcelan, veshje guri) konform me anësoren 3539

(h). metal IBC konform me anësoren 3622 ose

(i). plastik e ashpër IBC konform me anësoren 3624

(j). IBC i përbërë me marrësa të brendshëm plastik konform me anësoren 3625, me përjashtim të tipeve 11HZ2 dhe 31HZ2.

(2) Solide si janë përcaktuar në anësoren 2430(10) mund të paktohen gjithashtu në:

(a). fuçi druri konform me anësoren 3523 ose në fuçi fibre konform me anësoren 3525 në se është e nevojshme me një ose më shumë qeska të brendshme kundër rrjedhjes ose

(b). Çanta film plastik konform me anësoren 3535, duke siguruar se ato formojnë një ngarkesë të plotë ose janë të ngarkuara në paleta,

(3) Substancat e 1° mund të paktohen gjithashtu në çanta letre shumë veshje (5M1) dhe çanta rezistente ndaj ujit më shumë veshje (5M2) konform me anësoren 3536.

(4) Bukëpeshku e 2°(b) mund të paktohen gjithashtu në IBC fleksibël, konform me anësoren 3623 me përjashtim të tipeve 13H1 dhe 13L1 dhe 13 M1 duke siguruar se ato formojnë një ngarkesë të plotë ose IBC fleksibël janë të ngarkuara në paleta, (5) 3313 pigment organik, vetë nxehëse, të 5°(b) gjithashtu mund të paktohen në:

(a). çanta rezistente ndaj ujit me shumë veshje (5M2) konform me anësoren 3536.

(b). çanta plastike e thurur, kundër rrjedhjes (5H2) konform me anësoren 3534.

(c). IBC fleksibël, konform me anësoren 3623 me përjashtim të tipeve 13H1 dhe 13L1 dhe 13 M1.

Paketimet dhe IBC referuar sipas (a), (b) dhe (c) mund të transportohen vetëm si një peshë e plotë ose ngarkuar në paleta.

2437 (1) Substanca të klasifikuara sipas (c) të titujve të ndyshëm duhet të paktohen në:

(a). fuçi çeliku konform me anësoren 3520 ose (b). fuçi alumini konform me anësoren 3521 ose

(c). bidona çeliku ose alumini konform me anësoren 3522 ose (d). fuçi plastike dhe bidona konform me anësoren 3526 ose (e). paketime të përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537

- (f). paketime i kombinuar konform me anësoren 3538
- (g). paketime të përbëra (xham, porcelan, veshje guri) konform me anësoren 3539
- (h). paketime metalik mjet i lehtë konform me anësoren 3540

SHËNIM: Paketim metalik për substancat e 4° duhet të konstruktohet dhe të mbyllet që të jepen kur presioni brendshëm arrin një vlerë jo më të madhe se 300 kPa (3 bar)

(2) Me përjashtim të substancave të 4°, substancat mund të paktohen gjithashtu në

- (a). metal IBC konform me anësoren 3622 ose
- (b). plastik e ashpër IBC konform me anësoren 3624 ose
- (c). IBC të përbëra me marrësa të brendshëm plastik konform me anësoren 3625 me përjashtim

të tipeve 11HZ2 dhe 31 HZ2.

(3) Solide si janë përcaktuar në anësoren 2430(10) mund të paktohen gjithashtu në:

(a). fuçi druri konform me anësoren 3523 ose në fuçi fibre konform me anësoren 3525 në se është e nevojshme me një ose më shumë qeska të brëndshme kundër rrjedhjes ose

(b). Çanta kundër rrjedhjes (5L2) konform me anësoren 3533, çanta plastike të thurur kundër rrjedhjes (5H2) konform me anësoren 3534, çanta film plastik (5H4) konform me anësoren 3535 ose me çanta letre rezistente ndaj ujit më shumë veshje (5M2) konform me anësoren 3536.

(4) Me përjashtim të substancave të 4°, solidet si janë përcaktuar në anësoren 2430 mund të paktohen në fleksibël IBC konform me anësoren 3623, me përjashtim të tipeve 13H1, 13L1, dhe 13M1

(5) Substancat e 1°(c) mund të paktohen gjithashtu në çanta letre me shumë veshje (5M1) në përputhje me anësoren 3536. Për 1362 karbon, i aktivizuar, çanta letre më shumë veshje duhet të mbyllet në çanta plastike të vulosura hermetikisht ose të mbështjella ose të shtrënguara të mbështjella në paleta.

(6) Substancat e 2°(c) dhe 3°(c) mund të paktohen gjithashtu në paketime të pa testuara, të cilat duhet vetëm të plotësojnë parashikimet e anësore 3500 (1), (2) dhe (4) deri (7). Pambuk me një përmbajtje vaji më pak se 5% (të masës) gjithashtu mund të mbarten në topa të sigurt.

2438 (1) Rezervuarët e hapur për transport të lëngjeve që kanë një vizkozitet 23° C më pak se 200 mm²/s me përjashtim të ampulave prej xhami dhe cilindrave me presion të paisur me dy mjete në seri një e cila është e mbyllshme duke u rrotulluar ose e siguruar me një mënyrë ekuivalente.

SHËNIM: Për IBC shiko anësoren 3621(8)

Klasi 4.2

2438 (2) fuçi çeliku konform me anësoren 3520 që përmban katalist metali të shkrirë të lagësht të 12°(b) duhet të pajiset me një ventilator në përputhje me anësoren 3500(8)

2439-2440

3. Paketimet e përziera

2441 (1) Substancat e klasifikuara sipas të njëtit titull mund të paktohen së bashku në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538.

(2) Substancat e 6°(a), 11°, 17°(a), 19°(a) dhe 31° deri 33° nuk mund të paktohen së bashku me substancat ose artikujt e titujve të tjerë të Klasës 4.2. me substanca ose artikuj të klasave të tjera ose me mallra të cilat nuk janë subjekt i parashikimeve të ADR.

(3) Me përjashtim të substancave referuar në (2) me lart, substancat e Klasës 4.2. në sasi që nuk tejkalojnë 3 litra për lëngje dhe/ose 6kg për solide, për marrësa, mund të paktohen së bashku në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538, me substanca ose artikuj të klasave të tjera duke siguruar së paketimet e përziera janë gjithashtu të lejuara për substancat dhe artikujt e këtyre klasave- dhe/ose mallra të cilat janë subjekt i parashikimeve të ADR duke siguruar së ato nuk bëjnë reaksion me njëra tjetrën.

Për substancat e klasifikuara në grupin (a) , sasia neto për paketim nuk duhet të tejkalojë 3 kg për solide dhe 3 litra për lëngje.

(4) Konsiderohen reaksione të rrezikshme si më poshtë:

- (a). të djegshme dhe ose që prodhojnë nxehtësi të konsiderueshme
- (b). emetim i gazeve toksik dhe/ose të djegshëm
- (c). formim të lëngjeve gërryes
- (d). formim të substancave të pa qëndrueshme.

(5) Parashikimet e anësore 2002(6) dhe (7) dhe 2432 duhet të shqyrtohen.

(6) Një paketim nuk duhet të peshojë më shumë se 100 kg kur përdoren kasa druri ose fibre
4. Shenjat dhe etiketat e rrezikut mbi paketime (shiko Shtojcën A.9)

Shenjat.

2442 (1) Çdo paketim duhet të jetë i shënuar në mënyre të qartë me numrin e identifikimit të mallrave për tu futur në dokumentet e transportit, të paraprirë nga gërmat “UN”

Etiketat e rrezikut

(2) Paketimet që përmbajnë substanca të klasës 4.2 duhet të kenë një etiketë konform Modelit Nr.4.2.

(3) Paketimet që përmbajnë substanca të 17°(a) maneb ose përgatitje manebi të 16°(c) dhe substanca të 31° deri 33° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 4.3.

Klasi 4.2

2442 (4) Paketimet që përmbajnë substanca të 7°, 8°, 11°, 18° dhe 19° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 6.1

(5) Paketimet që përmbajnë substanca të 9°, 10°, 15°, 20° dhe 21° duhet të kenë një etiketë konform Modelit Nr. 6.1. dhe një etiketë konform Modelit Nr.8.

(6) Paketime që përmbajnë lëngje, mbyllja e të cilëve nuk është e dukshme nga jashtë dhe paketimet që përmbajnë marrësa të venteluar ose marrësa të venteluar pa paketim të jashtëm dhe paketime që përmbajnë fosfor të 11°(a) në shtesë duhet të kenë në të dy anët e kundërta një tabelë konform Modelit Nr 11.

2443

B. Veçoritë në dokumentet e transportit.

2444 Përshkrimi i mallrave në dokumentet e transportit duhet të jetë konform me një nga numrat e identifikimit dhe emrat në anësoren 2431.

Në se substanca nuk është përmendur me emër, por është përcaktuar në një hyrje n.o.s. ose në ndonjë hyrje tjetër kolektive përshkrimi i mallrave do të konsistojë në numrin e identifikimit dhe në n.o.s ose në përcaktimin e hyrjes kolektive, e ndjekur nga emri kimik ose teknik 3/

Përshkrimi i mallrave do të ndiqet nga veçoritë e klasës, numri i identifikimit në se është i aplikueshëm, gërma dhe inicialet “ADR” ose (RID), p.sh “4,2. 13°(b),ADR”

Për transportin e shkrirësave (shiko anësoren 2000(5) përshkrimi i mallrave do të jetë ”Përmbajtje e shkrirësave...” komponentët e përdorur për klasifikimin e shkrirësave sipas anësore 2002(8) dhe të futet sipas emrit të tij kimik p.sh. “Shkrirës që përmban 1281 fosfor të bardhë nën ujë 4.2,11°(a) ADR”.

Për transportin e solucionëve ose përzierjeve (të tillë si përgatitjet dhe shkrirësit) që përmbajnë disa komponentë subjekt i parashikimeve të ADR nuk është e nevojshme në përgjithësi tu referohesh më shumë se dy komponentëve të cilët kontribuojnë më shumë në rritjen e rrezikut të solucionëve ose përzierjeve.

Në se një substancë e emëruar në përputhje me anësoren 2430(9) nuk është subjekt i kushteve të këtij klasi, dërguesi mund të fusë në dokumentin e transportit : “Nuk ka mallra të Klasës 4.2”.

Në transportin e solucionëve dhe përzierjeve që përmban vetëm një komponent subjekt i parashikimeve të ADR, fjala “solucion” ose “përzierje” duhet të shtohet si pjesë e emrit në dokumentet e transportit shiko anësoren 2002(8)(a)

Kur një solid do të transportohet në një gjendje të shkrirë përshkrimi i mallrave do të këtë me tepër specifikimin “i shkrirë” megjithëse termi mund të duket te emërtimi.

2445-2451

3/Emri teknik duhet të jetë një emër aktualisht i përdorur në librat shkencore dhe teknik, gazeta dhe tekste. Emri tregtar nuk duhet të përdoret për këtë qëllim.

Klasi 4.2

C. Paketime bosh

2452 (1) Paketime bosh përfshijnë IBC bosh, të papastëra te 41°. Do të mbyllet në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën shkallë të rrjedhjes sikur ato të ishin plot.

(2) Paketime bosh përfshijnë IBC bosh, të papastra te 41° duhet të kenë të njëjtën përshkrim dhe etiketat e rrezikut sikur ato të ishin plot.

(3) Përshkrimi i mallrave në dokumentet e transportit duhet të jetë konform me një nga emrat e 41° p.sh. “Paketim bosh 4.2, 41°, ADR”

Në rast të mjeteve rezervuar bosh, rezervuarve të çmontueshëm bosh dhe konteniereve-rezervuar bosh , të papastër. Ky përshkrim duhet të plotësohet duke shtuar fjalët “Ngarkesë e fundit” së bashku me emrin dhe numrin e titullit të mallrave të ngarkimit të fundit p.sh. “Ngarkimi fundit 1381 fosfor i thatë, 11 ° (a)”

2453-2469

KLASI 4.3. SUBSTANCAT TË CILAT NË KONTAKT ME UJIN EMETOJNË GAZE TË DJEGSHËM

1.Lista e substancave

2470 (1) Midis substancave dhe artikujve të mbuluar nga titulli i Klasës 4.3 , ato të cilat janë në listë në anësoren 2471 ose të mbuluara nga një titull kolektiv të kësaj anësore janë subjekt i kushteve të vendosura në anësoren 2470(2) deri 2492 dhe të parashikimet e këtij Aneksi dhe të Aneksit B. Ato janë konsideruar si substanca të ADR

SHËNIM: Për sasitë e substancave dhe artikujve në listë në anësoren 2471 të cilat nuk janë subjekt i parashikimeve për këtë Klas, ose në Aneks ose në Aneksin B shiko anësoren 2471a.

(2) Titulli i Klasës 4.3 mbulon substancat dhe artikujt të cilat bëjnë reaksion me ujin dhe emetojnë gaze djegës të gatshëm për të formuar përzierje eksplozive me ajrin.

SHËNIM. Termi “reaksion-ujë” e përdorur në hyrjet n.o.s të anësore 2471 shënon një substancë e cila në kontakt me ujin emeton gaze të djegshme.

(3) Substancat dhe artikujt e Klasës 4.3 janë nëndare si më poshtë:

A. Substanca organike, organometalik të përbëra dhe substanca në shkrirës organik të cilët në kontakt me ujin emeton gaze të djegshëm.

B. Substanca inorganike të cilët në kontakt me ujin emeton gaze të djegshëm.

C. Artikuj të cilët përmbajnë substanca të cilët në kontakt me ujin emeton gaze të djegshëm.

D Paketime bosh

Substancat dhe artikujt e Klasës 4.3, të klasifikuar sipas titujve të ndryshëm të anësore 2471, do të përcaktohen në një nga grupet vijuese të përcaktuar nga gërma (a), (b) ose (c) në përputhje me shkallën e tyre të rrezikut.

(a). shumë të rrezikshme

(b). të rrezikshme

(c). më pak të rrezikshme

(4) Përcaktimi i substancave që nuk janë përmendur me emër në anësoren 2471, 1°,3°,11°,13°,14°,16° dhe 20° deri 25°, si dhe brënda titujve të këtyre gërmave mund të bazohen në eksperiencë ose në rezultatet e procedurave të testimeve në përputhje me Manualin e Testimeve dhe Kriteret Pjesa III, seksioni 33.4. Eksperiencia duhet të merret në llogari në rast të përcaktimeve më strikte.

(5) Kur substancat jo të specifikuar me emër janë përcaktuar të titujt e anësore 2471 mbi bazën e procedurave të testimit në përputhje me Manualin e Testimeve dhe Kriteret Pjesa III, seksioni 33.4. duhet të aplikohen kriteret si më poshtë

Një substancë do të përcaktohet te Klasa 4.3 në se:

(a) gjatë çdo faze të testimit gazi i emetuar ndizet spontanisht, ose

(b) Shkalla e emetimit të gazit të djegshëm, është e barabartë me ose më e madhe se 1 litër për kilogram për orë të substancës që do të testohet

Klasi 4.3

2470 (6) Kur substancat jo të specifikuar me emër janë përcaktuar tek gërmat e titujve të anësore 2471 mbi bazën e procedurave të testimit në përputhje me Manualin Testimit dhe Kriteret, Pjesa III seksioni 33.4, zbatohen kriteret si më poshtë:

(a) Çdo substancë që zhvillon reaksion të fuqishëm me ujin në ambient me temperaturë që prodhon gaz i cili ndizet spontanisht, ose të tillë që vepron menjëherë me ujin në temperaturën e ambientit të tillë që shkalla e emetimit të gazit të djegshëm brënda një minuti është e barabartë ose më e madhe se 10 litra për kilogram të substancës, do të përcaktohet në gërmën (a)

(b) Çdo substancë që zhvillon reaksion të menjëhershëm me ujin në ambient me temperaturë e tillë që shkalla maksimum e emetimit të gazeve për orë është e barabartë ose më e madhe se 20 litra për kilogram të substancës, dhe e cila nuk plotëson kriteret e gjermës (a) do të përcaktohet në gjermën (a)

c). Çdo substancë që zhvillon reaksion të ngadalshëm me ujin në ambient me temperaturë të tillë që shkalla maksimum e emetimit të gazeve për orë është e barabartë ose më e madhe se 1 litër për kilogram të substancës, dhe e cila nuk plotëson kriteret e gjermës (a) ose (b) do të përcaktohet në gjermën (c)

(7) Në se substancat e Klasës 4.3 si rezultat i përzierjes, bien në kategori të ndryshme të rrezikut nga të cilat substancat e anësore 2471 i përkasin, këto përzierje do të përcaktohen në titujt dhe gjermat tek të cilat ato u përkasin mbi bazën e shkallës së tyre aktuale të rrezikut.

SHËNIM: Për klasifikimin e solucioneve dhe përzierjeve (të tilla si përgatitjet dhe shkrirësat) shiko gjithashtu anësoren 2002(8)

(8) Kur substancat dhe artikujt janë emëruar në mënyrë specifike sipas më shumë se një gjërme të të njëjtit titull të anësore 2471 gjërma përkatëse mund të përcaktohet mbi bazën e rezultateve të procedurave të testimit në përputhje me Manualin Testimit dhe Kriteret, Pjesa III seksioni 33,4, dhe kriteret e vendosura në paragrafin (6)

(9) Mbi bazën e procedurave të testimit në përputhje me Manualin Testimit dhe Kriteret, Pjesa III seksioni 33,4, dhe kriterëve të vendosura në paragrafin (6), ajo gjithashtu mund të përcaktohet në se natyra e një substance e emëruar në mënyrë specifike është e tillë që substanca nuk është subjekt i parashikimeve për këtë klas (shiko anësoren 2484)

(10) Substancat dhe përzierjet e substancave që kanë një pikë shkrirje më të lartë se 45°C do të konsiderohen si solide për qëllim të kushteve të paketimit të anësore 2474(2), 2475(3) dhe 2476(2)

(11) Solidet reaksion-uji të djegshme, të përcaktuara te numri identifikimit 3132, solide reaksion-uji oksiduese, të përcaktuar te numri identifikimit 3133 dhe solidet reaksion-uji, vetë-nxehëse, të përcaktuar te numri identifikimit 3135 të Rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara mbi Transportin e Mallrave të Rrezikshme, nuk duhet të pranohen për transport (shiko sidoqoftë anësoren 2002(8) shënimin në fund të faqes 1/ tek tabela në paragrafin 2.3.1.

2471 A. Substancat organike, përbërësat organometalik dhe substancat në solvente organike të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze të djegshme

1° Klorosilan:

1183 etildiklorosilan. 1242 metildiklorosilan, 1295 triklorosilan. 2988 klorosilan, reaksion-uji, i djegshëm, gjërres n.o.s.

SHËNIM 1: Kushtet e paketimit të veçantë janë të aplikueshme për këto substanca (shiko anësoren 2473(1))

SHËNIM 2: Klorosilanët që kanë një pikë flesh të barabartë ose më të madhe se 23°C dhe të cilët në kontakt me ujin nuk emetojnë gaze të djegshëm janë substanca të Klasës 3 [shiko anësoren 2301, 21°(a)]

SHËNIM 3: Klorosilanët duke patur një pikë flesh më të vogël se 23°C dhe të cilët në kontakt me ujin nuk emetojnë gaze të djegshëm janë substanca të Klasës 8 (shiko anësoren 2801, 37°)

2° trifluorid boron kompleks si më poshtë:

2965 trifluorid boron dimetileterat

3° Përbërësa organometalik dhe solucionet e tyre:

(a). 1928 bromid metilmagnezium në eter etil

3207 Përbërësa organometalik, reaksion-uji, i djegshëm n.o.s. ose 3207 solucion i përbërësve organometalik reaksion-uji, i djegshëm n.o.s. ose 3207 shpërbërje e organometalik, i përbërë reaksion-uji, i djegshëm n.o.s.

SHËNIM: Kushtet e paketimit të veçantë janë të aplikueshme për këto substanca (shiko anësoren 2473(2))

(b). 3207 Përbërësa organometalik, reaksion-uji, i djegshëm n.o.s. ose 3207 solucion i përbërësve organometalik reaksion-uji, i djegshëm n.o.s. ose 3207 shpërbërje e organometalik, i përbërë reaksion-uji, i djegshëm n.o.s.

(c). 3207 Përbërësa organometalik, reaksion-uji, i djegshëm n.o.s. ose 3207 solucion i përbërësve

organometalik reaksion-ujë, i djegshëm n.o.s. ose 3207 shpërbërje e organometalik, i përbërë reaksion-ujë, i djegshëm n.o.s.

SHËNIM 1: Përbërja organometalik dhe solucionet e tyre të cilët ndizen spontanisht janë substanca të Klasës 4.2 (shiko anësoren 2431, 31° dhe 33°)

SHËNIM 2: Solucionet e djegshme me përbërja organometalik në koncentrim të cilët në kontakt me ujë ose emetojnë gaze të djegshëm në sasi të rrezikshme ose ndizen spontanisht janë substanca të Klasës 3.

Klasi 4.3

2471 B Substanca organike të cilat në kontakt me ujë emetojnë gaze të djegshëm.

SHËNIM 1: Grupi i metaleve alkali përfshin elementet litium, sodium, potasium, rubidium dhe kaesium.

SHËNIM 2: Metalet alkali dhe metalet tokë alkaline përfshijnë elementet magnezium, kalcium, strontium dhe barium.

11° Metalet alkali dhe metalet tokë alkaline dhe lidhjet e tyre dhe përbërjet metalike:

(a). 1389 amalgam metal alkali, 1391 shpërbërës metal alkali ose 1391 shpërbërës metalet tokë alkaline, 1392 amalgam metalet tokë alkaline. 1407 kaesium, 1415 litium, 1420 potasium lidhje metalike. 1422 potasium lidhje sodium. 1423 rubidium, 1428 sodium, 2257 potasium,

1421 alkali lidhje metalike, lëng, n.o.s.

(b). 1400 barium, 1401 kalcium

(c). 2950 granule magneziumi, i veshur me pjesëza jo më të vogla se 149 mikron.

SHËNIM 1: metalet tokë alkaline dhe lidhjet metalike tokë alkaline në formë piroforike janë substanca të Klasës 4.2 (shiko anësoren 2431, 12°)

SHËNIM 2: 1869 magnezium ose 1869 lidhje magneziumi që përmban më shumë se 50% magnezium si palet në rripa janë substanca të Klasës 4.1 [shiko anësoren 2401, 13°(c)]

SHËNIM 3: 1418 pluhur magneziumi dhe 1418 lidhje magneziumi në formë pluhuri janë substanca të 14°.

SHËNIM 4: 3292 bateri, që përmbajnë sodium ose 3292 qeliza, që përmbajnë sodium dhe artikujt e titullit 31°(b)

12° Lidhjet silikon dhe metalet silikon.

(b). 1405 silicid kalcium, 1417 silikon litium, 2624 silicid magnezium, 2830 ferrosilikon litium

(c). 1405 silicid kalcium, 2844 silikon mangan kalcium.

SHËNIM: Për substancat e (c) shiko gjithashtu anësoren 2471a.

13° Metale të tjerë lidhje metalike dhe përzierje, jo-toksike të cilat në kontakt me ujë emetojnë gaze të djegshëm:

(a). 3208 substanca metalike, reaksion-ujë n.o.s.

(b). 1369 pluhur alumini, i pa veshur, 3078 cerium i përthyer ose në pluhur të imët

3170 alumin i shkrirë nga prodhimi ose 3170 alumin i rishkrirë nga prodhimi, 3208 substanca metalike, reaksion-ujë n.o.s.

Klasi 4.3

2471 (c). 1398 pluhur silikon alumini, i pa veshur, 1435 hi zinku,

3170 alumin i shkrirë nga prodhimi ose 3170 alumin i rishkrirë nga prodhimi, 3208 substanca metalike, reaksion-ujë n.o.s.

SHËNIM 1: Pluhuri dhe mbetje pluhur të metaleve në formë piroforike janë substanca të Klasës 4.2 (shiko anësoren 2431, 12°)

SHËNIM 2: pluhur silikon alumini, i veshur nuk është subjekt i parashikimeve të ADR

SHËNIM 3: 1333 cerium në bllok, në formë shkopi, ose lingote janë substanca të Klasës 4.1 [shiko anësoren 2401, 13°(b)]

14° Metalet dhe lidhjet metalike në formë pluhuri ose në një formë tjetër, e cila në kontakt me ujë emeton gaze të djegshëm dhe janë në gjendje për vetë-nxehje:

(a). 1436 pluhur zinku, ose 1436 mbetje pluhuri zinku, 3209 substanca metalike, reaksion-ujë, vetë-nxehëse n.o.s.

(b). 1418 pluhur magnezium ose 1418 pluhur lidhje magneziumi, 1436 pluhur zinku, ose 1436 mbetje pluhuri zinku, 3209 substanca metalike, reaksion-ujë, vetë-nxehëse n.o.s.

(c).1436 pluhur zinku, ose 1436 mbetje pluhuri zinku, 3209 substanca metalike, reaksion-uji, vetë-nxehëse n.o.s.

SHËNIM 1: Metalet dhe lidhjet metalike në formë piroforike janë substanca të Klasës 4.2 (shiko anësoren 2431, 12°)

SHËNIM 2: Metalet dhe lidhjet metalike të cilat në kontakt me ujin nuk emetojnë gaze të djegshme dhe nuk janë piroforik dhe vetë-nxehëse, por të cilat nuk mund të ndizen lehtë janë substanca të Klasës 4.1 (shiko anësoren 2401, 13°)

15° Metalet dhe lidhjet metalike, toksike.

(b). 1395 pluhur ferrosilikon aluminiumi

(c). 1408 ferrosilikon me 30% ose më shumë por më pak se 90% silikon.

SHËNIM: Ferrosilikon që përmban më pak se 30% ose jo më pak se 90% (masës) silikoni nuk është subjekt i parashikimeve të ADR.

16° Hidride metali.

a. 1404 hidrid kalciumi, 1410 hidrid aluminium litium, 1411 hidrid aluminium litium, etereal, 1413 borohidrid litium, 1414 hidrid litium, 1426 borohidrid sodium, 1427 hidrid sodium, 18700 borohidrid potasium, 2010 hidrid magnezium, 2463 hidrid aluminium, 1409 hidrid metal, reaksion-uji n.o.s.

b. 2805 hidrid litium, solid , i derdhur. 2835 hidrid aluminium sodium, 1409 hidrid metal, reaksion-uji n.o.s.

Klasi 4.3

SHËNIM 1: 1871 hidrid titanium dhe 1437 hidrid zirkonium janë substanca të Klasës 4.1 (shiko anësoren 2401, 14°)

SHËNIM 2: 2870 borohidrid aluminium është një substancë e Klasës 4.2 [shiko anësoren 2431, 17°(a)]

17° Metale karbid dhe metale nitrit

(a). 2806 nitrit litium

(b). 1394 karbid aluminium. 1402 karbid kalcium.

18° Metal fosfide, toksik.

1360 fosfid kalcium, 1397 fosfid aluminium, 1419 fosfid aluminium magnezium, 1432 fosfid sodium, 1433 fosfidstani, 1714 fosfidzinku, 2011 fosfid magnezium, 2012 fosfid potasium, 2013 fosfid strontium.

SHËNIM 1: Përbërësit e fosforeve me metale të tillë si hekur, bakër, etj nuk janë subjekt i parashikimeve të ADR.

SHËNIM 2: 3948 pesticid fosfid aluminiumi me aditiv ndalues të emetimit të gazeve djegës janë substanca të Klasës 6.1 [shiko anësoren 2601, 43°(a)]

19° Metale amide dhe metale cianamide.

(b). 1390 amide metal alkali

(c). 1403 cianimid kalcium me jo më shumë se 0.1% (masë) karbid kalciumi.

SHËNIM 1: cianimid kalcium që përmban jo më shumë se 0.1% (masë) karbid kalcium nuk është subjekt i parashikimeve të ADR.

SHËNIM 2: 2004 diamid magneziumi është një substancë e Klasës 4.2 [shiko anësoren 2431, 16°(b)]

20° Substanca solid inorganike dhe përzierje (të tilla si përgatitje dhe shkrirësa) të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze djegëse, jo-toksike dhe jo-gërryese dhe të cilat nuk mund të klasifikohen sipas titujve të tjerë.

(a). 2813 reaksion-uji, solid, n.o.s.

(b). 1340 pentasulfid fosforus (P₂S₂) i lirë nga fosfori i verdhë dhe i bardhë, 2813 reaksion-uji, solid, n.o.s.

SHËNIM: pentasulfid fosforus (P₂S₂) jo i lirë nga fosfori i verdhë dhe i bardhë nuk mund të pranohet për transport.

c. 2968 maneb (etilen manganez 1,2-bis(ditiokarbamat) I stabilizuar kundër vetë-nxehjes ose 2968 përgatitje manebi I stabilizuar kundër vetë-nxehjes

2813 reaksion-uji, solid, n.o.s.

SHËNIM: 2210 maneb ose 2210 përgatitje manebi në formë vetë-nxehëse janë substanca të

Klasës 4.2 [shiko anësoren 2431, 16°(c), shiko dhe anësoren 2471a(1) (c)]

21° Substancat inorganike lëngje dhe solucionet e substancave inorganike (të tilla si përgatitjet dhe shkrirësat) të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze djegëse, jo-toksike dhe jo-gërryese dhe të cilat nuk mund të klasifikohen sipas titujve të tjerë.

3148 reaksion-uji, solid, n.o.s.

SHËNIM: Kushtet e paketimit të veçantë janë të aplikueshme për këtë substancë shiko dhe anësore 2473(2)

b. 3148 reaksion-uji, solid, n.o.s.

c. 3148 reaksion-uji, solid, n.o.s.

22° Substancat inorganike solide dhe përzierjet (të tilla si përgatitjet dhe shkrirësat) të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze djegëse, jo-toksike dhe jo-gërryese dhe të cilat nuk mund të klasifikohen sipas titujve të tjerë.

(a). 3134 reaksion-uji, solid, n.o.s.

(b). 3134 reaksion-uji, solid, n.o.s.

(c). 3134 reaksion-uji, solid, n.o.s.

SHËNIM: Per kriteret toksike shiko dhe anësore 2600(3)

23° Substancat inorganike lëngje dhe solucionet e substancave inorganike (të tilla si përgatitjet dhe shkrirësat) të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze djegëse, toksike dhe të cilat nuk mund të klasifikohen sipas titujve të tjerë.

3130 reaksion-uji, solid, n.o.s.

SHËNIM: Kushtet e paketimit të veçantë janë të aplikueshme për këtë substance shiko dhe anësore 2473(2)

(b). 3130 reaksion-uji, solid, n.o.s.

(c). 3130 reaksion-uji, solid, n.o.s.

SHËNIM: Për kriteret toksike shiko dhe anësoren 2600(3)

24° Substancat inorganike solide dhe përzierjet (të tilla si përgatitjet dhe shkrirësat) të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze djegëse, gërryese dhe të cilat nuk mund të klasifikohen sipas titujve të tjerë.

(a). 3131 reaksion-uji, solid, n.o.s.

(b). 3131 reaksion-uji, solid, n.o.s.

(c). 3131 reaksion-uji, solid, n.o.s.

Klasi 4.3

2471 SHËNIM: Për kriteret gërryese shiko dhe anësoren 2800(3)

25° Substancat inorganike lëngjet dhe solucionet e substancave inorganike (të tilla si përgatitjet dhe shkrirësat) të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze djegëse, gërryese dhe të cilat nuk mund të klasifikohen sipas titujve të tjerë.

3129 lëng reaksion-uji n.o.s.

SHËNIM: Për kriteret toksike shiko dhe anësore 2473(2)

(b). 3129 lëng reaksion-uji n.o.s.

(c). 3129 lëng reaksion-uji n.o.s.

SHËNIM: Për kriteret gërryese shiko dhe anësore 2800(3)

C. Artikujt që përmbajnë substanca të cilat në kontakt me ujin emetojnë gaze djegëse.

SHËNIM: Kushtet e paketimit të veçantë janë të aplikueshme për këtë substancë shiko dhe anësore 2473(5)

(b). 3292 bateri, që përmbajnë sodium ose

3292 kontenier i vogël, që përmban sodium.

SHËNIM 1: Bateritë ose Konteinerët e vegjël që nuk përmbajnë substanca të ADR përveç sodiumit, sulfur ose polisulfid.

SHËNIM 2: Bateritë ose Konteinerët e vegjël nuk duhet të pranohen për transport në një temperaturë të tillë që sodiumi elemental lëng të jetë prezent në bateri ose në ose Konteinerët e vegjël në se nuk është miratuar sipas kushteve të vendosura nga autoriteti kompetent i vendit të origjinës. Në se vendi i origjinës nuk është një Palë Kontraktuese e ADR miratimi dhe kushtet e transportit duhet të njihen nga autoritetet kompetente të Palës së parë Kontraktuese të ADR të mbërritur nga dërguesi.

SHËNIM 3: Konteinerët e vegjël duhet të jenë kasa metali të vulosura hermetikisht e cila të

bylle plotësisht mallrat e rrezikshme dhe të cilët të jenë konstruktuar në atë mënyrë dhe të mbyllur për të parandaluar daljen e përmbajtjes në kushtet normale të transportit.

SHËNIM 4: Bateritë duhet të jenë në konteniere të vegjël, të sigurt brënda dhe e sigurt brënda një kase metali të mbyllur të konstruktuar në atë mënyrë dhe të mbyllur për të parandaluar daljen e mallrave të rrezikshme në kushtet normale të transportit.

D. Paketimet bosh

41° Paketimet bosh përfshijnë Konteinerët ndërmjetës bosh IBC, mjetet rezervuar bosh, rezervuarët e çmontueshëm bosh dhe Konteinerët rezervuar bosh, të pa pastër si dhe mjetet bosh për transportin në masë dhe konteniere të vegjël bosh, të pa pastër të cilët përmbajnë substanca dhe artikuj të Klasës 4.3.

Klasi 4.3

2471a (1) substancat e titujve të ndryshëm zbatuar sipas kushteve vijuese nuk janë subjekt i parashikimeve për këtë klasë të përmbajtura në Aneksin A dhe në Aneksin B, përveç si janë dhënë në paragrafin (2) më poshtë:

(a). Substancat e klasifikuara sipas (a) të çdo titulli janë mbuluar nga kjo anësore:

(b) Substancat e klasifikuara sipas (b) të çdo titulli:

lëngje deri në 500 ml për paketim të brendshëm

pluhur aluminiun prej 13°(b) deri në 1 kg për paketim të brendshëm

solide të tjerë deri në 500 gr për paketim të brendshëm

(c). Substancat e klasifikuara sipas (c) të çdo titulli:

lëngje deri në 1 litër për paketim të brendshëm

solide të tjerë deri në 1 kg për paketim të brendshëm.

Këto sasi substancash do të transportohen në paketime të kombinuara, e cila të paktën të plotësojë kushtet e anësore 3538. Një paketim nuk duhet të peshojë më shumë se 30 kg. Këto sasi të përmbajtura në paketimet të brendshme metalike ose plastike të cilat nuk mund të thyhen ose të shpohen lehtë gjithashtu mund të transportohen në fletë të mbështjella të përdorura si paketim i jashtëm duke siguruar që masa bruto totale e paketimit nuk i tejkalon 20 kg.

“Kushtet e Paketimit të përgjithshëm” të anësore 3500(1),(2) dhe (5) deri (7) duhet të shqyrtohen.

(2)Për transportin në përputhje me paragrafin (1) më sipër çdo paketim duhet të jetë i shënuar qartë dhe në mënyrë të qëndrueshme.

(a) numri identifikimit të mallrave të përmbajtura duhet të parprihen me gërmat UN

(b) Në rast të mallrave të ndryshëm me numra identifikimi të ndryshëm brënda një paketimi:

- numrat e identifikimit të mallrave të përmbajtur duhet të parprihen nga gërmat UN ose

-gërmat :LQ” 1/

Këto shenja duhet të jenë në një zone në formë diamanti e rrethuar nga një linjë me përmasa të paktën 100 x 100 mm. Në se përmasa e paketimit e kërkon në këtë mënyrë, ndryshe dimensionet mund të zvogëlohen duke siguruar që shenjat të mbeten të dallueshme.

(3) Bateritë e 31°(b) të instaluar në mjet nuk janë subjekt i parashikimeve të kësaj Klase të përmbajtur në këtë Aneks ose në Aneksin B.

1/ gërmat “LQ” janë shkurtim i fjalëve anglisht “Sasi të kufizuara”

Klasi 4.3

2. Parashikime

A. Paketime

1. Kushtet e përgjithëshme të paketimit

2472 (1) Paketimet duhet të përmbushin kushte e Shtojcës A.5 në se kushtet e veçanta për disa substanca nuk janë përshkruar në anësoret 2473

Konteinerët e ndërmjetëm (IBC) duhet të plotësojnë kushtet e Shtojcës A.6

(2) Paketimet që përfshijnë konteniere masiv të ndërmjetem IBC duhet të jenë të mbyllur hermetikisht për të parandaluar ndonjë infiltrim të lagështisë ose ndonjë humbje të përmbajtjes. Ato duhet të ventilojnë në përputhje me anësoret 3500(8) ose 3601(6)

(3) Në përputhje me parashikimet e anësoreve 2470(3) dhe 3511(2) ose 3611(2) duhet të përdoren kërkesat si më poshtë”

-paketimet ose grupi i paketimeve i shënuar me gërmën “X” ose IBC të grupit I të paketimit shënuar me gërmën “X” për substanca shumë të rrezikshme të klasifikuara sipas gërmës (a) të çdo titulli

-paketimet ose grupi i paketimeve II ose I i shënuar me gërmën “Y”, ose “X”, ose IBC të grupit II ose I të paketimit, shënuar me gërmën “Y” ose “X” për substanca të rrezikshme klasifikuar sipas gërmës (b) të çdo titulli

- paketimet ose grupi i paketimeve III, II ose I i shënuar me gërmën “Z”, “Y” ose “X”, ose IBC të grupit të paketimit III, II ose I, shënuar me gërmën “Z” ose “Y” ose “X” për substanca më pak të rrezikshme klasifikuar sipas gërmës (c) të çdo titulli

SHËNIM: Për transportin e substancave të Klasës 4.3 në mjete rezervuar, rezervuar të çmontueshëm ose konteniere rezervuar dhe për transport në masë shiko Aneksin B.

2. Kushtet e veçanta të paketimit.

2473 (1) (a) Klorosilan I 1° (a) duhet të paketohen në marrësa çeliku rezistente gërryese me një kapacitet maksimum prej 450%. Rezervuarët duhet të jenë subjekt i testeve fillestare dhe testeve periodike çdo 5 vjet në një presion jo më të vogël se 0.4 Mpa (4 bar) (presioni mjeteve matëse) Mjetet mbyllëse të rezervuarëve duhet të jetë e ,brojtur nga një tapë. Masa e lejueshme maksimum të mbushjes për litër të kapacitetit për triklorosilan, etildiklorosilan dhe metildiklorosilan nuk duhet të tejalojë 1.14 kg, 0.93 kg ose 0.95 kg respektivisht në masë, në se mbushja është në volum, shkalla e mbushjes nuk duhet të tejalojë 85%. Rezervuarët gjithashtu duhet të kenë një tabelë që tregon veçoritë në një formë të qëndrueshme.

- klorosilan Klasi 4.3

- përshkrimi i klorosila(ve) të pranuar për transport

-qëllimi 2/ të rezervuarëve, përfshi aksesorët

2/ Njësitë e matjes të shtohen çdo kohë pas vlerës numrike.

Klasi 4.3

2473 - presioni testimi 3/ (presioni mjeteve matëse):

-data (muaji, viti i testimit të fundit)

-vula e ekspertit që ka kryer testimin

-kapaciteti 3/ i rezervuarëve

-shkalla maksimum e mbushjes së lejuar në masë 3/ për çdo substancë të pranuar për transport

(b). Klorosilanët e 1°(a) gjithashtu mund të paketohen në paketime të kombinuara me paketime të brëndshme metalike plastike ose xhami konform me anësoren 3538. Paketimet e brëndshme duhet të jenë të mbyllura hermetikisht dhe të kenë një kapacitet maksimum prej 1 litër. Një paketim nuk duhet të peshojë më shumë se 30 kg. Paketimet e kombinuara duhet të testohen dhe miratohen në përputhje me Sstojcën A.5 për paketimet e grupit I.

(2) Substancat e 3°(a), 21°(a), 23°(a) dhe 25°(a) duhet të paketohen në marrësa metalik të mbyllur hermetikisht të cilët nuk duhet të preken nga përmbajtja dhe të kenë një kapacitet jo më shumë se 450 litra. Rezervuarët duhet të jenë subjekt i testeve fillestare dhe testeve periodike çdo 5 vjet në një presion jo më të vogël se 1 Mpa (10 bar)(presioni mjetit matës)

Rezervuarët nuk duhet të mbushen më shumë se 90% e kapacitetit të tyre, por një hapsirë prej 5% duhet të mbetet bosh për siguri kur lëngu është në një temperaturë mesatare prej 50°C. Gjatë transportit lëngu duhet të jetë nën një shtresë e gazit inert, presioni i mjetit i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 50 kPa(0.5 bar). Rezervuarët duhet të kenë një tabelë në një formë të qëndrueshme ku duhet të tregohen veçoritë e mëposhtëme.

-substancë ose substancat 4/ të pranuar për transport

-qëllimi 3/ i rezervuarëve përfshi aksesorët

-presioni testimi 3/ (presioni mjeteve matëse)

-data (muaji, viti i testimit të fundit)

-vula e ekspertit që ka kryer testimin

-kapaciteti 3/ i rezervuarëve

-shkalla maksimum e mbushjes së lejuar 3/

(3) Substancat e referuara në paragrafin (2) me lart gjithashtu mund të paketohen në paketime të kombinuara konform me anësoren 3538 me një paketim të brëndshëm me xham dhe një paketim i jashtëm prej çeliku ose alumini konform me anësoren 3532. Rezervuarët nuk duhet të mbushen më shumë se 90% e kapacitetit të tyre. Një paketim duhet të përmbajë vetëm një paketim të brëndshëm.

Të tilla paketime të kombinuara duhet të jenë konform me tipin e projektuar i cili është testuar dhe miratuar në përputhje me Shtojcën A.5 për grupin I të paketimeve.

3/ Njësia e matjes të shtohet çdo kohë pas vlerës numrike

4/Emri të zëvendësohet nga një përshkrim kolektiv që mbulon substancat e të njëjtës natyrë dhe e barabartë e krahasueshme me vetitë e rezervuarëve.

Klasi 4.3

2473 (4) Substancat e referuara në paragrafin (2) gjithashtu mund të paktohen në paketime të kombinuara konform me anësoren 3538 me një paketim të brendshëm me xham të mbyllur hermetikisht me një kapacitet jo më shumë se 1 litër e cila duhet të jetë e siguar në mënyrë individuale në marrësa metalik me anë të materialeve të butë. Rezervuarët prej xhami nuk duhet të mbushen më shumë se 90% e kapacitetit të tyre. Paketimet vijuese të jashtme duhet të lejohen: fuçi çeliku me kokë të heqshme konform me anësoren 3520, kuti prej druri natyral konform me anësoren 3527, kuti druri konform me anësoren 3528, kuti druri i përpunuar konform me anësoren 3529 ose kuti çeliku ose alumini konform me anësoren 3532.

Të tilla paketime të kombinuara duhet të jenë testuar dhe miratuar në përputhje me Shtojcën A.5 për grupin I të paketimeve.

Një paketim nuk duhet të përmbajë më shumë se 30 kg të substancës

(5) (a) Konteinerët e vegjël të 31°(b) duhet të vendosen në paketime të jashtme të përshtatshme me material të butë për të parandaluar kontaktet midis konteinerëve të vegjël dhe midis konteinerëve të vegjël dhe sipërfaqes së brendshme të paketimit të jashtëm dhe për të siguruar së asnjë lëvizje e rrezikshme e konteinerëve të vegjël brenda paketimit të jashtëm të mos ndodh gjatë transportit. Paketime të jashtme të përshtatshme janë fuçitë metalike (1A2, 1B2) fuçi dërrase (1D), fuçi fibre (1G), fuçi plastike (1H2), kuti metalike (4A,4B), kuti druri (4C,4D,4F), kuti fibre (4G) dhe kuti plastike (4H2). Të tilla paketime duhet të jenë konform me tipin e projektuar dhe testuar dhe miratuar në përputhje me Shtojcën A.5 për grupin II të solideve.

(b). Bateritë e 31°(b) mund të transportohen të pa paketuara ose në mbyllëse të mbrojtur. (p.sh. e mbyllur plotësisht ose në mbajtëse druri) të cilat nuk janë subjekt i kërkesave të testimit të paketimit dhe miratimit të Shtojcës A.5.

2474 (1) Substancat e klasifikuara sipas (a) të 2°, 11°, 13°, 14°, 16°, deri 18°, 20°, 22° dhe 24° duhet të paktohen në: tituj të ndryshëm duhet të paktohen

(a) në një fuçi me kokë jo-të heqshme çeliku konform me anësoren 3520; ose

(b) në një fuçi me kokë jo-të heqshme çeliku ose në bidona alumini konform me anësoren 3521; ose

(c) në një bidon me kokë jo-të heqshme çeliku ose në bidona alumini konform me anësoren 3522; ose

(d) në një fuçi me kokë jo-të heqshme plastike me një kapacitet prej 60 litra ose në bidona plastike konform me anësoren 3526; ose

(e) në paketimet e përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537; ose

(f) në paketimet e kombinuara me material xhami, plastike ose marrësa të brendshme metalik konform me anësoren 3538.

(2) Substancat e përcaktuara në anësoren 2470(10) gjithashtu mund të paktohen në:

(a) fuçi me kokë të heqshme konform me anësoren 3520 për çelik, me anësoren 3521 për alumin, me anësoren 3526 për materiale plastike, ose në bidona me kokë të heqshme konform me anësoren 3522 për çelik ose alumin, ose me anësoren 3526 për materiale plastik ose

(b) paketimet e kombinuara konform me anësoren 3538 me një ose më shumë çanta kundër rrjedhjeve

(3) Substancat solide në përputhje me anësoren 2470(10) të 11°, 13°, 17°, dhe 20° gjithashtu mund të paktohen në IBC metalik konform me anësoren 3622.

Klasi 4.3

2475 (1) Substancat e klasifikuara sipas (b) të titujve të ndryshëm duhet të paktohen në:

(a) fuçi çeliku konform me anësoren 3520 ose

(b) në fuçi alumini konform me anësoren 3521

(c) në bidona çeliku ose alumini konform me anësoren 3522.

(d) në fuçi plastike ose në bidona ose alumini konform me anësoren 3526.

(e) në paketimet e përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537; ose
(f) në paketimet e kombinuara konform me anësoren 3538 ; ose
(g) paketimet e përbëra (xham, porcelan, veshje guri) konform me anësoren 3539
(2) Substancat e 12° deri 17° dhe 20° gjithashtu mund të pakëtohen në:
(a) IBC metalike konform me anësoren 3622 ose
(b) plastik i ashpër konform me anësoren 3624 ose
(c) IBC të përbëra me marrësa të brendshëm me plastik konform me anësoren 3625 me përjashtim të tipeve 11MZZ dhe 31HZ2.

(3) Solidet si janë përcaktuar në anësoren 2470(10) gjithashtu mund të pakëtohen në:
(a) në një fuçi druri konform me anësoren 3523; ose në fuçi fibre konform me anësoren 3525, në se është e nevojshme me një ose më shumë çanta kundër rrjedhjeve; ose
(b) çanta film plastik konform me anësoren 3535, duke siguruar së është një ngarkesë e plotë ose e ngarkuar në paleta.

2476 (1) Substancat e klasifikuara sipas (c) të titujve të ndryshëm duhet të pakëtohen në:

- (a) fuçi çeliku konform me anësoren 3520
- (b) fuçi alumini konform me anësoren 3521
- (c) bidon çeliku ose në bidona alumini konform me anësoren 3522; ose
- (d) fuçi plastike ose bidon plastike konform me anësoren 3526; ose
- (e) në paketimet e përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537; ose
- (f) në paketimet e kombinuara konform me anësoren 3538.
- (g) në paketimet e përbëra (xham, porcelan, veshje guri konform me anësoren 3539 ose
- (h) paketime metalike të masave të lehta konform me anësoren 3540 ose
- (i) IBC metalike konform me anësoren 3622 ose

Klasi 4.3

2476 (j) plastik e ashpër IBC konform me anësoren 3624 ose

(k) IBC e përbërë me marrësa të brendshëm plastik konform me anësoren 3625 me përjashtim të tipeve 11MZZ dhe 31HZ2.

(2) Solidet të përcaktuar në anësoren 2470(10) mund të pakëtohen gjithashtu në :

- (a) fuçi gruri konform me anësoren 3523 ose në fuçi fibre konform me anësoren 3525 në se është e nevojshme me një ose më shumë çanta të brendshme kundër rrjedhjeve; ose
- (b) çanta filmi plastik konform me anësoren 3535 ose
- (c) fleksibël IBC konform me anësoren 3623. me përjashtim të tipeve 13M2 dhe 13L1 dhe 13M1

SHËNIM: Substancat e 15° mund gjithashtu të pakëtohen në pakëta, të cilat duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e anësore 3500(1), (2) dhe (5) deri (7) dhe mund të pakëtohen në IBC të tipit 13H1.

2477 Hapja e rezervuarëve për substancat e 23° duhet të jetë e mbyllur fort me anë të dy mjeteve në seri, njëra nga të cilat të jetë me rrotullim ose e siguruar në një mënyrë ekuivalente.

SHËNIM: Për IBC shiko anësoren 3621(8)

2478-2480

3. Paketime të përziera.

2481 (1) Substancat e klasifikuara sipas të njëtit titull mund të pakëtohen së bashku në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538.

(2) Substancat e klasifikuara sipas (a) të titujve të ndryshëm nuk mund të pakëtohen së bashku me substancat të titujve të ndryshëm të Klasës 4.3 me substancat dhe artikujt të klasave të tjera ose me mallra të cilat nuk janë subjekt i parashikimeve të ADR.

(3) Me përjashtim të substancave të referuara në (2) , substancat e titujve të ndryshëm të Klasës 4.3 në sasi që nuk e tejkalojnë 3 litra për lëngje dhe/ose 6kg për solidet për rezervuarët, mund të pakëtohen së bashku në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538 me njëri tjetrin, me substancat ose artikujt e klasave të tjera, duke siguruar së paketimet e përziera është gjithashtu i lejuar për substancat dhe artikujt të këtyre klasave dhe/ose më mallra jo subjekt i parashikimeve të ADR duke siguruar që ato të mos bëjnë reaksion me njëra tjetrën

(4) Të mëposhtëmet konsiderohen se kanë reaksione të rrezikshme:

- (a). të djegshme dhe/ose që prodhojnë nxehtësi të konsiderueshme

(b). emtimi i gazeve të djegshëm dhe/ose toksik

(c). formim i lëngjeve gërryese

(d). formimi i substanacve të pa qëndrueshme

(5) Parashikimet e anësore 2002(6) dhe (7) duhet të shqyrtohen:

(6) Në se përdoren kasa prej druri ose fibre një paketim nuk duhet të peshojë më shumë se 100 kg.

Klasi 4.3

4 Shenjat dhe etiketat e rrezikut mbi paketime (shiko Shtojcë N A.9)

2482 Shenjat

(1) Çdo paketim duhet të jetë i shënuar në mnyre të qartë me numrin e identifikimit të mallrave për tu futur në dokumentet e transportit, të paraprirë nga gërmat “UN”

Etiketat e rrezikut.

(2) Paketimet që përmbajnë substanca dhe artikuj të kësaj klase duhet të kenë një etiketë konform Modelit 4.3.

(3) Paketimet që përmbajnë substanca të 1° dhe 2° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr.3 dhe 8.

(4) Paketimet që përmbajnë substanca të 3°, 1391 shkrirës ose shkrirës metal-toke alkaline të 11°(a) me një pikë ftohje jo më shumë se 61° C dhe 1411 hidrid aluminium litium, eteral të 16°(a) duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 3

(5) Paketimet që përmbajnë substanca të 14° duhet të kenë një etiketë konform Modelit Nr. 4.2. dhe një etiketë konform Modelit Nr.8.

(6) Paketime që përmbajnë substanca të 15°, 18°, 22° dhe 23° duhet të kenë një etiketë konform Modelit Nr. 6.1.

(7) Paketime që përmbajnë substanca të 24° dhe 25° duhet të kenë një etiketë konform Modelit Nr. 8

(8) Paketime që përmbajnë lëngje në marrësa të mbyllur të cilët nuk janë të dukshëm nga jashtë në të dy anët e kundërta duhet të kenë një etiketë konform Modelit Nr. 11.

2483.

B. Veçoritë në dokumentet e transportit.

2484 (1) Përshkrimi i mallrave në dokumentet e transportit duhet të jetë konform me një nga numrat e identifikimit dhe emrat në anësoren 2471.

Nëse substanca nuk është përmendur me emër, por është përcaktuar në një hyrje n.o.s. përshkrimi i mallrave do të konsistojë në numrin e identifikimit dhe në n.o.s ose në përcaktimin e emrit kimik ose teknik të substancës 5/

Përshkrimi i mallrave do të ndiqet nga veçoritë e klasës, numri i titullit në se është i aplikueshëm, gërma dhe inicialet “ADR” ose (RID), p.sh”4.3,1°(a) “ADR”

Për transportin e shkrirësave (shiko anësoren 2000(5) përshkrimi i mallrave do të jetë ”Përmbajtje e shkrirësave....” komponentet e përdorur për klasifikimin shkrirësave sipas anësore 2002(8) dhe të futet sipas emrit të tij kimik p.sh. “Shkrirës që përmban tokë 1428 sodium, 4.3, 11°(a) ADR”

5/ emrat teknike do të jenë përdorur aktualisht në librat teknike dhe shkencor shtypin dhe tekset.Emrat tregtare nuk do të jenë përdorur për këto qëllime.

Klasi 4.3

2484 Për transportin e substancave dhe përzierjeve (të tillë si përgatitjet dhe shkrirësit) që përmbajnë disa komponentë subjekt i parashikimeve të ADR nuk është e nevojshme në përgjithësi të referohesh më shumë se dy komponentëve të cilët kontribuojnë më shumë në rritjen e rrezikut të substancave ose përzierjeve.

Nëse një substancë e emëruar në përputhje me anësoren 2470(9) nuk është subjekt i kushteve të kësaj klase dërguesi mund të fusë në dokumentet e transportit “Mallra jo të Klasës 4.3”

Për substancat dhe përzierjet, që përmbajnë vetëm një komponent subjekt i parashikimeve të ADR fjala “substancë” ose “përzierje” duhet të shtohet si pjesë e emrit në dokumentet e transportit (shikoi anësoren 2002(8)(a)

Kur një solid mbartet për transport në gjendje të shkrirë përshkrimi i mallrave duhet të

specifikohet “i shkrirë” përderisa termi është dukur në emër

2485-2491

5/emri teknik do te perdoret si i perodur ne literaturen tyeknike ose shkencore, gazeta e tekste. Emri tregtar nuk do te perdoren per kete qellim.

C. Paketime bosh

2492 (1) Paketime bosh përfshijnë IBC bosh, të papastra të 41°. Do të mbyllet në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën shkallë të rrjedhjes sikur ato të ishin plot.

(2) Paketime bosh përfshijnë IBC bosh, të papastëra të 41° duhet të kenë të njëjtën përshkrim dhe etiketat e rrezikut sikur ato të ishin plot.

(3) Përshkrimi në dokumentet e transportit duhet të jetë konform me një nga emrat e 71° p.sh. “Paketim bosh 4.3, 41°, ADR”

Në rast të mjeteve rezervuar bosh, rezervuarëve të çmontueshëm bosh dhe kontenierëve-rezervuar bosh, të papastër. Ky përshkrim duhet të plotësohet duke shtuar fjalët “Ngarkes e fundit” së bashku me emrin dhe numrin e titullit të mallrave të ngarkimit të fundit p.sh. “Ngarkimi i fundit 1295 triklorosilan, 1°(a)”

2493-2499

KLASA 5.1 SUBSTANCAT OKSIDUESE

1.Lista e substancave

2500. (1) Midis substancave dhe artikujve të mbuluar nga titulli i Klasës 5.1, ato të cilët janë në listë në anësoren 2501 ose janë të mbuluar nga një titull kolektiv në këtë anësore, janë subjekt i kushteve të vendosura në anësoren 2500(2) deri 2522 dhe të parashikimeve të këtij Aneksi dhe të Aneksit B. Ato janë konsideruar si substanca dhe artikuj të ADR

SHËNIM:Për sasitë e substancave në listë në anësoren 2501 të cilët nuk janë subjekt i parashikimeve të këtij Klasi ose në këtë Aneks ose në Aneksin B, shiko anësoren 2501a.

(2) Titulli I Klasës 5.1 mbulon substancat të cilat në vetëvetë nuk janë të nevojshme të jenë të djegshme por në përgjithësi jepen nga oksigjeni i cili shkakton ose ndihmon në djegien e materialeve të tjerë.

(3) Substancat e Klasës 5.1 janë të nëndara si më poshtë:

A. Substanca lëngje oksidues dhe solucione të tjera ujore

B. Substanca solide oksidues dhe solucione të tjera ujore

C. Paketime bosh

Substancat e Klasës 5.1 (përveç substancave të 5° dhe 20°) të cilat janë të klasifikuara sipas titujve të ndryshëm të anësores 2501 do të përcaktohen tek një nga grupet vijuese të përcaktuara nga gërma (a), (b) ose (c) në përputhje me shkallën e tyre të rrezikut.

(a). oksidues të lartë

(b). oksidues

(c). oksidues të lehtë

(4) Substancat oksiduese jo të përmendura specifiku me emër mund të përcaktohen të Klasi 5.1. ose mbi bazën e eksperiencës ose në përputhje me metodën e testimit, procedurat dhe kriteret e vendosura në Manualin e Testimit dhe Kriterëve, Pjesa III, seksioni 34.4. Në rast të divergjencave midis rezultateve të testimit dhe eksperiencës së njohur, gjykimi do të bazohet mbi eksperiencën e njohur e cila do të mbizotërojë mbi rezultatet e testimit.

(5) Substancat oksiduese jo të përmendura specifiku me emër janë përcaktuar të titujt e anësores 2501 mbi bazën e procedurave të testimit në përputhje me Manualin e Testimit dhe Kriterëve, Pjesa III, nën-seksioni 34.4.1. do të apllohen kriteret si më poshtë:

- Një substancë solide do të përcaktohet të Klasi 5.1 në se në 4:1 ose në mostrën-pjesë-celulozë (të masës) 1:1 të testuar, ajo ndez ose djeg ose shfaq një kohë djegie më të madhe se 3:7 e përzierjes (masës) të bromat potasiumit dhe celulozës.

- Një substancë solide do të përcaktohet të gërma (a) kur në 4:1 ose në mostrën-pjesë-celulozë (të masës) 1:1 të testuar, ajo ndez ose djeg ose shfaq një kohë djegie më të madhe se 3:2 e përzierjes (masës) të bromat potasiumit dhe celulozës.

- Një substancë solide do të përcaktohet të gërma (b) kur në raportin 4:1 ose në mostrën-pjesë-celulozë (të masës) 1:1 të testuar, ajo ndez ose djeg ose shfaq një kohë djegie më të madhe se 2:3 e përzierjes (masës) të bromat potasiumit dhe celulozës dhe nuk plotëson kriteret e gjermës (a).

Klasi 5.1

(b). Marrësa të bërë me alumin të pastër, që kanë një trashësi muri jo më shumë se 5 mm ose në marrësa me çelik të pandryshkem. Rezervuarët duhet të jenë plotësisht të salduar. Rezervuarët fillimisht të testohe periodikisht një herë në pesë vjet, të testohen në një presion jo më të vogël se 0.5 Mpa (5 bar) (mjet matës) në përputhje me anësoren 2215 deri 2217. Ato duhet të jenë të mbyllura me anë të mjeteve që të ndalojnë rrjedhjen me anë dy mbyllësave njëra mbi tjetrën, njëra nga të cilat të jetë me mbyllje me rrotullim ose e siguruar me një mjet ekuivalent. Shkalla e mbushjes nuk duhet të tejkalojë 90%

Fuçitë që peshojnë më shumë se 100 kg duhet të jenë të paisur me kapse (dorëza) rotulluese ose fikse.

Klasi 6.1

2605 (c). Rezervuarët në konformitet me (b) duhet kenë të dhënat si më poshtë të lexueshme dhe të qëndrueshme:

- emrin ose markën e prodhuesit dhe numrin e rezervuarit
- fjalën “metil isocianate”
- qëllimin e rezervuarëve dhe masën e lejueshme maksimum kur mbushen
- data (muaji, viti) dhe testimi fillestar i testimit më të fundit
- vula e ekspertit që ka kryer testimin

2606 (1). Substancat e klasifikuara sipas (a) të titujve të ndryshëm duhet të paktohen:

(a) në një fuçi me kokë jo-të heqshme çeliku konform me anësoren 3520; ose

(b) në një fuçi me kokë jo-të heqshme alumini konform me anësoren 3521; ose

(c) në një bidon me kokë jo-të heqshme çeliku ose në bidona alumini konform me anësoren 3522; ose

(d) në një fuçi me kokë jo-të heqshme plastike me një kapacitet që nuk e tejkalon 60 litra ose në bidona plastike konform me anësoren 3526; ose

(e) në paketimet e përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537; ose

(f) në paketimet e kombinuara më paketim të brendshëm me material xhami, plastike ose metal konform me anësoren 3538.

(2) Substancat solide brënda qëllimit të anësores 2600(13) mund të paktohen gjithashtu:

(a). në një fuçi me kokë të heqshme konform me anësoren 3520 prej çeliku, 3521 për alumin, 3523 për dërrasë, 3525 për fibër, ose 3526 për materiale plastike ose në një bidon me kokë të heqshme konform me anësoren 3522 për çelik ose alumin ose 3526 për material plastik, nëse është e nevojshme me një ose më shumë çanta të brendshme pa rrjedhje; ose

(b). në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538 me një ose më shumë çanta të brendshme pa rrjedhje

(3) Substanca solide në përputhje me anësoren 2600(13) të 12°, 17° me përjashtim të 1694 bromobenzil cianid, 23°, 25°, 32°, 33°, 34° me përjashtim të 1698. Difenilamin kloroarsin 35°, 36°, 41°, 51°, 52°, 55°, 61°, 65°, 73° dhe 90° mund të paktohen gjithashtu në IBC metalik konform me anësoren 3622, në plastike të ashpër IBC konform me anësoren 3624, në IBC e përbërë konform me anësoren 3625 ose në IBC prej druri të paisur me një linjë filtrash konform me anësoren 3627.

IBC e përbërë të tipit 11HZ2 dhe 21HZ2 dhe IBC prej druri duhet të transportohen në mjete të mbyllur ose në kontenier të tipit të mbyllur me mure komplet.

(4) Substanca solide në përputhje me anësoren 2600(13) të 26° mund të paktohen gjithashtu në IBC metalik konform me anësoren 3622, në plastikë të ashpër IBC konform me anësoren 3624, në IBC e përbërë konform me anësoren 3625 me përjashtim të tipeve 11HZ2 dhe 21HZ2

IBC e përbërë duhet të transportohen në mjete të mbyllur ose në kontenier të tipit të mbyllur me mure komplet.

Klasi 6.1

2607 (1). Substancat e klasifikuara sipas (b) të titujve të ndryshëm duhet të paktohen.

(a) në një fuçi çeliku konform me anësoren 3520; ose

(b) në një fuçi alumini konform me anësoren 3521; ose

(c) në një bidon çeliku ose në bidona alumini konform me anësoren 3522; ose

(d) në një fuçi plastike me një kapacitet që nuk e tejkalon 60 litra ose në bidona plastike konform me anësoren 3526; ose

(e) në paketimet e përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537; ose

(f) në paketimet e kombinuara konform me anësoren 3538.

SHËNIM: deri të (a), (b), (c) dhe (ç): Kushtet e thjeshtuara janë të aplikueshme për fuçitë me kokë të heqshme dhe bidonat për substancat vizkoze që kanë një viskozitet më shumë se 200 mm²/s në 23°C dhe për solidet shiko anësoret 3512, 3553, 3554 dhe 3561).

(2). Substancat e klasifikuara sipas (b) të titujve të ndryshëm, që kanë një presion avullimi në 50°C jo më shumë se 110kPa (1.10 bar) mund të paktohen gjithashtu në IBC metalik konform me anësoren 3622, në plastikë të ashpër IBC konform me anësoren 3624, në IBC e përbërë konform me anësoren 3625

(3) Substancat e klasifikuara sipas 15° (b) mund gjithashtu të paktohen në paketime të përbëra (xham, porcelan ose në veshje guri) konform me anësoren 3539.

(4) Substanca solide brënda qëllimit me anësoren 2600(13) mund të paktohen gjithashtu:

(a). në një fuçi me kokë të heqshme konform me anësoren 3523 për dërrasë, ose 3525 për fibër, në se është e nevojshme me një ose më shumë çanta të brëndshme pa rrjedhje ose

(b) në çanta rezistente ndaj ujit konform me anësoren 3533 për materiale tekstile, 3534 materiale plastik e thurur, 3535 për filma plastik ose 3536 për letër rezistente ndaj ujit duke siguruar së mallrat janë transportuar si një ngarkesë e plotë ose çantat janë të siguruar në paleta.

(c). Në IBC e përbërë me marrësa të brendshëm plastik fleksibël konform me anësoren 3625, IBC prej fibre konform me anësoren 3626 ose IBC prej druri konform me anësoren 3627, ose

(d) Në IBC fleksibël konform me anësoren 3623 me përjashtim të IBC të tipit 13H1, 13L1, 13M1, duke siguruar së mallrat janë transportuar si një ngarkesë e plotë ose IBC fleksibël të ngarkuar në paleta.

2608 (1). Substancat e klasifikuara sipas (b) të titujve të ndryshëm duhet të paktohen

(a) në një fuçi çeliku konform me anësoren 3520; ose

(b) në një fuçi alumini konform me anësoren 3521; ose

(c) në një bidon çeliku ose në bidona alumini konform me anësoren 3522; ose

(d) në një fuçi plastike ose bidona plastik konform me anësoren 3526; ose

(e) në paketimet e përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537; ose

(f) në paketimet e kombinuara konform me anësoren 3538; ose

(g) në paketime të përbëra (xham, porcelan ose veshje guri) konform me anësoren 3539; ose

(h) në paketime e metal të lehtë konform me anësoren 3540

SHËNIM: deri të (a), (b), (c), (ç) dhe (ë) : Kushtet e thjeshtuara janë të aplikueshme për fuçitë me kokë të heqshme dhe bidonat më paketime material të lehtë për substancat vizkoze që kanë një viskozitet më shumë se 200 mm²/s në 23°C dhe për solidet (shiko anësoret 3512, 3552 deri 3554

dhe 3561).

Klasi 6.1

2608 (2) Substancat e klasifikuara sipas (c) të titujve të ndryshëm, që kanë një presion avullim në 50°C të jo më shumë se 110 kPa (1.10 bar) mund të paketohen gjithashtu në IBC metalik konform me anësoren 3622, në plastikë të ashpër IBC konform me anësoren 3624, në IBC e përbërë me marrësa të brëndshme plastik konform me anësoren 3625. IBC e tipit 31HZ2 duhet të mbushen të paktën 80% të volumit të kasës së jashtme.

(3) Substanca solide brënda qëllimit të anësores 2600(13) mund të paketohen gjithashtu:

(a) në një fuçi me kokë të heqshme konform me anësoren 3523 për dërrasë, ose 3525 për fibër, në se është e nevojshme me një ose më shumë çanta të brëndshme pa rrjedhje ose

(b) në çanta rezistente ndaj ujit konform me anësoren 3533 për materiale tekstile, 3534 materiale plastik e thurur, 3535 për filma plastik ose 3536 për letër rezistente ndaj ujit

(c) Në IBC fleksibël konform me anësoren 3623 me përjashtim të IBC të tipit 13H1, 13L1, 13M1, në IBC e përbërë me marrësa të brëndshme plastik fleksibël konform me anësoren 3626 ose në IBC prej druri konform me anësoren 3627.

2609 3315 mostrat kimike, toksik të 90°(a) duhet të paketohet në përputhje me instruksionet e paketimit 623 në Instruksionet Teknike të Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme me anë të ajërit.

2610 3. Paketimet e përziara .

2611 (1) Substancat e mbuluara nga i njëjti numër titulli mund të paketohen së bashku në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538

(2) Substancat e titujve të ndryshëm të Klasës 6.1 në sasi të që nuk i tejkalojnë për paketime të brëndshme 3 litra për lëngje dhe/ose 5 kg për solid mund të paketohen së bashku dhe/ose me mallra jo subjekt i parashikimeve të ADR në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538 duke siguruar se nuk bëjnë reaksione të rrezikshme me njëri tjetrin

(3) substancat e 1°, 3°, 4° dhe 5° nuk mund të paketohen me mallra të tjerë.

(4) substancat e 2° dhe substancat e klasifikuara sipas (a) të titujve të ndryshëm nuk duhet të paketohen së bashku me substancat dhe artikujt e klasave 1 dhe 5 dhe materiale të Klasës 7.

(5) Përveç se kur është specifikuar ndryshe substancat e 2° dhe substanca lëngje të klasifikuara sipas (a) të titujve të ndryshëm, në sasi që nuk e tejkalon 0.5 litra për paketim dhe substanca të klasifikuara sipas (b) dhe (c) të titujve të ndryshëm, në sasi që nuk e tejkalon për paketime të brëndshme, 3 litra për lëngje dhe/ose 5 kg për solid mund të paketohen së bashku në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538, me sëubstanca ose artikuj të klasave të tjera duke siguruar se paketimet e përziara janë të lejuara për substancat e këtyre klasave dhe/ose me mallra të cilat nuk janë subjekt i parashikimeve të ADR, duke siguruar së ato nuk bëjnë reaksione të rrezikshme me njëri tjetrin.

(6) Konsiderohen reaksione të rrezikshme si më poshtë:

(a). të djegshme dhe/ose që lëshojnë nxehtësi të konsiderueshme

(b). emetime të gazeve të djegshme dhe/ose toksik

Klasi 6.1

2611 (c) formojnë lëngje gërryes

(d) formojnë substanca të pa qëndrueshme

(7) parashikimet e anësores 2001(7) , 2002(6) dhe (7) dhe 2602 duhet të zbatohen me:

(8) në se kutitë e drurit ose fibrës janë përdorur, një paketim nuk duhet të pësojë më shumë se 100 kg.

4. Shenjat dhe etiketat e rrezikut (shiko Shtojcen A.9)

Shenjat

2612 (1) Çdo paketim duhet të jetë i shënuar në mënyre të qartë me numrin e identifikimit të mallrave për tu futur në dokumentet e transportit, të paraprirra nga gërmat “UN”

Etiketat e rrezikut.

(2) Paketimet që përmbajnë substanca ose artikuj të kësaj Klase duhet të kenë një etiketë konform Modelit 6.1.

(3) Paketimet që përmbajnë substanca të 1° deri 6°, 7°(a) 2,8°(a), 2,9°, 11°(a) dhe (b) 2,13°,

16°, 18°, 20°, 22° ose 26°(a)1, ose(b) duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 3

(4) Paketime që përmbajnë pesticide të djegshme që kanë një pikë flesh 23°C ose më lart duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 3

(5) Paketimet që përmbajnë substanca të 7°(a) 1,8°(a), 1,10°, 11°(b) 1 ose 28° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 3 dhe 8.

(6) Paketimet që përmbajnë substanca të 26°(a)2, ose(b)2 ose 54°(b)1 duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 4.1.

(7) Paketimet që përmbajnë substanca të 66° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 4.2.

(8) Paketimet që përmbajnë substanca të 44° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 4.3.

(9) Paketimet që përmbajnë substanca të 68° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 0.5

(10) Paketimet që përmbajnë substanca të 24°(b)2, 27° ose 67° duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 8

(11) Paketimet që përmbajnë lëngje në marrësa të mbyllur të cilët nuk janë të dukshëm nga ana e jashtme, paketimet që përmbajnë marrësa me ventilim, dhe marrësa pa ventilim por pa një paketim të jashtëm, si shtesë duhet të ketë në të dy anët e kundërta një etiketë konform me modelin No.11

2613

Klasi 6.1

B. Veçoritë në dokumentet e transportit

2614 (1)Përshkrimi i mallrave në dokumentet e transportit duhet të jetë konform me një nga numrat e identifikimit dhe emrat e nënvizuar në anësoren 2601.

Në se substanca nuk është përmendur me emër, por është përcaktuar në një hyrje n.o.s, ose në ndonjë hyrje tjetër kolektive përshkrimi i mallrave do të konsistojë në numrin e identifikimit përcaktimi i n.o.s, ose përcaktimi i hyrjes kolektive, e ndjekur nga emri kimik ose teknik //

Përshkrimi i mallrave do të ndiqet nga veçoritë e klasës, numri i titullit në se është i aplikueshëm, gërma dhe inicialet “ADR” ose (RID), [p.sh”6,1, 11°(a),ADR”]

Për transportin e substancave dhe përgatitjeve të përdorura si pesticide të 71° deri 73° përshkrimi i mallrave duhet të përmbledhë emrin teknik 8/ të ingredientit aktiv p.sh. “2783 pesticide organofosforus, solid, toksik,(propafos) 6.1, 73°(c) ADR.“

Për transportin e shkrirësave [shiko anësoren 2000(5)] përshkrimi i mallrave do të jetë”Përmbajtje e shkrirësave...” komponentet më të përdorur për klasifikimin e shkrirësave sipas anësore 2002(8) dhe të futet sipas emrit të tij kimik p.sh. “Shkrirës që përmban 2570 përbërësa kadiumi 6.1, 61°(c), ADR”

Për transportin e solucionëve dhe përzierjeve të tillë si përgatitjet dhe shkrirësit që përmbajnë disa komponentë subjekt i parashikimeve të ADR nuk është e nevojshme në përgjithësi tu referohesh më shumë se dy komponentëve të cilët kontribuojnë më shumë në rritjen e rrezikut të solucionëve ose përzierjeve.

Për transportin e solucionëve dhe përzierjeve që përmban vetm një komponentë subjekt i parashikimeve të ADR, fjala “solucion” ose “përzierje” duhet të shtohet si pjesë e emrit në dokumentet e transportit shiko anësoren 2002(8)

Për transportin e 3315 mostër kimike, toksik, 90°(a), një kopje e lejes së transportit, që tregon sasi të limit dhe kërkesat e paketimit duhet ti bashkangjitet dokumenteve të transportit [shiko gjithashtu SHËNIMIN tek 90°(a)]

Kur një substancë solid mbartet për transport në një gjendje të shkrirë përshkrimi i mallrave duhet të specifikohet “ i shkrirë” përderisa termi është përfshirë të emrit.

Në se një solucion ose përzierje që përmban një substancë të emëruar në përputhje me anësoren 2600(5) nuk është subjekt i kushteve të kësaj klase dërguesi mund të fus në dokumentet e transportit “Mallra jo të Klasës 6.1”

2615-2621

Paketime bosh

7/ Emri teknik dyhet te jete nje emer aktualisht i perdorur ne shkencen teknike,librat teknike botimet dhe tekset.emri tregetar nuk do te perdoret per kete qellim

8/ Emri teknik duhet të jetë sipas ISO9shiko ISO1750,1981) ose në listën e “Rekomandimeve për Klasifikimin e Pesticideve të Rrezikshme dhe Guidës së Klasifikimit“ose me emrin e substancës aktive.

Klasi 6.1

2622 (1) Paketime bosh të papastra të 91 janë bagazhe ose IBC fleksibël, ato duhet të vendosen në kuti ose çanta kundër ujit për të parandaluar ndonjë rrjedhje të substancave.

(2) Paketime bosh të papastra përfshijnë IBC të 91 ° duhet të mbyllën në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën shkallë të rrjedhjes sikur ato të ishin të mbushura plot.

(3) Paketime bosh të papastra përfshijnë IBC të 91 ° duhet të njëjtën përshkrim dhe etiketën e rrezikut sikur ato të ishin të mbushura plot.

(4) Përshkrim në dokumente e transportit duhet të jetë konform me një nga emrat e nënvizuar në 91 ° p.sh. “Paketime bosh, 6.1 91 ° ADR”

Në rast të mjeteve rezervuar bosh, rezervuar të çmontueshëm bosh, kontenier rezervuar bosh si dhe mjete bosh për transport në masë dhe konteniere bosh, të pa pastër, ky përshkrim duhet të kompletohet duke shtuar fjalët “ Ngarkesë e fundit” së bashku me emrin dhe titullin e mallrave të ngarkesës së fundit p.sh. “Ngarkesë e fundit: 2312 fenol, i shkrirë, 24 °(b)”

2623-2649

Klasa 6.2 - Substanca infektuese.

1. Lista e substancave

2650 (1). Midis substancave 1/ dhe artikujve të mbuluar nga titulli I Klasës 6.2 , ato të cilat jenë në listë në anësoren 2651 ose të mbuluara nga një titull kolektiv të kësaj anësore janë subjekt i kushteve të vendosura në anësoren 2650(2) deri 2675 dhe të parashikimet e këtij Aneksi dhe të Aneksit B. Ato janë konsideruar si substanca të ADR

(2) Klasës 6.2 përfshin substancat të cilat janë të njohura ose në mënyrë të arsyeshme priten që të kenë patogjene. Patogjenët janë përcaktuar si mikro-organizma (përfshi bakteriet, viruset parazitet dhe kërpudhat) ose rikombinimet mikro-organizmash (hibrid ose shtrembërim) të cilat janë të njohura ose në mënyrë të arsyeshme priten që të shkaktojnë sëmundje në kafshë ose në njerëz. Ato janë subjekt i parashikimeve të kësaj klasi në se ato janë në gjendje të përhapin sëmundje tek kafshët ose njerëzit kur ekzpozohen ndaj atyre

SHËNIM 1: Të modifikuara gjenetiksht mikro-organizmat, produktet biologjike, specimenët diagnostike dhe kafshët e gjalla të infektuara do të përcaktohen në këtë klase në se ato plotësojnë kushtet e kësaj klase.

SHËNIM 2: Toksinat toksike nga bimët, kafshët ose burimet bakterologjike, të cilat nuk përmbajnë ndonjë substancë infektonjëse , ose organizma janë substanca të klasës 6.1 (shiko anësoren 2601, 90°, numër identifikimi 3172)

(3) Substanca të Klasës 6.2 janë të nëndara si më poshtë:

A. Substanca infektive me një mundësi të lartë rreziku

B. Substanca infektive të tjera

C. Paketime bosh.

Këto Substanca të anësores 2651, 3° dhe 4° janë përcaktuar të grupi i gërmës (a) mbi bazën e shkallës së tyre të rrezikut:

(b) Substanca të rrezikshme.

(4) Përcaktimi i substancave që nuk janë në listë me emër nga 1°, 2° dhe 3° të anësores 2651 do të bëhen mbi bazën e njohurive shkencore aktuale në përputhje me grupet e rrezikut si më poshtë:

(i) Grupi 4 i rrezikut, një patogjen që zakonisht shkakton sëmundje serioze te kafshët dhe njeriu dhe i cili transmetohet lehtë nga një individ tek tjetri, direkt ose indirekt dhe për të cilën duhen marrë masa efektive trajtimi dhe parandaluese janë zakonisht të vlefshme (d.m.th. rrezik të lartë të komunitetit dhe të individit)

1/ Për qëllim të kësaj klase viruset, mikro-organizmat si dhe artikujt e prekur nga to do të konsiderohen si substanca të këtij klasi.

2/ Shiko Manualin e Biosferës Laboratorike, botimi i dytë (1993) të Organizatës së Shëndetësisë Botërore (ËHO)

Klasi 6.2

(ii) Grupi 3 i rrezikut, një pantogjen që zakonisht shkakton sëmundje serioze te kafshët dhe njeriu dhe i cili nuk transmetohet lehtë nga një individ i infektuar tek tjetri, dhe për të cilën duhen marrë masa efektive traitimi dhe parandaluese janë zakonisht të vlefshme (d.m.th. rrezik të lartë të të individit por të ulët për komunitetin)

(iii) Grupi 2 i rrezikut, një pantogjen që mund shkakton sëmundje te kafshët dhe njeriu por nuk ka ndonjë rrezik serioz dhe i cili shkakton infektive serioze tek tjetri, dhe për të cilën duhen marrë masa efektive traitimi dhe parandaluese janë zakonisht të vlefshme (d.m.th. rreziku infektimit është i kufizuar d.m.th rrezik të pakët të individit dhe të ulët për komunitetin)

SHËNIM 1: Grupi I i rrezikut përfshin mikro-organizma të cilat shkaktojnë sëmundje te kafshët dhe njerzit (d.m.th., nuk kanë rrezik ose shumë të ulët individual ose të komunitetit). Substancat që përmbajnë vetëm mikro-organizma të tilla nuk konsiderohen substanca infektive për qëllim të këtij parashikimi.

SHËNIM 2: Të modifikuara gjenetikisht mikro-organizmat dhe organizmat 3/ janë mikro-organizma dhe organizma në të cilat materiale gjenetik është ndryshuar me anë të metodave teknike ose me anë të mjeteve që nuk mund të ndodhin në mënyrë natyrale në natyrë.

SHËNIM 3: Të modifikuara gjenetikisht mikro-organizmat të cilat janë infektuese brënda qëllimit të kësaj klase janë substanca të 1°, 2° ose 3°. Ato nuk mund të caktohen të 4°. Të modifikuara gjenetikisht mikro-organizmat të cilat janë infektuese brënda qëllimit të kësaj klase mund të jenë substanca të Klasës 9 (shiko anësoren 2901, 13°) numër identifikimi 3245.

SHËNIM 4: Të modifikuara gjenetikisht mikro-organizmat të cilat janë të njohura ose të dyshuara të rrezikshme për kafshët dhe njerëzit ose ambientin, duhet të transportohen në përputhje me kushtet e specifikuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës.

(5) Substancat dhe përzierjet e substancave të kësaj klase do të konsiderohen si solide për parashikimet e paketimit të anësore 2654 dhe 2655 përderisa ato nuk do të përmbajnë lëngje të lirë në një temperaturë më pak se 45°(C)

(6) Produktet biologjike janë ato produkte të nxjerra nga organizmat e gjalla, që janë prodhuar dhe shpërndarë në përputhje me kërkesat e autoriteteve qeveritare kombëtare të cilat mund të kenë kërkesa licensimi speciale dhe të cilat përdoren për parandalimin, trajtimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve në njerëz ose në kafshë ose për zhvillimin e eksperimenteve ose për qëllime hetimi. Atë përfshijnë por nuk janë të kufizuara, prodhime të mbaruara ose të pa mbaruara si vaksina, prodhime diagnostike.

Për qëllim të këtyre parashikimeve, produktet biologjike janë ndarë në grupe si më poshtë:

(a) ato të cilat përmbajnë patogjenë në grupin I të rrezikut, ato të cilat përmbajnë patogjenë sipas kushteve dhe aftësisë së tyre të ulët për të shkakuar sëmundje ose jo sëmundje dhe ato të njohura që nuk përmbajnë patogjenë.

Substancat në këtë grup nuk konsiderohen substanca infektuese për qëllim të këtyre parashikimeve.

3/ Shiko gjithashtu Direktiven 90/219/EEC. Gazeta zyrtare e Komuniteteve Europiane No. L 117 të 8 maj 1990, faqe 1.

Klasi 6.2

2650 (b) ato të prodhuara dhe të paketuara në përputhje me kërkesat autoriteteve shëndetësore qeveritare kombëtare dhe të zbatuara për qëllim të paketimit final ose të shpërndarjes dhe të përdorura për kujdesin e shëndetit personal nga mjekë profesioniste ose persona të veçantë.

Substancat në këtë grup nuk janë subjekt i parashikimeve të aplikueshme për këtë klas.

(c) ato të njohura ose të pritëshme në mënyrë të arësye shme që përmbajnë patogjenë në grupin e rrezikut 2,3 ose 4 dhe të cilat nuk plotësojnë kriteret e (b) me lart.

Substancat në këtë grup do të klasifikohen në Klasin 6.2 sipas numrit të identifikimit 2814 ose 2900 si të jetë më e përshtatëshme

(7) Specimenët diagnostike përfshihen materiale të kafshëve ose të njerëzve , por që nuk kufizohen me kaq, ekstremitete, sekrecione, gjak dhe përbërsit e tij, fasho të transportuara për qëllim

të diagnostikimeve ose kërkimeve, por që përjashtojnë kafshë të gjalla të infektuara.

Për qëllim të këtyre parashikimeve specimenët diagnostike janë ndarë në grupe si me poshtë:

(a) ato të njohura ose të pritëshme në mënyrë të arsyeshme që përmbajnë patogjenë në grupin e rrezikut 2,3 ose 4 dhe ato me një probabilitet të vogël të prezencës së patogjenit në grupin 4 të rrezikut. Substanca të tilla duhet të përcaktohen në numrat e identifikimit 2814 ose 2900 si të jetë më e përshtatëshme. Specimenët e zbatuara për këtë qëllim të testimit fillestar ose konfirmues për prezencën e patogjeneve bie brënda këtij grupi.

(b) të cilat nuk plotësojnë kriteret e (b) më lart. ato të njohura ose të pritëshme në mënyrë të arsyeshme që përmbajnë patogjenë në grupin e rrezikut 2,3 janë prezente. Substanca të tilla duhet të përcaktohen në numrat e identifikimit 2814 ose 2900 si të jetë më e përshtatëshme, përveç kur kushtet e anësore 2656 do të aplikohen. Specimenët e zbatuara për këtë qëllim të testimit rutine të ekranizuar ose diagnostika fillestare përveç prezencës së patogjenë që bien brënda këtij grupi.

SHËNIM: Ato të njohura që nuk përmbajnë patogjenë nuk konsiderohen si substanca të kësaj Klase.

(8) Kafshët e ngordhura të cilat janë të njohura ose besohet se përmbajnë substanca infektuese duhet të paketohen, të shënohen, të etiketohen dhe të transportohen në përputhje me kushtet e specifikuara 4/ nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës.

(9) Kafshët vertebrorë ose jo vertebrorë të gjalla nuk duhet të transportohen në se kanë agjent infektiv, ato të transportohen me mjete të tjera. Kafshë të tilla duhet të paketohen, të shënohen, të tregohen dhe zbatohen në përputhje me rregullat përkatëse të drejtimit të transportit të kafshëve 6/.

4/ Rregulla të tjera janë përmbajtur p.sh. në Këshillin e Direktivave të Komuniteteve Europiane 90/667/EEC të 27 nëndorit 1990 të vendosura në rregullat vetërinare për disponimin dhe procesimin e kafshëve, për vendosjen në treg dhe për parandalimin e patogjenëve në ushqime të kafshëve ose me origjinë detare dhe amendimi I Direktives 90/425/EEC (Gazeta zyrtare e Komuniteteve Europiane No. L 363 të 27 Dhjetorit 1990 P.0051 - 0060)

5/ Në se vendi I origjinës nuk është palë kontraktuese e ADR, autoritetet kompetente të vendit të parë të ADR të mbërritur nga dërguesi.

6/ Rregulla të tilla janë përmbajtur në p.sh. Direktives 91/628/EEC (Gazeta zyrtare e Komuniteteve Europiane No. L 340 të 11 Dhjetorit 1991 f. 17) dhe në rekomandimet e Këshillit të Europës (Komiteti Ministerial) në transportin e disa specieve të kafshëve.

Klasi 6.2

(10) Për transportin e substancave të kësaj Klase, mbajtja e një temperature të specifikuar mund të jetë i nevojshëm.

A. Substanca infektive me mundësi rreziku të lartë

2651 1° 2814 Substanca infektive, që prekin njerëzit

2900 Substanca infektive, që prekin vetëm kafshët

SHËNIM 1: Substancat të cilat, në përputhje me anësoren 2650(4) janë përcaktuar në grupin IV të rrezikut, do të përcaktohet në këtë titull

SHËNIM 2: Kushtet e veçanta të paketimit janë të aplikueshme te këto substanca (shiko anësoren 2653 dhe 2654)

2° 2814 Substanca infektive, që prekin njerëzit

2900 Substanca infektive, që prekin vetëm kafshët

SHËNIM 1: Substancat të cilat, në përputhje me anësoren 2650(4) janë përcaktuar në grupin III të rrezikut, do të përcaktohet në këtë titull

SHËNIM 2: Kushtet e veçanta të paketimit janë të aplikueshme te këto substanca (shiko anësoren 2653 dhe 2654)

Substanca infektive të tjera

3° (b) 2814 Substanca infektive, që prekin njerëzit

2900 Substanca infektive, që prekin vetëm kafshët

SHËNIM: Substancat të cilat, në përputhje me anësoren 2650(4) janë përcaktuar në grupin II të rrezikut, do të përcaktohet në këtë titull

4° (b) 3291 shkrirësa klinik, të pa specifikuar n.o.s.

SHËNIM 1: Shkrirësat e pa specifikuar që rezultojnë nga trajtimet veterinerë/mjeksore të kafshëve/njerëzve ose nga kërkimet biologjike dhe të cilat në mënyrë të pa përcaktuar përmbajnë substanca të kësaj klase duhet të përcaktohen në këtë titull.

SHËNIM 2: Shkrirësat e specifikuar do të përcaktohen të 1^o, 2^o ose 3^o

SHËNIM 3: Shkrirësat klinik të pa prekur ose shkrirësat që rezultojnë nga kërkimet biologjike dhe të cilat me parë kanë përmbajtur substanca infektive nuk janë subjekt i parashikimeve të kësaj klase

C. Paketime bosh

11^o Paketime bosh të papastra përfshi kontenier rezervuar bosh IBC, mjete rezervuar bosh, rezervuar të çmontueshëm bosh dhe kontenier rezervuar bosh të pa pastër të cilët kanë përmbajtur substanca të Klasës 6.2 (shiko anësoren 2672)

Klasi 6.2

2. Parashikime

A. Paketime.

1. Kushtet e përgjithëshme të paketimit.

2652 (1) Paketimet duhet të përmbushin kushte e Shtojcës A.5 përderisa kushtet e veçanta për paketim për disa substanca janë përshkruar në anësoren 2653 dhe 2656. Konteinerët e ndërmjetëm (IBC) duhet të plotësojnë kushtet e Shtojcë A.6

(2) Në përputhje me parashikimet e anësoreve 2650(3) dhe 3511(2) ose 3611(2) duhet të përdoren të dhënat si më poshtë: Paketimet e grupit II ose I i shënuar me gjermën "Y", ose "X", ose IBC të grupit II të paketimit, shënuar me gjermën "Y" për substancat e rrezikshme të klasifikuara sipas gjermës (b) të çdo titulli

SHËNIM: Për transportin e substancave të Klasës 6.2 në mjete rezervuar, ose konteniere rezervuar shiko Aneksin B.

2. Kushtet e veçanta të paketimit.

2653. (1) Paketimi për substancat e 1^o dhe 2^o duhet të përfshijne elementet me kryesor si me poshtë:

(a). Paketimi i brendshëm përfshin:

- marrës parësor kundër rrjedhjeve

- paketim dytësor pa rrjedhje

- material absorbues midis rezervuarit parësor dhe paketimit dytësor, në se disa marrësa primar janë vendosur në një paketim dytësor, ato duhet të mbështillen në mënyrë individuale për të parandaluar kontaktet midis tyre. Materiali absorbues i tillë si pambuk, lesh, duhet të jetë në sasi të mjaftueshme për të absorbuar të gjithë përmbajtjen e rezervuarëve parësor.

Çfardo që të jetë temperatura e dërgesës, marrësi parësor ose paketim dytësor duhet të përballojë pa rrjedhje në një presion të brendshëm i cili shkakton një diferencë presioni jo më pak se 95 kPa (0.95 bar) dhe temperatura në shkallë -40°C deri +55°C.

SHËNIM: Paketimet e brendshme që përmbajnë substanca infektive nuk do të konsolidohet në një paketim të jashtëm me tipe të tjerë të mallrave. Paketimet komplet do të mbi paketohen në përputhje me parashikimet e 2002(5), një mbipaketim i tillë mund të përmbajë akull të thatë.

(b). Një paketim i jashtëm i një fuqie të mjaftueshme për kapacitetin e tij, masën dhe qëllimin e përdorimit dhe me një dimension të jashtëm minimum prej 100 mm.

(2) Paketimet konform me paragrafin (1) duhet të testohet në përputhje me parashikimet e anësore 2654, tipi i projektit të paketimit duhet të lejohet nga autoritetet kompetente. Çdo paketim i bërë në përputhje me miratimin e tipit të projektit duhet të shënohen në përputhje me anësoren 3512.

Klasi 6.2

Testimet për paketimet në përputhje me anësoren 2653.

2654 (1) Përveç paketimeve për kafshët e gjalla dhe organizmat, mostrat e secilit paketim duhet të përgatiten për testim si është përshkruar në paragrafin (3) deri (5). Në se natyra e paketimit bën të nevojshme, përgatitje ekuivalente dhe testimet janë lejuar duke siguruar së këto mund të demonstrohen që të jenë të paktën efektive.

(2) Mostrat e secilit paketim duhet të përgatiten si për transport, përveç së kur substanca që do

të transportohet do të zëvendësohet me ujë ose kur kushtet në -18°C janë specifikuar, nga një përzierje ujë/antingrirje. Çdo marrës parësor do të mbushet deri 98% të kapacitetit.

(3) Paketimet e përgatitura për transport duhet të jenë subjekt i testimeve në tabelë, e cila, për qëllime testimi, kategorizon paketimet në përputhje me karakteristikat e materialeve të tyre. Për paketimet e jashtme titujt në tabelë kanë lidhje me:

- fibër ose materiale të njëta karakteristikat e të cileve mund të preket shpejt nga lagështira.
- plastik e cila mund të mblidhet në temperatura të ulta; dhe
- materiale të tjera të tilla si metale karakteristikat e të cileve nuk mund të preket shpejt nga lagështira.

Në se një marrës parësor dhe një paketim dytësor (shiko anësoren 2653(1) janë bërë nga materiale të ndryshme, materiali i rezervuarit parësor përcakton testimin përkatës. Në instancat kur një marrës parësor është bërë nga dy materiale, materiali që mund të dëmtohet më shumë do të përcaktojë dhe testimin përkatës

Tabelë

Materiale të				Testi kërkuar			
Paketim i jashtëm		Paketim i brendshëm		në përputhje me (3), gërma		në përputhje me (4),	
Fibër, plastik,	Të tjera	Plastik, të tjera		(a),	(b), (c),	(d),	
X		X		X	X	Kur	X
X			X	X		përdoret	X
	X	X			X	akull i	X
	X		X		X	thatë	X
		X			X		X
			X	X			X

(a). Mostra duhet të jetë subjekt i rënies së lirë mbi një sipërfaqe të fortë, të shështë, horizontale dhe jo elastike. Nga një lartësi 9 metra. Kur mostra është në formën e një kutie duhet të hidhen pesë njëra pas tjetres.

- një nga niveli në fund
- një nga niveli në majë
- një nga niveli në anën më të gjatë
- një nga niveli në anën më të shkurter
- një nga niveli tek këndi

Klasi 6.2

2654 Kur mostra është në formën e një fuçie duhet të hidhen pesë njëra pas tjetres.

- një diagonal në majë, me qendrën e gravitetit direkt mbi pikën e ndeshjes
- një diagonalisht me bazën e kulmit
- një nga niveli në anë.

Duke ndjekur sekuencat e rënieve përkatëse, nuk duhet të këtë rrjedhje nga rezervuarët parësor, të cilët duhet të jenë të mbrojtur me anë të materialeve absorbente në paketimin dytësor.

(b) Mostra duhet të jetë subjekt i një spërkatje me ujë e cila të stimulojë rënien e shiut afërsish të paktën 5 cm për orë . Ajo pastaj do të jetë subjekt i testimit si në përshkrimin (a)

(c.) Mostra duhet të jetë në kushte të -18°C ose më pak për një periudhë të paktën 24 orë dhe brënda 15 minutave nga heqja nga një atmosferë subjekt i testit të përshkruar në (a). Kur mostra përmban akull të thatë , periudha kushtëzimit mund të reduktohet në katër orë.

(d.) Kur paketimi ka për qëllim të përmbajë akull të thatë, një test shtesë në (a) ose (b) ose (c) duhet të kryhet. Mostra duhet të ruhet deri sa akulli thatë të shkrihet dhe pastaj të bëhet subjekt i testit të përshkruar në (a)

(4) Autoritetet kompetente mund të lejojnë testim selektiv të paketimeve që ndryshojnë pak në lidhje me tipin e testuar p.sh. formë të vogël të paketimit të brendshëm ose paketim të brendshëm me masë neto të vogël si dhe paketimet të tilla si fuçi, çanta dhe kuti të cilat janë prodhuar në forma të reduktuara të dimensioneve të jashtme.

(5) Paketimet me një masë bruto prej 7 kg duhet të jenë subjekt i parashikimeve të përshkuara në (a) me poshtë dhe një paketim me një masë bruto që e tejkalon 7 kg të testimit në (b) më poshtë:

(a) Mostrat do të vendosen në një nivel të fortë , një shufur çeliku cilindrike me një masë të paktën 7 kg , dhe një diametër që nuk i tejkalon 38 mm dhe anët e tij të ndeshjes të kenë

një rreze që nuk e tejkalon 6 mm, duhet të lëshohet dhe të bjerë në një rënie të lirë nga një lartësi prej 1 metër e matur nga fundi i ndeshjes mbi sipërfaqen e ndeshjes së mostrës, Një mostër duhet të vendoset mbi bazën e tij. Një mostër e dytë duhet të vendoset me një orientim përpindikular deri te ajo e përdorur për herë të parë. Në çdo instancë shufra prej çeliku do të këtë për qëllim të ndeshë të marrësi parësor.

Duke ndjekur çdo goditje, penetrimi i paketimit të dytë pranohet duke siguruar së nuk ka ndonjë rrjedhje nga marrësi parësor.

(b) Mostrat do të lëshohet mbi fundin e një shufur çeliku cilindrike. Shufra duhet të vendoset vertikalisht në një nivel të fortë. dhe të këtë një diametër 38 mm dhe anët e fundit të sipërm me një rreze që nuk e tejkalon 6 mm. Shufra duhet të shtrihet nga sipërfaqja në një distancë të paktën të barabartë të saj midis rezervuarit të parë dhe sipërfaqes së jashtme të paketimit të jashtëm me një minimum prej 200 mm. Mostra duhet të lëshohet dhe të bjerë në një rënie të lirë vertikale nga një lartësi prej 1 metër e matur nga maja e shufres prej çeliku. Një mostër e dytë duhet të lëshohet nga e njëjta lartësi me një orientim përpindikular nga ajo e përdorur për herë të parë. Në çdo instancë paketimi duhet të orientohet që shufra e çelikut të mund të penetrojë marrësin parësor. Duke ndjekur çdo goditje, penetrimi i paketimit të dytë pranohet duke siguruar se nuk ka ndonjë rrjedhje nga marrësi parësor.

Klasi 6.2

2654 (6) Për aq kohë sa niveli ekuivalent i kësaj mbahet, ndryshimet si me poshtë në rezervuarët parësor të vendosur brënda paketimit dytësor lejohen pa nevojën e një testimi të mëtejshëm të paketimit komplet.

Rezervuarët parësor janë të krahasuar me rezervuarët parësorë të testuar mund të përdoren duke siguruar:

(a). rezervuarët parësor janë të njëjtit projektim me rezervuarët parësor të testuara (p.sh. të rrumbullakët, katërkëndësh):

(b). materiali konstruktimit të rezervuarëve parësor (p.sh. xham, plastik, metal) kanë një rezistencë ndaj goditjes dhe presionit të masës ekuivalent ose më të mire së rezervuarët parësor të testuar filimisht.

(c). Rezervuarët parësor kanë të njëjtën, ose hapje/mbyllje më të vogël të projektit ekuivalent (p.sh. tapë me rrotullim,)

(d). të përdoret material i butë i mjaftueshëm shtesë për të mbushur hapsirat boshe dhe për të parandaluar lëvizjet e mëdha të rezervuarëve.

(e). rezervuarët parësor të orientohen brënda paketimeve dytësore në të njëjtën mënyrë si dhe paketimi i testuar.

(7) rezervuarët e brendshëm të çdo tipi mund të mblidhen brënda një paketimi ndërmjetës(dytësor) dhe të transportohet pa testim në paketime të jashtme sipas kushteve me poshtë:

(a.) Paketimet e kombinuara të ndërmjetme/të jashtme duhet të testohen në mënyrë të mjaftueshme në përputhje me nënparagrafin (3) (a) me marrësa të brendshëm të thyeshëm (p.sh. xhami)

(b) Masa bruto totale e kombinuar e rezervuarëve të brendshëm nuk duhet të tejkalojë një gjysëm të masës bruto të rezervuarëve të brendshëm të përdorur për testimin në rënie në (a) më sipër.

(c) trashësia e materialit të butë midis rezervuarëve të brendshëm dhe midis marrëave të brendshëm dhe të jashtëm të paketimeve të ndërmjeteme nuk duhet të reduktohet me poshtë së trashësia koresponduese në paketimin e testimit origjinal, dhe në se një marrës i brendshëm i vetëm është përdorur në testin origjinal, trashësia e materialit të butë midis rezervuarëve të brendshëm nuk duhet të jetë më pak se trashësia e materialit të butë midis anës së jashtme të paketimit ndërmjetës dhe dhe rezervuarëve të brendshëm në testimin origjinal. Kur përdoren marrësa të brendshëm më të vegjël (të krahasuar me rezervuarët e brendshëm të përdorur në testimin e rënies) material i butë shtesë i mjaftueshëm duhet të përdoret për të mbushur zbrazëtirat.

(d) Paketimet e jashtme duhet të kenë kaluar me sukses një test masiv si në anësoren 3555 kur janë të zbrazët. Masa totale e paketimit identik duhet të bazohet në masën e kombinuar të rezervuarëve të brendshëm të përdorur në testimin e rënies në (a) më sipër.

(e) Për rezervuarët e brendshëm që përmbajnë lëngje duhet të përdoret një sasi e mjaftueshme materiali absorbues për të gjithë lëngun që përmbahet në rezervuarët e brendshëm.

(f.) Në se paketimi i jashtëm ka për qëllim të përmbaje marrësa të brendshëm për lëngje dhe nuk është kundër rrjedhjeve, ose ka për qëllim të përmbaje marrësa të brendshëm për solide dhe nuk është kundër rrjedhjeve, të përdoren linja kundër rrjedhjeve, çanta plastike ose mjete të tjera efektive kundër rrjedhjeve.

Klasi 6.2

2654 (g.) Shënimet mbi paketime në konformitet me këtë paragraf duhet të përfshije gërmën "U" menjëherë pas shënimit të përshkruar në anëoren 3512(1)(c)(iii)

2655. (1) Substancat e klasifikuara sipas 3° dhe 4°(b) duhet të pakëtohen në:

- (a) në një fuçi çeliku konform me anësoren 3520"ose
- (b) në një fuçi alumini konform me anësoren 3521"ose
- (c) në një bidon çeliku ose në bidona alumini konform me anësoren 3522: ose
- (d) në një fuçi plastike ose bidona plastik konform me anësoren 3526: ose
- (e) në paketimet e përbëra (material plastik) konform me anësoren 3537:Ose
- (f) në paketimet e kombinuara konform me anësoren 3538 ose
- (g) në paketime të përbëra (xham, porcelan ose veshje guri) konform me anësoren 3539 ose
- (h) metal IBC konform me anësoren 3622
- (i) plastik e ashpër IBC konform me anësoren 3624
- (j) (e rezervuar)

(k) Ibc e përzier marrësa të brendshëm plastik konform me anësoren 3625 me përjashtim të IBC të tipeve 11HZ2 dhe 31HZ2.

(2) Substancat solide brënda kuptimit të anësore 2650(5) gjithashtu mund të pakëtohen në fuçi dërrase konform me anësoren 3523, ose në fuçi fibre konform me anësoren 3525, në se është e nevojshme me një ose më shumë çanta të brëndëshme kundër rrjedhjeve

2656 Mostrat diagnostike tek e cila anësorja 2650(7)(b) aplikohet duhet të jetë subjekt vetëm i parashikimeve të anësore 2664 në se plotësohen kushtet si me poshtë:

- (1)- rezervuarët parësor nuk përmbajnë më shumë se 100 ml
- paketimi i jashtëm nuk përmbajnë më shumë se 500 ml
- rezervuarët parësor janë kundër rrjedhjeve
- paketimet në përputhje me parashikimet e kësaj klase, nuk mund të jenë subjekt i testeve.

Ose

(2) paketimet të përmbushin standartet EN 829:1996

2657 Kur substancat e këtij klasi transportohen në nitrogjen lëng shumë të ngrirë, paketimi i brëndshëm duhet të jetë konform me parashikimet e këtij klasi dhe Konteinerët për nitrogjen të jenë konform me parashikimet e Klasës 2.

2658. (1) Hapja e rezervuarëve parësor për lëngje të 1° dhe 2° duhet të mbyllet dhe të mos jenë të rrjedhshëm duke patur dy mjete mbyllje të vendosura në seri njëra nga të cilat të jetë e rrotullueshme ose e siguruar me një mjet tjetër ekuivalent.

(2) Rezervuarët për substancat e 3° dhe 4° të cilët lëshojnë gaze dhe të cilët transportohen në një temperaturë ambienti më shumë se 15°C duhet të paisen me një ventilator specifik të shtrënguar në kapak, e cila të jetë e mbrojtur kundër goditjeve (forcave) të jashtme.

Me rezervuarët e ripërdorshëm filtri i ventilatorit duhet të zëvendësohet para rimbushjes.

(3) Paketimet plastike ose prej fibre që kanë për qëllim transportin e shkrirësave të 4° duhet të jenë rezistent dhe në se shkrirësi përmban objekte të mrehta, duhet të jetë i pa penetrueshëm në objekte të tilla.

(4) Mbyllja e paketimeve për substancat e 4° duhet të jetë e konstruktuar që ato të jenë të mbyllura hermetikisht mbas mbushjes dhe të projektuara që të mos ndodhë asnjë hapje e evidente.

Klasi 6.2

2659-2660

3. Paketimet e përziera .

2661 (1) Substancat e mbuluara nga i njëjti numër titulli mund të pakëtohen së bashku në një paketim të kombinuar konform me anësoren 3538

(2) Substancat e 10,20 dhe 30mund te jene pakëtuara bashke ne nje kombinacion pakëtimi

konform anesores 3538,nqs paketimi eshte testuar dhe aprovuar ne lidhje me vendimin per substancat te 10, dhe20

(3) Substancat e klasit 6.2 nuk mund të paktohen bashke me substancat dhe me mallra të tjerë te klasit, as me mallrat jo subjekt vendimeve te ADR.Kjo nuk do te perdore modelin diagnostik te cilet jane paketuuar ne lidhje me anesoren2656 ose te substancave qe jane transportuar si ftohes,etj akull, ose nitrogjen leng per ftohje te thelle.

(4) Vendimet e anesores 2002 (6) dhe (7) dhe 2652 do te jene ruajtur.

(5) Nqs arkat jane perdorur me dru ose fibraderrase nje paketim nuk do te peshoje me shume se 100 kg.

4. Shenjat dhe etiketat e rrezikut (shiko Shtojcen A.9)

Shenjat

2662 (1) Çdo paketim duhet të jetë i shënuar në mënyre të qartë me numrin e identifikimit të mallrave për tu futur në dokumentet e transportit, të paraprirra nga gërmat “UN”

Etiketat e rrezikut.

(2) Paketimet që përmbajnë substanca ose artikuj të kësaj Klase duhet të kenë një etiketë konform Modelit 6.2.

(3) Paketimet që përmbajnë substanca të ketij klasi bartes te nitrogjen si ftohes i thelle duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 2

(4) Paketime që përmbajnë substanca te lengeta si 3° ne rezervuare te mbyllur te cilet nuk jane te dukshem nga jashte,ndersa paketimet permbajne rezervuare me rrugedalje,dhe rezervuare me pa rrugedalje te jashteme duhet të kenë si shtesë një etiketë konform Modelit Nr. 11

2663

B. Vecorite në dokumentat e transportit.

2664 (1)Përshkrimi i mallrave në dokumentet e transportit duhet të jetë konform me një nga numrat e identifikimit dhe emrat e nënvizuar në anësoren 2651,pasuar nga emrat biologjik te substancave per substancat 1o,3o

Nqs substancat infektuese si nje substance e modifikuar gjenetikusht, duhet te shtohen fjalet „mikroorganizmat e modifikuar gjenetikusht „

7/ Emrat biologjik te dhene normalisht te jene perdorur ne referime teksesh,rrregulla operative publike dhe tekse shkencore dhe teknike.Emrat tregtare nuk do te jene perdorur per kete qellim.

Klasi 6.2

2664 Per mostren diagnostike te cilat kane mbuluar transportin nen kushtet e anesores 2656 pershkrimi i mallrave mund te jete „ Moster diagnostike, duke mbajtur....“ substancat infektuese duke percaktuar klasifikimin nen 2o ose 3o te jene ne liste.

Përshkrimi i mallrave do të ndiqet nga veçoritë e klasës, numri i titullit në se është i aplikueshëm, gërma dhe inicialet “ADR” ose (RID), [p.sh”6,2.3o (b) ADR”]

Për transportin e shkrirësave [shiko anësoren 2000(5)] përshkrimi i mallrve do të jetë”Përmbajtje e shkrirësave....” komponentet më të përdorur për klasifikimin e shkrirësave sipas anësores 2002(8) dhe të futet sipas emrit të tij kimik ose biologjik p.sh. “Shkrirës që përmban 2814 substanca infektuese,ndikuese njerezore,viruse 6.2, 2° ADR”

Për transportin e solucioneve dhe përzierjeve të tillë si përgatitjet dhe shkrirësit që përmbajnë dy ose me shume komponentë subjekt i parashikimeve të ADR në përgjithësi jo me shume se dy komponente të cilët kontribuojnë më shumë në rritjen e rrezikut të solucioneve ose përzierjeve eshte e nevojeshme te tregohen.per shkriresit e 4o pershkrimi i nenvizuar eshte i mjaftueshem „ Shkrires klinik, nen specifikimin, n.o.s.6.2, 4o (b) ADR „

Per transportin e mallrave qe prishen lehtesisht ,informacioni i pershtatshem do te jete parashikuar p sh. „ I fresket ne +2/+4 oC ose „ transportuar me njesi ngrirese“ ose „jo ngrirese“

2665-2671

Paketime bosh.

2672 (1) Paketime bosh të papastra përfshijnë IBC të 11°duhet të mbyllën në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën shkallë të rrjedhjes sikur ato të ishin të mbushura plot.

(2) Paketime bosh të papastra përfshijnë IBC te 11° duhet të njëjtën përshkrim dhe etiketën e

rrezikut sikur ato të ishin të mbushura plot.

(3) Përshkrim në dokumente e transportit duhet të jetë konform me një nga emrat e nënvizuar në 11° p.sh. “Paketime bosh, 6.2, 11° ADR” Në rast të mjeteve, rezervuar bosh, rezervuar të çmontueshëm bosh, kontenier rezervuar bosh si dhe mjete bosh për transport në masë dhe konteniere bosh, të pa pastër, ky përshkrim duhet të kompletohet duke shtuar fjalët “ Ngarkesë e fundit” së bashku me emrin dhe titullin e mallrave të ngarkesës së fundit p.sh. “Ngarkesë e fundit: 2900 substance infektive, ndikues tek kafshet, 3°(b)”

2673

D. Parashikime te tjera.

Parashikime te tjera per substancat e kesaj klase te cilat jane vendosur per aresye te tjera te sigurise nuk jane efektive (psh ne lidhje me import – exportin,marketingun,shperndarjen qellime veterinare etj)

2675-2699

Klasa 7. Materiale radioaktive

2700 (1) Pasqyra e aktivitetit.

a) Ndërmjet materialeve me një veprimtari të veçantë jo më shumë se 70 kBq/kg (2 nCi/g), dhe artikujve që përmbajnë mallra të tilla, vetëm këto të cilat janë të shënuara apo të caktuara në një hyrje n.o.s. të marzhinalit 2701 janë të pranuar për transport dhe vetëm nën kushtet¹⁾ e kërkuara të katalogut përkatës të marzhinalit 2704 dhe Shtojcës A.7 (marzhinalet 3700 – 3799).

b) Materialet dhe artikujt referuar tek (a) janë të ADR-së.

Shënim: Stimuluesit kardiakë që përmbajnë material radioaktiv, kur tek të sëmurët ato nguliten me ndërhyrje kirurgjikale, ose radiogramet farmaceutike administruar tek një pacient në kursin e trajtimit mjekësor, nuk janë subjekt i klauzolave të ADR-së.

2) Përkufizime dhe shpjegime

A1 dhe A2

1. A1 nënkupton veprimtarinë maksimale tek format speciale në materialin radioaktive lejuar në një paketim të Tipit A. A2 nënkupton veprimtarinë maksimale të materialit radioaktive, por ndryshe nga forma speciale e materialit radioaktive të lejuar në paketimin e Tipit A (shih Shtojca A.7, Tabela 1).

Klasi 7

2700 Emetuesit Alfa të Helmueshmërisë së Ulët

1. Emetuesit e Helmueshmërisë së Ulët Alfa nënkuptojnë uran natyror; uran të varfëruar; torium natyror; uran 235 apo 238; torium 232; torium 228 dhe 230 kur xeherori i tyre përmban përqëndrime fizike apo kimike; bërthamat radioaktive me gjysmë-jetën e më pak se 10 ditëve.

Miratimi

¹⁾ Klauzolat e Klasit 7 janë bazuar në parime vijuese dhe në klauzolat e Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (International Atomic Energy Agency, IAEA).

Rregullat për Transportin e Sigurtë të Materialit Radioaktive, Seritë e Sigurise Nr. 6, Edicioni 1985 (i përmirësuar më 1990), përfshin edhe parime të përgjithshme mbi Mbrojtjen Radioaktive.

Shpjegime dhe informacione plotësuese rreth këtyre rregullave mund të gjendet te bibliografia e mëposht-me:

IAEA ‘Material Këshillues për Rregullat IAEA të Transportit të Sigurtë për Mallrat Radioaktive’ (Edicioni 1985) Seritë e Sigurise Nr. 37, Edicioni i Tretë (i përmirësuar më 1990).

IAEA ‘Material Shpjegues për Rregullat IAEA të Transportit të Sigurtë për Mallrat Radioaktive’ (Edicioni 1985) Seritë e Sigurise Nr. 7, Edicioni i Dytë (i përmirësuar më 1990).

IAEA ‘Standartet e Sigurisë Themelore për Mbrojtjen Radioaktive’ Seritë e Sigurise Nr. 9, Edicioni 1982.

IAEA ‘Planifikimi i Përgjigjeve Urgjente dhe i Gatishmërisë për Aksidente Transporti ku përfshihen Mallrat Radioaktive’ Seritë e Sigurise Nr. 87, Edicioni 1988.

IAEA ‘Lista e Kërkesave për Transportet e Veçanta të Materialeve Radioaktive’ Seritë e Sigurise Nr. 80 (i përmirësuar në 1990).

Miratim i shumanshëm nënkupton pranimin prej të dy autoriteteve përkatës nga vendi i origjinës së projektit apo transportit, dhe i çdo vendi përmes të cilit ngarkesa është kaluar.

2. Miratim i njëanshëm nënkupton një pranim projekti i cili është kërkuar të jepet nga autoriteti përgjegjës i vendit të origjinës së projektit.

Në qoftë se vendi i origjinës nuk është pjesë e ADR-së, të miratuarit duhet të kërkojnë sanksionim nga autoriteti përgjegjës i vendit të parë ADR që shtrihet në itinerarin e ngarkesës.

Konteinerët

3. Një konteiner si vagon i mallrave të këtij klasi duhet të jetë me karakter të mbyllur dhe të qëndrueshëm, i ashpër dhe mjaft i fortë për punë të përsëritura. Mund të përdoret si ambalazhim n.q.s. klauzolat në zbatim janë plotësuar, gjithashtu mund të përdoret të kryejë funksionet e një “mbipaketimi”.

Sistemi ndotës

4. Sistem ndotës nënkuptohet përmbledhja e përbërësve të paketimit caktuar si diçka e parashikuar për të mbajtur materialet radioaktive gjatë transportimit.

Ndotja

5. Me ndotje nënkuptohet prania e substancave radioaktive mbi një sipërfaqe, në tejkallim të madhësisë 0.4 Bq/cm^2 ($10^{-5} \mu\text{Bq/cm}^2$) për emetuesit beta dhe gama dhe emetuesit e një helmimi të ulët alfa, ose 0.04 Bq/cm^2 ($10^{-6} \mu\text{Bq/cm}^2$) për të tërë emetuesit alfa.

Ndotja e përcaktuar nënkupton një ndotje tjetër nga ajo e pacaktuar.

Ndotja e pacaktuar nënkupton një ndotje që s'mund të pastrohet prej sipërfaqes gjatë rasteve normale.

Skicimi

6. Skicimi nënkupton përshkrimin e materialeve radioaktive të formave speciale, dërgesa, apo paketimi i cili bën të mundur që një njësi e tillë të identifikohet plotësisht. Përshkrimi mund të përfshijë specifikime, vizatime inxhinierike, raporte të paraqitura pëlqyeshëm me nene të rregullta, dhe tjetër dokumentim përkatës.

Klasi 7

Rastet e veçantë

Rastet e veçantë nënkupton përdorim të vetëm, nga vetëm një nisës ngarkese, i një makine apo konteineri të madh me një minimum gjatësie prej 6 m, në respektim të të cilit të tëra inicialet, ndërmjetësit, dhe ngarkimi dhe shkarkimi final janë kryer gjer në fund sipas drejtimeve të nisësit apo rezervuarit.

Lënda e ndashme

Për transport të tretësirave dhe përzierjeve me përmbajtje të vetëm një subjekti përbërës në klauzolat e ADR-së, fjalët tretësirë ose përzierje duhet të shtohen si pjesë e emrit në dokumentet transportues [shih anësoren 2002 (8)].

Kur një substancë e ngurtë është dorëzuar për transportim në gjendje të shkrirë, përshkrimi i të mirave duhet të kompletohet nga fjala i shkrirë, nëse nuk është e përfshirë në emër.

Për transport të substancave lehtësisht delikate informacioni përkatës i 13° duhet të jepet, p.sh.: E ftohtë në +2° / +4° ose Mbartet në gjendje të ngrirë ose Të mos ngrijë.

Për transport të artikullit 5° me miratim të autoritetit kompetent (shih Shënimi 2 të marzhinalit 2901, 5°), një kopje e miratimit me kushtet e transportit duhet të ngjitet te dokumenti i transportit. Ky miratim duhet të hartohet në një gjuhë zyrtare të vendit kryesor dhe gjithashtu, në qoftë se kjo gjuhë nuk është anglisht, frëngjisht ose gjermanisht duhet vënë në këto tri gjuhë nëse marrëveshjet vendosen ndërmjet vendeve të interesuara me transportin të siguar në kushte të tjera.

—2920

Paketimet boshe

Klasi 9

Në qoftë se paketimet boshe ku përfshihen IBCs, të papastruara, 71° janë çanta, këto duhet të vihen në kuti ose çanta hermetike për të penguar ndonjë rrjedhje të substancës.

Paketime të tjera boshe me përfshirje të IBCs, të papastruara, të 71° duhet të mbyllen në të njëjtën mënyrë dhe të paraqesin të njëjtën shkallë të hermeticitetit kur ato janë plot.

Paketimet boshe, të papastruara, të 71° duhet të mbajnë mbishkrime të njëjta dhe etiketa të rrezikshmërisë kur ato janë plot.

Përshkrimet në dokumentin e transportit duhet të konfirmohen me një nga emrat e pjerrët në 71°, p.sh. Paketime boshe, 9, 71°, ADR. Në rastin e autobotëve bosh dhe të papastër, ky përshkrim duhet të kompletohet me fjalët shtesë Ngarkesa e fundit së bashku me emrin dhe numrin e çështjes së të mirave, si ngarkesë e fundit, p.sh. Ngarkesa e fundit: azbest bojëkaf 2212, 1° (b).

— 2999

⁵⁾ Emri teknik ose biologjik duhet të jetë një emër i përdorur aktualisht në manualët teknike, shken-core, revistat dhe tekstet. Emrat tregtarë nuk duhen përdorur për këtë qëllim. Për pesticidet, emri teknik duhet të jetë emër i përbashkët ISO (shih ISO 1750:1981 si i përmirësuar), ose emër tjetër shënuar në Klasifikim i Këshilluar nga OBSH (WHO) të Pesticideve, Nga Rreziqet dhe Manualët të Klasifikimi, ose emri i substancave aktive.

Pjesa III. SHTOJCA TE ANEKSIT A

SHTOJCË A.1

3000-3099

Konditat e stabilitetit dhe sigurisë në lidhje me substancat eksplozive , artikujve e përzierjeve nitrate të nitrocelulozës

Të përgjithshme

Kushtet e mëposhtëme janë minimumi i pranueshëm për transport.

Kushtet në lidhje me artikujt dhe substancat eksplozive.

3101 (1) Testimi për ngarkesat e Klasit 1

Ç' do substancë apo artikull që ka ,apo dyshohet të ketë karakteristika shpërthyes duhet të konsiderohet si ngarkesë e Klasit 1, në lidhje me testimet, procedurat e përshkruara në Pjesën e I , Manuali i Testimeve dhe Kriteret. Një substancë apo artikull që bën pjesë në Klas 1, mund të pranohet për transportim vetëm pasi t'i jetë përcaktuar emri ose numri referues në 2101 dhe përshtatet me kriteret e Manualit të Testimeve dhe Kriterëve.

Klasifikimi

Substancat dhe artikujt e Klasit 1 duhet të jenë regjistruar në ndarjen e përshtatshme në grupin përkatës , me procedurat dhe kriteret e përshkruara në Manualin e Testimeve dhe Kriterëve.

Përcaktimi i numrit të artikullit, numrit të identifikimit dhe emrit.

Substancat dhe artikujt e Klasit 1 duhet të përcaktohen me numër artikulli, numër indentifikimi dhe emër ose kod hyrje në Tabelën 1 në 3170.

Interpretimi i emrit të substancës apo artikullit në numrin përkatës individual të Tabëlës 1 në 2101, është bazuar në fjalorin përmbledhes dhënë në 3170.

Substancat eksplozive dhe artikujt, munt të përcaktohen vetëm nepërmjet numrit të references së hyrjes, nëqoftëse nuk mund të përcaktohen nga emri në Tabelën 1ne paragrafin 2101.Përcaktimi i references së hyrjes, mund të behet nga autoritetet kompetente të vendit të origjines.

Testi i kullimit.

(a)Substancat e artikullit 4, me numër identifikimi 0081 (eksploziv shpërthyes tipi A),nëse do të përmbajne më tepër se 40% lëng eter nitrik, do tu behet prova e cilesuar me lart , që të kalojë testin e kullimit si me poshtë.


(b)Aparaturat për testimin e eksploziveve shpërthyes për kullim (fig.1deri në 3) përbehet nga një cilindër i zbrazet bronxi. Ky cilindër, që është i mbyllur në një ane me një pjaster të të njëjtit metal, ka diametër të brëndëshëm 15.7 mm dhe thellesine 40 mm. Është i shpuar nga 20 vrima me diametër 0.5 mm (katër fole nga pesë vrima) gjatë perimetrit. Një piston cilindrik i veshur në gjatësi 48. 00 ka gjatësi totale 52 mm, rreshqet brënda cilindrit në pozicionin vertikal. Pistoni me diametër 15.6 mm është i ngarkuar me një masë 2.220 g kështu që presioni prej 120 kPa (1.20 bar) ushtrohet në bazen e cilindrit.

SHTOJCË A.1

3101(vazhdim)

(c)Një copë e vogël e eksplozivit thërmues me peshë 5 deri 8 g, 30mm e gjatë dhe 15 mm diametër, është mbështjellë me një fasho (pëlhurë) të hollë dhe vendosur në cilindër; pistoni me masën e ngarkuar janë të vendosura në të , që eksplozivi shpërthyes, ushtron presion 120 kPa (1.20 bar). Koha e arritur për shfaqjen e shenjës së parë të kullimit (pikes së parë) të nitroglicerines në vrimat e jashtme të hapura në cilindër, shënohet.

(d)Substanca eksplozive konsiderohet e pranueshme , nëse koha që zgjat përpara shfaqjes së fenomenit të kullimit (pikimit) të lëngut , është më tepër se 5 minuta, dhe testi është zhvilluar në temperaturën 15-25 grad celcius.



SHTOJCË A.1
Testi i kullimit të eksploziveve
shpërthyesë




Fig.1: forma,masa 2220g,i
përshtatshëm për të ndërfutur pistonin
prej bronxi




Fig.2: pistoni cilindrik prej
bronxi, dimensionet në mm.




Fig.3: cilindri i zbraet
prej bronxi, i mbyllur në një ane, plan me
prerje, dimensioned në mm.

Fig.1 deri 3
4 seri nga 5 vrima me diametër 0.5 mm

baker

pllakë hekuri me zgavër konike në sipërfaqen e brëndëshme

katër dritare me përpasa të përafërta 46x56 në intervale të barabarta në periferri

SHTOJCË A.1

Kushtet në lidhje me përzjerjet e nitrocelulozës së Klasit 4.1

3102

Nitrocelulosa në paragrafin 2401, 24 0 (a) ngrohet për 30 minuta në 132 0c nuk duhet të çliroje gazra (tym) nitratit ngjyre të verdhë në kafe. Temperatura e ndezjes duhet të jetë mbi 180 0C. Shif paragrafin (3) deri në (8) ,(9) (a) dhe (10) me poshtë.

3 g nitrocelulozë plastikide ,pasi ngrohet për rreth 1 orë në temperaturën 132 0C, nuk duhet të çliroje tym të verdhë në kaf, të gazrave azotik. Temperatura e ndezjes duhet të jetë mbi 170 0C. Shif paragrafet (3) deri (8), (9) (b), dhe (10) me poshtë.

Proçedurat e testimit të dhëna me poshtë, janë të aplikueshme kur shqyrtohen opsione të ndryshme në lidhje me pranueshmërinë e transportit me transport rrugor të substancave.

Nëse, metodat apo proçedura testimi të tjera janë përdorur për të verifikuar kushtet e qëndrueshmërisë të përshkruara me lart në këtë Shtojcë, këto metoda duhet të udhëheqin në arritjen e të njëjtave rezultate, siç mund të arrihen nga metodat e specifikuar me poshtë.

Për kryerjen e testeve të qëndrueshmërisë sipas ngrohjes të përshkruar më poshtë, temperatura e furrës që përmban kampionin nën testim, nuk duhet të devijojë më tepër se 20C nga temperatura e dhënë. Proçedura e përshkruar gjatë 30 apo 60 minutash duhet të vrojtohet çdo 2 minuta. Furra duhet të jetë e tillë që temperatura e kërkuar të arrihet jo më tepër se 5 minuta pas futjes së kampionit.

Përpara së të kalojë në testim, në paragrafin (9) dhe (10), kampioni duhet të jetë i thare jo me pak se 15 orë në temperaturën e ambientit, paisje tharese me vakum, që përmban klorid kalciumi të grimtuar. Kampioni i substancës duhet të shpërndahet në një shtrese të hollë: për këtë pikësytim, substancat që nuk janë në formë pluhuri apo fibroze, apo të grira , duhet të coptohen në grimca të vogla. Presioni në paisjen tharëse, duhet të bjerë nën 6.5kPa (0.065bar).

Përpara tharjes të përshkruar në paragrafin (6), substancat që përputhen me paragrafin (2) duhet të kalojnë në tharje paraprake në furrë ventilimi, në temperaturë 700C derisa humbja e masës për 15 minuta të jetë me pak se 0.3% e masës fillestare.

Nitrocelulozat e nitratet e dobëta, të përshkruara në paragrafin (1), duhet të kalojë në tharje paraprake sic është përshkruar në paragrafin (7) ;dhe atëherë tharja duhet të behet complete duke e mbajtur nitrocelulosen të pakten 15 orë mbi acid sulfuric të koncentruar në paisjen tharese.

Test ii qëndrueshmërisë kimike nën nxehtësii

Në secilën nga dy testet, tubat e qelqit janë me dimensionet e mëposhtëme:

gjatësia350 mm

diametri i brëndëshëm.....16 mm

trashësia e murit.....1.5 mm

Është vendosur 1 g substancë e tharë klorid kalciumi . Të dy tubat e testimit të mbyllura me tapa të rregjistrueshme ,vendosen në furrë në distancë të paktën 1/4deri në 1/ 5 e gjatësisë së tyre, dhe në temperaturën konstnte 1320C për 30 minuta. Mbikqyret nëse gazrat azotike në formë tymi të verdhë në kaf, shihen qartë kundrejt sfondit të bardhë gjatë kësaj kohe.

(ii) Në mungesë të tymrave të tilla, mendohet që substancë të jetë e qëndrueshme

SHTOJCË A.1

3102 (vazhdim)

Testi i nitrocelulozës plastike (paragrafi (2) me sipër)

3 g nitrocelulozë plastikide vendoset në tubat e qelqit për testim të njëjtë si ato të përdorura në (a) të cilat vendosen në furrë me temperaturë konstante 132 0C

tubat e testimit me nitrocelulozë plastike mbahen në furrë për një orë.Gjatë kësaj kohe nuk duhet të çlirohen tymra të verdhë në kaf të gazrave azotik. Mbikqyrja vlerësohet si në (a)

(10) Temperaturë e flakërimit (shih paragrafin (1) dhe (2) me sipër).

Temperatura e flakërimit është e prcaktuar duke ngrohur 0.2 g të mbyllur në një tub qelqi testimi të zhytur në një vatër me përzjerje druri.Tubat futen në vatër pasi të këtë arritur temperatura 1000C. Më pas , temperatura në vatër rritet për 50C për çdo minutë.

Dimensionet e tubave të testimit janë si me poshtë

Gjatësia.....125 mm
Diametri i brëndëshëm.....15 mm
Trashësia e mureve0.5 mm
Dhe duhet të zhytet në një thellësi prej 20 mm.

Testi duhet të përsëritet 3 herë dhe temperatura që ndodh ndezja (flakërimi) me djegje të ngadaltë apo të shpejtë apo shpërthim, do të shënohet në çdo kohë.

Temperatura më e ulët e fillimit të flakërimit, regjistrohet në të tre testimet.

B. Fjalori i emrave në marginalin 2101 [shif gjithashtu në marginalin 3101(3)]

3170 SHËNIM 1 : Përshkrimi në fjalor nuk është menduar që të zëvendësojë procedurat e testimit dhe as klasifikimin e përcaktuar të rrezikshmërisë së substancave apo artikujt e Klasit 1. Detyra për të korrigjuar ndarjen dhe vendosur që Grupi i caktuar S duhet të bazohet në testimin e produkteve në përputhje me Manualin e Kritereve dhe Testimit, Pjesa e Parë, ose në analogji me produktet e ngjashme që tashmë janë testuar dhe përcaktuar në përputhje me Manualin e Kritereve dhe Testimeve.

SHËNIM 2 : Shifrat e dhëna pas emrave në lidhje me numrin e artikullit, (kollona 1) dhe

Numrat e identifikimit (kollona 2) të Tabelës 1 në lidhje me kufirin

2101, ndahen në mënyrë të tërthortë (210/0171).

Për kodin e klasifikimit, shih kufirin 2100 (4).

SHTOJCË A.1

3170 (vazhdim)

Municionet ndriçuese me ose pa shpërthyes, me ngarkesë gufuese apo lëvizëse 210/0171; 300 / 0254; 430 /0297

Municionet ndriçuese janë konstruktuar për prodhim të një burimi të madh drite për ndricimin e një zone. Ato përmbledhin fishek ndriçues, Granada dhe predha; po ashtu dhe bomba ndriçuese dhe me qëllim identifikues.

Shënim: Artikujt e mëposhtëm: fishek sinjalizues, aparate dore sinjalizimi, sinjalizueset në rast fatkeqsie, raketat ndriçuese ajrore, dhe sipërfaqore, nuk hyjnë në këtë kategori. Ato janë listuar veçantë.

Municionet ndezëse, lëng apo xhelatine, me plasje, me ngarkesë gufuese apo lëvizëse 320 /0247.

Municionet përbehen nga lëngje apo substancë xhelatinoze ndezëse. Përveç rasteve kur substancat janë vetë shpërthyes, ato përmbajnë një ose me shumë : kapsollë mbushëse dhe ndezëse, fitil me ngarkesë ndezëse dhe plasëse.

Municionet ndriçuese , fosfor i bardhë me lëndë shpërthyes, plasëse dhe lëvizëse. 220/0243; 310/0244.

Municionet përmbajnë fosfor të bardhë si substancë ndriçuese. Ato gjithashtu përmbajnë një apo me shumë: kapsolla mbushëse dhe ndezëse , fitil me lëndë ndezëse dhe plasëse.

Municione ndriçuese me apo pa plasës, lëndë shpërthyes apo ndezëse. 220/0243; 310/0300.

Municionet përmbajnë kompozim ndriçues. Përveç rasteve kur përbërja është veteshpërthyes, gjithashtu përbëhet nga një apo me shumë ; kapsollë mbushëse dhe ndezëse, fitil me lëndë ndezëse dhe plasëse.

Municione stervitje 300/0488; 430/0362

Janë municione pa lëndën kryesore plasëse, përmbajnë ngarkesë gufuese dhe ndezëse. Normalisht përmbajnë gjithashtu fitil me lëndë ndezëse.

Shënim: Granatat stërvitore nuk futen në këtë klasifikim. Ato janë listuar veçantë.

Municionet testuese 430/0363

Municionet përmbajnë substancë piroteknike , që përdoren për të testuar efektshmërinë apo fortësinë e municioneve të reja ,komponenteve apo të komplet armëve

Municione tymosëse , fosfor i bardhë, me ndezës, lëndë gufuese dhe plasëse. 220/0245; 310/0246

Municionet përmbajnë fosfor të pardhë si një substancë prodhuese tymi. Ato përmbajnë

gjithashtu : kapsollë mbushëse dhe ndezëse, fitil me lëndë ndezëse dhe plasëse. Granadat tymuese futen në këtë klasifikim.

SHTOJCË A.1

3170 (vazhdim)

Municionet tymuese me apo pa plasës, lëndë gufuese apo ndezëse 210/0015; 300/0016 430/0303.

Municionet përmbajnë substancë që prodhojnë tym si acid klorosulforik e përzier me tetraklorid titani; ose kompozim piroteknik si një tymprodhues, me bazë heksaklorotan ose fosfor të kuq. Përveç rasteve kur janë substancat janë veteplasëse, ato përmbajnë gjithashtu : kapsollë mbushëse dhe ndezëse, fitil me lëndë ndezëse dhe plasëse. Granadat tymuese futen në këtë klasifikim.

Shënim :tymueset, sinjalizuese, nuk futen në këtë klasifikim, ato janë listuar veçantë.

Municionet lotuese me lëndë ndezëse, plasëse apo gufuese. 210/0018; 300/0019; 430/0301

Municionet përmbajnë substancë që shkaktojnë lot. Ato gjithashtu përmbajnë: një substancë piroteknike, lëndë gufuese dhe ndriçuese; fitil me lëndë ndezëse ose gufuese.

Artikujt eksploziv me pandjeshmëri ekstreme (Artikujt EEI) 500/0486

Artikujt përmbajnë vetëm substancë shpërthyes me pandjeshmëri ekstreme(EIDS)të cilat demonstron një propabilitet të papërfillshëm të ndezjes te papritur gjatë transportit në kushte normale, të cilat kanë kaluar Testin e serisë 7.

Artikujt piroforik 250/0380

Artikujt që përmbajnë një substancë piroforike (të afta për tu ndezur në mënyrë spontane kur ekspozohen në ajër) dhe një substancë apo komponent eksploziv, Klasifikimi përjashton substancat që përmbajnë fosfor të bardhë.

Artikujt piroteknik , për qëllime teknike 90/0428; 210/0429; 430/0431; 430/0432.

Artikujt që përmbajnë substancë piroteknike dhe janë të përdorshme për qëllime teknike si prodhim nxehtësie, prodhim gazi , efekte teatrale etj.

Shënim: Artikujt e mëposhtëm: të gjithë municionet; fishek sinjalizues;kabllo eksplozive;fishekzjarre;sinjale ajrore dhe tokësore me drite; lidhje eksplozive sinjalizues dore; sinjale rreziku etj.. nuk futen në këtë klasifikim. Ato janë listuar ne mënyrë te veçantë.

Barut i ngjeshur apo në saçme 40/0028

Substanca konsiston në barut në formë saçme.

Barut i grimcezuar ose në formë pluhuri 40/0027

Substanca konsiston në një përzierje të brëndëshme të qymyr druri ose karbon tjetër me nitrat potasi ose sode nitrati, me ose pa squfur.

Bombat,me lëng të djegshëm me lëndë shpërthyes 100/0399; 230/0400

Artikujt që vendosen në avionët, konsistojnë në një rezervuar të mbushur me lëng të djegshëm

SHTOJCË A.1

3170 (vazhdim)

Bombat foto-flesh 50/0038

Artikujt eksploziv që lëshohen nga avionët për të siguruar një ndriçim të madh për efekt fotografimi. Ato përmbajnë lëndë shpërthyes me mjetin e nisjes ose me mjete nisëse që përmbajnë dy ose me shumë veçori mbrojtëse efektive.

Bomba foto-flesh 70/0037

Artikujt eksploziv që lëshohen nga avionët për të siguruar një ndriçim të madh për efekt fotografimi. Ato përmbajnë lëndë detonative eksplozive me mjete nisëse që nuk përmbajnë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive.

Bomba foto-flesh 210/0039; 300/0299

Artikujt eksploziv që lëshohen nga avionët për të siguruar një ndriçim të madh për efekt fotografimi. Ato përmbajnë lëndë përzierje foto-flesh.

Bomba me ngarkesë plasëse 50/0034;170/0035

Artikujt eksploziv që hidhen nga avionët me mjete nisëse që përmbajnë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive.

Bomba me ngarkesë plasëse 70/0033;190/0291

Artikuj eksplozive hidhen nga avionët me mjete nisëse që nuk përmbajnë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive.

Raketat me detonator 10/0225;130/0268

Artikujt konsistojnë në lëndë ndezëse eksplozive me mjetin e nisjes. Ato janë të përdorshëm për rritjen e fuqisë fillestare të ndezësve ose kordës detonative.

Raketat pa detonator 50/0042;170/0283

Artikujt konsistojnë në lëndë ndezëse eksplozive pa mjetin e nisjes. Ato janë të përdorshëm për rritjen e fuqisë fillestare të ndezësve ose kordoni detonativ.

Shpërthyes eksploziv 50/0043

Artikujt konsistojnë në një ngarkesë të vogël eksplozivi që përdoren për të hapur predhat ose municione të tjera, me qëllim për të prishur përbërjen e tyre.

Fishekë flesh 90/0049;300/0050

Artikujt konsistojnë në veshje me pudër shkrepëse, e mbledhur e gjitha në një pjesë të gatëshme për qitje.

Fishek për armë, bosh 30/0326;170/0413;270/0327;370/0338;470/0014

Municioni konsiston në një gëzhgjë fisheku të mbyllur me një qëndër ose mbushje skajore Përdoruese dhe lëndë jo tymosëse, ose barut, por jo predhë. Ato prodhojnë një zhurmë të madhe dhe përdoren për stervitje përshëndetje etj. Klasifikimi përfshin municionet boshe

SHTOJCË A.1

3170 (vazhdim)

Fishekë për armë, predha të palëvizshme 150/0328;270/0417;270/0327;370/0339;470/0012

Municionet konsistojnë në predha pa ngarkesë shpërthyes por me ngarkesë gufuese me apo pa kapsollë. Artikujt mund të përfshijnë një plumb gjurmëlënës, duke siguruar që rreziku më i lartë është i ngarkesës lëvizëse.

Fishekë për armë, me ngarkesë shpërthyes 60/0006;180/0321;400/0412

Municioni konsiston në një predhë me ngarkesë shpërthyes pa mjetin e nisjes ose me mjet nisje që përmban dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive dhe ngarkesë lëvizëse me apo pa kapsollë. Klasifikimi përfshin municionet e montuara, fikse, gjysem fikse, municione me ngarkesa të ndara kur komponentet janë paketuar sëbashku.

Fishekë për armë, me ngarkesë shpërthyes 70/0005;190/0007;410/0348

Municioni konsiston në një predhë me ngarkesë shpërthyes me mjetin e nisjes që nuk përmban dy ose më shumë veçori mbrojtëse, efektive dhe ngarkesë lëvizëse me apo pa kapsollë. Klasifikimi përfshin municionet e montuara, fikse, gjysem fikse, municione me ngarkesa të ndara kur komponentet janë paketuar sëbashku.

Fishekë, pus naftë 270/0277; 370/0278

Artikujt konsistojnë në një veshje ose skatull fibre të hollë metali apo materiale të tjera që përmbajnë vetëm barut shtytës të cilët hedhin predhat e kalitura për të shpuar puse naftë.

Shënim: Ngarkesat në formë kallëpi, nuk janë përfshirë në këtë klasifikim. Ato janë listuar veçantë.

Fishekë, mjete fuqie 150/0381;270/0275;370/0276;470/0323

Artikujt janë konstruktuar të kryejnë veprime mekanike. Ato konsistojnë në një veshje me eksploziv flakërues dhe me mjetin e nisjes. Produktet prej gazi të procesit të flakërimit fryhen duke prodhuar lëvizje lineare apo rrotative ose aktivizojnë diafragma, valvola apo çelësa, ose konstruktojnë lëvizje të shpejta ose agjentë asgjësues.

Fishekë sinjalizues 300/0054; 430/0312; 470/0405

Artikujt janë konstruktuar për shkrepje me flakë të ngjyrosur ose sinjale të tjera nga pistoletat sinjalizuese, etj.

Fishekë të vegjël armësh 270/0417; 370/0339; 470/0012

Municioni konsiston në një gëzhgjë të mbushur në qëndër apo skaj me kapsollën dhe i përmban të dyja, ngarkesën lëvizëse dhe predhën solide. Ato janë konstruktuar për të shkrepur nga armë të kalibrit jo më shumë se 19.1mm. Fishekët e pushkëve të gjahut të çdo kalibri përfshihen në këtë klasifikim.

Shënim; Fishekët e armëve të vogla boshe, nuk përfshihen në këtë klasifikim. Ato janë listuar veçantë. Disa fisheke të armeve ushtarake nuk janë përfshirë në këtë klasifikim. Ato janë listuar nën

predhat e palevizshme fisheke per arme.

SHTOJCË A.1

3170 (vazhdim)

Fishekë të vegjël armësh, bosh 270/0327; 370/0338; 470/0014

Municioni konsiston në një gëzhjojë e mbshur në qëndër apo skaj me kapsollën dhe ngarkesë pa tym ose barut .Veshja e fishekut nuk përmban predhë. Ato janë konstruktuar për tu shkrepur nga armë të kalibrit pothuajse 19.1mm dhe sherbejnë për të prodhuar zhurmë të lartë ,dhe përdoren për stervitje , përshtëdetje, pistoleta starteri etj.

Veshjet, gëzhoja bosh, me kapsollë. 370/0379; 470/0055

Artikujt konsistojnë në një veshje gëzhjojë prej metali, plastike apo tjetër material jondezës, ku i vetmi komponent eksploziv, është kapsolla.

Veshjete djegshme bosh, pa kapsollë. 270/0447; 370/0446

Artikujt konsistojnë në veshje gëzhjojë e prodhuar pjesërisht apo krejtësisht prej nitrocelulozë.

Ngarkesa plasëse, amballazh plastik 50/0457; 170/0458; 390/0459; 470/0460

Artikujt konsistojnë në lëndë shpërthyes plasëse, në amballazh plastik, prodhuar në mënyrë specifike pa veshje dhe pa mjetin e nisjes.Ato janë konstruktuar si komponente municioni për mbushje rrakëte.

Ngarkesa shëmbje 50/0048

Artikujt konsistojnë në lëndë plasëse detonative , me veshje fibre , plastike ,metali ose materiale të tjera. Artikujt janë pa mjetin e nisjes ose me mjet nisje me dy apo me shumë veçori mbrojtëse.

Shënim: Artikujt: bomba, mina, predha nuk janë përfshirë në këtë klasifikim. Ato janë listuar veçantë.

Ngarkesa thellësie 50/0056

Artikujt konsistojnë në ngarkesa me përbërës detonativ, plasës, në fuçia apo predha , pa mjetin e nisjes, ose me mjet nisje me dy apo me shumë veçori mbrojtëse. Ato janë konstruktuar për të shpërthyer nën ujë.

Ngarkesa plasëse komerciale, pa detonator 50/0442; 170/0443; 390/0444; 470/0445

Artikujt konsistojnë në ngarkesa shpërthyes plasëse pa mjetin e nisjes, të përdorshme për të shpërthyer saldime, bashkime, ose procese metalurgjike të tjera.

Ngarkesa shtytëse, për top 30/0279; 150/0414; 270/0242

Lëndë për lëvizje në çdo formë fizike për ndarje, ngarkesë municioni për topa.

Ngarkesa shtytëse 30/0271 150/0415 270/0272;370/0491

Artikujt konsistojnë në një ngarkesë lëvizëse në çdo formë fizike, me apo pa amballazhim, si një komponent të motoraketave apo për reduktimin e rezistencës së predhave.

SHTOJCË A.1

3170 (vazhdim)

Ngarkesë Kallëp 50/0059 170/0439; 390/0440;470/0441

Artikujt konsistojnë në një kuti që përmbajnë lëndë plasëse , me një zgavër të veshur me material të ngurtë, pa mjetin e nisjes. Ata janë konstruktuar për të prodhuar fuqi, efekte depërtuese reaktive.

Ngarkesë Kallëp fleksibël linear 50/0288; 390/0237

Artikujt konsistojnë në kallëp-V zemër prej lënde shpërthyes plasëse të veshur me këllëf.

Ngarkesat suplementare plasëse 50/0060

Artikujt konsistojnë në një përforcues të vogël të zmontueshëm në brëndësi të predhave, ndërmjet siguresës dhe ngarkesës plasëse.

Komponentë varg eksploziv 10/0461130/0382; 350/0383; 470/0384

Artikujt përmbajnë një plasës të konstruktuar për të transmetuar ndezje apo flakërimin brënda një vargu eksploziv.

Të veçanta, aktivizim me ujë, me plasje, gufuese ose lëvizëse. 250/0248; 340 /0249

Artikujt, funksionimi i të cilave varet nga reaksione fiziko-kimike të përbrësve të tyre me ujin.

Fitil, ndezës, fleksibël 50/0065; 390/0289

Artikujt konsistojnë në një palce ndezëse plasëse brënda një veshje pëlhurë dhe një veshje plastike apo tip tjetër. Nuk ka rëndësi nëse veshja e jashtme është mbrojtëse apo në formë thurje.

Fitil (siguresë) ndesës, veshje metali 50/0290; 170/0102

Artikujt konsistojnë në një palcë ndezëse plasëse e veshur nga tub prej metali të butë me apo pa mbulesë mbrojtëse. Sasia e substancës eksplozive është aq e vogël sa që manifestohet vetëm një efekt i ngadalshëm jashtë fitilit.

Fitil ndezës 430/0066

Artikujt konsistojnë në fitila tekstili të veshura me barut ose kompozime piroteknike me djegie të shpejtë dhe me një mbulesë mbrojtëse fleksibël; ose ato konsistojnë në fitila prej baruti e mbështjellë me një thurje plastike. Ato digjen në mënyrë progresive gjatë gjithë gjatësisë me flakë të jashtme dhe përdoren për të trasmetuar ndezjen nga aprati në ngarkesë apo kapsollë.

Prerës, trasmetues plasës 470/0070

Artikujt konsistojnë në mekanizëm the thike, që lëvizën nga ngarkesa të vogla të eksplozivëve flakërues brënda në kudhër.

SHTOJCË A.1

3170 (vazhdim)

Ndezës komplet, jo elektrik, për shpërthim 10/0360; 350/0361; 470/0500

Ndezës komplet jo elektrik, që aktivizohen nga kapsolla sigurie, tub godites, tub flakërimi apo fitil ndezës. Ato mund të jenë kompozim i çastit ose përfshijnë element të ngadalshëm. Relet ndezëse, fitilat ndezës përfshihen në këtë klasiifikim.

Ndezësit elektrik për shpërthim 10/0030; 350/0255; 470/0456

Artikuj special të konstruktuar për ndezjen e ngarkesave shpërthyes. Ato mund të jenë konstruktuar për ndezje të menjëherëshme ose mund të përmbajnë elementë të ngadalshëm. Detonatorët elektrik aktivizohen me rrymë elektrike.

Ndezësit për municione 10/0073; 130/0364; 350/0365; 470/0366

Artikujt konsistojnë në një tub metali apo plastik që përmbajnë grafit, PETN ose eksploziv të kombinuar. Ato janë konstruktuar për startimin e detonimit të tranave.

Detonatorët –jo elektrik 10/0029; 350/0264; 470/0455

Artikujt janë konstruktuar vecanërisht për ndezjen e eksplozivëve shfryrës. Këto ndezës janë të konstruktuar për detonimin e menjëherëshëm ose mund të përmbajnë elementë të ngadalshëm. Ato mund të jenë konstruktuar të aktivizohen nga mjete të tilla si tuba goditës, tub flakërues, tel siguresë, paisje të tjera ndezëse ose kordon detonativ fleksibël.

Reletë detonativ pa kordon, janë përfshirë në këtë klasifikim.

Eksplozivët shpërbërës tip A 40/0081

Substancat konsistojnë në nitrato organike të lëngët të tilla si nitroglicerina ose përzjerje të përbërësve të tillë me një apo më shumë të elementeve që vijojnë: nitrocelulozë, nitrato amoni ose nitrato të tjera jo organike: derivatet nitroaromatike, ose e materialeve të djegshme si tallash druri dhe pudër alumini. Ato mund të përmbajnë komponente të tilla si kieselguhr, dhe shtesa të tilla si agjentë ngjyruar dhe stabilizuesit. Eksplozive të tilla duhet të jenë në formë pudre, zhelatinoze apo elastike. Këtu përfshihen dinamite, xhelatine, dinamite xhelatine shpërthyes.

Eksplozivët shpërbërës tip B 40/0082 480/0381

Substancat konsistojnë në :

një përxjerje të nitrato amonit ose nitratoeve të tjera jo organike, me një eksploziv të tillë si trinitrotoluol, me ose pa substanca të tjera të tilla si, tallash druri dhe pluhur alumini ose

një përxjerje të nitrato amonit ose nitratoeve të tjera jo organike me substancë të tjera të djegshme që janë përbërës jo shpërthyes. Në të dy rastet ato mund të përmbajnë komponente të tilla si kieselguhr dhe shtesa të tilla si agjentë ngjyrosës dhe stabilizues. Të tillë shpërthyes nuk mund të përmbajnë nitroglicerine, nitrato organike të lëngëta të ngjashme, ose klorate.

Shtojcë A.1

3170 Lënda plasëse, shpërthimi, tipi C 4°/0083

(vazhdon)

Substancat duke konsistuar prej një përzjerje të kaliumit ose klorat natriumi, ose kaliumi, sodium ose perklorat amoniaku me nitro deivatet organike, ose materialet e djegshme të tilla si pluhur druri, ose pluhur alumini, ose një hidrokarbur. Ato mund të përmbajnë përbërës inertë të tillë si kizelgur (diatomit) dhe shtesa të tilla si përbërës (faktor) ngjyrosjeje dhe lëndë stabilizuese. Lëndë të

tilla plasëse nuk duhet të përmbajnë nitroglicerinë apo nitrate organike të lëngshme të ngjashme.

Lënda plasëse, shpërthimi, tipi D 4°/0084

Substanca duke konsistuar prej një përzierje të përzierjve të nitratuara organike dhe materialeve të djegshme të tilla si hidrokarburet dhe pluhuri i aluminit. Ato mund të përmbajnë përbërës inert të tillë si kizelguri (diatomit) dhe shtesa të tilla si faktor ngjyrosje dhe lëndë stabilizuese. Të tilla lëndë plasëse nuk duhet të përmbajnë nitroglicerinë, nitrate organike të lëngshme, klorate dhe nitrit amoniaku. Termi përgjithësisht përfshin lëndët plasëse plastike.

Lënda plasëse, shpërthimi, tipi E 4°/0241; 48°/0332

Substancat duke konsistuar prej ujit si një përbërës themelor dhe raporte të larta të nitratisht të amoniakut ose oksiduesat e tjerë, disa ose të gjithë prej të cilëve janë në tretësirë. Përbërësat e tjerë mund të përfshijnë nitro-derivate të tilla si tritol (trinitrotoluol), hidrokarbure ose pluhur alumini. Ato mund të përmbajnë përbërës inert të tillë si kizelgur (diatomit) dhe shtesa të tilla si faktor ngjyrosje dhe lëndë stabilizuese. Termi përfshin lëndët plasëse, emulsion, lëndët plasëse, fundërrit dhe lëndë plasëse, ...(watergel).

Fishekzjarre 9°/0333; 21°/0334; 30°/0335; 43°/0336; 47°/0337

Artikuj piroteknikë të projektuar për zbavitje.

Fishekzjarret ajror 9°/0420; 21°/0421; 30°/0093; 43°/0403; 47°/0404

Produktet që përmbajnë substanca piroteknike të cilat janë projektuar të jetë të zbritur prej një aeroplani për të ndriçuar, për të identifikuar, për të sinjalizuar ose paralajmëruar.

Fishekzjarret sipërfaqësorë 9°/0418; 21°/0419; 30°/0092

Artikuj që përmbajnë substanca piroteknike të projektuara për përdorim në sipërfaqe për të ndriçuar, identifikuar, sinjalizuar apo paralajmëruar.

Pluhur (pudër) e re (e freskët) 8°/0094; 29°/0305

Substancë piroteknike, e cila kur ndizet, prodhon një dritë të fortë.

Pajisjet e shkallës së plasaritjes, lënda eksplozive, pa shkrepës (kapsollë plasëse), për pusët e naftës, 5°/0099

Produkt duke konsistuar prej një plasës të minës, të lëndës plasëse e përmbajtur në një kuti pa mjete të ngacmimit. Ato janë përdorur për të thyer shkëmbin rreth një boshti trapezoidal, për të ndihmuar rrjedhjen e naftës bruto nga shkëmbi.

Fitili, ndezësi, tubor, veshje metali 43°/0103

Produkt duke konsistuar prej një tubi metali me një zemër (bërthamë) prej lënde plasëse që digjet në çast.

Shtojcë A.1

3170 Fitili, joplasës 30°/0101

(vazhdon)

Produkti duke konsistuar prej fije (pe) pamguku i njomur me pluhur të zi të imët. Ai digjet me një flakë të jashtme dhe është përdorur në trenat me ndezje me shkëndijë, për fishekzjarre etj. Ai mund të jetë i mbyllur në një tub letre për të siguruar një efekt të menjëhershëm dhe të shpejtë.

Fitili, siguria 47°/0105

Produkti duke konsistuar prej një bërthame prej një pluhuri të zi të bluar hollë i rrethuar prej një tekstili (pëlhure), me një ose më shumë mbulesa të jashtme mbrojtëse. Kur ndizet, ajo digjet në një afat të paracaktuar pa ndonjë efekt shpërthyes të jashtëm.

Kapsollat, shpërthyes 1°/0106; 13°/0107; 35°/0257; 47°/0367

Artikujt me komponentet shpërthyes të projektuar për të prodhuar një municion (mjet mbrojtjeje). Ato përmbajnë komponente mekanikë, elektrikë, kimikë ose hidrostatikë, për të filluar detonimin (plasjen). Në përgjithësi, ato përmbajnë veçori mbrojtëse.

Kapsollat, shpërthyes, me veçori mbrojtëse 5°/0408; 17°/0409; 39°/0410

Artikujt me komponentet shpërthyes të projektuar për të prodhuar një municion (mjet mbrojtjeje). Ato përmbajnë komponente mekanikë, elektrikë, kimikë ose hidrostatikë, për të filluar detonimin (plasjen). Kapsolli plasës duhet të përmbajë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive.

Kapsollat që ndizen 30°/0316; 43°/0317; 47°/0368

Artikujt me komponentë kryesorë plasës të projektuar për të prodhuar një flakërim në municion. Ato përmbajnë komponente mekanike, elektrike, kimike ose hidrostatike për të filluar flakërimi. Ato përgjithësisht kanë veçori mbrojtëse.

Granatat, dore ose për granatahedhëse, me mbushje shpërthyesë 5°/0284; 17°/0285
Artikuj të cilët janë projektuar për t'u hedhur me dorë ose me pushkë (granatahedhëse). Ato janë pa mjete inicuese ose me mjete inicuese që kanë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive.

Granata, dore ose granatahedhëse, me mbushje shpërthyesë 7°/0292; 19°/0293
Artikujt, të cilët janë projektuar për t'u hedhur me dorë ose me granatahedhëse. Ato janë me mjete inicuese ose jo, kanë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive.

Granatat stërvitore, dore ose me granatahedhëse 21°/0372; 30°/0318; 43°/0452; 47°/0110
Artikuj pa një mbushje kryesore shpërthyesë, të cilat janë projektuar për t'u hedhur me dorë ose me granatahedhëse. Ato përmbajnë pajisje për mbushje baroti dhe munden për të pasur një veçori njollosëse.

Heksotonal 4°/0393
Substancat që përmbajnë një përzierje të brëndshme të ciklotrimetileni-trinitramine (RDX), trinitrotoluen (TNT) dhe alumin.
Shtojcë A.1
3170 Hekzotol, i thatë ose i njomur me më pak se 15% ujë, prej masës 4°/0118 (vazhdon)
Substancë e përbërë prej një përzierje të brëndshme të ciklotrimetilenit-trinitamine (RDX) dhe trinitrotoluol (TNT). Afati përfshin "Kompozimin B".
Ndezësit 9°/0121; 21°/0314; 30°/0315; 43°/0325; 47°/0454
Artikujt që përmbajnë një ose më shumë substanca shpërthyesë (plasëse) të projektuara për të prodhuar flakërim në një tren me lëndë plasëse. Ata mund të jenë të aktivizuara kimikisht, elektrikisht ose mekanikisht.

Shënim: Artikujt vijues: litar, ndezës; fitil, ndezës; fitil jo ndezës; kapsollat (fitilat) që ndizen; ndriçuesit; mbushës tip kapuçi; mbushës tubolarë nuk janë të përfshirë me këtë përcaktim. Ata janë të renditura të shkëputura.

Armët depërtuese reaktive, të mbushura, pus naftë, pa plasës 5°/0124; 39°/0494
Artikujt me përmbajtje të një tubi çeliku ose shirit metalik, brënda të cilave janë futur mbushësat e lidhur prej litari plasës, pa mjetet e inicimit.
Kapsollat (fitilat) ndriçues 47°/0131
Artikujt e projekteve të ndryshme të aktivizuar prej fërkimit, goditjes ose elektricitetit dhe të përdorura për të ndezur fitilin e sigurisë.
Minat, me mbushje djegëse 5°/0137; 17°/0138
Artikuj të përbërë normalisht prej metali ose përbërjes së rezervuareve të mbushur me një lëndë plasëse shpërthyesë me mjete inicuese, që nuk përmbajnë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive. Ato janë projektuar të jetë të përdorur prej kalimeve të anijeve, mjeteve ose personelit. Artikulli përfshin "Silurat Bangalore".
Minat, me mbushje djegëse 7°/0136; 19°/0294
Artikujt me përmbajtje normalisht të metalit ose përbërjes së rezervuareve të mbushur me lëndë plasëse shpërthyesë, me mjetet e inicimit, që nuk përmbajnë dy ose më shumë veçori mbrojtëse efektive. Ata janë të projektuara për të qënë të futur në veprim nga kalimi i anijeve, mjeteve ose personelit. Artikulli përfshin "Silurat Bangalore".
Oktol, i thatë ose i lagur me më pak se 15% ujë, prej masë 4°/0266
Substancat me përmbajtje të përzierjes së brëndshme të ciklotetrametilenit-tetranitraminë (HMX) dhe trinitrotol (TNT).
Octonal 4°/0496
Substancë me përmbajtje të një përzierje të brëndshme të ciklotetrametilen tetranitraminë (HMX) dhe trinitrotol (TNT) dhe alumin.
Pentolit i thatë ose i lagur me më pak se 15% ujë, prej masës 4°/0151
Substancat me përmbajtje të një përzierje të brëndshme të pentaerit tetranitrat (PETN) dhe trinitrotol (TNT)
Shtojcë A.1
3170 Pastë pudër, e lagur me më pak se 17% alkool, prej masës. Pastë pudër, e lagur me më
(vazhdon) shumë se 25% ujë, prej masës 2°/0433; 26°/0159
Substancë me përmbajtje të nitrocelulozës të mbarsur (plenuar) me jo më shumë se 60% të

nitroglicerines ose nitrateve të tjera organike të lëngshme ose një përzierje e këtyre.

Pluhurat, pa blozë 2°/0160; 26°/0161

Substanca e bazuar në nitrocelulozë, e përdorur si lëvizës. Artikulli përfshin lëvizësat me një bazë të vetme (vetëm nitrocelulozë (NC)), ato me një bazë dyfishe (të tilla si NC dhe nitroglicerinë (NG)) dhe ato me bazë trefishe (të tillë si NC/NG/ nitroguanidinë).

Shënim: Forma e presuar ose qese-mbushësit të pudrës pa tym janë renditur nën mbushësat që lëvizin.

Kapsolla tip kapuçi 1°/0377; 35°/0378; 47°/0044

Artikujt me përmbajtje të një metali ose kapuçi plastik që përmbajnë një sasi të vogël të përzierjes të lëndës plasëse fillestare që është gati i ndezur prej veprimit. Ata shërbejnë si elemente ndezës në gëzhhojat e krahëve të vegjël dhe në goditjen e kapsollave për mbushësat e lëvizshëm.

Kapsollat tubolare 30°/0319; 43°/0320; 47°/0376

Artikujt me përmbajtje të një kapsollë për inicim dhe një mbushje ndihmëse të plasësit flakërues të tillë si pudra e zezë e përdorur për me ndezë mbushësin lëvizës në një arkë gëzhgojash për top etj.

Predhat inerte (të ngurta) me gjurmues 30°/0424; 43°/0425; 47°/0345

Artikuj të tillë si predha ose plumbi, të cilët janë projektuar prej një topi ose pushke tjetër, armë e vjaska ose armë tjetër e vogël.

Predhat, me mbushje plasëse ose me ngarkesë të dëbuar 17°/0346; 39°/0347

Artikuj të tillë si një predhë ose plumbi, të cilat janë projektuar prej një topi ose pushke tjetër. Ato janë pa mjete të inicimit ose me mjete të fillimit që përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës. Ato janë përdorur për të shpërndarë bojrat për njollosje ose materialet e tjera inerte.

Predhat, me mbushje plasëse ose me ngarkesë të dëbsuar 19°/0426; 41°/0427

Artikuj të tillë si një predhë ose plumbi, të cilët janë projektuar prej një topi ose pushke tjetër. Ato janë me mjete të fillimit që nuk përmbajnë dy ose më shumë elementë efektive mbrojtës. Ato janë përdorur për të shpërndarë bojrat për njollosje ose materiale të tjera inerte.

Predhat, me mbushje plasëse ose ngarkesë të dobësuar 21°/0434; 43°/0435

Artikuj të tillë si një predhë ose plumb, të cilët janë projektuar prej një topi ose pushke tjetër, armë me vjaska ose armë të tjera të vogla. Ato janë përdorur për të shpërndarë bojrat për njollosje ose materiale të tjera inerte.

Predhat, me ngarkesë me mbushje plasëse 5°/0168; 17°/0169; 39°/0344

Artikuj të tillë si një predhë ose plumb, të cilët janë projektuar prej një topi ose pushke tjetër. Ato janë pa mjetet e fillimit ose me mjetet e fillimit që përmbajnë dy ose më shumë elementë efektive mbrojtës.

Shtojcë A.1

3170 Predhat, me ngarkesë me mbushje plasëse 7°/0167; 19°/0324

(vazhdon)

Artikuj të tillë si një predhë ose plumb, të cilët janë projektuar prej një topi ose pushke tjetër. Ato janë me mjetet e fillimit që nuk përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës.

Lëngu lëvizës 2°/0497; 26°/0495

Substanca që konsiston prej një lënde plasëse e lëngshme që digjet në çast, përdorur për vënie në lëvizje.

Trupi i ngurtë lëvizës 2°/0498; 26°/0499

Substancë që konsiston prej një lënde plasëse e ngurtë që digjet në çast, përdorur për vënie në lëvizje.

Pajisjet e hedhjes, lëndët plasëse 47°/0173

Artikujt, konsistojnë prej një ngarkese të vogël të lëndës plasëse me mjetet e fillimit dhe shufrat e pastrimit dhe lidhjet. Ato ndajnë shufrat e pastrimit dhe lidhjet për të çliruar paisjen shpejt.

Përçinat, lëndët plasëse 47°/0174

Artikujt që konsistojnë prej një ngarkese të vogël të lëndës plasëse brënda një përçine metalike.

Motorat raketë 3°/0280; 15°/0281; 27°/0186

Artikujt që konsistojnë prej një ngarkese të lëndës plasëse, përgjithësisht një lëvizës i ngurtë, i

përmbajtur në një cilindër i përshtatur me një ose më shumë hundëza. Ato janë projektuar për të vënë në lëvizje një raketë ose një raketë të drejtuar.

Motorat raketë, mbushur me lëndë djegëse të lëngshme 23°/0395; 32°/0396

Artikujt që konsistojnë prej një lënde djegëse të lëngshme brënda një cilindri të përshtatur me një ose më shumë hundëza. Ato janë projektuar për të vënë në lëvizje një raketë ose një raketë të drejtuar.

Motorat raketë me lëngje që marrin vetë flakë me ose pa ngarkesa të përjashtuara 25°/0322; 34°/0250

Artikujt që konsistojnë prej një lënde djegëse që merr vetë flakë, përmbajtur në një cilindër të përshtatur me një ose më shumë hundëza. Ato janë projektuar për të vënë në lëvizje një raketë ose një raketë të drejtuar.

Raketat, linja e hedhjes 21°/0238; 30°/0240; 43°/0453

Artikujt që konsistojnë prej një motori raketë, i cili është projektuar për të zgjatur një linjë.

Raketat mbushur me lëndë djegëse të lëngshme, me ngarkesë plasëse 10°/0397; 23°/0398

Artikujt që konsistojnë prej një lënde djegëse të lëngshme brënda një cilindri të përshtatur me një ose më shumë hundëza dhe përshtatur me një mbushje luftarake (predhë). Artikulli përfshin raketat e drejtuara.

Raketat me ngarkesë plasëse 6°/0181; 18°/0182

Artikujt që konsistojnë prej një motor raketë dhe një mbushje luftarake (predhë) pa mjetet e fillimit ose me mjetet e fillimit që përmbajnë dy ose më shumë elemente efektivë mbrojtës. Artikulli përfshin raketat e drejtuara.

Shtojcë A.1

3170 Raketat, me ngarkesë plasëse 7°/0180; 19°/0295

(vazhdon)

Artikujt që konsistojnë prej një motor raketë dhe një mbushje luftarake (predhë) me mjetet e fillimit që nuk përmbajnë dy ose më shumë elementë efektivë mbrojtës. Artikulli përfshin raketat e drejtuara.

Raketat me ngarkesë plasëse 15°/0436; 27°/0437; 37°/0438

Artikujt që konsistojnë prej një motor raketë dhe një ngarkesë për të nxjerë ngarkesën e dobishme prej një koke raketë. Artikulli përfshin raketat e drejtuara.

Raketat, me kokë inerte 27°/0183

Artikujt që konsistojnë prej një motor raketë dhe një koke inerte. Artikulli përfshin raketat e drejtuara.

Mostrat (modelet), lëndët plasëse, ndryshe nga lëndët plasëse që fillojnë 51°/0190

Substancat e lëndëve plasëse të reja ose ekzistuese ose artikujt, jo akoma të vlerësuar me një emër të rrethuesit (anësorit) 2101 dhe e mbartur në përshtatje me instruksione të drejtimit kompetent dhe përgjithësisht në sasi të vogla, ndër të tjera, për qëllimet e testimit, klasifikimin, kërkimin dhe zhvillimin, ose kontrollin e cilësisë, ose si modele industriale.

Shënim: Substancat e lëndëve plasëse ose artikujt tashmë të vlerësuar me një tjetër emër të rrethuesit (anësorit) 2101 nuk janë përfshirë në këtë përcaktim.

Pajisjet e sinjalizimit me dorë 43°/0191; 47°/0373

Artikujt e lëvizshëm që përmbajnë substanca piroteknike të cilat prodhojnë sinjale vizuale (të dukshme) ose paralajmëruese. Artikulli përfshin fishekzjarre me sipërfaqe të vogël të tillë si fishekzjarret e autostradave ose hekurudhës dhe fishekzjarret e vogla të rrezikshme.

Sinjalet, dëmtimi, anije 9°/0194; 30°/0195

Artikujt që përmbajnë substanca piroteknike të projektuara për të prodhuar sinjale prej mjeteve të tigullit, flakës ose tymit ose ndonjë kombinimi.

Sinjalet, rruga hekurudhore, lëndët plasëse 9°/0192; 30°/0492; 43°/0493; 47°/0193

Artikujt që përmbajnë një substancë piroteknike e cila plasë me një shpërthim me zë të lartë kur artikulli është thërmuar (copëtuar). Ato janë projektuar për t'u vendosur në një shinë.

Sinjalet, tymi 9°/0196; 19°/0313; 30°/0487; 43°/0197

Artikujt që përmbajnë substancat piroteknike të cilat lëshojnë tym. Përveç kësaj, ato mund të përmbajnë pajisje për lëshimin e sinjaleve të dëgjueshme.

Pajisjet që tingëllojnë, lëndët plasëse 5°/0374; 17°/0375

Artikujt që konsistojnë prej një ngarkesë të lëndës plasëse që shpërthen, pa mjetet e fillimit

ose me mjetet e fillimit, që përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës. Ato hidhen nga anijet dhe funksionojnë kur ato arrijnë një thellësi të paracaktuar ose shtratin e detit.

Shtojcë A.1

3170 Pajisjet që tingëllojnë, lëndët plasëse 7°/0296; 19°/0204
(vazhdon)

Artikujt që konsistojnë prej një ngarkesë prej lënde plasëse që shpërthen me mjetet e fillimit që nuk përmbajnë dy ose më shumë elementë efektive mbrojtës. Ato hidhen prej anijeve dhe funksionojnë kur arrijnë një thellësi të paracaktuar ose shtratin e detit.

Substancat, lëndët plasëse, substancat jo shumë të ndjeshme (EVI), N.O.S 48°/0482

Substancat duke paraqitur një rrezik të shpërthimit të masës por të cilat janë jo aq të ndjeshme që gjendet shumë pak mundësi e fillimit ose të kalimit prej djegies tek shpërthimi në kushtet normale të transportit dhe të cilat kanë kaluar Seritë e Testit 5.

Silurët, të mbushur me lëndë djegëse të lëngshme, me kokë të ngurtë 32°/0450

Artikujt që konsistojnë prej një sistemi lëndë plasëse të lëngshme për të lëvizur silurin përmes ujit, me një kokë inerte.

Silurët, të mbushur me lëndë djegëse të lëngshme, me ose pa ngarkesë plasëse 10°/0449

Artikujt që konsistojnë ose prej një sistemi të lëndës plasëse të lëngshme për të lëvizur silurin përmes ujit, me ose pa një mbushje luftarake; ose një sistemi të lëngët të lëndës jo plasëse për të lëvizur silurin përmes ujit, me një predhë.

Silurët, me ngarkesë plasëse 5°/0451

Artikujt që konsistojnë prej një sistemi jo plasës, për të lëvizur silurin përmes ujit dhe një predhë pa mjetet e inicimit ose me mjetet e fillimit që përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës.

Silurët me ngarkesë plasëse 6°/0329

Artikujt që konsistojnë prej një sistemi të lëndës plasëse për të lëvizur silurin përmes ujit dhe një predhë pa mjetet e inicimit ose me mjetet e inicimit që përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës.

Silurët, me ngarkesë me lëndë plasëse 7°/0330

Artikujt që konsistojnë prej një sistemi të lëndës plasëse ose jo plasëse për të lëvizur silurin përmes ujit, dhe një predhë me mjetet e inicimit që nuk përmbajnë dy ose më shumë elementë efektive mbrojtës.

Aparatet gjurmuese për municionin 30°/0212; 43°/0306

Artikujt e vulosur që përmbajnë substancat piroteknike, të projektuara për të zbuluar trajektoren e një predhë (raketë).

Tritonal 4°/0390

Substancë që konsiston prej trinitrotolue (TNT) e përzier me alumin.

Shtojcë A.1

3170 Predhat, raketa, me ngarkesë me mbushje plasëse ose që nxirret 39°/0370
(vazhdon)

Artikujt që konsistojnë prej një ngarkesë të dobishme të ngurtë dhe një ngarkesë të vogël prej lëndës plasëse që shpërthen ose që digjet në çast, pa mjetet e inicimit ose me mjetet e inicimit që përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës. Ato janë projektuar për t'u përshtatura me një motor raketë për të shpërndarë materialin e ngurtë. Artikulli përfshin predhat për raketat e drejtuara.

Predhat, raketa, me ngarkesë me mbushje plasëse ose që nxirret 41°/0371

Artikujt që konsistojnë prej një ngarkesë të dobishme të ngurtë dhe të një ngarkesë të vogël prej lëndës plasëse që shpërthen ose që digjet në çast, me mjetet e inicimit që nuk përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës. Ato janë projektuar për t'u përshtatur me një motor raketë për të shpërndarë materialin e ngurtë. Artikulli përfshin predhat për raketat e drejtuara.

Predhat, raketa, me ngarkesë me mbushje plasëse 5°/0286; 17°/0287

Artikujt që konsistojnë prej një lënde plasëse që shpërthen, pa mjetet e inicimit ose me mjetet e inicimit që përmbajnë dy ose më shumë elemente efektive mbrojtës. Ato janë projektuar për t'u përshtatur me një raketë. Artikulli përfshin predhat për raketat e drejtuara.

Predhat, raketa, me mbushje plasëse 7°/0369

Artikujt që konsistojnë prej një lënde plasëse që shpërthen, me mjetet e inicimit që nuk përmbajnë dy ose më suhmë elemente efektivë mbrojtës. Ato janë projektuar për t'u përshtatur me një raketë. Artikulli përfshin predhat për raketat e drejtuara.

Predhat, siluri, me ngarkesë me mbushje plasëse 5°/0221

Artikujt që konsistojnë prej një lënde plasëse që shpërthen, pa mjetet e inicimit ose me mjetet e inicimit që përmbajnë dy ose më shumë elementë efektivë mbrojtës. Ato janë projektuar për t'u përshtatur me një silur.

3171-3199

Shtojcë A.2

A. Kushtet që lidhen me natyrën e enëve të lidhjes së aluminit për gazet e sigurta të Klasës 2

I. Cilësia e materialit

3200 (1) Materialet e enëve të lidhjes të cilat duhen pranuar për gazet referuar në paragrafin 2230 (1) (d) duhet të përmbushin kërkesat vijuese:

	A	B	C	D
Fortësia në këputje, Rm, në MPa (=N/mm ²)	49 deri 186	196 deri 372	196 deri 372	343 deri 490
Kufiri i rrjedhshmërisë Re, në MPa (=N/mm ²) deformimi i mbetur $\lambda = 0,2\%$)	10 deri 167	59 deri 314	137 deri 334	206 deri 412
Zgjatja e mbetur në thyerje ($l = 5d$) në përqindje	12 deri 40	12 deri 30	12 deri 30	11 deri 16
Prova në përkuqe (diametri i shabllonit $d = n \cdot e$, ku e është trashësia e pjesës që testohet)	n=5(Rm = 98) n=6(Rm =98)	n=6(Rm = 325) n=7(Rm = 325)	n=6(Rm = 325) n=6(Rm = 325)	n=7(Rm = 392) n=8(Rm = 392)
Lidhja e Aluminit Numrat e Serisë ⁷	1 000	5 000	6 000	2 000

Cilësitë aktuale do të varen në strukturën e lidhjes së përzier dhe në trajtimin final të enës, por për çfarëdo lidhje është përdorur trashësia e enës duhet të jetë e llogaritur prej formulës vijuese:

$$e = \frac{P_{bar} \times D}{\frac{20 \times R_e}{1.30} + P_{bar}}$$

ose

ku: e = trashësia miniale e murit të enës, në mm;
 PMPa = presioni i provës, në MPa (Pbar = presioni i provës në bar)
 D = diametri i jashtëm nominal i enës, në mm dhe
 Re = tensioni maksimal 0.2% i minimumit të garantuar, në MPa (=N/mm²).

Përveç kësaj, vlera e tensionit maksimal të minimumit të garantuar (Re) të paraqitur brënda formulës nuk është përshtatja për të qënë më i madh se 0.85 herë së fortësia e këputjes të minimumit të garantuar (Rm), çfarëdo tipi i lidhjes së përdorur.

Shtojcë A.2

3200 Shënim 1: Karakteristikat më sipër janë bazuar në ekspëriencën e mëparshme me materialet vijuese (vazhdon) të përdorura për enët:

⁷ Shih "Të Dhënat dhe Standardet e Aluminit", botimi i Pestë, Janar 1976, shtypur prej Lidhjes së Aluminit, 750 Rruga e Tretë, Nju Jork.

Kolona A: Alumin, i papërzier, 99.5% i pastër;
 Kolona B: Lidhje të aluminit dhe magneziumit;
 Kolona C: Lidhje të aluminit, silikon dhe magnezium, të tillë si ISO/R209-Al-Si-Mg (Lidhja e Aluminit 6351);

Kolona D: Lidhjet e aluminit, bakër dhe magnezium.

Shënim 2: Zgjatja e mbetur në thyerje ($l = 5d$) është matur prej mjeteve të pjesëve-provë të seksionit rrethor në të cilin gjatësia provë l është e barabartë me pesë herë diametrin d ; në qoftë se pjesët-provë të seksionit kënddrejtë janë përdorur, gjatësia provë mund të jetë e llogaritur prej formulës:

ku F_0 është sipërfaqja e prerjes-kryq fillestare e pjesës-provë.

Shënim 3: a) Prova e përkuljes (shih diagramën) duhet të jetë e zbatuar mbi mostrat (kampionët) të


Përzierjet e hidrokarbureve (alkool i bardhë) për substancat dhe përgatitjet që shkaktojnë polietilenin për t'u bymyer, në mënyrë të veçantë për hidrokarburet, eteret e përbëra dhe ketonet.

Një përzierje e hidrokarbureve që ka një diapazon vlimi 160°C deri 220°C, densitet relativ 0.78-0.80, pikë ndezje më të madhe së 50°C dhe një përmbajtje aromatike 16% deri 21% duhet të përdoret.

Testi i vendosjes stivë duhet të zbatohet në bazë të një densiteti relativ jo më të vogël se 1.0.

Në rast se substancat mbushëse që bymejnë polietilenin në shkallë të tillë që masa e polietilenit rritet prej më tepër se 7.5%, pranueshmëria kimike e mjaftueshme mund të provohet pas ruajtjes paraprake për tri javë në 40°C, në përputhje me paragrafin 3551 (6) por me substanca mbushëse origjinale.

Acidi nitrik për të gjithë substancat dhe përgatitjet që kanë një efekt oksidues në polietilen dhe që shkaktojnë degradim molekular identik në ose më pak se 55% acid nitrik.

Acidi nitrik me koncentrim 55% duhet të përdoret.

Testi i vendosjes në stivë duhet të zbatohet në bazë të densitetit relativ të jo më pak se 1.4.

Në rast se substancat mbushëse më të oksiduara se 55% acid nitrik ose që shkaktojnë degradim të masës molekulare të kapërcyer në përputhje sipas paragrafit 3551 (5).

Përiudha e përdorimit duhet të përcaktohet në të tillë raste nga shkalla e vëzhgimit të dëmtimeve (p.sh. dy vjet për acidin nitrik në jo më pak se 55% koncentrim).

Uji për substancat të cilat nuk bren polietilenin në ndonjë prej rasteve referuar (a) dhe (e), në mënyrë të veçantë për acidet organike dhe finjë me sodë, solucionet ujore me kripë, alkool shumëvalent dhe substancat organike në solucionet ujore.

Testet e vendosjes në stivë duhet të zbatohen në bazë të një densiteti relativ të jo më pak se 1.2.

Plotësim i shtojcës A.5

Seksioni II

Lista e substancave në të cilat lëngjet standarde mund të konsiderohen si të njëjta në përputhje me paragrafin 3551 (6).

Klasi 3

Artikulli		Substanca	Lëngu standard
A. Substancat që kanë një pikë ndezje më poshtë 23°C, jo helmuese, jo gërryese			
3°	(b)	Substancat që kanë një presion avullimi në 50°C jo më shumë se 110 kPa (1.1 bar)	
		- Nafta e papërpunuar dhe vajrat e tjerë të papërpunuar	Përzierje e hidrokarbureve
		- Hidrokarburet	Përzierje e hidrokarbureve
		- Substancat halogjenë	Përzierje e hidrokarbureve
		- Alkoolet	Acid acetik
		- Eteret dietilik	Përzierje e hidrokarbureve

		- Aldehidet	Përzierje e hidrokarbureve
		- Ketonet	Acetat normal butil ku efekti i bymimit është deri 4% (masës); rastet e tjera, përzierje e hidrokarbureve
4°	(b)	Përzierjet e substancës 3° (b) që kanë një pikë vlimi ose pikë vlimi fillestare që kalon 35°C, që përmbajnë jo më shumë se 55% nitrocelulozë me një përbërje azoti nuk kalon 12.6%	Acetat normal butili / acetat normal butili i ngopur me solucion lagës dhe përzierje e hidrokarbureve.
5°		Substancat viskoze	Përzierje e hidrokarbureve
B. Substancat që kanë një pikë ndezje poshtë 23°C dhe lëndë toksike			
17°	(b)	Metanoli (alkooli metilik)	Acidi acetik
E. Substancat që kanë një pikë ndezje ndërmjet 23°C dhe 61°C që përfshin e cila mund të jetë fort toksike ose pak korrozive			
31°	(c)	Substancat që kanë një pikë ndezjeje ndërmjet 23°C dhe 61°C që përfshin:	
		- Nafta, solvent nafta	Përzierje e hidrokarbureve
		- Alkooli i bardhë (zëvendësues vaj pishe)	Përzierje e hidrokarbureve
		- Hidrokarbure	Përzierje e hidrokarbureve
		- Substancat halogjenë	Përzierje e hidrokarbureve

Plotësim i shtojcës A.5

Seksioni II (vazhdon)

Artikulli		Substanca	Lëngu standard
31° (vazhd)	(c)	- Alkool	Acid acetik
		- Eter	Përzierje hidrokarburi
		- Aldehyd	Përzierje hidrokarburi
		- Keton	Përzierje hidrokarburi
		- Eter i përbërë	Acetat butili normal ku efekti i bymimit është deri në 4% (masës); rastet e tjera, përzierje të hidrokarbureve
		- Substanca azotike	Përzierje hidrokarburi
34°	(c)	Përzierjet e substancave të 31° (c) që përmbajnë jo më shumë se 55% nitrocelulozë me një përmbajtje azoti që nuk kalon 12.6%	Acetat normal butili / acetat butili e ngopur solucion i lagësht dhe përzierje e hidrokarbureve

Klasi 5.1

A. Substancat oksiduese të lëngëta dhe solucionet ujore të tyre			
1°		Përoksid hidrogjeni dhe solucionet e tij ¹⁵	
	(b)	Solucionet ujore me jo më pak se 20% por jo më shumë se 60% përoksid hidrogjeni	Ujë
	(c)	Solucionet ujore me jo më pak se 8% por jo më shumë se 20% përoksid hidrogjeni	Ujë
3°	(a)	Acid përklorik me më shumë se 20% përoksid hidrogjeni	Acid nitrik
B. Solucionet ujore të substancave oksiduese të ngurta			
11°	(b)	Solucion klorat kaliumi Solucion klorat potasi Solucion korat sode	Ujë Ujë Ujë

Plotësim i shtojcës A.5
Seksioni II
(vazhd)

Artikulli		Substanca	Lëngu standard
Klasi. 5.2			
Shënim: Tre hidropëroksid butili me më shumë se 40% përmbajtje përoksidi dhe acid përoksiacetik janë të përjashtuara nga artikujt në vijim.			
Më poshtë përfshihen:			
1° 3° 5° 7° 9° 11° 17° 19°	(b), (b), (b), (b), (b), (b), (b), (b),	Të gjithë përoksidet organike në një teknologji të pastër formon ose në solucion ose në tretësat të cilët, me sa dihet përputhshmëria e tyre është shqetësuese, mbuloen nga lëngu standard "Përzierje e hidrokarbureve në këtë listë të seksionit II.	Acetat butili normal / solucion i lagësht me 2% acetat butili normal dhe përzierje të hidrokarbureve dhe acidit nitrik në 55%
Përputhshmëria e vrimave dhe guarnicioneve me peroksid organik mund të verifikohet, gjithashtu në mënyrë të pavarur të projektimit të tipeve të testeve, nga testet laboratorike me acid nitrik.			
Klasi 6.1			
B. Substancat organike të cilat kanë një pikë ndezje të 23°C ose mbi substancat organike jo të rrezikshme ndaj zjarrit			
12°		Substancat azotike që kanë një pikë ndezje mbi 61°C	
	(b)	Anilinë	Acid acetik

¹⁵ Testi të kryhet vetëm me një vrimë.

14°		Substancat e oksiduara që kanë pikë ndezje mbi 61°C	
	(c)	Eter monobutil glykol-etilen Alkool furfural Solucion fenol	Acid acetik Acid acetik Acid acetik
27°		Substancat organike helmuese gërryese, artikujt që përmbajnë substanca organike helmuese gërryese (të tillë si përgatitjet dhe mbetjet), të cilat nuk mund të klasifikohen në titujt e tjerë kolektiv):	
	(b)	Kresoli ose acidi kresolik	Acid acetik

Plotësim i shtojcës A.5

Seksioni II

(vazhd)

Artikulli		Substanca	Lëngu standard
Kateg. 6.2			
3° dhe	4°	Të gjithë substancat infektuese të konsideruara për të qënë lëngje në përputhje me paragrafin 2650 (5)	Ujë
Kateg. 8			
A. Substancat acide			
Acidet joorganike			
1°	(b)	Acid sulfurik Acid sulfurik i dobësuar	Ujë Ujë
2°	(b)	Acid nitrik me jo më shumë se 55% acid	Acid nitrik
4°	(b)	Acid përklorik me jo më shumë se 50% acid, nga masa në solucion ujor	Acid nitrik
5°	(b)	Acid klorhidrik me jo më shumë se 36% acid të pastër	Ujë
dhe	(c)	Acid hidrobromik Acid hidrojodik	Ujë
7°	(b)	Acid hidrofluoror me jo më shumë se 60% fluoride hidrogjeni 16	Ujë
8°	(b)	Acid florborik me jo më shumë se 50% acid të pastër Acid hidroflorosilicik	Ujë
17°	(b)	Solucion acidi kromik me jo më shumë se 30% acid të pastër	Acid nitrik
dhe	(c)		
17°	(c)	Acid fosforik	Ujë
Substancat organike			
32°	(b)	Acid acetik, acid formik, acid acetik, acid tioglokolik	Acid acetik
32°	(c)	Acid metakrilik, acid propionik	Acid acetik
40°	(c)	Alkilfenolet, të lëngët	Acid acetik

Plotësim i shtojcës A.5

¹⁶ Maksimumi 60 litrit; perioda e lejueshme e përdorimit 2 vjet.

Seksioni II
(vazhd)

Artikulli		Substanca	Lëngu standard
B. Substancat bazike			
Substancat joorganike			
42° dhe	(b) (c)	Solucion i hidroksid natriumit, solucioni i hidroksid kalciumit	Ujë
43°	(c)	Solucion amoniaku	Ujë
44°	(b)	Hidrozinë, solucion uxor me jo më shumë se 64% hydrozine nga masa	Ujë
C. Substancat e tjera gërryese			
61°	(c)	Solucionet klorite dhe hidroklorite ¹⁷	Acid nitrik
63°	(c)	Solucionet formaldehide	Ujë

SHTOJCA A 6

KUSHTE TE PERGJITHSHME PER PERDORIMIN E KONTENIEREVE TE NDERMJETEM PER MALLRA ME SHUMICE (IBCS), TIPET E IBCS, KERKESAT PER KONSTRUKSIONIN E IBCS, DHE SPECIFIKIMET E PROVES PER IBCS,.

“Kontenier i Ndërmjetëm për Mallra me shumicë” (IBC) do të thotë një paketim i transportueshëm, i ngurtësuar apo fleksibël, ndryshe nga ato të specifikuara në Shtojcën A.5, i cili:

ka një kapacitet prej

jo më shumë se 3.0 m³ (3,000 litra) për ngarkesë të lëngët dhe solide të Grupeve të paketimit të II-të dhe të III-të.

jo më shumë se 1.5 m³ për ngarkesat solide të Grupit të I-rë të Paketimit kur paketohen në kontenierë IBCs fleksibël, plastikë të ngurtë, të përbërë, fibre dërrase dhe druri.

jo më shumë se 3.0 m³ për ngarkesa solide të Grupit të I-ë të Paketimit kur paketohen në kontenierë metalikë IBCs.

Është projektuar për përdorim mekanik;

Është rezistent ndaj goditjeve gjatë manovrimit dhe transportit sikurse përcaktohet nga prova të specifikuara në këtë Shtojcë.

SHENIM 1: Dispozitat e kësaj Shtojce janë të zbatueshme për kontenierët e ndërmjetëm për mallra me shumicë (IBCS) përdorimi i të cilëve është vecanërisht i autorizuar në klasat përkatëse për transportimin e disa lëndëve të dëmshme.

SHENIM 2: Kontenierët çisternë të cilët përmbushin të dhënat e Shtojcës B.1b nuk konsiderohen si kontenierë të ndërmjetëm të mallrave me shumicë (IBCS).

SHENIM 3: Kontenierët e ndërmjetëm të mallrave me shumicë (IBCS) të cilët përmbushin të dhënat e kësaj Shtojce nuk konsiderohen si kontenierë për qëllimet e ADR-së

SHENIM 4: Gërmat IBC do të përdoren për pjesën tjetër të tekstit për t’ju referuar

¹⁷ Testi zbatohet vetëm jashtë në gyp. Në qoftë se testi zbatohet me acid nitrik si lëng standart, një vend që i reziston acidit dhe guarnicionit (mbrojtës) duhet të përdoret. Për solucionet hipoklorite vendet dhe guarnicionet e të njëjtit tip të projektuar, rezistente ndaj hipokloriteve (p.sh. gomina silikon) por jo rezistent ndaj acidit nitrik, lejohen gjithashtu.

kontenierëve të ndërmjetëm të mallrave me shumicë.

Seksioni 1: Kushte të përgjithshme të aplikueshme tek IBCs

3601 (1) IBCs-ja duhet të projektohet, prodhohet dhe testohet sipas një programi të një sigurie të larët cilësie, i cili është i pranueshëm për autoritetet kompetente, me qëllim që të sigurohet që çdo IBC përmban të dhënat e kësaj Shtojce.

Çdo IBC duhet ti korrespondojë me të gjitha të dhënat tipit të tij të projektit.

Autoritetet kompetente mund të kërkojnë në çdo kohë prova, duke kryer teste në përputhje me dispozitat e kësaj Shtojce, me qëllim që IBCS-ja të plotesojë kërkesat për testet e tipit të projektuar.

(3) Përpara mbushjes dhe përdorimit për transportim, çdo IBC duhet të kontrollohet për tu siguruar që ai është pa korrozion, ndotje apo dëmtime të tjera dhe kontrolli në lidhje me funksionimin e duhur të paisjeve të shërbimit. Çdo IBC që ka shenja të paksimit të forcës, krahasuar me tipin e projektuar të testuar, nuk duhet të përdoret më, ose duhet të riparohet në mënyre që të jetë i aftë ti qëndrojë testeve të tipit të projektuar.

(4) Kur janë përshtatur dy ose me shumë sisteme mbyllje në seri, duhet të mbyllet i pari ai që është me afër me lëndën që transportohet.


Gjatë transportimit nuk duhet të ngjiten mbeturina të dëmshme në sipërfaqen e jashtme të IBCs-së.

Kur një IBCs ndodhet nën presion nga emetimet e gazeve të përmbajtjes (si rezultat i rritjes së temperaturës apo shkaqeve të tjera) IBCs mund të pajiset me një të çarë me qëllim që gazi i rrezatuar nuk do të shkaktojë ndonjë dëmtim për shkak të toksicitetit të tij; ndezshmërisë, sasia e lëndës e çliruar, etj. E çara duhet të jetë e projektuar me qëllim që, kur IBC është në pozicionin në të cilin mendohet të transportohet, rrjedhjet e lëngjeve dhe penetrimi i lëndëve të jashtme ndalohen nga kushtet normale të transportimit. Sidoqoftë, një lende mund të transportohet në një IBC të tille, vetëm, kur e çara është paracaktuar për këtë lëndë sipas kushteve të transportit të klasit të përshtatshëm ose me miratimin e autoriteteve kompetente të ndonjë nga Shtetet e Palëve Kontraktuese në ADR-ë.

Kur IBCs janë mbushur me lëngje, duhen lënë rrjedhjet të mjaftueshme për të siguruar që nuk ndodh ndonjë derdhje apo dëmtim i perkohshëm i IBC si rezultat i bymimit të lëngjeve, për shkak të temperaturës e cila mund të rritet gjatë transportimit.

Për një temperaturë të mbushjes prej 15 0 C, shkalla maximale e mbushjes duhet të përcaktohet sikurse vijon, po të mos kete furnizim tjetër të një klasi të vecante:

Ose (a)



ose (b)

$$\text{Shkalla e mbushjes} = \frac{98}{1 + \alpha (50 - tF)} \% \text{ e kapacitetit të IBC}$$

Në këtë formulë α përfaqëson koeficientin kryesor të bymimit të lëngut në kub ndërmjet temperaturave 15 0 C dhe 50 0 C, mund të thuhet, për një ngritje maximale në temperaturën prej 35 0 C:

$$\alpha \text{ është llogaritur sipas formulës: } \alpha = \frac{d15 - d50}{35 - d50}$$

d15 dhe d50 janë densitetet relative të lëngut në 15 0 C dhe 50 0 C dhe tF temperatura kryesore e lëngut në kohën e mbushjes.

IBCs e tipit 31HZ2 duhet të mbushet jo më pak se 80% e kapacitetit të veshjes së jashtme.

Kur IBCs përdoren për transportimin e lëngjeve me një pikë-ndezje prej 55 0 C (kupë e

mbyllur) ose më pak, ose transportimin e pluhurave që mund të shkaktojnë eksplozion, duhen marrë masat për ndalimin e shkarkimeve të dëmshme elektrostatische gjatë mbushjes dhe zbrazjes.

Mbyllja e IBCs që përmban lëndë të lagshme apo të holluara duhet të jetë e tillë që përqindja e lëngut (ujit, tretësit apo lende e ngadalëshme) nuk bie më poshtë se kufinj të caktuar gjatë transportimit

Lëngjet mund të ngarkohen vetëm në IBCs plastike të ngurtë ose IBCs të përbërë, të cilët kanë rezistencën e duhur ndaj presionit të brendshëm që mund të ndodhë edhe në kushte normale të transportimit. IBCs të shënuar me testin hidraulik të presionit, sikurse përshkruhet në anëshkrimet 3612 (2) duhet të mbushen vetëm me një lëng që kanë një presion avulli:

Të tillë që presioni standart total në paketim (p.sh. presioni i avullit i lëndës mbushëse plus presionin e pjesshëm të ajrit ose të gazeve të tjera inerte, më pak se 100 kPa) në 55 0 C i vendosur në bazat e një shkalle maximale të mbushjes në përputhje me paragrafin (7) dhe temperaturës së mbushjes prej 15 0 C, nuk do të kalojë dy të tretat e presionit të shënuar të provës;

ose

në 50 0 C më pak se katër të shtatët e madhësisë së presionit të shënuar të provës plus 100 kPa; ose

në 55 0 C më pak se dy të tretat e madhësisë së presionit të shënuar të provës plus 100 kPa.

(11) Gjatë transportit, IBCs duhet të jenë të lidhur në mënyrë të sigurtë ose të qëndrojnë brenda një mjete transporti me qëllim që të parandalohen goditjet apo lëvizjet ansore dhe gjatësore, dhe kështu të japin mbështetjen e jashtëme të nevojshme. Në vazhdim, IBCs të tipit 31HZ2 duhet të transportohen vetëm në mjete transporti të mbyllura.

3602-

3609

Seksioni 2: Llojet e IBCs

Përkufizime

3610 (1) Në varësi të dispozitave të vecanta të çdo klase, IBCs e përmendur më poshtë mund të përdoren:

IBCs metalikë

IBCs metalikë përbëhen nga trup metalik së bashku me paisjen e duhur strukturore dhe paisjen e shërbimit.

IBCs fleksibël

IBCs fleksibël përbëhen nga trupi prej një flete të hollë, dru i fabrikuar ose ndonjë material tjetër fleksibël ose kombinim i tyre, dhe nëse, është e nevojshme një veshje e brendshme ose një këmishë, së bashku me ndonjë paisje të përshtatshme shërbimi dhe paisje manovrimi.

IBCs plastike të ngurtë

IBCs plastike të ngurtë përbëhen nga trupi plastik i ngurtë, të cilët mund të kenë paisje strukturore së bashku me paisjen e duhur të shërbimit.

IBCs të përbërë me depozitë të brëndëshme plastike

IBCs të përbërë, përbëhen nga paisje strukturore në formën e një mbulese të jashtme e ngurtë, bashkangjitur një depozitë të brendshme plastike së bashku me ndonjë paisje tjetër shërbimi ose drejtimi. Ato janë konstruktuar në menyrë të tillë që depozita e brendshme dhe veshja e jashtme mblidhen në një formë, dhe përdoren si një njësi e vetme e integruar për tu mbushur, magazinuar, transportuar ose boshatisur si e tillë.

3610 IBCs dërrase fibrore

IBCs prej dërrase fibrore përbëhen nga trupi me ose pa kapak të ndarë në fillim dhe në fund, nëse është e nevojshme një këmishë të brëndëshme (por jo këmishë ambalazhuese) dhe paisjen e duhur strukturore dhe të shërbimit.

IBCs druri

IBCs prej druri përbëhen nga trupi prej druri të shtanget ose i përkulshëm, së bashku me një këmishë të brëndëshme (por jo këmishë ambalazhuese) dhe paisja e përshtatshme strukturore dhe e shërbimit.

(2) Përkufizimet që vijojnë zbatohen në IBCs të listuara në pikën (1):

Trupi (për të gjitha kategoritë e IBCs përveç IBCs të përbërë) nënkupton depozitën e duhur, përfshirë hapjet dhe mbylljet e tyre, por nuk përfshin paisjen e shërbimit (shiko më poshtë);

Paisja e shërbimit (për të gjitha kategoritë e IBCs) nënkupton paisjet e mbushjes dhe të shkarkimit dhe, në përputhje me kategorinë e IBCs, nënkupton edhe paisjet e lehtësimit të presionit ose ajrimit, sigurisë, paisjet e ngrohjes apo paisjet e izolimit të nxehtësisë dhe instrumentat matës;

Paisja strukturore (për të gjitha kategoritë e IBCs përveç IBCs fleksibël) nënkupton pjesët stabilizuese, mbrojtëse, manovruese, shpejtuese apo rforcuese të trupit (përfshirë paletën bazë për IBCs e përbërë me depozitë të brëndëshme plastike);

Masa bruto maksimale e lejuar (për të gjitha kategoritë e IBCs përveç IBCs fleksibël) nënkupton masën e trupit, pajisjen strukturore dhe të shërbimit dhe ngarkesën maksimale të lejuar;

Ngarkesa maksimale e lejuar (për IBCs fleksibël) nënkupton masën maksimale neto për të cilën IBC paracaktohet të përdoret dhe për të cilën është i autorizuar për të transportuar.

Mbrojtësja (për IBCs prej metali) nënkupton pajisjen me një mbrojtëse shtesë kundra goditjeve, mbrojtje që merr formën e, për shembull, të një konstruksioni shumë shtresash (sanduiç) ose me mur të dyfishtë, ose një strukturë me një veshje rrjete metalike;

Lëndët plastikë të thurura (për IBCs fleksibël) nënkupton një material të përbërë prej materiali plastik të përshtatshëm njëfijesh ose me shirita të ngushtë.

Lëndët plastikë (për IBCs e përbërë me depozitë të brëndëshme plastike), kur përdoret i bashkuar me depozitat e brëndëshme për IBCs e përbërë, duhet të përmbajë materiale të tjerë polimerikë si p.sh. gomë, etj.;

Paisja manovruese (për IBCs fleksibël) nënkupton ndonjë rrip, nyje, syth apo skelet të ngjitur në trupin e IBCs ose e formuar nga një vazhdim i materialit të trupit të IBC;

Këmisha (për IBCs fleksibël, dërrasëfibrore dhe druri) nënkupton një tub të vecantë ose i futur në trupin e IBCs por jo duke formuar një pjesë integrale të tij, përfshirë mbyllset e hapjeve të tij;

Depozita e brëndshme e ngurtë (për IBCs e përbërë) nënkupton një këmishe e cila e mban formën e saj të përgjithshme kur boshatiset pa mbylljen e saj në vend dhe pa ndihmën e veshjes së jashtme. Çdo depozitë e brëndshme që nuk është “e ngurtë” konsiderohet të jetë “fleksibël”.

Kodimi i tipeve të projektuara të IBC

Sistemi i kodit për IBCs

Kodi përbëhet nga:

Dy numurore Arabikë që tregojnë tipin e IBCs sikurse specifikohet në pikën (a) më poshtë;

Një gërmë ose gërma kapitale (karakterë Latine) sikurse specifikohet në pikën (b) më poshtë, duke treguar natyrën e materialit (p.sh. metal, plastik, etj.);

Kur është e nevojshme, një numror Arabik duke treguar kategorinë e IBC brënda tipit të cilit i përket IBC.

Për IBCs e përbëra, duhet të përdoren dy gërma kapitale (karakterë Latine). E para do të tregojë materialin e depozitës së brëndëshme të IBCs dhe e dyta ambalazhimin e jashtëm të IBC.

(a)

Tipi	Për IBCs solidë, të ngarkuar dhe/ose të shkarkuar		Për lëngjet
	sipas gravitetit	nën presion më të madh se 10 kPa (0,1 bar)	
Të ngurtë	11	21	31
Elastik	13	-	-

(b) A. Çelik (të gjitha llojet dhe përpunimet sipërfaqore)

Alumin

Dru natyral

Kompesatë

Dru i ripërrirë

Dërrasë fibrore

Material plastik

Tekstil

Letër shumështrësash
Metal (ndryshe nga çeliku ose alumini)
Kodi i IBCs duhet të pasohet në shënimin me një gjermë të cilat tregojnë grupet e lëndëve për të cilat tipi i projektuar është aprovuar, p.sh.:
Për lëndët e grupit I, II dhe të III të Paketimit (IBCs vetëm për solidë);
Për lëndët e grupit të II dhe të III të Paketimit.
Për lëndë të grupit të III të paketimit.
SHENIM: Për grupet e paketimit shiko anëshkrimet 3511 (2).

Shënjimi

3612 (1) Shënjimi primar.
Të gjithë IBCs të ndërtuar dhe të përcaktuara për përdorim konform këtyre parashikimeve duhet të mbajnë një shënjim rezistent dhe të lexueshëm duke dhënë vecoritë e mëposhtme:
Simbolin e paketimit të Kombeve të Bashkuara Ø
(Për IBCs në të cilën shënimin është stampuar ose gdhendur, mund të përdoren gjermat UN në vënd të simbolit);
kodin e përcaktimit të tipit të IBC në përputhje me anëshkrimet 3611 (1);
Një gjermë (X, Y, ose Z) që përcakton grup-in (et) e ambalazhinit për të cilat tipi i projektuar është aprovuar;
viti dhe muaji (dy numrat e fundit) i prodhimit;
Shënimin 1/ i Shtetit në të cilin aprovimi është botuar;
emri ose simboli i prodhimit ose ndonjë identifikim tjetër i IBCs sikurse specifikohet nga autoritetet kompetente
testi i ngritjes së ngarkesës në kg.; figura “O” duhet të ngjitet në IBCs që nuk janë caktuar për ngritje;
masa bruto maksimale e lejuar e ngarkesës ose, për IBCs fleksibël ngarkesa maksimale e lejuar, në kg;
Shënjimi primar i kërkuar më sipër duhet të zbatohet në rradhët e nënparagrafeve të mësipërm.
Shënjimi i kërkuar nga paragrafi (2) dhe ndonjë shënjim tjetër i autorizuar nga autoriteti kompetent duhet rregulluar në menyre të tillë që të bëjë të mundur identifikimin korrekt të pjesëve të ndryshme të shënjimit.
Në vazhdim, depozita e brëndëshme e IBCs të përbërë, duhet të shënohet, të paktën me, informacionin e përshkruar në pikat (d), (c), dhe (f) të mësipërme.
Shëmbuj të shënjimit primar
Për IBC druri për ngarkesa solide me një këmishë të brëndëshme dhe e autorizuar për paketime të Grupit I solidë
11C/X/01 93
S/Auriguy 9876
3000/910
11A/Y/0289
Ø NI/Mulder 007/5500/1500
IBC metalikë prej çeliku për ngarkesa solide i shkarkueshem, p.sh.në sajë të gravitetit, për Grupin e II dhe të III të Paketimit të prodhuar në Prill të vitit 1989 i aprovuar në Hollandë dhe i prodhuar nga Mulder konform një tipi të projektuar në të cilën autoriteti kompetent ka caktuar numrin serial 007 të ngarkesës të përdorur për testin e ngritjes në kg. për madhësinë maksimale të lejuar në kg.
13H3/Z/0389
Ø
F/Meunier 1713/1000/500
IBC fleksibël për ngarkesa solide të shkarkueshëm, bie fjala, në sajë të gravitetit dhe i

^{1/} Shënja dalluese për automjetet në trafikun ndërkombëtar i paraqitur në Konventën e Vienës në Trafikun Rrugor (1968)

prodhuar prej lende plastikë me këmishë.
31H1/Y/0489

θ

GB/9099/10800/1200

IBC plastikë të shtangët për lëngje, të prodhuar prej materiali plastik me paisje strukturale për qëndrueshmërinë e ngarkesës së ngritur.

31HA1/Y/0589

θ

D/Muller/1683/10800/1200

IBC të përbërë për lëngje me një depozitë të brëndëshme plastikë të shtangët dhe një mbështjellëse të jashtme celiku.

Shënjimi shtesë 2

Për të gjitha kategoritë e IBCs përveç IBCs fleksibël:

pesha e paketimit në kg 3

Për IBCs metalikë, IBCs plastikë të shtangët dhe IBCs e përbërë me depozitë të brëndëshme plastike:

kapaciteti në litra 3 në 20 0 C,

data e testit të fundit të hermetizimit (viti dhe muaji), nqs aplikohet,

data e kontrollit të fundit (viti dhe muaji),

presioni maksimal i shkarkimit të mbushjes në kPa (ose në bar) 3, nqs aplikohet,

Për IBCs metalikë:

materiali i trupit dhe trashësia e tij minimale në mm,

numri serial i prodhuesit,

Për IBCs plastikë të shtangët dhe IBCs e përbërë me depozitë të brëndëshme plastike:

Testi i presionit (standart) në kPa (ose bar) 3, nqs aplikohet

Kur mbështjellësja e jashtme e IBCs të përbërë është e çmontueshme çdo njëri nga elementet e çmontueshëm duhet të mbajë një shënjim sipas anëshkrimeve 3612(1) (d) ose (f).

(3) IBCs e shënuar në përputhje me këtë Shtojcë por i aprovuar në një Shtet i cili nuk është Palë Kontraktuese në ADR mund gjithashtu të përdoret për transport sipas ADR.

Vërtetim

Duke ngjitur shënjimin në përputhje me të dhënat e kësaj shtojce vërtetohet që IBCs e prodhuar në seri korrespondojnë me tipin e caktuar të aprovuar dhe se janë përmbushur kushtet referuar certifikatës së aprovuar

Tregues të IBCs

Kodet që i korespondojnë tipeve të ndryshëm të IBCs janë si vijojnë:

IBCs për ngarkesa solide të ngarkuara dhe të shkarkueshëm me anë të gravitetit

Tipi	Materiali	Kategoria	Kodi	Anë shkrimi
11 i	Çelik	Metal	11 A	3622

² Cdo IBC fleksibël mund gjithashtu të mbajë një pictogram që tregon metodat ngritëse të rekomanduara

³ Duhet të tregohet njësia e përdorur

ngurte	Alumin		11 B	
	Dru natyral	Dru	11 C	3627
	Kompesatë		11 D	
	Dru i përpunuar		11 F	
	Dërrasë fibrore		11 G	
	Plastike	Plastikë e ngurtë (i përshtatur me paisje strukturore)	11 H1	3624
			11 H 2	
		I përbërë me depozitë të brendshme plastikë (i ngurtë)	11 HZ14/	3625
		I përbërë me depozitë të brendëshme plastikë (fleksibël)	11 HZ24/	
	Metal tjetër	Metal	11N	3622
13 elastik	Plastikë i endur pa mbulesë ose këmishë	Fleksibël	13 H1	3623
			13 H2	
			13 H3	
			13 H4	
			13 H5	
			13 L1	
	Tekstil pa mbulesë ose këmishë		13 L2	
			13 L3	
	Tekstil me mbulesë dhe me këmishë		13 L4	
			13M1	
	Letër shumë shtresëshe		13M2	
	Letër shumë shtresëshese rezistente ndaj ujit			

3614 2. IBCs për ngarkesa solide ose të shkarkueshëm nën presion prej më shumë se 10 kPa (0.1 bar)

Tipi	Materiali	Kategoria	Kodi	Anëshkrimet
21 i ngurtë	Çelik	Metal	21A	3622
	Alumin		21B	
	plastik	Plastik i ngurtë (i përshtatur me paisje strukturore)	21H1	3624
			21H2	
		I përbërë me depozitë të brëndëshme plastike (i ngurtë)	21HZ1 4/	3625
I përbërë me depozitë të brëndëshme plastike (elastik)	21HZ2 4/			

⁴ në lidhje me gërmen Z, shiko marxhinet 3625 (1) (b);

ne lidhje me gërmen Z shih anesoren 3625 (1)(b)

	Metal tjetër	metal	21N	3622
--	--------------	-------	-----	------

IBCs për lëngje

Tipi	Materiali	Kategoria	Kodi	Marxhinat	
31 i ngurtë	Çelik	metal	31A	3622	
	Alumin		31B		
	Plastik	Plastik i ngurtë (i përshtatur me paisje strukture)		31H1	3624
				31H2	
		I përbërë me depozitë të brëndëshme plastike (i ngurtë)		31HZ1 4/	3625
	I përbërë me depozitë të brëndëshme plastike (elastik)		31HZ2 4/		
Metal tjetër	Metal		31N	3622	

3615-
3620

Seksioni 3: Kërkesat për konstruksionin e IBCs

Dispozita të përgjithshme

3621 (1) IBCs duhet të jetë rezistent ose i mbrojtur në mënyrën e duhur nga prishjet, për shkak të ambientit.

(2) IBCs duhet të jetë i konstruktuar dhe i mbyllur në mënyrë të tillë që asnjë nga përmbajtjet të mos shpëputet në kushtet normale të transportit, përfshirë efektin e vibracionit, ose ndryshimeve të temperaturës, lageshtirës ose presionit.

(3) IBCs dhe mbylljet e tyre duhet të konstruktohen nga materiale të pajtueshëm me lëndet që përmbajnë, ose të jenë të mbrojtur në pjesën e brendshme, në mënyrë që të mos jenë të rrezikuar që:

të jenë të dëmtueshëm nga përmbajtja duke e bërë kështu përdorimin e tyre të rrezikshëm; të shkaktojnë kundërveprimin ose dekompozimin e përmbajtjes, ose të formojnë përzierje të rrezikshme ose të dëmshme me IBC;

(4) Kur përdoren guarnicione duhet të prodhohen prej materiali që të mos bëhet objekt dëmtimi nga përbërja e IBCs.

(5) Të gjitha paisjet e shërbimit duhet të jenë të mbrojtura ose të pozicionohen në mënyrë të tillë që të minimizojnë rrezikun e derdhjes ose vetëdëmtimit të përbërjes së tyre gjatë transportimit apo përdorimit.

(6) IBCs, lidhjet e tyre dhe paisjet e tyre të shërbimit dhe të drejtimit duhet të projektohen që ti rezistojnë, pa humbje të përbërjes, presionit të brëndshëm të përzierjes, goditjeve normale gjatë përdorimit dhe transportit. IBCs e planifikuar për ngritje duhet të projektohen për ngritje. Çdo veti ngritëse apo siguruese e IBCs duhet të jetë në mënyrë të mjaftueshme e fortë për ti rezistuar kushteve normale të përdorimit dhe transportit pa dëmtime apo shkatërrime të mëdha dhe duhet të pozicionohet në mënyrë të tillë që të mos shkaktohet ndonje shtypje e palejueshme në ndonjë pjesë të IBC.

(7) Kur një IBC përbëhet nga një trup brenda një skeleti, ai duhet konstruktuar në mënyrë të tillë që:

Trupi të mos fërkohet apo të mos nxehet nga skeleti që të shkaktojë dëmtime të materialit të trupit.

Trupi mbahet brënda skeletit gjatë gjithë kohës.

Pjesët e paisjeve janë fiksuar në mënyrë të tillë që ato nuk mund të dëmtohen nëq lidhjet ndërmjet trupit dhe skeletit lejojnë levizje apo zgjerime relative.

(8) Kur ka një valvël fundore shkarkimi, ajo duhet të jetë në gjëndje që të ketë siguri në pozicionin e mbyllur dhe i gjithë sistemi i shkarkimit duhet të jetë komplet i mbrojtur nga dëmtimi. Valvolat që kanë leva mbyllëse duhet të jenë në gjëndje të sigurohen ndaj hapjeve aksidentale dhe pozicioni i hapur apo i mbyllur duhet të jetë i dukshëm në mënyrë të qartë. Për IBCs që përmbajnë lëngje, duhet të sigurohet gjithashtu një mjet i dytë i dyllosjes së hapjes së shkarkimit, p.sh. me anë të një fllanxhë qorre ose një paisje ekuivalente me të.

(9) IBCs të rinj, të riparuar ose të përdorur duhet të jenë në gjëndje për ti kaluar të gjithë testet e përshkruara.

Dispozit të vecanta për IBCs metalikë

3622 (1) Këto dispozita zbatohen për IBCs metalikë të parashikuar për transportimin e lëndëve të ngurta ose lëngjeve. Këto IBCs janë sipas tipeve që vijnë:

11A, 11B, 11N

Për lëndë të ngurta të cilat ngarkohen apo shkarkohen me anë të gravitetit.

21A, 21B, 21N

Për lëndë të ngurta të cilat ngarkohen ose shkarkohen nën një presion standart më të madh se 10 kPa (0.1 bar).

31A, 31B, 31N.

Për lëngjet; IBCs metalikë të parashikuar për transportimin e lëngjeve dhe i përmbahen kushteve të kësaj Shtojce nuk duhet të përdoren për të transportuar lëngje që kanë një presion avulli me të madh se 110kPa (1,1 bar) në 90 0 C ose më shumë se 130 kPa në 55 0 C.

Trupat duhet të bëhen prej një metali të përshtatshëm të butë tek të cilët saldimi është plotësisht i dukshëm. Saldimi duhet të bëhet me precizion të lartë dhe duhet të japi siguri të plotë.

Kujdes duhet treguar për eliminimin e dëmtimeve nga galvanizimi për shkak të pranisë të metaleve të ndryshëm.

IBCs alumini që parashikohen të përdoren për transportimin e lëngjeve ndezës me një pikë ndezje jo më të madhe se 55 0 C nuk duhet të kenë pjesë të lëvizshme, si mbulesa, kapakë mbyllës, etj. të prodhuar prej çeliku që nuk i reziston ndryshkjes, i cili mund të shkaktojë një reaksion të rrezikshëm për shkak të kontakteve dhe goditjeve me aluminin.

IBCs metalikë duhet të prodhohen prej metali i cili plotëson kërkesat e mëposhtme:

(a) për çelikon zgjatimi në thyerje, në përqindje, nuk duhet të jetë më i vogël se

$$\frac{1000}{R_m} \quad \text{me një minimum absolut prej 20\%}$$

ku R_m = forca tërheqese minimale e garantuar e çelikut në N/mm²

(b) për aluminin dhe lidhjet e tij zgjatimi në thyerje, në përqindje, nuk duhet të jetë më i vogël se

$$\frac{10\,000}{6 R_m} \quad \text{me një minimum absolut prej 8\%}.$$

Kampionet e zgjedhur për përcaktimin e zgjatimit në thyerje duhet të merren në drejtim tërthor të cilindrit dhe duhet të sigurojnë që:

3622 $L_0 = 5d$
(vazhdim)
ose

$$L_o = 5.65 \cdot 3A$$

Ku: L_o = gjatësia standart e kampionit përpara kontrollit

d = diametër

A = sipërfaqja e seksionit tërthor të kampionit të kontrolluar

Trashësia minimale e murit:

Referuar një çeliku me rezultatin e $R_m \times A_o = 10000$, trashësia e murit nuk duhet të jetë më e vogël se:

Kapaciteti në m ³	Trashësia e murit në mm			
	Tipet: 11A, 11B, 11N		Tipet: 21A, 21B, 21N, 31A, 31B, 31N	
	I pambrojtur	I mbrojtur	I pambrojtur	I mbrojtur
$> 0.25 \leq 1.0$	2.0	1.5	2.5	2.0
$> 1.0 \leq 2.0$	2.5	2.0	3.0	2.5
$> 2.0 \leq 3.0$	3.0	2.5	4.0	3.0

Ku: A_o = zgjatimi minimal (në përqindje) referuar çelikut të përdorur në thyerje nga forca e tërheqjes [shiko paragrafin (6)].

Për metalet jashtë atyre të çelikut të referuar të përshkruar në (a), trashësia minimale e murit është llogaritur me formulën ekuivalente që vijon:

$$e_1 = \frac{21.4 \times e_o}{\sqrt{R_{m1} \times A_1}}$$

ku: e_1 = trashësia ekuivalente e kërkuar e murit e metalit që duhet përdorur (në mm)
 e_o = trashësia minimale e kërkuar për çelikun e referuar (në mm)

R_{m1} = forca tërheqëse minimale e garantuar e metalit që duhet (në N/mm²)

A_1 = zgjatimi minimal (në përqindje) i metalit që duhet përdorur në thyerje nën forcën e tërheqjes

Sidoqoftë, në asnjë rast trashësia e murit nuk duhet të jetë më e vogël se 1,5 mm.

3622 (7) Kërkesat për pakësimin e presionit (vazhdim)

IBCs për lëngje duhet të jenë në gjendje të paksimit të një sasive të konsiderueshme të avujve për të siguruar që, në rast perfshirjeje zjarri, nuk do të ndodhe asnjë thyerje ose këputje e trupit. Kjo mund të arrihet me anë të paisjeve të pakësimit të presionit konvencional ose me anë të mjeteve të tjera konstruktive.

Fillimi i shkarkimit të presionit nuk duhet të jetë më i lartë se 65 kPa (0.65 bar) dhe jo më i ulët se masa standarte e presionit total i eksperimentuar në IBC p.sh. presioni i avullit i lëndës mbushëse plus presionin e pjesshëm të ajrit ose gazeve të tjera inerte, minus 100 kPa (1 bar) në 55 °C, i vendosur në bazat e një shkalle maksimale të mbushjes sikurse përcaktohet në shënimet anore 3601 (7). Paisjet e kërkuara të pakësimit të presionit duhet të përshtaten në hapsirën e avujve.

Dispozita të vecanta për IBCs fleksibël

3623 (1) Këto dispozita të zbatueshme për IBCs fleksibël parashikohen për transportin e lëndëve të ngurta. Këto IBCs janë të tipeve në vijim:

- 13H1 plastikë e ngjeshur pa mbulesë ose këmishë
- 13H2 plastikë e ngjeshur, e mbuluar.
- 13H3 plastikë e ngjeshur me këmishë.
- 13H4 plastikë e ngjeshur, me mbulesë dhe me këmishë.
- 13H5 plastike filmi.
- 13L1 tekstil pa mbulesë ose këmishë.
- 13L2 tekstil, i mbuluar.
- 13L3 tekstil me këmishë.
- 13L4 tekstil, me mbulesë dhe këmishë.
- 13M1 letër shumështrësëshe.
- 13M2 letër shumështrësëshe, rezistente ndaj ujit.

Trupat duhet të prodhohen prej materiali të përshtatshëm. Fortësia e materialit dhe konstruksionit të IBCs fleksibël duhet ti përshtatet kapacitetit të tij dhe qëllimit të përdorimit të tij.

Të gjitha materialet të përdorura në konstruksionin e IBCs fleksibël të tipit 13M1 dhe 13M2 duhet, pas zhytjes komplet në ujë për jo më pak se 24 orë, të ruajnë të paktën 85% të forcës tërheqëse të matur konkretisht në materialin e kushtëzuar, me ekuilibër në 67% të lagështirës relative ose më pak.

Tegeli duhet të formohet nga të qepura, vulosje e nxehtë, ngjitje ose ndonjë metodë ekuivalente, dhe të gjithë nyjet e fundeve të tegelit duhet të jenë të sigurtë.

IBCs fleksibël duhet të japin rezistencën e mjaftueshme ndaj pjekjes dhe degradimit të shkaktuar nga radiacioni ultraviolet, kushtet klimatike ose lënda që përmban, duke i bërë ato në këtë mënyrë të përshtatshme për destinacionin e përdorimit të tyre.

IBCs fleksibël plastike, ku kërkohet mbrojtja nga radiacioni ultraviolet, duhet paisur me shtesë karbon të zi, ose pigmente ose pengues të tjerë të përshtatshëm. Keto shtesa duhet të jenë të pajtueshme me përmbajtjen dhe të mbeten efektive gjatë gjithë jetës së trupit. Kur përdoret karbon i zi, pengues ose pigmente ndryshe nga ato të përdorura në prodhimin e tipit të përcaktuar të testuar, rritimi mund të mënjanohet në qoftëse ndryshimet në përbërjen e karbonit të zi, në përbërjen e pigmentit ose në përbërjen e penguesit nuk veprojnë në mënyrë të dukshme në vetite fizike të materialit të konstruksionit.

Shtesat mund të përfshihen në përbërjen e materialit të trupit, për të përmirësuar rezistencën ndaj të pjekurit ose për të shërbyer për qëllime të tjera, duke siguruar që këto nuk veprojnë në mënyrë të dukshme në vetite fizike ose kimike të materialit.

Në prodhimin e trupave të IBCs, nuk duhet të përdoret asnjë material i përmirësuar nga kontenieret e përdorur. Sidoqoftë, mbetjet e prodhimit ose mbeturinat nga i njëjti proces prodhimi, mund të përdoren. Mund të përdoren gjithashtu pjesë përbërse të tilla si armatura ose paleta autobusash, nëse komponentë të tillë nuk janë dëmtuar me ndonjë mënyrë në përdorimin e mëparshëm.

Kur është i mbushur, raporti i lartësisë me gjërësinë nuk duhet të jetë më i madh se 2:1.

Këmisha duhet të prodhohet nga një material i përshtatshëm. Fortësia e materialit të përdorur dhe konstruksionit të këmishes duhet të përshtatet me kapacitetin e IBCs dhe përdorimin e menduar. Bashkimet dhe mbylljet duhet të jenë të siguruar dhe në gjëndje të qëndrueshmerisë ndaj presioneve dhe efekteve të detyrueshme që ndodhin në kushtet normale të transportimit dhe manovrimit.

Dispozita të vecanta për IBCs plastikë të shtanget.

3624 (1) Këto dispozita zbatohen tek IBCs plastikë të shtanget të menduar për transportin e trupave të ngurtë ose lëngjeve. Keto IBCs janë të tipeve që vijojnë:

11H1 për trupa të ngurtë të cilët ngarkohen apo shkarkohen me anë të gravitetit, të përshtatur me paisjen strukturore të projektuar, ti rezistojë të gjithë ngarkesës kur IBCs janë

grumbulluar.

11H2 për trupa të ngurtë të cilët shkarkohen ose ngarkohen me anë të gravitetit, në gjëndje të lirë.

21H1 për trupa të ngurtë të cilët ngarkohen ose shkarkohen me presionin prej më shumë se 10 kPa (0.1 bar), i pajisur me paisje strukturore të përcaktuara për ti rezistuar të gjithë ngarkesës kur IBCs grumbullohen.

21H2 për trupa të ngurtë të cilët ngarkohen ose shkarkohen me presion prej më shumë se 10 kPa (0.1bar), në gjëndje qetësie.

31H1 për lëngjet, të paisur me paisje strukturore të përcaktuara për ti rezistuar të gjithë ngarkesës kur IBCs grumbullohen.

31H2 për lëngjet, në gjëndje qetësie.

Trupi duhet të jetë prodhuar prej materiali të përshtatshëm plastik me specifikime të njohura dhe të jetë me fortësi dhe durim në lidhje me kapacitetin e tij dhe përdorimit të menduar. Materiali duhet të jetë mjaftueshëm rezistent ndaj të pjekurit dhe degradimit të shkaktuar nga lënda që përmbahet ose, kur përshtatet, nga rrezatimi ultraviolet. Çdo depërtim i substancës përmbajtse nuk duhet të përbëjë rrezik në kushtet normale të transportit.

Kur kërkohet mbrojtje kundër rrezatimit ultraviolet, ai duhet të sigurohet me shtimin e karbonit të zi ose pigmente dhe pengues të tjerë të përshtatshëm. Këto shtesa duhet të jenë të pajtueshme me përbërjen dhe të mbeten efektive gjatë gjithë jetës së trupit. Kur përdoret karbon i zi, pigmente ose pengues, ndryshe nga ato të përdorura në prodhimin e tipit të caktuar të testuar, rritet nuk do të merret parasysh në qoftë se ndryshimet në përbërjen e karbonit të zi, në përbërjen e pigmentit ose në përbërjen e penguesit, nuk ndikojnë në mënyrë të dukshme në vetitë fizike të materialit të konstruksionit.

Materialët shtesë mund të bashkohen me materialin e trupit për të përmirësuar rezistencën ndaj pjekjes ose të shërbejnë për qëllime të tjera, duke siguruar që këto nuk ndikojnë në mënyrë të dukshme në vetitë fizike ose kimike të materialit.

Në prodhimin e IBCs plastikë të ngurtë, nuk mund të përdoren materiale të tjerë ndryshe nga mbetjet e prodhimit ose ribluarja nga i njëjti proces prodhimi.

IBCs plastikë të ngurtë për lëngje duhet të jenë në gjëndje të qetësisë të një sasi të mjaftueshme të avullit për të siguruar mosthyerje të trupit. Kjo mund të arrihet me anë të paisjeve të shkarkimit të presionit konvencional ose me anë të mjeteve të tjera konstruktive. Presioni i fillimit të shkarkimit nuk duhet të jetë më i lartë se presioni i përdorur në testin e presionit hidraulik.

Vetëm nëse në rast të kundert aprovohet nga autoritetet kompetente, periudha e lejuar e përdorimit për transportin e lëngjeve të rrezikshme nuk duhet të kalojë 5 vjet nga data e prodhimit të depozitës të IBCs përveç se, kur përshkruhet një periudhë më e shkurtër, për shkak të natyrës së lengut që do të transportohet,

Dispozita të vecanta për IBCs e përbërë me depozitë të brendshme plastike

3625 (1).Këto dispozita zbatohen tek IBCs e përbërë të paracaktuara për transportin e materialeve solidë ose të lëngët. Këto IBCs janë të tipeve që vijojnë:

(a) 11HZ1 për materiale solidë të ngarkuar ose shkarkuar me anë të gravitetit, i paisur me një depozitë të brendshme plastike të ngurtë;

11HZ2 për materiale solidë të ngarkuar ose shkarkuar me anë të gravitetit, i paisur me një depozitë të brendshme plastike fleksibël;

21HZ1 për materiale solidë të ngarkuar ose shkarkuar me presion prej më shumë se 10 kPa (0.1bar), i pajisur me një depozitë të brendshme plastikë të ngurtë;

21HZ2 për materiale solidë të ngarkuar ose shkarkuar me presion prej më shumë se 10 kPa (0.1bar), i pajisur me një depozitë të brendshme plastike fleksibël;

31HZ1 për lëngje, i paisur me një depozitë të brendshme plastike të ngurtë;

31HZ2 për lëngje, i paisur me një depozitë të brendshme plastike fleksibël;

(b) Ky kod duhet të plotësohet duke zëvendësuar gërmën Z me një gërmë kapitale në përputhje me shënimet ansore 3611 (1) (b) për të treguar natyrën e materialit të përdorur për veshjen e jashtme.

Dispozita të përgjithshme

Depozita e brëndëshme nuk mendohet të kryejë një funksion mbajtës pa veshjen e saj të jashtme.

Veshja e jashtme normalisht konsiston e formuar nga material i ngurtë për të mbrojtur kështu depozitën e brëndëshme nga dëmtimet fizike gjatë manovrimit dhe transportit por nuk është menduar të kryej funksion mbajtës; kjo përfshin paletën bazë kur është e përshtatshme.

Në IBCs, i përbërë, me një veshje të jashtme plotësisht të mbyllur duhet të projektohet e tillë që tërësia e kontenerit të brëndshëm mund të testohet lehtë duke vijuar testet hidraulike dhe të mosrjedhjes.

Kapaciteti maksimal i IBCs i tipit 31HZ2 duhet të kufizohet në 1,250 litra.

Depozita e brëndëshme

Të njëjtat kërkesa që jepen në shënimet ansore 3624 (2) deri në (6) për IBCs plastikë të ngurtë zbatohen në depozitat e brëndëshme, në kuptimin që, në këtë rast, kërkesat e zbatueshme tek trupi i IBCs plastikë të ngurtë janë të zbatueshme tek depozita e brëndshme e IBCs të përbërë. Depozita e brëndëshme e IBCs të tipit 31HZ2 duhet të përfshijë të paktën 3 shtresa të filmit.

Mbulesa e jashtme

Fortësia e materialit dhe konstruksionit të mbulesës së jashtme duhet të jetë e përshtatshme me kapacitetin e IBCs së përbërë dhe përdorimit të parashikuar të tij.

Mbulesa e jashtme duhet të jetë pa ndonje të dalë që mund të dëmtojë depozitën e brëndshme.

Mbulesat e jashtme me metal mur-i plote ose rrjetë-formuar duhet të konstruktohen prej një materiali të përshtatshëm me trashësinë e duhur.

Mbulesat e jashtme prej druri natyral duhet të jenë prej druri të mirë të stinës, të tharë për tregëti dhe pa difekte që do të ulnin thelbësisht fortësinë e ndonjë pjese të mbulesës. Fillimet dhe fundet mund të bëhen prej druri i ristrukturuar rezistent ndaj ujit të tillë si dërrase e fortë, dërrase grimcore ose tip tjetër i përshtatshëm.

Mbulesat e jashtme prej kompesate duhet të bëhen nga prerje rrethore të mira stinore, në feta ose rimeso e sharruar, e tharë në mënyrë tregtare dhe pa difekte që do të ulnin në mënyre thelbësore fortësinë e mbulesës. Të gjitha shtresat e afërta duhet të mbyllën me ngjitës rezistent ndaj ujit. Materiale të tjerë të përshtatshëm mund të përdoren me kompesatën për konstruksionin e mbulesave. Mbulesat duhet të jenë të gozhuara qendrushmërisht ose të siguruar në vëndet ansore dhe fundore dhe të jenë montuar nga paisje të përshtatshme të njëjta.

Muret e mbulesave të jashtme prej druri të rikonstruktuar duhet të bëhen prej druri të rikonstruktuar rezistent ndaj ujit si, dërrasë e fortë, dërrasë grimcore ose tip tjetër i përshtatshëm. Pjesë të tjera të mbulesës mund të bëhen prej materiali tjetër të përshtatshëm.

Për mbulesat e jashtme dërrase antizjarr, duhet të përdoren dërrasë fibrore e rrudhosur solide ose dopio-faqe (teke ose shumë shtresëshe) e përshtatshme me kapacitetin e mbulesës dhe përdorimit të parashikuar të saj. Rezistenca ndaj ujit e sipërfaqes së jashtme duhet të jetë e tillë që rritja në masë, sikurse përcaktohet në testin e kryer mbi 30 minuta me metodën e përcaktimit të thithjes së ujit, Cobb, nuk është më shumë se 155g/m² - shiko ISO 535-1991. Ajo duhet të ketë cilësitë e duhura të përkuljes. Dërrasa fibrore duhet të pritët, e rrudhosur pa gërvishtje, dhe të çara, në mënyre që të lejojë montimin pa të çara, thyrje të sipërfaqes ose përkulje të tepërta. Pjesa e luget e dërrases fibrore të rrudhosur duhet të jetë e vendosur qëndrushmërisht tek manshetat.

Fundet e veshjeve të jashtme mund të kenë një kornizë druri ose e bërë e gjitha prej druri. Mund të përdoren përforcime prej mbajtëse druri.

Bashkimet gjatë prodhimit në veshjet dërrase fibrore duhet të jenë në formë rripash, të lidhur dhe të vulosur, ose të lidhur dhe të qepura me kapse metali. Bashkimet e palave duhet të kenë bllokimin e duhur. Kur mbyllja bëhet me dyllosje ose me lidhje rripash, duhet të përdoret një ngjitës rezistent ndaj ujit.

Kur veshja e jashtme është prej materiali plastik, dispozitat përkatëse të shënimeve ansore 3624 (2) deri (5) për IBCs plastikë të ngurtë zbatohen, në kuptimin që, në këtë rast, kërkesat e zbatueshme tek trupi i IBCs plastikë janë të zbatueshme tek veshja e jashtme e IBCs të përbërë.

Veshja e jashtme e një IBC të tipit 31HZ2 do të mbylli plotësisht depozitën e brëndshme.

Paisje tjeter strukturore

Çdo bazë e poshtme e paletit të plotë që formojnë pjesë të një IBCs ose çdo paletë e ndashme

duhet të jetë e përshtatshme për manovrim mekanik të IBC të mbushur në masën bruto maksimale të lejueshme.

Paleta ose baza e poshtme e plotë duhet të përcaktohet që të shmangë çdo zgjatje të bazamentit të IBC që mund të jetë rrezik të shkaktojë dëmtime në manovrim.

Veshja e jashtme duhet të sigurohet në çdo paletë të ndashme për të siguruar qëndrueshmëri në manovrim dhe transport. Kur përdoret një paletë e ndashme, sipërfaqja e saj e sipërme duhet të jetë pa të dala të mprehta që mund të dëmtojnë IBC.

Paisje përforcuese si mbajtëse druri për rritjen e efektshmërisë të ngritjes mund të përdoret, por duhet të jetë jashtë nga depozita e brëndëshme.

Kur IBCs parashikohen për ngritje, sipërfaqja mbajtëse do të jetë e tillë që të shpërndaje ngarkesën në mënyrë të sigurtë. IBCs të tillë duhet të projektohen në mënyrë që ngarkesa nuk do të mbahet nga depozita e brëndëshme.

(6) Vetëm në se aprovohet ndryshe nga autoritetet kompetente, periudha e përdorimit e lejuar për transportin e lëngjeve të rrezikshme nuk duhet të kalojë 5 vjet nga data e prodhimit të depozitës të IBC, me përjashtim, kur jepet një periudhë më e shkurtër përdorimi për shkak të llojit të lëngut që do transportohet.

Dispozita të vecanta për IBCs dërrasëfibrore

3626 (1) Këto dispozita zbatohen tek IBCs dërrasëfibrore për transportimin e materialeve të ngurtë të cilët ngarkohen dhe shkarkohen me anë të gravitetit. IBCs fibredërrase janë të tipit që vijon: 11G.

IBCs fibredërrase nuk do të përmbajnë paisje ngritëse në lartësi.

Trupi

Materialët fiberdërrase e rrudhosur, solide ose dopio-faqe, të forta dhe cilësi e mirë (e thjeshtë ose shumë shtresëshe), do të përdoren, në përshtatje me kapacitetin e IBCs dhe përcaktimit të tij për përdorim. Rezistenca ndaj ujit e sipërfaqes së jashtme duhet të jetë e tillë që rritja e masës, sikurse përcaktohet nga një test të kryer gjatë një kohe prej më shumë se 30 minuta me anë të metodës të përcaktimit të absorbimit të ujit, Cobb, nuk është më e madhe se 155 g/m² –shiko Standartin Ndërkombëtar ISO 535:1991. Dërrasëfibrore do të ketë cilësitë e duhura përkulëse. Ajo do të pritët, rrudhoset pa gervishtje dhe të pritët në mënyrë që të lejojë mbledhjen pa plasaritje, thyerje të sipërfaqes apo përkulje të tepërta. Kanalizimi i dërrasësfibrore të rrudhosur do të jetë i vendosur tek manshetat.

Muret, përfshirë pjesën e sipërme dhe bazamentin, do të kenë një rezistence minimale shpuarje prej 15 J të matur në perputhje me Standartin Ndërkombëtar ISO 3036:1975.

Bashkimet e prodhimit në trupin e IBCs do të bëhen me një bashkuese të përshtatshme dhe do të lidhen, mbyllen, qepen me kapse metalike, ose fiksohen me mjete të tjera vepruese të paktën afërsisht të ngjashme. Kur bashkimet janë efektive me anë të mbylljes ose lidhjes, do të përdoret një ngjitës rezistent ndaj ujit. Kapse metalike do të kalojnë plotësisht nëpër të gjitha pjesët për tu fiksuar dhe të marrin formën e duhur ose të jenë të mbrojtura në mënyrë të tillë që çdo këmishë e brëndëshme nuk mund të ferkohet ose të cahet prej tyre.

Këmisha

Këmisha duhet të jetë prej një materiali të përshtatshëm. Fortësia e materialit të përdorur dhe konstruksioni i këmishës duhet të përshtatet me kapacitetin dhe përdorimin e parashikuar të IBC. Bashkimet dhe mbylljet do të jenë hermetike dhe në gjëndje për të rezistuar presioneve dhe ndikimeve të rrezikshme që mund të ndodhin në kushte normale të manovrimit dhe transportimit.

Paisja strukturore

Çdo bazë e një paletë të plotë që formojnë pjesë të një IBC ose çdo paletë e ndashme duhet të

jetë e përshtatshme për manovrim mekanik të IBC e mbushur në masën e saj maksimale të lejuar.

Paleta ose baza e plotë duhet të përcaktohet në mënyrë që të eliminojë çdo zgjatje të fundit të IBC që mund të jetë e rrezikshme për dëmtim në manovrim.

Trupi duhet të jetë i siguar për çdo paletë të ndashme për të siguruar stabilitet në manovrim dhe transport. Sipërfaqja e sipërme e paletës së ndashme duhet të jetë pa të dala të mprehta që mund të dëmtojnë IBC.

Paisje përforcuese si mbajtëse druri për rritjen e efektshmërisë të ngritjes mund të përdoret, por duhet të jetë jashtë nga depozita e brendshme.

Kur IBCs parashikohen për ngritje, sipërfaqja mbajtëse do të jetë e tillë që të shpërndajë ngarkesën në mënyrë të sigurtë.

Dispozita të veçanta për IBCs prej druri

3627 (1) Këto dispozita zbatohen tek IBCs prej druri për transportimin e materialeve të ngurtë të cilët ngarkohen dhe shkarkohen me anë të gravitetit. IBCs prej druri janë të tipeve që vijon:

11C Dru natyral me këmishë të brëndshme.

11D Dru me shtresa me këmishë të brëndëshme.

11F Dru i ristrukturuar me këmishë të brëndshme.

IBCs druri nuk do të përmbajnë paisje ngritëse në lartësi.

Trupi

Fortësia e materialit të përdorur dhe metoda e ndërtimit duhet të përshtatet me kapacitetin dhe përdorimin që mendohet të ketë IBCs.

(b) Nëse trupat janë prej druri natyral, ky duhet të jetë dru i stines, i tharë në mënyrë tregtare, dhe pa difekte, që mund të paksojnë materialisht fortësinë e ndonjë pjesë të IBC. Çdo pjesë e IBC duhet të përbëhet prej një cope ose të jetë ekuivalent me të. Pjesët konsiderohen ekuivalent me një pjesë kur është përdorur metoda bashkimit me ngjitje (si për shëmbull bashkimi Linderman, bashkimi i bukosur ose me kanale, i mbyllur ose me kllapa), por bashkojnë të paktën dy mbërthyes metalike të rrudhosura në çdo bashkim, ose metoda të tjera të përdorura të paktën të barabarta efektivisht.

(c) Nëse trupat janë prej druri me shtresa, duhet të ketë të paktën tre shtresa. Ai duhet të bëhet prej druri të stinës me prerje rrethore, i prerë në feta ose rimeso, i tharë në mënyrë tregtare dhe pa difekte që mund të ulin fortësinë e trupit të gjitha të palosurat e afërta duhet të mbyllet me ngjitësa rezistent ndaj ujit me drurin me shtresa, mund të përdoren edhe materiale të tjerë të përshtatshëm për ndërtimin e trupit.

Trupat prej druri të riformuar duhet të prodhohen prej druri të riformuar rezistent ndaj ujit, të tillë si, dërrasë e fortë, me pjesëza ose tip tjetër i përshtatshëm.

IBCs duhet të gozhdohen fort ose të sigurohen në vëndet e qosheve ose fundet ose të montohen me paisje ekuivalente.

Këmisha

Këmisha duhet të jetë prej një materiali të përshtatshëm. Fortësia e materialit të përdorur dhe konstruksioni i këmishës duhet të përshtatet me kapacitetin dhe përdorimin e parashikuar të IBC. Bashkimet dhe mbylljet do të jenë hermetike dhe në gjëndje për ti rezistuar presioneve dhe ndikimeve të rrezikshme që mund të ndodhin në kushte normale të manovrimit dhe transportimit.

(5) Paisja strukturore

Çdo bazë e një paletë të plotë që formojnë pjesë të një IBC ose çdo paletë e ndashme duhet të jetë e përshtatshme për manovrim mekanik të IBC e mbushur në masën e saj maksimale të lejuar.

Paleta ose baza e plotë duhet të përcaktohet në mënyrë që të eliminojë çdo zgjatje të fundit të IBC që mund të jetë e rrezikshme për dëmtim në manovrim.

Trupi duhet të jetë i siguar për çdo paletë të ndashme për të siguruar stabilitet në manovrim dhe transport. Sipërfaqja e sipërme e paletës së ndashme duhet të jetë pa të dala të mprehta që mund të dëmtojnë IBC.

Paisje përforcuese si mbajtëse druri për rritjen e efektshmërisë të ngritjes mund të përdoret, por duhet të jetë në anën e jashtme të këmishes.

Kur IBCs parashikohen për ngritje, sipërfaqja mbajtëse do të jetë e tillë që të shpërndajë ngarkesën në mënyrë të sigurtë.

3628-3649

Seksioni 4: Kërkesat e testit për IBCs.

Testet e tipit të projektuar

Kërkesa të përgjithshme

3650 (1) Tipi i përcaktuar për çdo IBC duhet të testohet dhe aprovohet nga autoritetet kompetente ose nga një trupë e caktuar nga ky autoritet.

Përpara përdorimit të çdo tipi të përcaktuar një IBC i vetëm duhet të kalojë me sukses provën e dhënë në listën e mëposhtme (5), sipas rregullit që përmendet në tabelë dhe në përputhje me dispozita të specifikuara në anëshkrimet 3652 deri në 3660. IBCs të vecantë fleksibël mund të përdoren për çdo test.

Të gjitha këto teste duhet të kryhen në përputhje me procedurat e vendosura nga Autoritetet kompetente. Një tip i projektuar IBC përcaktohet nga konstruksioni, madhësia, materiali dhe trashësia, mënyra e konstruktimit dhe mjetet e mbushjes dhe shkarkimit por mund të përfshijë trajtime të ndryshme të sipërfaqes. Ai gjithashtu pëfshin IBCs të cilët ndryshojnë nga tipi i projektuar vetëm në dimensionet e jashtme më të vogla.

Autoriteti kompetent mund, gjithashtu, të autotizojë një testim përzgjedhës të IBCs, të cilët ndryshojnë nga tipi tashmë i testuar vetëm në përmasat më të vogla respektive, për shëmbull, zvoglime të vogla në dimensionet e jashtme.

Testet duhet të kryhen tek IBCs që përgatiten për tu nisur. IBCs duhet të mbushen sikurse tregohet për teste të ndryshëm. Lëndet që do të transportohen me IBCs mund të zëvendësohen nga lëndë të tjera, me përjashtim të rasteve kur kjo gjë do të shfuqizonte rezultatet e testit. Për lëndët e ngurta, nëse përdoret një lëndë tjetër, ajo duhet të ketë karakteristika të njëjta (masa, madhësia e kokrrizës, etj.) me lëndën që do të transportohet. Është e lejueshme të përdoren lëndë shtesë, të tilla si gjyle grafiti, për të arritur masën totale të kërkuar të paketës, nëse ato janë vendosur në mënyre që rezultatet e testit nuk ndikohen.

Në testin e pikimit për lëngjet, nëse është përdorur një lëndë tjetër, densiteti dhe viskoziteti i tij relativ duhet të jetë i ngjashëm me ato të lëndës që do të transportohet. Gjithashtu për testin e rrjedhjes së lëngut, mund të përdoret edhe uji me kushtet e mëposhtme:

në qoftë se lëndët që do të transportohen kanë një densitet relativ që nuk i kalon 1,2, lartësitë e pikimit duhet të jenë ato të treguara në seksionet përkatëse për tipet e ndryshëm të IBC:

në qoftë se lëndët që do të transportohen kanë një densitet relativ që i kalon 1,2, lartësitë e pikimit duhet të llogariten në bazë të densitetit relativ (d) të lëndës që do të transportohet të rrumbullakosur në presjen e parë dhjetore si vijon:

Paketa e Grupit I	Paketa e Grupit II	Paketa e Grupit III
$d \times 1.5 \text{ m}$	$d \times 1.0 \text{ m}$	$d \times 0.67 \text{ m}$

(5) Testet e kërkuara për çdo tip të projektuar IBC

Çdo X tregon që kategoria e IBC e treguar në krye të kolumnës duhet ti nënshtrohet testit të treguar në rradhën e pyetjes, sipas rregullit të dhënë në listë:

	IBCs Metali	IBCs Fleksibël	IBCs Plastikë të ngurtë	IBCs Të përbërë me depozitë të brëndshme plastike	IBCs Dërrasë-fibër	IBCs druri

Ngritje nga bazamenti	Xa/		X	X	X	X
Ngritje nga sipër	Xa/	Xb/	Xa/	Xa/		
Çarje		X				
Ngarkimi	X	X	X	X	X c/	X
Hermetizimi	X d/		Xd/	Xd/		
Presioni hidraulik i brëndshëm	Xc/		Xc/	Xc/		
Pikim	Xf/	X	X	Xf/	X	X
Përmbysje		X				
Drejtueshmëria		Xb/				

a/ Për IBCs që janë projektuar të transportohen në këtë mënyrë.

b/ Kur IBCs janë projektuar të ngrihen nga sipër ose nga anash.

c/ Kur IBCs janë projektuar të ngarkohen.

d/ Testi i hermetizimit nuk kërkohet për IBCs të tipit 11A, 11B, 11N, 11H1, 11H2, 11HZ1 ose 11HZ2.

e/ Testi i presionit të brëndshëm hidraulik nuk kërkohet për IBCs të tipit 11A, 11B, 11N, 11H1, 11H2, 11HZ1 ose 11HZ2.

f/ Një IBC tjetër i të njëjtit projekt mund të përdoret për testin e pikimit.

Përgatitja e IBCs për testim

3651 (1) IBCs fleksibël, IBCs fibërdërrase dhe IBCs të përbërë me veshje të jashtme fibërdërrase.

IBCs letre, IBCs fibërdërrase dhe IBCs të përbërë me veshje të jashtme fibërdërrase duhe të kushtëzohen të paktën për 24 orë në një atmosferë që ka temperaturë të kontrolluar dhe lagështirë relative (r.h). Ka tre opsione nga të cilët duhet të zgjidhet njëri. Atmosfera e preferuar është $23.0\text{ C} \pm 2.0\text{ C}$ dhe $50\% \pm 2\%$ r.h. Dy opsionet e tjera janë $20.0\text{ C} \pm 2.0\text{ C}$ dhe $65\% \pm 2\%$ r.h. ose $27.0\text{ C} \pm 2.0\text{ C}$ dhe $65\% \pm 2\%$ r.h.

SHENIM: Këto vlera korespondojnë me vlerat mesatare në termat afatshkurtër vlerat e lagështirës relative mund të variojnë me $\pm 5\%$ pa influencuar në testim.

IBCs plastikë dhe IBCs të përbërë me depozitë të brëndshme plastike.

Hapa shtesë duhen marrë për të përcaktuar që materialet plastikë të përdorur në prodhimin e IBCs plastikë të ngurtë të tipit 31H1 dhe 31H2 dhe IBCs të përbërë të tipit 31HZ1 dhe 31HZ2 përputhen me dispozitat e 3624 (2) deri në (4).

Për ta provuar nëse ka përputhje kimike të mjaftueshme me mallrat që përmbahen, IBCs kampion, duhet ti nënshtrohet një magazinimi paraprak prej 6 muajsh, gjatë të cilit kampionët mbeten të mbushura me lëndët që ato mendohen të përmbajnë ose me lëndët që dihet, të kenë të paktën si ndarje një sforcim-carje, veprim keqsues molekular ose dobësues në materialet plastikë në fjale, dhe pas të cilit kampionët duhet ti nënshtrohen testeve të aplikueshme, të listuara në anëshkrimin 3650 (5).

Kur sjellja e materialit plastik vendoset me mjete të tjera, testi i mësipërm i pajtueshmërisë mund të jetë i panevojshëm. Proçedura të tilla duhet të jenë të paktën të njëjtë me testin e mësipërm të pajtueshmërisë dhe të njihen nga autoriteti kompetent.

Proçedurat e testimit

3652 Testi i ngritjes nga fundi

Zbatueshmëria

Për të gjitha tipet e IBCs të cilët përshtaten me mjetet e ngritjes nga bazamenti.

Përgatitja e IBCs për testim.

IBCs duhet të mbushen deri 1.25 herë të masës bruto maksimale të lejuar, me ngarkesën që shpërndahet rregullisht.

(3)Metoda e testimit.

IBC duhet të ngrihet dhe të ulet dy herë me anë të një kamioni ngritës me pirunët të pozicionuar në qënder dhe të vendosur në tre të katertat e dimensionit të faqes ansore të hyrjes (po të

mos jenë fiksuar pikat e hyrjes). Pirunet duhet të depërtojnë në tre të katërtat e drejtimit të hyrjes. Testi duhet të përsëritet nga çdo drejtim i mundshëm i hyrjes.

(4) Kriteret për kapërximin e testit.

Asnjë deformim i përhershëm i cili i bën IBC (përfshirë bazamentin e paletës për IBCs e përbërë me depozitë të brëndshme plastike, IBCs fibërdërrase dhe IBCs druri) të pasigurtë për transport dhe asnjë humbje të përmbajtjes.

3653 Testi i ngritjes nga sipër.

Zbatueshmëria.

Për të gjitha tipet e IBC të cilët përshtaten me mjetet e ngritjes nga sipër ose, kur është e përshtatshme, nga anash për IBCs fleksibël.

Përgatitja e IBCs për testim.

IBC metalikë, IBCs plastikë të ngurtë dhe IBCs të përbërë me depozitë të brëndshme plastike:

IBC duhet të mbushet deri në dy herë të masës së tij bruto maksimale të lejuar.

3653 IBCs fleksibël:

IBC fleksibël duhet të mbushen deri në 6 herë të ngarkesës maksimale të lejuar, me ngarkesën që shpërndahet rregullisht.

Metoda e testimit

IBC metalikë dhe fleksibël:

IBC duhet të ngrihet nga dyshemeja në mënyrën për të cilën ai është projektuar derisa ai është I zbratur dhe të mbahet në këtë pozicion për një kohë prej 5 minutash.

Për IBCs fleksibël mund të përdoren metoda të tjera testimi dhe përgatitje të ngritjes nga sipër dhe të paktën me përdorim të njëlojtë efektiv.

IBC e ngurtë plastikë dhe IBCs e përbërë me depozitë të brëndshme plastike:

IBC duhet të ngrihet nga çdo palë e paisjeve ngritëse diagonalisht të kundërta, kështu që forcat ngritëse veprojnë vertikalisht, për një kohë prej 5 minutash; dhe

IBC duhet të ngrihet nga çdo çift i paisjeve ngritëse diagonalisht të kundërta, kështu që forcat ngritëse janë zbatuar drejt qëndrës në 45° me drejtimin vertikal, për një periudhë prej 5 minutash.

Kriteret për kapërximin e testit

IBC metalikë, IBCs të ngurtë plastikë, IBCs të përbërë me një depozitë të brëndshme plastike:

Asnjë deformim mbetës i cili i bën IBC (përfshirë bazamentin e paletës për IBCs e përbërë) të pasigurtë për transportin dhe asnjë humbje të përmbajtjes.

IBC fleksibël:

Asnjë dëmtim të IBC ose paisjet e tij ngritëse të cilat e bëjnë IBC të pasigurtë për transportim ose manovrim.

3654 Testi i carjes.

Zbatueshmëria

Për të gjitha tipet e IBCs fleksibël.

Përgatitja e IBCs për testim.

IBC duhet të mbushet deri jo më pak se 95% të kapacitetit të tij dhe deri në ngarkesën e tij maksimale të lejuar, dhe me ngarkesën që shpërndahet uniformisht.

Metoda e testimit.

Ndonjëherë IBC vendoset mbi një vend, një thikë me bazë 100 mm, që depërton komplet murin e një faqe të gjërë, është bërë në një kënd 45° me akset kryesore të IBC, në gjysëm të distancës ndërmjet sipërfaqes së bazamentit dhe nivelit të sipërm të përmbajtjes. Atëherë IBC duhet të jenë subjekt të një ngarkese të mbivendosur uniformisht të shpërndarë të barabartë me dyfishin e ngarkesës maksimale të lejuar. Ngarkesa duhet të zbatohet të paktën për 5 minuta.

3654 IBCs të cilët janë projektuar të ngrihen nga lart ose nga anash duhet atëherë, që pas heqjes të ngarkesës të mbivendosur, të ngrihen lart nga dyshemeja dhe të mbahen në këtë pozicion për një kohë prej 5 minutash. Të tjera metoda ekuivalente mund të përdoren.

Kriteri për kapërcimin e testit.

Prerja nuk duhet të përhapet më shumë se 25% të gjatësisë së tij origjinale.

3655 Testi i ngarkimit.

Zbatueshmëria.

Për të gjitha tipet e IBC.

Përgatitja e IBCs për testim.

Të gjitha kategoritë e IBC përveç IBCs fleksibël:

IBC duhet të mbushet deri në masën e tij maksimale të lejuar bruto.

IBC fleksibël:

IBC duhet të mbushet deri në jo më shumë se 95% të kapacitetit të tij dhe deri në ngarkesën e tij maksimale të lejuar, me ngarkesën rregullisht të shpërndarë.

Metoda e testimit.

IBC duhet të vendoset mbi bazamentin e tij në nivelin ekstrem të tokës dhe ti nënshtrohet një testi të ngarkesës se mbivendosur uniformisht të shpërndarë (shiko (4) më poshtë)

Kategoritë dhe Tipet e IBC	Koha e testimit
IBC Metalikë	5 minuta
IBC fleksibël. IBCs të ngurtë plastikë Tip 11H1, 21H1 dhe 31H1 IBCs të përbërë me depozitë të brëndshme plastike ndryshe nga 11HH1, 11HH2, 21HH2, 31HH1 dhe 31 HH2. IBCs fibërdërrase, IBCs druri	24 orë
IBCs plastikë të ngurtë Tip 11H2, 21H2 dhe 31H2 IBCs të përbërë me depozitë të brëndshme të brendshme plastike dhe veshje plastike të jashtme të Tipeve 11HH1, 11HH2, 21HH2, 31HH1 dhe 31HH2.	28 dite në 400C

Për të gjitha kategoritë e IBC përveç IBCs metalikë, ngarkesa e mbivendosur e testimit duhet të zbatohet me anë të një prej metodave që vijojnë:

një ose më shumë IBCs prej të njëjtit tip ngarkimi deri në masën e tyre bruto maksimale të lejuar (ngarkesa maksimale e lejuar në rastin e IBCs fleksibël) janë ngarkuar në IBC që testohet;

pesha të përshtatshme janë ngarkuar mbi një plate të sheshtë ose një riprodhim i bazamentit të IBC, i cili është vendosur në IBC që testohet.

Llogaritja e ngarkësës së mbivendosur të testit.

Ngarkesa që do të vendoset mbi IBC duhet të jetë të paktën sa 1.8 herë të masës së kombinuar bruto maksimale të lejuar të numrit të IBCs të ngjashëm që mund të ngarkohen sipër IBC gjatë transportit.

Kriteri për kapërcimin e testit.

IBC ndryshe nga IBCs fleksibël:

Asnjë deformim mbetës i cili e bën IBC (përfshirë bazamentin e paletës për IBCs e përbërë, IBCs fibërdërrase ose IBCs druri) të pasigurtë për transport dhe asnjë humbje e përbërjes.

IBC fleksibël:

Asnjë dëmtim të trupit i cili e bën IBC të pasigurtë për transport dhe asnjë humbje të përmbajtjes.

3656 Testi i hermetizimit.

Zbatueshmëria.

Për të gjitha tipet e IBC metalikë dhe për tipet e IBC plastikë dhe IBCs të përbërë me depozitë të brëndëshme plastike për transportin e ngarkesave solide ose shkarkim nën presion për transportin e lëngjeve.

Përgatitja e IBCs për testim.

Mbylljet e shfryerjeve duhet ose të zëvendësohen me anë të mbyllseve të ngjashme joshfryrëse, ose vrima duhet të jetë e mbyllur, për më tepër për IBCs metalike, testi tip i projektit duhet të kryhet përpara montimit të ndonje paisje të izolimit termik.

Për këtë test IBCs nuk ka nevojë të ketë të montuara mbyllset e tij. Depozita e brëndëshme e IBCs të përbërë mund të testohet pa ambalazhimin e jashtëm duke siguruar që rezultatet e testit nuk ndikohen.

Metoda e testimit dhe presioni që duhet zbatuar.

Testi duhet të kryhet për një kohë prej të paktën 10 minutash duke përdorur ajer në një presion etalon konstant prej jo më pak se 20 kPa (0.2 bar). Hermeticiteti i IBCs duhet të percaktohet nga një

metodë e përshtatshme të tillë si testi diferencial i presionit të ajrit ose duke e zhytur IBC në ujë, në rastin e fundit duhet të përdoret një faktor korigjues për presionin hidraulik. Metoda të tjera të paktën efektive mund të përdoren për IBCs plastikë dhe për IBCs e përbërë.

Kriteri për kalimin e testit.

Jo rrjedhje ajri.

Testi i presionit të brendshëm (hidraulik)

Zbatueshmëria.

Për IBCs e tipeve:

21A, 21B, 21N, 31A, 31B, 31N

21H1, 21H2, 31H1, 31H2

21HZ1, 21HZ2, 31HZ1, 31HZ2

3657 vazhdim

Përgatitja e IBCs për testim.

Paisjet e kontrollit të presionit duhet të hiqen dhe hapjet e tyre të taposen ose të bëhen të pafunksionueshëm, në vazhdim, për IBCs metalike testi duhet të kryhet përpara montimit të ndonjë paisje të izolimit termik.

Metoda e testimit.

Testi duhet të kryhet për një kohe të paktën prej 10 minutash duke zbatuar një presion hidraulik jo më të vogël se ai i treguar në (4). IBCs nuk duhet të jetë i kufizuar mekanikisht gjatë testimit.

Presioni që do të zbatohet.

IBCs metalikë:

Për IBCs të tipeve 21A, 21B dhe 21N, për Grupin e Paketimit të I-rë të ngurte, një presion etalon 250kPa (2.5 bar)

Për IBCs të tipeve 21A, 21B, 21N, 31A, 31B dhe 31N, për Grupin e Paketimit të II ose të III të lëndës, një presion etalon 200 kPa (2 bar);

Në vazhdim, për IBCs të tipeve 31A, 31B, dhe 31N, një presion etalon 65 kPa (0.65bar). Ky test duhet të kryhet përpara testit me 2 bar.

IBCs plastikë të ngurtë dhe IBCs me depozitë të brëndëshme plastike:

Për IBCs të tipeve 21H1, 21HZ1 dhe 21HZ2: një presion etalon prej 75kPa (0.75 bar)

Për IBCs të tipeve 31H1, 31HZ1 dhe 31HZ2: cilido që është më i madh se vlerat sipas (i) ose

(ii):

Presioni etalon total i matur në IBCs (p.sh. presioni i avullit i lëndës mbushëse dhe presioni i pjesës së ajrit ose i gazeve të tjera inerte, minus 100 kPa) në 550C ,shumëfishuar me një faktor sigurie prej 1.5; ky presion etalon total duhet të përcaktohet në bazat e një shkalle maksimale të mbushjes në përputhje me 3601 (7) dhe një temperaturë të mbushjes prej 15 0C: ose

1.75 herë presionin e avullit në 50 0C të lëndës që do transportohet, minus 100kPa, por me një presion testimi minimal prej 100kPa; ose

1.5 here presionin e avullit në 55 0C të lëndës që do transportohet, minus 100kPa; por me një presion testimi minimal prej 100kPa;

dy herë presionin statik të lëndës që do transportohet, me një minimum të dy herë presionin statik të ujit.

3657 (5) Kriteri për kalimin e test-it(-eve).

(vazh'm)

IBCs Metalikë:

Per IBCs të tipeve 21A, 21B, 21N, 31A, 31B dhe 31N, kur i nënshtrohen presionit të testit të specifikuar në (4) (a) 1 ose 2.: jo rrjedhje.

Për IBCs të tipeve 31A, 31B, dhe 31N, kur i nënshtrohen presionit të testit të specifikuar në (4) (a) 3.: asnjë deformim mbetës i cili mund ta bëjë IBC të pasigurtë për transport, apo rrjedhje.

IBCs plastikë të ngurtë dhe IBCs të përbërë:

Asnjë deformim mbetës i cili mund ta bëjë IBC të pasigurtë për transport, apo humbje të përmbajtjes.

3658 Testi i pikimit.

Zbatueshmëria

Për të gjitha tipet e IBC.

Përgatitja e IBCs për testim.

IBCs duhet të mbushet:

Për materiale të ngurtë,

Jo më pak se 95% të kapacitetit të tij,

Për lëngjet,

Jo me shume se 98 % të kapacitetit të tij në rastin e IBCs metalikë ose IBCs plastikë të ngurtë, dhe jo më pak se 90 % të kapacitetit të tij në rastin e IBCs të përbërë me depozitë të brendshme plastike.

IBCs, më tej, duhet të mbushet në ngarkesën e tij maksimale të lejueshme në përputhje me tipin e projektit.

Për IBCs metalikë IBCs plastikë të ngurtë dhe IBCs të përbërë me depozitë të brëndëshme plastike, pajisjet e rregullimit të presionit duhet të hiqen dhe të hapurat e tyre të taposen, ose duhet të behen të pafunksionueshme.

Për IBCs plastikë të ngurtë dhe IBCs të përbërë me depozitë të brendëshme plastikë, testimi duhet të kryhet kur temperatura e kampionit të testit dhe përmbajtjes së tij është pakuar në - 18 0C ose më poshtë. Kur kampionet e testimit janë përgatitur në këtë mënyrë, kushtëzimet e specifikuar në anëshkrimin 3651 (1) për IBCs e përbërë me veshje të jashtme fibërdërrase mund të mos merren parasysh.

Lëngjet e testimit duhet të ruhen në gjëndje të lëngët nëse është e nevojshme me shtimin e anti-ngrirësit.

Ky kushtëzim mund të jetë i papërfillshëm nëse forca e butësisë dhe e elasticitetit të materialeve në fjalë nuk është zvogëluar në mënyrë të dukshme në - 18 0C ose më poshtë.

Metoda e testimit.

IBCs duhet të vendoset mbi një sipërfaqe të sheshtë horizontale, të lëmuar, jo-elastike, të ngurtë, mbi bazamentin e tij (për IBCs fleksibël) ose në një mënyrë të tillë që të sigurojë që pika e takimit është në këtë pjesë të bazamentit të IBCs të konsideruar si pjesa më e prekshme (e cënueshme) (për të gjitha tipet e tjera të IBC).

IBCs me kapacitet prej 0.45m³ ose më pak duhet gjithashtu të jenë objekt të një testi pikimi në pjesën më të prekshme ndryshe nga pjesa e bazamentit të IBC të testuar në vendosjen e parë (për IBCs metalike); në anën më të prekshme (për IBCs fleksibël); krejt mbi një anë, krejt mbi majë ose mbi një qoshe (për të gjitha tipet e IBC) IBCs të njëjtë ose të ndryshëm mund të përdoren për çdo vendosje.

Lartësia e pikimit.

Grupi i I i Paketimit	Grupi i II i Paketimit	Grupi i III i Paketimit
1.8 m	1.2 m	0,8 m

(5) Kriteret për kalimin e testit.

Të gjithë IBCs:

Jo humbje të përmbajtjes

IBCs përveç IBCs metalikë:

Një shkarkim i lehtë nga mbylljet (ose vrima të qepura në rastin e IBCs fleksibël) me ndikimin që nuk duhet të konsiderohet si dështim i IBC, duke siguruar që nuk ndodh pikimi i mëtejshëm.

3659 Testi i përmbysjes.

Zbatueshmëria.

Për të gjitha tipet e IBCs fleksibël.

Përgatitja e IBCs për testim

IBCs duhet të mbushet në jo më shume se 95% të kapacitetit të tij dhe në ngarkesën e tij maksimale të lejueshme, duke qënë ngarkesë e shpërndarë rregullisht.

Metoda e testimit.

IBC duhet të përmbysset mbi çdo pjesë të pjesës së tij të sipërme mbi një sipërfaqe horizontale të sheshtë, të lëmuar, jo-elastike, të ngurtë.

Lartësia e përmbysjes

Grupi i I i Paketimit	Grupi i II i Paketimit	Grupi i III I Paketimit
1.8 m	1.2 m	0,8 m

Kriteri për kalimin e testit.

Jo humbje të përmbajtjes, një shkarkim shumë i lehtë, p.sh. nga mbylljet ose vrimat e qepura, me ndikim që nuk duhet të konsiderohet si prishje e IBC, duke siguruar që nuk ndodh pikimi i mëtejshëm.

3660 Testi i Drejtueshmërisë.

Zbatueshmëria.

Për të gjitha IBCs të projektuar për tu ngritur nga pjesa e sipërme ose ansore.

Përgatitja e IBCs për testim.

IBCs duhet të mbushet në jo më shumë se 95% të kapacitetit të tij dhe në ngarkesën e tij maksimale të lejueshme, duke qënë ngarkesë e shpërndarë rregullisht.

Metoda e Testimit.

IBC, i shtrire në një ane të tij, duhet të jetë i ngritur në një shpejtësi prej të pakten 0.1 m/s në pozicion të drejtë, lart nga dysHEMEJA, me ane të një paisje ngritëse, ose me ane të dy paisjeve ngritëse kur janë siguruar katër.

Kriteri për kalimin e testit.

Jo dëmtim të IBC ose paisjeve të tij ngritëse të cilat e bëjnë IBC të pasigurtë për transport ose manovrim.

Raporti mbi testin

3661 (1) Nje raport i testit që përmban të paktën veçoritë që vijojnë duhet të hartohet dhe duhet të jetë i përdorshëm për përdoruesit e IBC:

Emri dhe adresa e realizuesit të testit;

Emri dhe adresa e aplikuesit (kur duhet);

Një raport testimi identifikimi i vetëm;

Data e raportit të testit;

Prodhimi i IBC;

Përshkrimi i tipit të projektit të IBC (p.sh. dimensionet, materialet, mbylljet, trashësia, etj.) përfshirë metodën e prodhimit (p.sh. formim me fryrje) dhe i cili mund të përfshijë vizatime(t) ose/dhe fotografi(të);

Kapaciteti maksimal;

Karakteristikat e përmbajtjes se testit, p.sh.viskoziteti dhe densiteti relativ për lëngjet dhe madhësia e kokrrizës për lëndët e ngurta;

Përshkrimi i testit dhe rezultatet;

Raporti i testit duhet të vuloset me emrin dhe statusin e firmosësit.

Raporti i testit duhet të përmbajë formulimin që IBC i përgatitur për transportim është testuar në përputhje me dispozitat e duhura të Shtojcës A.6 dhe që përdorimi i metodave të tjera të paketimit ose komponentëve mund të bëhet i pavlefshëm, një kopje të raportit të testit duhet të jetë i përdorshëm për autoritetet kompetente.

B. Testet dhe kontrollat për çdo IBC metalike, IBC plastike të ngurte dhe IBC të përbërë me depozitë të brendëshme plastike.

Testet fillestare dhe periodike.

3662 (1) Të gjithë IBCs metalikë të tipeve 21A, 21B, 21N,31A 31B dhe 31N, të gjithë IBCs plastike të ngurtë të tipit 21H1, 21H2, 31H1 dhe 31H2 dhe të gjithë IBCs e përbërë me depozitë të brendëshme plastike të tipit 21HZ1, 21HZ2, 31HZ1 dhe 31HZ2 duhet të kalojnë në mënyrë të sukseshme testin e hermetizimit, dhe të jenë në gjëndje të arrijne nivelin e duhur në përputhje me anëshkrimin 3656 (3) përpara përdorimit të tyre të parë për transport.

Testi i hermetizimit referuar pikës (1) duhet të përsëritet.

te paktën një herë në dy vjet e gjysëm.

pas çdo riparimi, përpara ripërdorimit të tij për transport.

Rezultatet e testit duhet të futen në raportet e testit për tu ruajtur nga pronari i IBC.

(a) Nje IBC i mbushur perpara dates të skadimit të afatit për testin periodik në përputhje me paragrafin (2) mund të kryhet, për një periudhe që nuk i kalon 3 muaj pas kesaj date.

(b) Në vazhdim, një IBC i mbushur përpara datës të skadimit të afatit për testin periodik

në përputhje me paragrafin (2) mund të kryhet, po të mos miratohet ndryshe nga autoritri kompetent, për një periudhë që nuk i kalon 6 muajt pas kësaj date me qëllim që të lejojë kthimin e substancave të ADR për dispozicionin e duhur ose riciklimin. Kur substancat transportohen në IBCs me këto kushte, në dokumentin e transportit duhet të përfshihet formulimi që vijon “Transport në përputhje me anëshkrimin 3662(4)(b)”.

IBCs bosh, të papastruar, mund të transportohen pas datës të kalimit të testit të tyre të fundit periodik, për qëllime të testimit.

Kontrolli

3663 (1) Të gjithë IBCs metalikë, të gjithë IBCs plastikë të ngurtë dhe të gjithë IBCs të përbërë me depozitë të brëndëshme plastikë duhet të kontrollohen për shlyerjen me autoritetin kompetent përpara vënies së tyre në servis, dhe pas kësaj në intervale që nuk i kalojnë 5 vjet, në lidhje me:

përputhjen me tipin e projektit përfshirë shënimin;

gjëndjen e jashtme dhe të brëndshme;

funksionimin e duhur e paisjes së shërbimit.

Për IBCs metalikë, veçimi termik ka nevojë të hiqet vetëm në hapsirën e nevojshme për një kontroll të nevojshëm të trupit të IBC.

Të gjithë IBCs referuar (1) duhet të jenë të kontrolluar vizualisht (me sy) nga autoriteti kompetent pas jo më shumë se dy vjet e gjysëm, referuar gjëndjes së jashtme të IBC dhe funksionimit të duhur të paisjes së shërbimit.

Për IBCs metalikë, veçimi ka nevojë të hiqet vetm nëse kjo është esenciale për një kontroll të përshtatshëm të trupit të IBC.

(3) (a) Nje IBC i mbushur përpara dates të skadimit te afatit për kontrollin vizual në përputhje me paragrafin (2) mund të kryhet për një periudhë që nuk kalon 3 muaj pas kësaj date.

(b) Në vazhdim, një IBC i mbushur përpara datës të skadimit të afatit për testin periodik në përputhje me paragrafin (2) mund të kryhet, po të mos miratohet ndryshe nga autoritri kompetent, për një periudhë që nuk i kalon 6 muajt pas kësaj date, me qëllim që të lejojë kthimin e substancave të ADR për dispozicionin e duhur ose riciklimin. Kur substancat transportohen në IBCs me këto kushte, në dokumentin e transportit duhet të përfshihet formulimi që vijon “Transport në përputhje me anashkrimin 3663(3)(b)”.

(4) IBCs bosh, të papastruar, mund të transportohen pas datës të skadimit të kontrollit të tyre të fundit vizual, në përputhje me (2), për qëllime të kontrollimit.

(5) Çdo kontroll duhet të jetë subjekt i një raporti i cili duhet të ruhet nga pronari të pakten deri në datën e kontrollit të ardhshëm.

Në qoftë se karakteristikat strukturale të një IBC janë dobësuar prej një ndikimi të dhushëm (për shëmbull një aksident) ose shkak tjetër, IBC duhet të riparohet dhe ti nënshtrohet testit të hermetizimit në përputhje me anëshkrimin 3656, nëse ky është i kërkuar për tipin e projektuar, dhe kontrollit të përshkruar në paragrafin (1) më sipër.

3664-3699

Shtojca 7

DISPOZITAT NE LIDHJE ME MATERIALIN RADIOAKTIV TE KLASIT 7

Kjo Shtojcë përmban:

SEKSIONET:

- I AKTIVITETI DHE KUFINJTE E MATERIALIT TE NDASHEM
- II DISPOZITA PERGATITORE DHE KONTROLLET PER TRANSPORTIN DHE PER MAGAZINIMIN NE TRANZIT
- III DISPOZITA PER MATERIALIN RADIOAKTIV, PER PAKETIMIN DHE PAKETAT DHE PROCEDURAT E TESTIT
- IV APROVIMI DHE DISPOZITAT ADMINISTRATIVE
- V MATERIALI RADIOAKTIV QE KA VETI TE TJERA TE RREZIKSHME

Shtojca 7

AKTIVITETI DHE KUFINJTE E MATERIALIT TE NDASHEM

Vlerat themelore A1 dhe A2

Vlerat A1/A2 për radionuklidet janë dhënë në tabelën 1.

Tabela 1: Vlerat A1 dhe A2 për radionuklidet

Simboli i Radionuklidit	Elementi dhe Numri atomik	A1		A2	
		TBq	(Ci) (afërsi.1/)	TBq	(Ci) (afërsi.1/)
225 Ac ² / 227 Ac 228 Ac	Aktinium (89)	0.6 40 0.6	10 1 000 10	1 x 10 ⁻² 2 x 10 ⁻⁵ 0.4	2 x 10 ⁻¹ 5 x 10 ⁻⁴ 10
105 Ag 108 Agm 110 Agm 111 Ag	Argjend (47)	2 0.6 0.4 0.6	50 10 10 10	2 0.6 0.4 0.5	50 10 10 10
26 Al	Alumin (13)	0.4	10	0.4	10
241 Am 242 Amm 243 Am	Amerikium (95)	2 2 2	50 50 50	2 x 10 ⁻⁴ 2 x 10 ⁻⁴ 2 x 10 ⁻⁴	5 x 10 ⁻³ 5 x 10 ⁻³ 5 x 10 ⁻³
37 Ar 39 Ar 41 Ar 42 Ar	Argon (18)	40 20 0.6 0.2	1 000 500 10 5	40 20 0.6 0.2	1 000 500 10 5
72 As 73 As 74 As 76 As 77 As	Arsenik (33)	0.2 40 1 0.2 20	5 1 000 20 5 500	0.2 40 0.5 0.2 0.5	5 1 000 10 5 10
211 At	Astatin (85)	30	800	2	50
193 Au 194 Au 195 Au 196 Au 198 Au 199 Au	Ar (79)	6 1 10 2 3 10	100 20 200 50 80 200	6 1 10 2 0.5 0.9	100 20 200 50 10 20
131 Ba 133 Bam 133 Ba 140 Ba	Barium (56)	2 10 3 0.4	50 200 80 10	2 0.9 3 0.4	50 20 80 10
7 Be 10 Be	Berylium (4)	20 20	500 500	20 0.5	500 10

1/ Kuotat e vlerave të Ci janë marrë duke rrumbullakosur shifrat TBq pas kthimit në Ci. Kjo siguron që madhësia e A1 ose A2 në Ci është gjithnjë më e vogël se ajo në TBq.

2/ Vlerat e kufizuara të A1 dhe/ose A2 nga prishja e prodhimit si-motra .

Shtojca 7

3700

Tabela 1 (vazhdim)

Simboli i Radionuklidit	Elementi dhe Numri atomik	A1		A2	
		TBq	(Ci) (afërsi.1/)	TBq	(Ci) (afërsi.1/)
t					

205 Bi	Bismuth (83)	0.6	10	0.6	10
206 Bi		0.3	8	0.3	8
207 Bi		0.7	10	0.7	10
210 Bim 2/		0.3	8	3x10 ⁻²	8x10 ⁻¹
210 Bi		0.6	10	0.5	10
212 Bi 2/		0.3	8	0.3	8
247 Bk	Berkelium (97)	2	50	2x10 ⁻⁴	5x10 ⁻³
249 Bk		40	1 000	8x10 ⁻²	2
76 Br	Brominë (35)	0.3	8	0.3	8
77 Br		3	80	3	80
82 Br		0.4	10	0.4	10
11 C	Karbon (6)	1	20	0.5	10
14 Ca		40	1 000	2	50
41 Ca	Kalcium (20)	40	1 000	40	1 000
45 Ca		40	1 000	0.9	20
47 Ca		0.9	20	0.5	10
109 Cd	Kadmium (48)	40	1 000	1	20
113 Cdm		20	500	9x10 ⁻²	2
115 Cdm		0.3	8	0.3	8
115 Cd		4	100	0.5	10
139 Ce	Cerium (58)	6	100	6	100
141 Ce		10	200	0.5	10
143 Ce		0.6	10	0.5	10
144 Ce 2/		0.2	5	0.2	5
248 Cf	Kalifornium (98)	30	800	3x10 ⁻³	8x10 ⁻²
249 Cf		2	50	2x10 ⁻⁴	5x10 ⁻³
250 Cf		5	100	5x10 ⁻⁴	1x10 ⁻²
251 Cf		2	50	2x10 ⁻⁴	5x10 ⁻³
252 Cf		0.1	2	1x10 ⁻³	2x10 ⁻²
253 Cf		40	1 000	6x10 ⁻²	1
254 Cf		3x10 ⁻³	8x10 ⁻²	6x10 ⁻⁴	1x10 ⁻²
36 Cl		Klorinë (17)	20	500	0.5
38 Cl	0.2		5	0.2	5
240 Cm	Kurium (96)	40	1 000	2x10 ⁻²	5x10 ⁻¹
241 Cm		2	50	0.9	20
242 Cm		40	1 000	1x10 ⁻²	2x10 ⁻¹
243 Cm		3	80	3x10 ⁻⁴	8x10 ⁻³
244 Cm		4	100	4x10 ⁻⁴	1x10 ⁻²
245 Cm		2	50	2x10 ⁻⁴	5x10 ⁻³

- 1/ Kuotat e vlerave të Ci janë marrë duke rrumbullakosur shifrat TBq pas kthimit në Ci
Kjo siguron që madhësia e A1 ose A2 në Ci është gjithnjë më e vogël se ajo në TBq.
2/ Vlerat e kufizuara të A1 dhe/ose A2 nga prishja e prodhimit si-motra

Shtojca 7

3700

Tabela 1 (vazhdim)

Simboli i Radionuklidit	Elementi dhe Numri atomik	A1		A2	
		TBq	(Ci) (afërsi.1/)	TBq	(Ci) (afërsi.1/)
246 Cm		2	50	2 x 10 ⁻⁴	5 x 10 ⁻³
247 Cm		2	50	2 x 10 ⁻⁴	5 x 10 ⁻³
248 Cm		4 x 10 ⁻²	1	5 x 10 ⁻⁵	1 x 10 ⁻³

55 Co	Kobalt (27)	0.5	10	0.5	10
56 Co		0.3	8	0.3	8
57 Co		8	200	8	200
58 Com		40	1 000	40	1 000
58 Co		1	20	1	20
60 Co		0.4	10	0.4	10
51 Cr	Kromium (24)	30	800	30	800
129 Cs	Cesium (55)	4	100	4	100
131 Cs		40	1 000	40	1 000
132 Cs		1	20	1	20
134 Csm		40	1 000	9	200
134 Cs		0.6	10	0.5	10
135 Cs		40	1 000	0.9	20
136 Cs		0.5	10	0.5	10
137 Cs2/		2	50	0.5	10
64 Cu	Bakërr (29)	5	100	0.9	20
67 Cu		9	200	0.9	20
159 Dy	Dyprosium (66)	20	500	20	500
165 Dy		0.6	10	0.5	10
166 Dy2/		0.3	8	0.3	8
169 Er	Erbium (68)	40	1 000	0.9	20
171Er		0.6	10	0.5	10
147 Eu	Europium (63)	2	50	2	50
148 Eu		0.5	10	0.5	10
149 Eu		20	500	20	500
150 Eu		0.7	10	0.7	10
152 Eum		0.6	10	0.5	10
154 Eu		0.9	20	0.9	20
155 Eu		0.8	20	0.5	10
156 Eu		20	500	2	50
		0.6	10	0.5	10

1/ Kuotat e vlerave të Ci janë marrë duke rrumbullakosur shifrat TBq pas kthimit në Ci Kjo siguron që madhësia e A1 ose A2 në Ci është gjithnjë më e vogël se ajo në TBq.

2/ Vlerat e kufizuara të A1 dhe/ose A2 nga prishja e prodhimit si-motra

Shtojca 7

3700

Tabela 1 (vazhdim)

Simboli i Radionuklidit	Elementi dhe Numri atomik	A1		A2	
		TBq	(Ci) (afërsi.1/)	TBq	(Ci) (afërsi.1/)
18 F	Fluorinë (9)	1	20	0.5	10
52 Fe 2/	Hekur (26)	0.2	5	0.2	5
55 Fe		40	1 000	40	1 000
59 Fe		0.8	20	0.8	20
60 Fe		40	1 000	0.2	5
67 Ga	Galium (31)	6	100	6	100
68 Ga		0.3	8	0.3	8
72 Ga		0.4	10	0.4	10

146 Gd 2/ 148 Gd 153 Gd 159 Gd	Gadolinium (64)	0.4 3 10 4	10 80 200 100	0.4 3 x 10 ⁻⁴ 5 0.5	10 8 x 10 ⁻³ 100 10
68 Ge 2/ 71 Ge 77 Ge	Geranium (32)	0.3 40 0.3	8 1 000 8	0.3 40 0.3	8 1 000 8
3719 (1) Përpara dërgesës së parë të çdo pakete kërkohet aprovimi i autoriteteve kompetentë, dërguesi i mallit duhet të sigurojë që kopje të çdo çertifikate të zbatueshme të autoriteteve kompetentë që i takon paketës së përcaktuar është dërguar tek autoriteti kompetent i çdo vëndi nëpër ose në të cilin ngarkesa do të transportohet. Dërguesit të mallit nuk i kërkohet të presi një dëftesë nga autoriteti kompetent, si dhe autoritetit kompetent nuk i kërkohet të bëjë një dëftesë të tillë të faturës së çertifikatës.

11/ Nqs mesatarja e TI nuk është më e madhe se 005, vlera e kuotës mund të jetë zero në lidhje me ansoren 3715(1)(c)

(2) Për çdo dërgesë të listuar më poshtë në (a), (b) ose (c), dërguesi i mallit duhet të njoftojë autoritetin kompetent të çdo vëndi nëpër, ose në të cilin do të transportohet ngarkesa. Ky informacion duhet të jetë në duart e çdo autoriteti kompetent përpara nisjes së dërgesës, dhe është e preferueshme të paktën 7 ditë në avancë.

Paketa tip B(U) që përmban material radioaktiv me një aktivitet më të madh se $3 \times 10^3 A1$, ose

3x 103 A2, si i përshtatshëm, ose 1000 TBq (20 kCi), e cila është më e ulët;
Paketa tip B(M);

Transport me marrveshje të vecantë.

(3) Informacioni i ngarkesës duhet të përfshijë:

Informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur identifikimin e paketës përfshirë, të gjithë numrat e certifikatës zbatuese dhe shenjat identifikuese;

Informacin mbi datën e dërgimit, datën e pritshme të mbërritjes dhe itinerarin e propozuar,
Emrin e materialit radioaktiv ose nuklidit,

Një përshkrim të formës fizike ose kimike të materialit radioaktiv, dhe nëse ai është një material radioaktiv i formës speciale, dhe

Aktivitetin maksimal të përmbajtjes radioaktive gjatë transportit të shprehur në njësitë e beckerel (Bq) (dhe, nëse dëshirohet, curie (Ci) me prefixin e duhur SI shiko anëshënimet 2001 (1). Për materialet e ndashëm, masa totale e materialit të ndashëm në gram (g), ose shumfishtë të saj, mund të përdoret në vënd të aktivitetit.

(4) Dërguesit të mallit nuk i kërkohet të dërgojë një shënim të veçantë, në qoftë se informacioni i kërkuar ka qënë i përfshirë në aplikimin për aprovimin e dërgimit. [Shiko anëshënimet 3757 (3)].

Zotërimi i certifikatave dhe instruksionet operative.

Dërguesi i mallit duhet të zotërojë një kopje të çdo certifikate kërkuar sipas Seksionit III të kësaj shtojce, dhe një kopje të instruksionit në lidhje me mbylljen e duhur të paketës dhe përgatitje të tjera për ngarkesën përpara transportimit sipas termave të certifikatës.

3720-3729

Shtojca 7

SEKSIONI III

DISPOZITA PER MATERIALET RADIOAKTIVE, PER PAKETIMET DHE PAKETAT DHE PROCEDURAT E PROVES.

SHENIM: Dispozitat në SEKSIONIN III janë të njëjta si ato të përshkruara në Botimin e vitit 1985 nga IAEA Regulations për transportin e sigurtë të materialit radioaktiv (i përmirësuar në 1990). Numrat e paragrafëve të përmendur në anëshkrimet 3730 deri 3742 janë numrat e paragrafëve të aplikueshëm të Botimit të vitit 1985.

3730 Dispozita për materialin LSA-III.
paragrafi 501.

3731 Dispozita për materiale radioaktive të formës speciale.
paragrafet 502 – 504.

3732 Dispozita të përgjithshme për të gjitha paketimet dhe paketat.
paragrafet 505 – 514.

3733 Dispozita për paketimet industriale tip I (IP-I).
paragrafi 518.

3734 Dispozita shtesë për paketimet industriale tipi 2 (IP-2).
paragrafi 519.

3735 Dispozita shtesë për paketimet industriale tipi 3 (IP-3).
paragrafi 520.

3736 Dispozita alternativë për botët dhe kontenierët për tu kualifikuar si IP-2 dhe IP-3.
paragrafët 521 – 523.

3737 Dispozita për paketimet e tipit A.
paragrafët 524 – 540.

3738 Dispozita për paketimet e tipit B.
paragrafët 541 – 548.

3739 Dispozita për paketimet e tipit B(U).
paragrafët 549 – 556.

3740 Dispozita për paketimet e tipit B(M).

- paragrafët 557 – 558.
3741 Dispozita për paketimet që përmbajnë material të ndashëm.
paragrafët 559 – 568.
3742 Proçedurat e provës.
paragrafët 601 – 633.

3743-3749

Shtojca 7

SEKSIONI IV.

DISPOZITAT APROVUESE DHE MIRATUESE.

SHENIM: Kur dispozitat në SEKSIONIN IV janë të njëjta me ato të përshkruara në Botimin e vitit 1985 të IAEA Regulations për Transportin e e Sigurtë të materialeve radioaktivë (i përmirësuar në 1990) numrat e përmendur nën anëshkrimet 3761 deri 3764 janë numrat e paragrafëve të aplikueshëm të Botimit të vitit 1985.

Të përgjithshme.

3750 Aprovimi i autoritetit kompetent duhet të kërkohet për sa vijon:

material radioaktiv të formës speciale (shiko anëshkrimet 3751);

Të gjithë paketat që përmbajnë material të ndashëm (shiko anëshkrimet 3754 dhe 3755);

Paketat Tipi B – Tipi B(U) dhe Tipi B(M) (shiko anëshkrimet 3752, 3753 dhe 3755);

Marrveshjet speciale (shiko anëshkrimet 3758);

Transporte të caktuara (shiko anëshkrimet 3755);

Llogaritja e vlerave A1 dhe A2 të palistuara [shiko anëshkrimet 3701 (1)].

Aprovimi i materialit të formës speciale.

3751 (1) Projekti për materialin radioaktiv i formës speciale do të kërkojë aprovim të njëanshëm. Një aplikim për aprovim duhet të përfshijë:

Një përshkrim të detajuar të materialit radioaktiv ose, nëse përmbajtja është një kapsulë; adresim i vecantë duhet të bëhet për të dyja gjëndjet, fizike dhe kimike;

Një ekspozim i detajuar i skicës të çdo kapsule që do të përdoret;

Një paraqitje e provave që janë bërë dhe rezultatet e tyre, ose evidenca e bazuar në metodat llogaritëse, për të treguar që materiali radioaktiv është në gjëndje të ketë normat përfundimtare, ose evidencë tjetër që materiali radioaktiv i formës speciale i përmbahet dispozitave të zbatueshme të kësaj Shtojce;

Evidencën e një programi të sigurisë të cilësisë.

(2) Autoriteti kompetent duhet të botojë një çertifikatë miratimi duke shpallur që projekti i aprovuar përmbush dispozitat për materialin radioaktiv të formës speciale, dhe duhet të shënojë në këtë projekt një shenjë identifikuese. Çertifikata duhet të specifikojë detajet e materialit radioaktiv të formës speciale.

Aprovimi i projekteve të paketës.

Aprovimi i projekteve të paketës Tip B(U).

3752 (1) Çdo projekt i paketës Tip B(U), i krijuar në një vënd palë e ADR, duhet të aprovohet nga autoriteti kompetent i këtij vëndi; Nëse vëndi, ku paketa është projektuar, nuk është palë në ADR, transporti është i mundur me kusht që:

është pajisur më një çertifikatë nga ky vënd, duke provuar që paketa kënaq dispozitat teknike të ADR, dhe që kjo çertifikatë është firmosur për së dyti nga autoriteti kompetent i vëndit të parë të arritur nga ngarkesa; që është palë në ADR, ;

Nëse nuk është pajisur me çertifikatë, projekti i paketës aprovohet nga autoriteti kompetent i vëndit të parë ADR të arritur nga ngarkesa.

Çdo projekt i paketës Tip B(U) për materialet e ndashëm, i cili është gjithashtu me kusht në anëshkrimet 3741 duhet të kërkojë aprovim të shumanshëm.

(2) Një aplikim për aprovim duhet të përmbajë:

Një përshkrim të detajuar të përmbajtjes radioaktive të propozuar me reference të veçantë të gjëndjes së tyre fizike dhe kimike dhe natyrës të rrezatimit të emetuar;

Një paraqitje të detajuar të projektit, përfshirë komplet vizatimet inxhinierike dhe listën e materialeve dhe metodave të ndërtimit që duhen përdorur;

Një paraqitje të testeve që janë bërë dhe rezultatet e tyre, ose evidenca të bazuara në metoda llogaritëse, ose evidencë tjetër që projekti është i përshtatshëm të përmbushë dispozitat e zbatueshme;

Instuksionin e propozuar të funksionimit dhe të mirmbajtjes për përdorimin e paketimit;

Nëse paketa është projektuar që të ketë një presion punë normal maksimal që i kalon 100 kPa (1.0 bar), aplikimi për aprovim duhet, në veçanti, të konstatojë, në lidhje me materialin e konstruksionit të sistemit të ndotjes, specifikimet, kampionët që do merren, dhe testet që do bëhen;

Kur përmbajtjet radioaktive të propozuara janë karburant ndezës, aplikimi duhet të konstatojë dhe arsyetojë çdo rast të marrë në analizat e sigurisë në lidhje me karakteristikat e karburantit;

Përgatitet ndonjë depozitë speciale e nevojshme për të siguruar shpërndarjen e sigurtë të nxehtësisë nga paketa; vëmendje duhet të kushtohet mënyrave të ndryshme të transportit që do përdoren dhe tipit të automjetit ose kontenerit;

Një ilustrim i rikopjuar jo më i madh se 21 cm x 30 cm duke treguar strukturën e paketës, dhe Evidenca e një programi të sigurisë të cilësisë.

(3) Autoriteti kompetent duhet të botojë një certifikatë aprovimi duke konstatuar që projekti përmbush dispozitat për paketën Tip B(U).

Aprovimi i projekteve të paketës Tip B(M).

3753 (1) Çdo projekt paketë Tip B(M), përfshirë ato për material të ndashëm të cilët janë gjithashtu me kusht në anëshkrimet 3754 duhet të kërkojë aprovim të shumanshëm.

(2) Një aplikim për aprovimin e projektit të një pakete Tip B(M) duhet të përfshijë, në vazhdim të informacionit të kërkuar në anëshkrimet 3752 (2) për paketat Tip B(U):

Një listë të dispozitave specifike për paketat Tip B(U) të specifikuara në anëshkrimet 3738 dhe 3739 me të cilat paketa nuk ;

Çdo kontroll operativ suplementar të propozuar për tu zbatuar gjatë transportit jo sipas atyre të dhëna në mënyrë të përgjithshme në këtë Shtojcë, por ato, që janë të nevojshëm për të siguruar parrezikshmerinë e paketës, ose të kompesimit të mangësive të listuara më lart, si ndërhyrjen e njeriut për matjet e temperaturës, ose të presionit, ose për erërat periodike, duke marrë parasysh mundësinë e vonësive të paparashikuara;

Përrjashtimet e çdo kufizimi në mënyrën e transportit dhe ndonjë ngarkimi të veçantë, transportimi, shkarkimi, ose procedura të manovrimit, dhe

Kushtet maksimale dhe minimale të ambientit (temperatura, rrezatimi diellor) që priten të merren parasysh gjatë transportit dhe që janë marrë parasysh në projekt.

(3) Autoriteti kompetent duhet të japë një certifikatë aprovimi duke konstatuar që projekti përmbush dispozitat e zbatueshme për paketat Tip B(M).

Aprovimi i projekteve të paketave për materiale të ndashme.

3754 (1) Çdo projektpaketë për materiale të ndashme kërkon një aprovim të shumëanëshëm.

(2) Një aplikim për aprovim duhet të përfshijë të gjithë informacionin e nevojshëm për të kënaqur Autoritetet kompetentë, që projekti përmbush dispozitat e anëshkrimit 3741 dhe evidencën e programit të sigurisë cilësore.

(3) Autoriteti kompetent duhet të nxjerrë një certifikatë aprovimi duke konstatuar që, projekti përmbush dispozitat e zbatueshme në anëshkrimin 3741.

Marrëveshjet për tranzitim.

3755 Paketat Tip B(U) dhe Tip B(M), dhe paketimet që përmbajnë material të ndashëm, të cilat nuk mbushen në përputhje me dispozitat e kësaj Shtojce, por të cilat me gjithë këtë mund të përdoren në përputhje me dispozitat e ADR të aplikueshme me 31 Dhjetor 1989 për materialin korespondues të Klasit të 7, mund akoma të përdoren sipas kushteve që vijojnë për transportin e këtij materiali:

(a) Aprovimi i shumëanshëm duhet të kërkohej me skadimin e aprovimit të një anëshëm , dhe

(b) Një numër serial në përputhje me dispozitat e anëshkrimit 2705 (3) duhet të firmoset dhe të shënohet në anën e jashtme të çdo paketimi.

Ndryshime në projektin e paketimit ,ose në natyrën, ose në sasinë e përmbajtjes radioaktive të autorizuar, e cila , sikurse përcaktohet nga autoritetet kompetente, do të veprojnë dukshëm në

sigurinë ,duhet të përmbushin dispozitat e kësaj shtojce.

Shënimi dhe regjistrimi i numrave serial.

3756 Autoriteti kompetent i vëndit të origjinës të projektit të aprovuar, duhet të informohet prej numrave serial të çdo paketimi të prodhuar, të një projekti të aprovuar sipas anëshkrimeve 3752,3753(1), 3754(1) dhe 3755. Autoriteti kompetent duhet të mbajë një regjistër të këtyre numrave serial.

Shtojca 7

Aprovimi i dërgesave.

3757 (1)Me përjashtim të atyre që lejohen në paragrafin (2) më poshtë, aprovimi i shumëanshëm duhet të kërkohet për :

(a) Dërgesa e paketave Tip B(M) veçanërisht e projektuar për lejimin e pauzave të kontrolluara të erës.

(b) Dërgesat e paketave të Tip B(M) që përmbajnë materiale radioaktivë me një aktivitet më të madh se 3×10^3 A1 ose 3×10^3 A2 , si i përshtatshëm , ose 1000 TBq (20kCi), i cili është më i ulët.

(c) Dërgesa e paketave që përmbajnë material të ndashëm, në se shuma e indekseve të transportit të paketave individuale i kalon 50 sikurse jepet në anëshkrimin 2712(4).

(2) Një autoritet kompetent mund të autorizojë transportin për futjen ose kalimin nëpër vëndin e tij (transit) pa dërgesë të aprovuar , me anë të dispozitës specifike në projektin e saj të aprovuar (Shiko anëshkrimin 3759).

(3) Një aplikim për aprovim dërgese duhet të përfshijë:

Përiudhën e kohës ,lidhur me dërgesën për të cilën është kërkuar aprovimi

Përmbajtja radioaktive aktuale ,mënyrat e parashikuara të transportit ,llojin e automjetit dhe rruga e propozuar ose e mundëshme ,dhe

Detajet se si masa paraprake specilae dhe kontrollet operationale ose administrative speciale, referuar sipas çertifikatës se aprovuar të projektit të paketës të botuar sipas anëshkrimeve 3752(3), 3753(3) dhe 3754(3) duhet të hyjnë në veprim (Fuqi)

(4) Në aprovimin e dërgesës autoriteti kompetent duhet të nxjerrë një çertifikatë aprovimi.

Aprovimi i dërgesës sipas marrëveshjeve speciale .

3758 (1) Çdo dërgesë e transportuar sipas kushteve speciale duhet të kërkojë një aprovim të shumëanshëm.

(2) Një aplikim për aprovim të një dërgese me kushte speciale, duhet të përfshijë të gjithë informacionin e nevojshëm për të bindur autoritetin kompetent që niveli i përgjithshëm i sigurisë në transport është të paktën ekujalent, me atë që duhet të parashikohej, në se të gjitha dispozitat e aplikueshme të kësaj shtojce janë përmbushur.Aplikimi duhet të përfshijë :

(a) Një gjëndje të kushteve në të cilën, dhe të arsyeve përse ,dërgesa nuk mund të bëhet në përputhje të plotë me dispozitat e zbatueshme të kësaj shtojce , dhe,

(b) Një gjëndje të çdo mase paraprake speciale ose kontrollove operationale ose administrative speciale, të cilat duhet të zbatohen gjatë transportit për të kompensuar mos suksesin për të përmbushur dispozitat e aplikueshme të kësaj shtojce.

(3) Në aprovimin e një dërgese me marrëveshje speciale, autoriteti kompetent duhet të nxjere një çertifikatë aprovimi.

Çertifikatat e aprovuara nga autoritetet kompetente .

3759 Mund të nxiren 4 tipe të çertifikatave të aprovuara: Material radioaktivë të formës speciale, marreveshje speciale, projekti i paketës dhe i dërgesës. Çertifikata e aprovuar e projektit të paketës dhe të dërgesës mund të kombinohen në nje çertificatë të vetme.

Shtojca 7

Shenjat identifikuese të Autoritetit Kompetent.

3760 (1) Çdo çertifikatë aprovuese e nxjerë nga Autoriteti kompetent duhet të firmoset me një shenjë identifikuese. Shenja duhet të jetë e tipit të përgjithshuar si vijon:

Simboli i Kombësisë të vëndit / Numuri / Tipi i kodit

(a) Simboli i Kombësisë paraqet shenjën dalluse për automjetet në trafikun ndërkombëtar në Konventën e Vjenës mbi Trafikun Rrugor (1968).

(b) Numuri duhet të firmoset nga Autoriteti Kompetent, dhe duhet të jetë unik dhe specifik. Në lidhje me projektin ose dërgesën e veçantë. Shenja identifikuese e aprovuar e dërgesës duhet të përshtatet qartë me shenjën identifikuese të aprovuar të projektit.

(c) Tipet e Kodeve që vijojnë duhet të përdoren sipas rregullit të dhënë në listë për të treguar tipet e certifikatave aprovuese të nxjerra:

- AF për projekte paketash tip A për materiale të ndashme .
- B(U) projekt paketë tip B(U) ; B(U)F në qoftë se është material i ndashëm .
- B(M) Projekt paketë tip B(M); B(M)F Në qoftë se është material i ndashëm .
- IF Projekt paketë industriale për materiale të ndashëm
- T Dërgesë .
- X Marrëveshje speciale.

Për certifikata aprovuese të projektit të paketës, ndryshe nga ato të nxjerra sipas dispozitave të anëshkrimit 3755, simboli “-85” 12 / duhet të shtohet tek tipi i kodit të projektit të paketës.

(2) Këto tipe kodesh duhet të zbatohen si vijon:

Çdo certifikatë dhe çdo paketë duhet të mbajnë shenjën identifikuese të përshtatshme, përfshirë simbolet e përkthyer në paragrafin (1) më lartë, me përjashtim që, për paketat, që përfshijnë vetëm tipin e kodeve të projekteve të zbatuar, në qoftë se është e mundshme, simboli “-85” 13/ duhet të tregojë veprimin e dytë vijuese, domethënë, “T” ose “X” nuk duhet të tregohet në shënimin identifikues mbi paketë. Kur aprovimi i projektit dhe aprovimi i dërgesës kombinohen, tipi i kodeve të aplikushme nuk është e nevojshme që të përsëritet. Për shëmbull:

Shtojca 7

A/132B(M)F-85: Një projekt paketë Tip B(M) i aprovuar për material të ndashëm, që kërkon aprovim të shumanshëm, për të cilin autoriteti kompetent i Austrisë ka caktuar numrin e projektit 132 (për tu shënuar në të dy paketat dhe në certifikatën aprovuese të projektit të paketës);

A/132/B(M)F-85T: Aprovimi i paketës i nxjerrë për një paketë që mban shenjën identifikuese të caktuar më lart (për tu shënuar vetëm në certifikatë);

A/137/X-85 Aprovimi i një marrëveshje të veçantë i nxjerrë nga autoriteti kompetent i Austrisë, Në të cilin është caktuar numri 137 (për tu shënuar vetëm në certifikatë);

A/139/IF-85: Projekti i një pakete industriale për material të ndashëm i aprovuar nga autoriteti kompetent i Austrisë, në të cilin është shënuar numri i projektit të paketës 139 (për tu shënuar në të dyja, edhe në paketë edhe në certifikatën aprovuese të projektit të paketës).

Kur aprovimi i shumanshëm është i vlefshëm, duhet të përdoret vetëm shenja identifikuese e nxjerre nga vendi i origjinës të projektit ose dërgesës. Kur aprovimi i shumanshëm vepron me anë të certifikatave të nxjerra nga vendet që vijojnë, çdo certifikatë duhet të mbajë shenjën e duhur dhe paketa projekti i të cilës ishte i aprovuar duhet të mbajë të gjitha shenjat identifikuese të duhura. Për shëmbull:

A/132/B(M)F-85

CH/28/B(M)F-85

do të ishte shenja identifikuese e një pakete e cila ishte fillimisht e aprovuar nga Austria dhe ishte e aprovuar më pas, me certifikata të veçanta, nga Zvicra. Shenja identifikuese shtesë duhet paraqitur në një mënyrë të ngjashme në paketë.

rishikimi i një certifikate duhet të tregohet nga një shprehje në kllapa që vijon shenjën identifikuese në certifikatë. Për shëmbull, A/132/B(M)F-85 (Rishik.2) do të tregonte rishikimin 2 të certifikatës aprovuese të projektit të paketës Austriake; ose A/132/B(M)F-85 (Rishik. 0) do të tregonte botimin origjinal të certifikatës aprovuese të projektit të paketës Austriake. Për botimet origjinale, futja e kllapave është fakultative dhe fjalet e tjera si “Botim Origjinal” mund të përdoret gjithashtu në vend të “Rishik. 0”. Numrat e certifikatave të rishikuara mund të përdoren vetëm nga vendi nxjerres i certifikatës aprovuese origjinale.

Simbole shtesë (sikurse mund të nevojiten nga kërkesat kombëtare) mund të shtohen të mbyllura në kllapa në fund të shenjës identifikuese; për shëmbull, A/132/B(M)F-85 (SP503).

Nuk është e nevojshme të ndryshojmë shenjë identifikuese në paketim në çdo kohë që bëhet një rishikim në projektin e certifikatës. Ri-shënime të tilla duhet të bëhen vetëm në ato raste kur rishikimi në certifikatën e projektit të paketës përfshin një ndryshim në gjermën e kodeve të tipit të projektit të paketës që pasohet me veprimin e dytë.

Shtojca 7

Përmbajtja e certifikatës aprovuese.

(shiko shënimin e hyrjes në këtë seksion)

3761 Çertifikatat aprovuese të materialeve radioaktive të formës speciale

Paragrafi 726.

3762 Çertifikatat aprovuese të marrveshjeve speciale

Paragrafi 727.

3763 Çertifikatat aprovuese të dërgesës

Paragrafi 728.

3764 Çertifikatat aprovuese të projektit të paketës.

Paragrafi 729.

Miratimi i certifikatave.

3765 Aprovimi i shumëanshëm mund të bëhet me anë të miratimit të certifikatës origjinale, të nxjerrë nga autoriteti kompetent i vëndit të origjinës të projektit ose të dërgesës.

Një miratim i tillë mund të marri formën e një nënshkrimi në certifikatën origjinale ose nxjerrjen e një miratimi të veçantë, shtojce apo aneksi, etj., nga autoriteti kompetent i vëndit nga ,ose nëpërmjet të cilit bëhet dërgesa.

Dispozita të përgjithshme për programin e sigurisë cilësore.

3766 Programet e sigurisë cilësore duhet të vendosen për projektin, prodhimin, testimin, dokumentimin, përdorimin, mirmbajtjen dhe inspektimin e të gjitha paketave dhe për transportin dhe veprimet e magazinimit jo-kalimtar për të siguruar përputhjen me dispozitat e përshtatshme të kësaj Shtojce. Kur kërkohet aprovimi i autoritetit kompetent për projektin ose dërgesën, një aprovim i tillë duhet të marri parasysh dhe të jetë pjesë në kompetencën e programit të sigurimit të cilësisë. Çertifikata, që kushtet teknike të projektit janë zbatuar plotësisht duhet të jetë e disponueshme për autoritetin kompetent. Prodhuesi, dorzuesi, ose përdoruesi i ndonjë projekti paketë, duhet të jetë i përgatitur të japi lehtësira për kontrollin paketimit nga autoritetet kompetente gjatë ndërtimit dhe përdorimit dhe të tregojë tek çdo autoritet kompetent që:

(a) Metodot e ndërtimit dhe materialet e përdorura për konstruksionin e paketimit janë në përputhje me kushtet teknike të projektit të aprovuar, dhe

Të gjitha paketimet të prodhuara sipas një projekti të aprovuar janë të kontrolluara periodikisht dhe, sikurse kërkohet, të riparuar dhe të mirëmbajtura në kushte të mira, kështu që ato vazhdojnë të pajtohen me të gjitha dispozitat dhe kushtet teknike të duhura, edhe pas përdorimit të përsëritur.

3767-3769

Shtojca 7

SEKSIONI V.

MATERIAL RADIOAKTIV QE KA TE BEJE ME VETI TE TJERA TE RREZIKSHME.

3770 (1) Materiali radioaktiv që ka të bëjë me veti të tjera të rrezikshme duhet të paktohet:

Në përputhje me dispozitat për Klasin e 7, dhe

po të mos transportohen si paketa Tip A ose Tip B, gjithashtu në përputhje me dispozitat e klasit të duhur.

(2) Materiali radioaktiv piroforik duhet të paktohet në paketa Tip A ose Tip B dhe duhet gjithashtu të jetë përshtatshëm inert.

(3) Për material radioaktiv në paketa të veçanta që kanë të bëjnë me veti të tjera të

rrezikshme, shiko anëshkrimet 2002 (12) dhe (13).

(4) Paketimet për hexafluoride uraniumi duhet të projektohen, ndërtohen dhe përdoren në përputhje me dispozitat e anëshkrimit 3771.

Dispozita për paketimin dhe transportin e hexafluoridit të uraniumit.

3771 (1) Paketimet për hexafluoridin e uraniumit duhet të projektohen si enë me presion dhe të prodhohen nga një çelik me karbon i përshtatshëm, ose lidhje tjetër çeliku të përshtatshëm.

(2) (a) Paketimet dhe paisja e tretë e shërbimit duhet të projektohet për temperatura pune të paktën prej – 400C deri në 121 0C dhe presion pune prej 1,4 Mpa (14 bar).

(b) Paketimet, paisja e tyre strukturore dhe e shërbimit, duhet të projektohen në mënyre të tillë që të ndalojnë çdo rrjedhje ose deformim të përhershëm kur ato ndodhen për pesë minuta nën një provë të presionit hidraulik prej 2.8 Mpa (28 bar).

Paketimet dhe paisja e tyre strukturore (në qoftë se kjo është e ngjitur përgjithmonë tek paketimi) duhet të projektohen në mënyrë të tillë që ti rezistojnë një presioni të jashtëm standart prej 150 kPa (1.5 bar) pa deformim të përhershëm.

(d) Paketimet dhe paisjet e tyre të shërbimit duhet të projektohen që të mbeten hermetikë kështu që kufizimi i specifikuar në paragrafin (4) (f) është i kontrollueshëm.

(e) Valvolat e stabilizimit të presionit nuk janë të lejueshme dhe numri i hapjeve duhet të jetë sa më i vogël të jetë e mundur.

(f) Paketimet me kapacitet për më shumë 450 l dhe paisjet e tyre të shërbimit dhe strukturore (në qoftë se është e ngjitur për gjithmonë tek paketimi) duhet të projektohen që të mbeten hermetike kur ato i nështrohen testit të rrjedhjes të specifikuar në anëshkrimin 3742.

(3) Pas prodhimit, pjesët e brëndëshme të pjesëve të mbajtjes së presionit duhet të pastrohen krejtësisht nga graso, smërçi, vaji, skorjet dhe lëndë të tjera të huaja me anë të nje procedure të përshtatshme.

(4) (a) Çdo paketim i prodhuar dhe shërbimi i tij dhe paisjeve të tij strukturore, duhet ,ose së bashku ose veç e veç, të kalojnë një kontroll fillimisht përpara vënies në shërbim dhe pas kësaj periodikisht. Këto kontrole duhet të kryhen dhe çertifikohen me marreveshje me autoritetin kompetent.

(b) Kontrolli fillestar duhet të konsistojë në kontrollin e karakteristikave të projektit, testi i forcës, testi i hermetizimit, testi kapacitetit të ujit dhe një kontroll i veprimit të pranueshëm të paisjes së shërbimit .

(c) Kontrollat periodike duhet të konsistojnë në një kontroll vizual, testi i forcës, testi i hermetizimit dhe një kontroll i veprimit të pranueshëm të paisjes së shërbimit. Intervali për kontrollat periodike nuk duhet të jetë më shumë se 5 vjet. Paketimet të cilat nuk kanë qënë kontrolluar brënda kësaj periudhe 5 vjecare duhet të egzaminohen përpara transportit në përputhje me një program të aprovuar nga autoriteti kompetent, ato nuk duhet të jenë të rimbushura përpara përfundimit të programit të plotë për kontrollat periodike.

Kontrolli i karakteristikave të projektit duhet të tregojë përputhje me specifikimet e projektit tip dhe programit të prodhimit.

(e) Testi i forcës përpara vënies për here të parë në shërbim duhet të kryhet me anë të mjeteve të nje testi hidraulik me nje presion të brëndeshm 2,8 Mpa (28bar), për kontrollat periodike mund të zbatohet ndonjë procedure tjetër egzaminimi ekuivalente jo shkatërruese, e njohur nga autoriteti kompetent.

(f) testi i hermetizimit duhet të kryhet në përputhje me një procedurë e cila është e aftë të tregojë rrjedhjet në sistemin e ndojtjes me një ndjeshmëri 0,1 Pa.l/s (10-6 bar.l/s).

(g) Kapaciteti i ujit i paketimeve duhet të vendoset me nje saktësi prej +_ 0,25% në nje tempërate referuese prej 15°C. Vëllimi duhet të jetë vendosur mbi pllakën e përshkruar në paragrafin (6.)

(5)Me përjashtim të paketimeve për më pak se 10 kg Heksafluoride Uraniumi autoriteti kompetent e vendit të origjinës(prodhimit) duhet, për çdo tip projekti të paketës të heksafluoridit të Uraniumit , të konfirmojë që ajo përputhet me dispozitat e ketij anëshkrimi dhe të nxjerë një aprovim. Ky aprovim mund të jetë pjese e aprvimit për paketat tip B dhe / ose për nje paketë me përmbajtje të mundshme në përputhje me seksionin IV të kësaj shtojce.

Pllaka e bërë prej metali jo korrodive duhet të ngjitet për nje kohe të gjatë në çdo paketim në

një vënd të dukshëm të pranueshëm. Metoda e ngjitjes së pllakës nuk duhet të dëmtojë fortësinë e paketimit. Veçoritë që vijojnë, të paktën, duhet të shënohen në pllakë me anë të stampimit ose me ndonjë metodë tjetër ekuivalente.

- Numri aprovues;

Numri serial i prodhimit;

Presioni maksimal i punës (presioni etalon) 1,4 Mpa (14 bar);

Presioni i provës (presioni etalon) 2,8 Mpa (28 bar);

Përmbajtjet: Heksafluoride Uraniumi;

Kapaciteti në litra;

Masa maksimale e lejueshme e mbushjes e Heksafluoridit të uraniumit;

Masa e tarës (ambalazhit).

Data (muaji, viti) e testit fillestar dhe e testit periodik më të fundit;

Stampa e ekspertit që kreu testin;

(7) (a) Heksafluoridi i uraniumit duhet të jetë në formë solide (të ngurtë) kur transportohet;

(b) Shkalla e mbushjes duhet të jetë e tillë që vetëm kapaciteti të mos jetë më shumë se 95% i mbushur në 121 °C.

(c) Pastrimi i paketimit duhet të kryhet vetëm me një procedurë të përshtatshme.

(d) Kryerja e riparimeve është e lejueshme vetëm në përputhje me projektin dhe programin e prodhimit të paraqitur me shkrim. Programet e riparimit kërkojnë aprovimin paraprak të autoritetit kompetent.

(e) Paketimet boshe të papastruara duhet të jenë aq fort të mbyllura gjatë transportimit dhe magazinimit të ndërmjetëm, po aq sa dhe kur janë të mbushura.

(f) Për mirëmbajtjen, duhet të vepohet me një program të aprovuar nga autoriteti kompetent.

(8) Paketime të ndërtuara në përputhje me standartin e Shteteve të Bashkuara ANSI N/14.1 – 1982 14/, ose ekuivalent, mund të përdoren me miratimin e autoritetit kompetent përgjegjës, në qoftë se testet e specifikuar në këto standarte janë kryer nga ekspertë të emëruar aty dhe vazhdojnë të kryhen dhe të çertifikoohen me marrëveshje me autoritetet kompetente në përputhje me paragrafin (4) (c).

3772-3799

Shënim: 14/ ANSI N 14.1 –1982 botuar më 1982 dhe i arritur nga Instituti Amerikan Kombëtar I standarteve, 10430 Broadway, New York, NY 10018.

SHTOJCA A.8

3800-3899 I Rezervuar

Shtojca 9

Dispozitat në lidhje me tabelat e rrezikshmërisë.

SHENIM: Për paketimet shiko gjithashtu anëshkrimin 2007

3900 (1) Tabelat Nr. 1, 1.4, 1.5, 1.6, 01, 2, 3, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 5.2, 05, 6.1, 6.2, 7A, 7B, 7C, 8 dhe 9 duhet të jenë në forme rombi dhe me madhësi të paktën 100 x 100 mm. Ato kanë një vijë të njëjtës ngjyrë si simboli i paraqitur në tabelë 5 mm brënda kulmit dhe që kalon paralel me të. Nëse madhësia e paketimit kërkohet në varësi të saj, kështu dimensionet e tabelës mund të zvoglohen, duke siguruar që ato mbeten qartazi të dukshme [shiko gjithashtu anëshkrimin 2224 (3)]. Tabela Nr. 7D dhe tabela të tjera për tu fiksuar tek automjetet, tek cisternat, më të mëdhaja se 3 m³ ose tek kontenierët e mëdhenj duhet të jenë të madhësisë jo më pak se 250 x 250 mm.

(2) Tabela nr.11 duhet të jetë drejtkëndore, të formatit standartA5 (148 x 210 mm). Nëse madhësia e paketimit varet nga tabela, kështu dimensionet e tabelës mund të zvoglohen, duke siguruar që ato mbeten qartazi të dukshme.

(3) Një mbishkrim, në numra ose gërma, në lidhje me natyrën e rrezikut mund të vendoset në pjesën më të ulët të tabelës.

(4) Formulimi në tabelat e rrezikshmërisë duhet të jenë të lexueshme qartë dhe të paheqshme.

3901 (1) Tabelat e rrezikshmërisë duhet të ngulen në paketim dhe në cisternat, e

fiksuara në një mënyrë të përshtatshme dhe të jenë të dukshme në mënyrë të qartë. Vetëm kur gjëndja e jashtme e një pakete nuk lejon këtë, tabelat duhet të jenë ngjitur në letra ose tableta të ngjitura në mënyrë të sigurtë në paketim. Shenja të rrezikshmërisë të paheqshme që i korespondojnë ekzaktësisht modeleve të përshkruara, mund të përdoren në vënd të tabelave.

Eshtë detyra e dorzuesit të montojë tabelat.

Në vazhdim të tabelave të rrezikshmërisë të përshkruara sipas ADR, tabelat e rrezikshmërisë në përputhje me kërkesat e mënyrave të tjera të transportit (sikurse tregohet në Kodin IMDG ose Instruksionet Teknike ICAO) mund të montohen tek paketimet, konteneret, çisterna-kontenierë dhe bateri-automjetesh që përmbajnë mallra të rrezikshëm të cilët transportohen për pjesë të udhëtimit nëpërmjet rrugës dhe të cilët duhet të pajisen me tabelë në përputhje me dispozitat e këtyre kërkesave.

2. Shpjegimi i simboleve.

3902 Tabelat e rrezikshmërisë përshkruese të lëndëve dhe artikujve të Klasave 1 deri në 9 (shiko pllakat në fund) kanë kuptimet që vijojnë:

Nr.1	(të zeza në sfond portokalli: shpërthim bombë në gjysmën e sipërme; numër ndarës të përshtatshëm dhe grup gjermash të pajtueshme të përshtatshme në gjysmën e poshtme; numrin 1 të vogël në fund të qoshes):	i rrezikuar nga eksplozionet, ndarjet 1.1, 1.2 dhe 1.3;
Nr. 1.4	(të zeza në sfond portokalli:numër ndarës '1.4' që mbush shumicën e gjysmës së sipërme; grupin e gjermave të pajtueshme të përshtatshme në gjysmën e poshtme; numrin 1 të vogël në fund të qoshes):	i rrezikuar nga eksplozionet, ndarja 1.4;
Nr. 1.5	(të zeza në sfond portokalli:numër ndarës '1.5' që mbush shumicën e gjysmës së sipërme; grupin e gjermave të pajtueshme 'D' në gjysmën e poshtme; numrin 1 të vogël në fund të qoshes):	i rrezikuar nga eksplozionet, ndarja 1.5;
Nr. 1.6	(të zeza në sfond portokalli:numër ndarës '1.5' që mbush shumicën e gjysmës së sipërme; grupin e gjermave të pajtueshme 'D' në gjysmën e poshtme; numrin 1 të vogël në fund të qoshes):	i rrezikuar nga eksplozionet, ndarja 1.6;
Nr. 01	(të zeza në sfond portokalli: shpërthim bombë në gjysmën e sipërme):	i rrezikuar nga eksplozionët
Nr.2	(cilindër gazi, i bardhë ose i zi, me sfond jeshil, numër i vogël "2" në fund të qoshes):	gaz jo-helmues jo i ndezshëm;
Nr.3	(flakë e zezë ose e bardhë në sfond të kuq):	i rrezikshëm nga zjarri (lëng i ndezshëm);
Nr. 4.1	(flakë e zezë në sfond prej rripash të alternuar të kuq dhe të bardhë (lëndë e ngurtë e ndezshme); në distancë të barabartë):	i rrezikshëm nga zjarri
Nr. 4.2	(flakë e zezë në sfond të bardhë, trekëndësh më i ulët i tabelës së kuqe):	lëndë e rrezikuar nga ndezje spontane);
Nr. 4.3	(flakë e zezë ose e bardhë në sfond blu):	rrezik nga rrezatimi i gazeve të ndezshëm në kontakt me ujin.
Nr. 5.1	(flakë sipër një rrethi, e zeze në sfond të verdhë, numër i vogël "5.1" në fund të qoshes):	lëndë oksigjenuese.
Nr. 5.2	(flakë sipër një rrethi, e zeze në sfond të verdhë, numër i vogël "5.2" në fund të qoshes)	peroksid organik, rrezik nga zjarri;
Nr. 05	(flakë sipër një rrethi, e zezë në sfond të Verdhë):	rrezik intesifikim-zjarri.
Nr. 6.1	(kafkë në kocka të kryqëzuara, e zezë	lëndë helmuese: të mbahet e

<p>në sfond të bardhë):</p> <p>përtej ngarkimit;</p> <p>Nr. 6.2 (simboli i tre gjysëmhenave të mbivendosura mbi një rreth):</p> <p>e ngarkimit, shkarkimit ose përtej ngarkimit, nga ushqimet, artikuj të tjerë të konsumit dhe ushqimet e kafshëve;</p> <p>Nr. 7A (trifil i stilizuar, i nënshkruar RADIOAKTIV pasuar nga një rrip vertikal në gjysmën e poshtme, me tekstin që vijon:</p> <p>Përmbajtja.....</p> <p>Aktiviteti.....</p> <p>numër i vogël 7 në fund të qoshes; dhe nënshkrimet në sfond të bardhë; rripa të kuq vertikalë):</p> <p>Nr. 7B (si më lart, por me dy rripa vertikale të kuq në gjysmën e poshtme dhe teksti që vijon: - E VERDHE; paketimet të ruhen larg nga paketimet</p> <p>Përmbajtja.....</p> <p>2711): në rast dëmtimi të Aktiviteti.....</p> <p>shëndetin nga thithja ose</p> <p>Indeksi i Transportit.....</p> <p>(në kuti drejtkëndore të rrethuar me të zezë)</p> <p>numër i vogël 7 në fund të qoshes; i zi dhe mbishkrimet; gjysma e sipërme e sfondit: e verdhë; gjysma e poshtme e sfondit: e bardhë; rripa të kuq vertikalë):</p> <p>Nr. 7C (si më lart, por me tre rripa të kuq</p> <p>vertikalë në gjysmën e poshtme):</p> <p>2711); në rast dëmtimi të paketimeve, rrezik për shëndetin nga thithja ose gëlltitja, prej, ose nga kontakti me përmbajtjen e derdhur, dhe rrezik i rrezatimit të jashtëm në distancë;</p> <p>Nr. 7D (trifil i stilizuar, mbishkrimi RADIOAKTIV, dhe shifra 7; simbol i zi dhe mbishkrimet; gjysma e sipërme e sfondit: e verdhë, gjysma e poshtme e sfondit: e bardhë. Përdorimi i fjalës "RADIOAKTIV" në gjysmën e poshtme është fakultativ për të lejuar përdorim alternativ të kësaj tabele, të paraqiti numrin e</p>	<p>veçuar nga ushqimet dhe artikujt e tjerë të konsumit në kamionat dhe në pikat e ngarkimit, shkarkimit ose</p> <p>infektiv:të mbahet veç në automjetet dhe në pikat</p> <p>material radioaktiv në paketime të Kategorisë I- E BARDHE; në rast të dëmtimit të paketimit, rrezik për shëndetin nga gëlltitja ose thithja ose kontakti me përmbajtjen e derdhur;</p> <p>që përmbajnë mbishkrimin "FOTO" (shiko anëshkrimin</p> <p>gëlltitja, ose kontakti me përmbajtjen e derdhur, dhe rrezik i rrezatimit të jashtëm simbol në distancë</p> <p>material radioaktiv në paketime të kategorise II - E VERDHE; paketimet të ruhen larg nga paketimet që përmbajnë mbishkrimin "FOTO" (shiko anëshkrimin</p> <p>material radioaktiv që paraqet rreziqet të përshkruara me 7A, 7B ose 7C;</p>
---	---

identifikimit të lëndës përkatëse për
 dërgesë):
 Nr.8 (lëng që pikon nga një tub-test mbi lëndë korrozive;
 Një pllakë nga një tjetër tub-test
 mbi një dorë; sfond i zi ose i bardhë,
 trekëndësh më i ulët i tabelës së zezë
 me një bordurë të bardhë):
 Nr. 9 (sfond i bardhë me 7 rripa vertikale artikuj dhe lëndë të
 në gjysmën e sipërme dhe shifër e përzierë, gjatë transportit,
 vogël 19, e nënvizuar, në fund të qoshes): rrezik i pranishëm ndryshe nga ato të
 trajtuara nga klasat e tjera;

Nr. 10 E Rezervuar.

Nr. 11 (dy shigjeta të zeza në sfond të bardhë kjo anë lart:
 ose me kontrast të përshtatshëm): tabelë për tu fiksuar, me
 shigjeta me tregim lart;
 Dispozita kalimtare.

Tabela të rrezikshmërisë të cilat deri në 31 Dhjetor 1998 në përputhje me modelet e
 përshkruara në këtë kohë, ndoshta të përdorura deri sa rezervat të jenë mbaruar.

3904-3905

TABELA TË RREZIKSHMERISE


Shtojca 9

Tabela të Rrezikshmërisë
 Për shpjegimin, shiko Shtojcën A.9 (anëshkrimet 3902)

- 1) Tregimi i numrit të duhur të ndarjes dhe grupi i gërmave korespondues
- 2) Tregimi i grupit të duhur korespondues të gërmave
- 3) Për dimensionët, shiko tabelën Nr.1

Tabela të Rrezikshmërisë





4)Për dimensiont, shiko tabelën 7A.

5)Dimensionet e tabelës që do të ngjitet tek paketimi mund të zvogëlohet në formatin A7 (74 X 105mm).